

# ENVER HOXHA

VEPRA

33



**PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT  
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË  
SHQIPËRISË



**ENVER HOXHA**



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

# ENVER HOXHA

VËLLIMI

33

QERSHOR 1966 – TETOR 1966

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË, 1981



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 33-TË

Në vëllimin e 33-të të Veprave të serisë të shokut Enver Hoxha përfshihen fjalime, diskutime, biseda e artikuj të periudhës qershor-tetor 1966.

Pjesa më e madhe e tyre botohen për herë të parë.

Këto materiale pasqyrojnë aktivitetin e gjithanshëm të Partisë në luftën që zhvillonte ajo në atë periudhë për të revolucionarizuar të gjithë jetën e vendit, për të mobilizuar masat punonjëse për realizimin e pesëvjeçarit të ri, për të shkuar me bilanc suksesesh në Kongresin e 5-të të Partisë, i cili po afronte.

Dokumentet e këtij vëllimi i përshkon, përveç të tjerash, ideja se është Partia ajo që bëri të mundur të realizohen aspiratat e popullit, prandaj gjithnjë vihen në plan të parë puna dhe kujdesi për forcimin e radhëve të saj. Një trajtim i veçantë i bëhet kësaj çështjeje në fjalën e mbajtur në Plenumin e 17-të të Komitetit Qendror «Disa probleme për revolucionarizimin e organizatave të Partisë» dhe në disa materiale të tjera, ku theksohet se e gjithë puna jonë duhet të synojë në forcimin e radhëve të Partisë, nëpërmjet zhvillimit të luftës së klasave.

Për të realizuar programin e saj madhështor Partia

jonë është mbështetur kurdoherë te masat. Te fjala e shokut Enver Hoxha para zgjedhësve «Në lidhjet me masat qëndron forca e Partisë dhe e pushtetit popullor» duket vlerësimi i lartë që u bën Partia masave punonjëse dhe kujdesi i saj i veçantë për t'i ruajtur të pastra e për t'i përsosur këto lidhje. «Lidhja e ngushtë me masat, dëgjimi i zërit të tyre, tërheqja aktive e masave në të gjithë jetën e vendit — thekson shoku Enver Hoxha — kanë qenë dhe janë vija, së cilës Partia jonë i është përmbajtur me rreptësi si gjatë Luftës Nacionalçlirimtare ashtu edhe gjatë punës për ndërtimin socialist të vendit».

Një vend të rëndësishëm në këtë vëllim zënë problemet e zhvillimit të ekonomisë socialiste. Te diskutimi në Byronë Politike «Njerëzit kaliten duke punuar» dhe te disa materiale të tjera ndihet preokupimi i madh i Partisë për mobilizimin e klasës punëtore e të fshatarësisë punonjëse për realizimin e planit të ri pesëvjeçar, i cili do të sillte rritjen e mirëqenies së popullit, forcimin e ekonomisë dhe të mbrojtjes. Ky plan, i hartuar nga masat sipas direktivave të Partisë, hapte perspektiva të mëdha; Partia shtronte çështjen se themelore për realizimin e tij ish-in mobilizimi i përgjithshëm i masave, vrulli i tyre revolucionar, mendimi krijues, ndjenja e sakrificës. «Ky mobilizim, ky patriotizëm dhe kjo frymë e lartë revolucionare që ekzistojnë në masat tona të popullit dhe të Partisë — thotë shoku Enver — të mos qëndrojnë në vend, po të vijnë duke u rritur, të bëhen një jetë e vërtetë për gjithë njerëzit tanë. Interesat e atdheut e kërkojnë të jemi vazhdimisht në këmbë, tepër të vëmendshëm». Dhe populli iu për-

gjigj kësaj detyre të lartë, duke mbajtur, si kurdoherë, në njërën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën.

Stadi i arritur në ndërtimin e socializmit kërkonte një nivel më të lartë në drejtimin e punës për zhvillimin e degëve të ndryshme të ekonomisë, të kulturës e të shkencës, prandaj Partia ka treguar një kujdes të veçantë për përgatitjen e kuadrit specialist, për kualifikimin e tij, e sidomos për arsimimin në masë të rinisë e të punonjësve. Në diskutimin «Sistemin arsimor ta përmirësojmë duke u bazuar në kritere shkencore» jepen ide e mësimë të çmuara, sipas të cilave u punua në vitet e mëvonshme për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë të re, që ajo t'u përgjigjej gjithnjë e më mirë nevojave të ndërtimit socialist.

Në këtë vëllim trajtohen gjerësisht edhe probleme të rëndësishme të situatës së jashtme dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Idetë se si duhet zhvilluar lufta e forcave marksiste-leniniste e revolucionare kundër imperializmit e revizionizmit modern në kushtet konkrete, përbëjnë një kontribut me vlerë historike për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit dhe për demaskimin e imperializmit, revizionizmit dhe të gjitha forcave të reaksionit.

Në bisedat e shokut Enver Hoxha me disa delegacione e ambasadorë të huaj ka ide, analiza e konkluzione të thella parimore që dëshmojnë për qëndrimin e vendosur të Partisë sonë në rrugën e drejtë revolucionare që zgjodhi ajo qysh me krijimin e saj, për guximin dhe mençurinë që e ka karakterizuar atë në të gjithë jetën e saj luftarake për të mbrojtur e zbatuar pa asnjë lëkundje marksizëm-leninizmin. Me një rëndësi të veçantë

janë materialet «Partia jonë do të vazhdojë si kurdoherë me konsekuencë, me trimëri e me pjekuri luftën e klasave», «Disa mendime paraprake për Revolucionin Kulturor Proletar kinez» etj., të cilat na njohin nga afër me luftën parimore që kishte nisur Partia jonë kundër një rryme të re të revizionizmit që po dukej në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, revizionizmit kinez.

Në këtë vëllim përfshihen edhe artikujt «Jugosllavia titiste në rrugëkryq» dhe «Kush përgjigjet për krimet e gjenocidit në Kosovë?», të cilët kanë një forcë të madhe demaskuese. Edhe pse janë shkruar para shumë vjetësh, ata tingëllojnë aktualë. Duke bërë fjalë për krimet e pashembullta që janë kryer në mënyrë sistematike mbi popullsinë shqiptare në Kosovë e në krahinat e tjera të Jugosllavisë, zbulohen shkaqet e vërteta dhe rrënjët e politikës barbare të udhëheqjes titiste jugosllave ndaj shqiptarëve dhe përgjegjësia e organeve të terrorit që veprojnë egërsisht e në mënyrë kriminale kundër popullsisë shqiptare në Kosovë.

Mësimet që nxjerrim nga materialet e këtij vëllimi të ri të Veprave të shokut Enver Hoxha i shërbejnë çdo komunisti, kuadri dhe çdo punonjësi në punën e tyre për të zbatuar direktivat e Partisë dhe për të punuar me frymë të lartë militantizmi në sektorët që u janë besuar.

# ORIENTIMI I PARTISË ËSHTË QË FSHATARËSIA TË LEHTËSOHET GJITHNJË E MË SHUMË NGA DETYRIMET

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

4 qershor 1966

Në relacionin e paraqitur bëhet propozimi që të mos u merret më detyrim në drithëra për tokat e kategorive të larta as atyre rretheve që u është marrë deri tani. Ne kemi përjashtuar nga detyrimi 12 rrethe të zonave malore dhe kufitare, se tokat e tyre i kemi konsideruar të dobëta, por për 14 rrethet e tjera le të diskutojmë, a është i bazuar propozimi që na bëhet?

Udhëheqjes i intereson të dijë si u diskutuan këto çështje në bazë? Mendimet kryesore në lidhje me ndryshimet që propozohen të bëhen u diskutuan ve-

---

<sup>1</sup> Në një nga pikat e rendit të ditës të kësaj mbledhjeje u diskutua mbi disa masa favorizuese për kooperativat bujqësore dhe për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të tyre me ndërmarrjet shtetërore dhe me kooperativat e konsumit.

tëm me të plotfuqishmit e grumbullimit apo u pyetën edhe kryetarët e kooperativave bujqësore, kryetarët e komiteteve ekzekutive, sekretarët e organizatave-bazë të Partisë, brigadierët e të tjerë? Në këtë relacion janë vënë vetëm ato që gjetët të arsyeshme apo edhe mendimet e bazës?

T'ua bëjmë të qartë njerëzve se ne luftojmë jo vetëm për përmirësimin e tokave të klasit të tretë dhe të katërt, por edhe për tokat e klasit të tetë në qoftë se do të kishte, për t'i bërë të klasave më të mira. Ky është orientimi ynë; të gjitha masat agroteknike dhe materiale që po merr shteti, si sigurimi i plehrave, kullimi dhe ujitja e tokave etj., këtu synojnë. Ne, pra, po ecim drejt përmirësimit të klasifikimit të tokave, domethënë orientimi i Partisë, për të cilin luftojmë, është të prodhojmë më shumë, në mënyrë që fshatarësia të vijë duke u lehtësuar gjithnjë nga detyrimet, që kjo të marrë kështu më shumë të ardhura. Edhe aktualisht, me gjithë këto që kemi bërë, detyrimi nuk i rëndon si përpara fshatarët, se prodhimi është rritur. Për sa i përket planit të detyrimeve, sidomos këta dy vjetët e fundit, rrethet po e realizojnë mirë, bile pa pasur nevojë fare për të deleguar.

Prandaj mendoj të mos lëvizim nga detyrimet që janë vendosur sipas klasifikimit ekzistues të tokave. Kur është bërë ky klasifikim janë marrë për bazë rendimentet dhe në përshtatje me to janë caktuar normat e detyrimit sipas kategorisë së tokës. Atëherë rendimenti ka qenë më i ulët nga ç'është sot dhe këto norma detyrimi janë quajtur të arsyeshme, po sot që

rendimenti ka ardhur duke u rritur si pasojë e përmirësimit të tokave nga ana e kooperativave bujqësore? Sigurisht që ne nuk jemi për ta rritur normën e detyrimit, por nuk më duket me vend as propozimi për ta ulur. Vetë fakti që mbahet e pandryshuar norma e detyrimit në drithëra në një kohë që është përmirësuar klasifikimi i tokave, është një lehtësi për fshatin. Shteti vazhdon t'u japë kooperativave bujqësore ndihmë që ato t'i përmirësojnë edhe më shumë tokat. Kjo sjell vetvetiu shtimin e prodhimit, gjë që gjithnjë e më shumë ndihmon që detyrimet të mos e rëndojnë fshatarësinë. Por, për disa fshatra që shihet se me të vërtetë prodhojnë në sasi të vogla, Qeveria mund ta shikojë gjendjen e tyre në mënyrë të veçantë dhe të vendosë t'ua ulë detyrimet ose t'i përjashtojë fare prej tyre.

Për tokat e reja jam dakord, ashtu siç propozohet, që t'i lëmë jashtë detyrimit. Aktualisht këto po hapen në zonat kodrinore e malore, prandaj duhet të përfshihen në kategorinë e tokave të atyre 12 rretheve që i kemi përjashtuar.

Lidhur me propozimet për heqjen e detyrimit në lesh vetëm për kooperativat bujqësore, jam dakord që kështu të bëhet. Ndërsa për detyrimin e mishit kam mendimin se nuk ka ardhur koha akoma t'i ulim normat e dorëzimit.

Krahas punës që do të bëhet për shtimin e prodhimit të mishit, të merren masa dhe medoemos të zgjidhet një herë e mirë çështja e prodhimit të peshkut. Kryetari i kooperativës bujqësore të Shalësit në Elbasan më ka thënë se asnjëri nuk interesohet për shfry-

tëzimin e liqeneve të Dumresë, kurse në atë zonë mund të prodhohen me dhjetëra e me dhjetëra kuintalë peshk. I njëjti fenomen ndodh edhe në rrethe të tjera. Kaq vjet kemi, shokë, që po flasim për këtë çështje dhe përsëri kjo nuk po vlerësohet si duhet. Duke mos prodhuar çdo vit peshk siç planifikohet, do të vijë një ditë që do të jemi ngushtë për mish.

Për çështjen e çmimit të blerjes së detyrimeve dhe të tepricave të drithit u dhanë disa mendime. Një mendim është për ta rritur çmimin e blerjes së tepricave, tjetri është për të mos e rritur se do të jetë e vështirë për ta ulur më vonë. Por, në rast se do të vijmë duke e shtuar prodhimin, nuk do të ketë ndonjë vështirësi për uljen e çmimeve. Ne e dimë mirë se janë prodhimi dhe vlera e tij ato që përcaktojnë çmimin. Po të ketë prodhim të bollshëm, çfarë do ta bëjë të gjithë grurin fshatari? Atëherë do t'i themi t'ia shesë shtetit me çmime diçka më të lira, sepse edhe shteti do t'i ulë çmimet e prodhimeve industriale që do të blejë fshati. Në rrugën që po ecim ne, me shtimin e prodhimit dhe me uljen e kostos së tij, çmimet do të ulen vetvetiu. Prandaj nuk e kuptoj përse nuk do të mund t'i ulim dot çmimet e tepricave kur të ketë prodhim më të madh?

Këtu duhet mbajtur parasysh edhe një fakt shumë i rëndësishëm. Krejt ndryshe ndodh në vendet kapitaliste ku fshatarësia paguan shumë shtrenjtë për qiranë e tokës, për shërbimin mjekësor, për shkollat e për shumë gjëra të tjera, ndërsa fshatarësia jonë ka lehtësi të mëdha në të gjitha këto shërbime, të domosdoshme për jetën. Me çmimet e blerjes nga



shteti të produkteve bujqësore ne e inkurajojmë fshatarin të mbjellë më shumë drithë dhe produkte të tjera bujqësore dhe të rritë prodhimin. Kur të prodhojmë sasi më të mëdha drithi, do të importojmë më pak. Atëherë vetvetiu edhe gruri ynë do të shitet më lirë në treg.

Lidhur me bluarjen e drithit është i drejtë propozimi që ujemi i blojës të hiqet si për mullinjtë e kooperativave bujqësore, ashtu edhe për ata të shtetit. Nuk është nevoja të merret drithë për shërbimin e bluarjes. Kush bluan në mulli, të paguajë para.

Çështja e drithërave në kooperativat bujqësore, dhënia, marrja, përdorimi, janë të organizuara, të kontrolluara dhe të drejtuara. Ne e dimë se fshatarësia jonë nuk spekulon as nuk fsheh bereqet. Pra, edhe sikur të mos i paguajnë SMT-të në natyrë, nuk do të na spekulojë në bukë fshatarësia. Ajo edhe tani ia dorëzon shtetit rregullisht tepricat. Pastaj ne kemi interes që fshatari të marrë edhe ca të holla që të blejë disa artikuj për të cilët ka nevojë, se nganjëherë ai mund të jetë ngushtë për para. Tani gjendja, organizimi dhe fryma janë të tillë që ne mund të marrim më shumë teprica. Masat që po marrim, do të jenë një nxitje për fshatarësinë.

Ne themi se duhet ta nxitim fshatarin për mbjelljen e drithit, kurse në marrëdhëniet që ekzistojnë midis kooperativave bujqësore dhe SMT-ve kjo nuk del. Tarifat e SMT-ve për punimin e tokave që do të mbillen me drithë janë më të larta se për ato që do të mbillen me pambuk. Kjo ndodh se gjer tani ne i kemi favorizuar bimët industriale, kurse tani e tutje

punimet e SMT-së është më e arsyeshme të paguhen njëlloj si për këto, edhe për drithërat. Kooperativistët e kanë ngritur këtë çështje, pse të ketë dy tarifa për punimet e SMT-së? Po t'i duket i rëndë fshatarësisë çmimi i punimeve të SMT-së, atëherë këtë gjë duhet ta mendojmë që ta përcaktojmë më drejt.

Në qoftë se do t'i barazojmë, kjo do të thotë që në të dy rastet të ketë një çmim të caktuar. Këtu më duket se nuk ka ndonjë vështirësi, sepse për punën që do të bëjë SMT-ja, për njërin prodhim e paguan në natyrë dhe për tjetrin, me të holla. Është çështje tjetër që barazimi duhet të bëhet në lekë, jo në drithë.

Në qoftë se pranojmë këtë variant, për punën që do të kryejë SMT-ja në tokat e mbjella me drithë, kooperativa bujqësore do të paguajë në natyrë, por në këtë rast të krijohet një çmim i ri mesatar që për drithin e dorëzuar SMT-ja t'i japë kooperativës edhe ca para, në mënyrë që tarifa për tokat e mbjella me drithë të barazohet me tarifën për tokat e mbjella me pambuk. Diferenca mund të kompensohet edhe nëpërmjet rregullimit të çmimit të blerjes. Kështu prodhuesi i drithit do të shohë se çmimi për punimin e tokave të drithit është ulur, do të shohë këtu një interes ekonomik, të cilin e do, prandaj ka më shumë interes që tokën t'ia punojë SMT-ja.

Mendoj që ne të ruajmë ujemin e SMT-së siç ka qenë deri tani, në natyrë, edhe për tokat e kategorisë së katërt, të pestë e të gjashtë. Për sa i përket pagës në të holla për sasinë e drithit që kooperativat paguajnë më tepër, të bëhet korigjimi, duke caktuar një çmim që të barazohet me bimët industriale.

Për të gjitha propozimet që bëhen lidhur me disa ndryshime në çmimet e blerjes së prodhimeve bujqësore e blegtorale jemi dakord.

Në material bëhet fjalë edhe për disa ndryshime në tatimin mbi të ardhurat e kooperativave bujqësore. Mund të ishte e kohës të vendosnim që kooperativave bujqësore të zonave kodrinore e malore t'u fallet detyrimi për pesë vjet, pastaj prapë e shikojmë këtë çështje.

Një masë favorizuese për kooperativat bujqësore është edhe përmirësimi i marrëdhënieve të tyre me kooperativat e konsumit dhe me ndërmarrjet ekonomike. Lëndët e ndërtimit vërtet janë deficitare, por po nuk pati dyqani i kooperativës së konsumit edhe ca spango, litar, xhama etj., atëherë ku do t'i blejë fshatari këto?

Kisha një vërejtje edhe për mënyrën e shitjes së makinave qepëse. Ne nuk kemi aq makina qepëse sa t'i plotësojmë të gjitha kërkesat, prandaj mendoj se ato duhet t'i shiten kolektivit, të bëhen pronë e kooperativës bujqësore. Të blejë makinë qepëse një individ në kushtet e tanishme është luks, sepse ai e shfrytëzon shumë pak, kurse kur këto i blen kooperativa për të krijuar një repart rrobaqepësie, dhe jo vetëm për të qepur, por edhe për të arnuar, ne lehtësojmë, në radhë të parë, nga një barrë e madhe gratë. Disa gjëra të tilla mendoj se duhen parë më me kujdes.

Mund të shikohet gjithashtu edhe çështja e baxhove, si është më mirë, t'i ketë kooperativa bujqësore apo kooperativa e konsumit? Kooperativa bujqësore, siç më thanë në Shalës të Elbasanit, ka leverdi ta për-

punojë qumështin vetë, se shfrytëzon hirrën e djathit, për të ushqyer me të derrat. Pse, më siguri kemi tek ata dy vetat që ka vënë konsumi në baxho, apo kur ia lëmë këtë gjë në dorë tërë fshatit? Shqipëria përpara nuk ka pasur baxho si këto të sotmet, por barinjtë e bënin vetë djathin dhe aq të mirë sa edhe kanë eksportuar gjer në Amerikë. Kur një kooperativë bujqësore ka mjaft tufa, si të mos e përpunojë vetë qumështin? Të gjithë të ne dinë të bëjnë djathë, aq më tepër që kooperativa bujqësore do të caktojë në baxhot specialistë ose zanatçinj që u vjen për dore.

Për çështjet që diskutuam, do të marrim vendimet përkatëse, por ato duhet t'i shoqërojmë edhe me masa organizative për të siguruar zbatimin e tyre.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**NE KURRË NUK LEJOJMË TË MERREN NËPËR  
KËMBË LIRIA DHE PAVARËSIA E ATDHEUT,  
NDERI DHE DINJITETI I POPULLIT**

*Nga biseda në takimin me ambasadorin e jashtëzakonshëm dhe fuqiptotë të Republikës Algjeriane Demokratike dhe Popullore*

**13 qershor 1966**

*Pasi u përshëndet me ambasadorin, fjalën e mori shoku Enver Hoxha:*

Mirë se erdhët në vendin tonë, shoku ambasador i Republikës Algjeriane Demokratike dhe Popullore. Për popullin algjerian ne ushqejmë ndjenja të sinqerta e të përzemërta, sepse ai ka një histori të pasur dhe heroike, ai ka vuajtur dhe ka luftuar si populli ynë.

Ne kemi ndjekur me admirim luftën e popullit tuaj për çlirim dhe ju themi sinqerisht se populli shqiptar ka qenë në çdo rast solidar me çështjen tuaj të drejtë. Partia jonë ka bërë çmos që në Shqipëri të njihen çdo ditë e më mirë drejtësia e luftës së popullit tuaj, forca e tij luftarake. Ne gëzohemi shumë kur dëgjojmë se Algjeria lufton për forcimin e pava-

rësisë së vet politike dhe ekonomike dhe për zhvillimin e saj kombëtar.

Shqiptarët nuk i kanë fshehur kurrë mendimet e tyre. Ne çdo gjë e kemi thënë kurdoherë hapur dhe në mënyrë të sqartë. Vendimet tona nuk janë marrë lehtëzi, përkundrazi, jemi matur mirë, duke u nisur nga parimi që një popull nuk duhet as të shpejtohet as të futet në aventura, por as edhe të gjunjëzohet. Prandaj jemi menduar thellë për të marrë vendime të drejta, kemi marrë parasysh se ato edhe mund të na kushtonin shtrenjtë, të kërkonin sakrifica e mundime, por, pavarësisht nga këto, me parimet ne nuk kemi luajtur dhe nuk kemi lejuar që të merren nëpër këmbë liria dhe pavarësia e atdheut, nderi dhe dinjiteti i popullit. Në botë kemi shumë miq, po edhe armiq të shumtë e të egër. Por nga armiqtë ne nuk kemi frikë. Ata na kanë bërë gjithnjë të këqija, nuk ia kanë dashur kurrë të mirën popullit shqiptar. Të tillë janë tani edhe revizionistët modernë me ata sovjetikë në krye. Ne kemi qëndruar shumë të durueshëm, shumë gjakftohtë ndaj qëndrimeve të tyre si përpara ashtu edhe tani. Edhe tradhtarin Tito në fillim nuk e njihnim, se ai hiqej si komunist. Tradhtinë e tij e kemi mësuar më vonë, dhe e mësuaam jo nga fjalët, por nga veprimet dhe nga qëndrimet e tij antimarksiste e armiqësore. Atëherë ne e goditëm ashpër e pa mëshirë atë dhe politikën e tij tradhtarë. Kështu do t'i luftojmë gjer në fund të gjithë armiqtë e popujve e të revolucionit, të hapët apo të maskuar qofshin ata, dhe jemi të sigurt se do të fitojmë.

Gjithashtu kur zbuluam lojën e tradhtarit Hrushov dhe të pasuesve të tij që maskoheshin me autoritetin e Partisë së Leninit e të Stalinit, ose të Dimitrovit apo të Gotvaldit, kur Hrushovi e hrushovianët në praktikë treguan se ç'qenë, ne ua përplasëm të vërtetën në fytyrë dhe kështu do të veprojmë gjer në fund me këta renegatë, sepse kanë tradhtuar çështjen e popujve të tyre, çështjen e përbashkët të të gjithë popujve, çështjen e popullit tonë, i cili, megjithëse i vogël, sot lufton me të gjitha forcat për çështjen e drejtë të marksizëm-leninizmit, të popujve, të revolucionit.

Eksperiencia e luftës me këta tradhtarë na dha një mësim të madh të hidhur, prandaj tani jemi në gjendje të njohim më mirë miqtë dhe armiqtë, të dallojmë çfarë fshihet nën fjalët e fryra dhe bombastike dhe të vlerësojmë sinqeritetin e fjalëve të thjeshta që mund të dalin nga thellësia e zemrës. Nga ata që kanë tradhtuar revolucionin dhe popujt e tyre ne kemi nxjerrë shumë mësim, i shikojmë me urrejtje dhe u themi miqve të kenë mendjen se ata luajnë me interesat e popujve, prandaj nuk duhen përkrahur në rrugën e tyre të ndyrë, përkundrazi duhen luftuar e duhen demaskuar gjer në fund.

Njerëzit e ndershëm duhet t'i njohin mirë tradhtarët dhe të gjithë armiqtë dhe në luftën kundër tyre të mbështeten si kurdoherë në popull, pse te populli qëndron forca jonë.

Ne kemi ndjekur parimin: Kur je në vështirësi, sado të mëdha e të padurueshme të jenë ato, shko

te populli, kërko përkrahjen e tij dhe ai do të të ndihmojë me të gjitha forcat, kur të shikojë se lufton për çështjen e tij të madhe.

Ne luftuam kundër pushtuesve e tradhtarëve dhe i mundëm se patëm gjithë mbështetjen e popullit, që ishte i etur për liri, pavarësi dhe për një jetë më të mirë. Ai ka luftuar gjatë gjithë jetës kundër pushtuesve të ndryshëm dhe ka qenë pikërisht kjo luftë e pandërprerë për lirinë dhe pavarësinë e vendit që bëri të mundur ta mbante kurdoherë gjallë, trim e të pamposhtur popullin tonë, të cilin sot edhe armët më moderne nuk do ta nënshtrojnë dot. Ne i dërrmuam pushtuesit e huaj, ashtu sikundër i mundët ju kolonizatorët e egër dhe me shumë eksperiencë francezë, të cilët i shkaktuan kaq mjerime dhe fatkeqësi popullit algjerian. Ne fituam mbi fashizmin italian dhe hitlerian që kishte pushtuar vendin tonë dhe bëmë njëkohësisht një luftë të ashpër, të pamëshirshme, gjer në fund, kundër gjithë tradhtarëve të vendit, bashkëpunëtorë të pushtuesve. Këto fitore i arritëm sepse patëm me vete popullin, luftuam për interesat e tij, për çështjen e tij të madhe. Në këtë rrugë kemi ecur, ecim e do të ecim kurdoherë.

Ka dhe nga ata që mendojnë se janë gjeni, se gjoja idetë që pjell koka e tyre e bëjnë historinë, por ne u themi atyre se ata janë njerëz pa kurrfarë gjenialiteti, sepse ata nuk kanë kuptuar gjënë më kryesore, madhështinë dhe gjenialitetin e popullit si krijuesi i vërtetë i historisë. Me idetë e tyre të gabuara, të tillë ideologë mund t'i çoroditin dhe ta frenojnë



për një moment lëvizjen e masave, ndaj kundër armiqve të tillë duhet luftuar me të gjitha forcat. Të tillë janë edhe revizionistët modernë. Me fjalë ata thonë shumë gjëra, duket sikur janë të gatshëm ta shfarosin menjëherë imperializmin amerikan, francez etj., etj., por ata nuk janë veçse shërbëtorë të këtyre imperialistëve, ato që thonë janë vetëm fjalë boshe, janë maska për të mbuluar tradhtinë dhe veprimtarinë e tyre armiqësore.

Këtë e kanë provuar ngjarjet, po, për fat të mirë, te ne manovrat e komplotet e tyre nuk kanë pasur sukses, se populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, e ka fituar pavarësinë dhe lirinë me armë në dorë dhe nuk mund të gënjëhet nga armiqtë e popujve. Kjo është shumë e rëndësishme. Mund të ketë në procesin e zhvillimit botëror momente të vështira, por një popull që ka luftuar dhe ka derdhur gjak, që është i ndërgjegjshëm për misionin e tij, nuk mund të nënshtrohet as të gënjëhet nga ata që nuk janë në rrugë të drejtë e që nuk sillen në mënyrë të sigurtë ndaj tij. Liria te ne ka kushtuar shumë dhe kur liria paguhet me gjak, atë nuk duhet t'ia besosh ujëve, siç thotë populli ynë.

Ju e dini mirë se revizionistët dhe imperialistët ne na godasin me të gjitha mjetet, çfarë nuk thonë ata kundër nesh, po kjo ne as na ka trembur e as nuk na tremb. Armiqtë tanë nuk janë veçse klika, ndërsa miqtë tanë dhe ata që janë dakord me luftën tonë janë më të shumtë në botë, me ne janë popujt, se ne luftojmë për të drejtën, për socializmin, për një të ardhme të lumtur e të begatshme.

Imperialistët dhe revizionistët thonë se janë për

paqen, por në realitet ata janë për luftën agresive, për shtypjen e popujve. Ujku qengj nuk bëhet, ai mund të ndërrojë lëkurën, po kurrë natyrën e tij. Fjalët e tyre nuk na gënjejnë, sepse ne nuk i vlerësojmë njerëzit e qeveritë nga fjalët, por nga veprat, nga qëndrimet që mbajnë, nga politika që ndjekin. Ne as kemi qenë dhe as jemi për një paqe të rreme; ne jemi për një paqe për të cilën kanë luftuar e luftojnë popujt, për atë paqe kur s'do të ketë më shtypës e shfrytëzues. Për një paqe të tillë jemi dhe do të jemi gjer në fund.

Ne jemi të gëzuar që qeveria juaj ju dërgoi ju në Shqipëri si ambasador. Lidhjet dhe marrëdhëniet e popullit tonë me tuajin janë të lashta. Edhe ne kemi në vendin tuaj një ambasador, i cili na vë në dijeni për dashurinë e singertë që populli juaj ka për Shqipërinë. Kjo na gëzon dhe na inkurajon në punën tonë, pse nuk ka gjë më të madhe se miqësia e singertë në mes popujve.

Miqësia e singertë nuk kërkon në çdo rast fjalë të mira. Është e mundur ndonjëherë që në mënyrë të singertë të mos jesh dakord me mikun për këtë ose për atë çështje. Mik i mirë është ai që ta thotë të vërtetën në sy dhe jo ai që të bën lajka. Populli ynë thotë një fjalë të urtë: «Mos ki shumë besim te lajkaxhiu». Ka gjëra që ne i shohim nga një pikëpamje, kurse dikush tjetër i sheh ndryshe. Pikëpamje të ndryshme mund të ketë jo vetëm midis dy popujve, po edhe midis dy vëllezërve. Por kjo s'do të thotë që ne të mbylлим gojën e të mos i shprehim hapur pikëpamjet tona, pavarësisht nëse u pëlqen apo s'u pëlqen kjo të tjerëve. Secili ka politikën e vet; kokën e ka mbi shpatulla dhe

është përgjegjës për të ardhmen e popullit të vet, sikurse edhe ne jemi përgjegjës për popullin tonë.

Ne po ndërtojmë me sukses socializmin në vendin tonë. Në punën tonë ndërtimore ne u ndihmuam nga Stalini, nga populli sovjetik në momentet më të vështira, kur porsa dolëm nga lufta. Megjithatë populli, puna dhe lufta e tij kanë qenë dhe janë faktorët kryesorë. Ç'mund të ishte ndihma sovjetike përpara punës së madhe revolucionare të popullit tonë? Hrushovi na akuzonte se ne nuk flisnim sa duhet për ndihmat sovjetike. Ne flisnim edhe për këto ndihma, po realiteti është se këto përfaqësonin vetëm një përqindje të vogël në krahasim me gjithë punën që bëhej në atë kohë në vendin tonë për ndërtimin e socializmit. Ne e kemi çmuar dhe e çmojmë edhe ndihmën që na jep Kina popullore, po edhe kjo as është e as mund të jetë vendimtare dhe kaq e rëndësishme sa është forca e popullit. Pra forca e popullit, puna e tij e madhe, janë faktorët vendimtarë për zhvillimin ekonomik e kulturor të çdo vendi. Kjo do të thotë që çdo vend duhet të mbështetet në forcat e veta, në forcat e vetë popullit. E tillë ka qenë dhe është rruga jonë.

Populli juaj ka një forcë të madhe krijuese. Algjerianët kanë bërë gjëra të mëdha, por për fat të keq kanë qenë imperialistët ata që i kanë përvetësuar frytet e krijimtarisë së popullit tuaj. Ata thonë se populli algjerian është «analfabet», «i prapambetur» etj. Kështu kanë thënë ata edhe për popullin shqiptar. Por si populli algjerian, ashtu edhe populli shqiptar, nuk kanë lindur të prapambetur e analfabetë, të tillë popujt tanë i kishin bërë armiqtë e jashtëm e të brendshëm. Ato

kohë tani për ne kanë përfunduar. Siç e patë edhe vetë gjatë vizitave në Shqipëri, populli ynë, me Partinë në krye, pasi i dha fund pushtetit të shtypjes e të shfrytëzimit, është hedhur në punën ndërtimtare. Me tërë gjenialitetin e vet ai i dha shqelmin analfabetizmit, mjerrimit dhe varfërisë. Kështu gjendja e prapambetur i përket së kaluarës. Me këtë nuk dua të them se ne tashtë kemi arritur gjithçka. Jo, ne kemi akoma shumë vështirësi e mungesa, po rëndësi të madhe ka ajo që fituam dhe që na siguron të ardhmen. Populli tani ka Partinë, që e zgjoi, i zhvilloi ndërgjegjen, e edukoi dhe tani e di ku shkon dhe ku do të shkojë nën udhëheqjen e saj. Kjo është fitorja më e madhe, mendojmë ne.

Uniteti i popullit gjithashtu ka rëndësi të madhe. E dini ç'thoshin reaksionarët për popullin tonë? «Shqiptarët, thoshin, janë si lepujt, nuk mund të bashkohen». Kjo ishte e logjikshme për ta, dhe ata punonin që populli të ishte kurdoherë i përçarë, se në këtë mënyrë donin të përjetësonin sundimin e tyre. Po erdhi koha që ata panë se shqiptarët u bashkuan rreth Partisë me një forcë të madhe, gjë që u solli armiqve katastrofën përfundimtare. Ata gjithmonë na janë sjellë vërdallë rreth e përqark si ujë, por e dinë se e kanë «kufirin të thana», se populli ynë u ka thënë dhe u thotë të mos e kalojnë kufirin se i pret vdekja. Vite me radhë fqinjët tanë, të nxitur nga imperialistët e miqtë e tyre, bënë çmos që të mos na linin rehat, po tani ka kohë që janë qetësuar, jo se na duan të mirën, po e shohin se është e rrezikshme ndjekja më tej e një veprimtarie

të tillë kundër vendit tonë. Ata e dinë tashmë se populli shqiptar nuk merret dot nëpër këmbë.

Ne edhe tani kemi përsëri pengesa e vështirësi, bile jo të pakta. Ne ndodhemi të rrethuar nga armiq të egër e të regjur, por uniteti i hekurt i popullit rreth Partisë është më i fortë se kurrë. Këtë unitet e kemi forcuar e do ta forcojmë pa ndërprerje, sepse ai është garanci e sigurt për arritjen e çdo sukcesi dhe për kapërcimin e çdo rreziku.

Të jeni të sigurt, shoku ambasador, se te populli shqiptar do të keni kurdoherë një mik të sinqertë, se ne nga ana jonë marrëdhëniet tona do të përpiqemi t'i zhvillojmë vetëm e vetëm nga dëshira për forcimin e miqësisë, hapur dhe pa asnjë paramendim, në interes të popujve e të vendeve tona.

*Botohet sipas shënimeve të  
mbajtura në këtë takim që  
gjenden në Arkivin Qendror  
të Partisë*

# **SOCIALIZMI KËRKON NJERËZ TË ZHDËRVJELLËT, TË FORTË FIZIKISHT DHE TË PASTËR MORALISHT**

*Nga biseda me delegacionin e kooperativave të konsumit  
dhe me atë të atletëve kinezë*

**14 qershor 1966**

*Pasi u përshëndet me mysafirët, fjalën e mori  
shoku Enver Hoxha:*

Gjatë vizitave që bëtë nëpër vendin tonë ju u takuat me popullin, me të rinj dhe me komunistë.

Miqësia e popullit shqiptar me popullin kinez frymëzohet nga marksizëm-leninizmi, të cilit ne i përmbahemi fort. Idetë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe të Stalinit janë për ne flamur që na udhëheq pa gabime në rrugën tonë të revolucionit dhe të socializmit. Detyra e Partisë, e popullit dhe e rinisë së vendit tonë është që këto ide t'i përvetësojnë dhe t'i zbatojnë sa më mirë, në mënyrë revolucionare. Puna e madhe që bëhet te ne në këtë drejtim është e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme, sepse ka për qëllim t'i kalitë njerëzit tanë.

Forca e Partisë sonë qëndron në idetë e mëdha të klasikëve të marksizëm-leninizmit, në parimet e drejta revolucionare dhe në politikën e drejtë marksiste-leniniste. Vetëm të udhëhequra e të frymëzuara nga këto ide partitë marksiste-leniniste mund të bëjnë revolucionin dhe të ndërtojnë socializmin, të ndihmojnë popujt që luftojnë kundër imperializmit dhe të mposhtin imperializmin dhe revizionizmin modern. Prandaj ato kanë rëndësi të madhe jetike për të ardhmen e popujve.

Çdo gjëje duhet t'i vëmë rëndësi por, në radhë të parë, t'u vëmë rëndësi politikës dhe ideologjisë; në prizmin e tyre duhet të shohim e të zgjidhim çdo problem të ekonomisë, tregtisë, kulturës, sportit etj.

Disa sportin e nënvleftësojnë, por edhe kjo fushë e aktivitetit njerëzor ka shumë rëndësi, sepse ne duam të kemi njerëz të zhdërvjellët, të zotë fizikisht, të pastër moralisht që të bëhen luftëtarë të aftë për të kapërcyer çdo vështirësi që kemi dhe mund të kemi në të ardhmen. Prandaj Partia jonë i kushton vëmendje sportit, ashtu si edhe sektorëve të tjerë. Të gjithë sektorët së bashku janë të nevojshëm, por gjithsecili ka rëndësinë e vet. Në sistemin tonë socialist kemi të bëjmë me një zhvillim të gjithanshëm, i cili ka për qëllim që të mosshuarit të rinohen dhe të rinjtë të mbeten kurdoherë të rinj, të mos plaken as fizikisht as shpirtërisht. Socializmi na kërkon të gjithë ushtarë dhe që të jemi të tillë, duhet të ngrihemi jo vetëm politikisht e ideologjikisht, por edhe të kalitemi fizikisht. Prandaj sporti duhet të jetë një veprimtari e domosdoshme jo vetëm për të rinjtë, por për të gjithë.

*Duke iu drejtuar përfaqësuesve kinezë të kooperativave të konsumit, shoku Enver Hoxha tha:*

Në qendër të tij, ligji themelor i socializmit ka plotësimin e nevojave gjithnjë në rritje të masave punonjëse. Kjo kërkon nga ne të prodhojmë sa më shumë dhe me cilësi të lartë, që ta furnizojmë popullin rregullisht e sa më mirë. Për këtë arsye i kemi vënë rëndësi të madhe edhe tregtisë socialiste, si asaj shtetërore dhe asaj kooperativiste. Duke marrë në duart e shtetit të diktaturës së proletariatit këtë forcë ekonomike që e kishin më përpara në duart e tyre klasat shfrytëzuese, ne zhdukëm çdo bazë për spekulim mbi kurrizin e masave punonjëse. Ky është një sukses i madh që bën pjesë në revolucionin tonë socialist.

Kooperativat e konsumit që kemi organizuar po luajnë një rol të madh në marrëdhëniet fshat-qytet, në ngushtimin e dallimeve midis tyre. Prandaj sa më mirë që t'i shërbejnë popullit këto, sa më të lidhura të jenë me të, sa më tepër të jenë nën kontroll, aq më mirë dhe aq më drejt shpërndahen të mirat materiale. Kështu, eliminohet spekulimi dhe elementët e vjetër spekulantë, që kanë tendencë të infiltrohen në radhët tona. Bashkë me ta, eliminohen gjithashtu edhe elementët e rinj spekulantë që lindin, në rast se mungojnë vigjilenca dhe kontrolli i masave.

Organizimi dhe mobilizimi i të gjitha mjeteve materiale, që ato të përdoren në interes të popullit, mbeten detyra të përhershme për ne. Nëpërmjet tyre ne duhet të tërheqim më mirë iniciativat e mëdha të masave për të shfrytëzuar plotësisht mjetet materiale,



njerëzore etj. Në këto drejtime kaq të rëndësishme ne kemi akoma shumë për të bërë.

Dëgjova se gjatë vizitave i keni lavdëruar shokët tanë, por ne do të dëshironim që atyre t'u bënit edhe kritika. Marksizëm-leninizmi na mëson që asgjë të mos i shpëtojë kritikës, se kjo duhet zhvilluar kudo ku duken dobësi dhe jo vetëm brendapërbrenda, por edhe në rrethin e miqve dhe të vëllezërve. Prandaj edhe ju duhet të na bëni vërejtje kur vini re të meta e dobësi. Nga kritikrat dashamirëse popullit dhe Partisë sonë nuk u vjen kurrë keq, ashtu sikundër nuk duhet t'ju vijë keq as juve kur ne ju bëjmë ndonjë kritikë për ndonjë të metë që mund të keni, sepse e dimë që kritika dhe autokritika janë armë të fuqishme për zgjidhjen e kontradiktave joantagoniste dhe që na ndihmojnë të ecim përpara. Prandaj mos u kurseni të na kritikoni, sepse në këtë mënyrë do të na ndihmoni të përmirësojmë punën tonë. Ja, për shembull, sporti te ne është akoma i ri, vetëm tani ai është duke u bërë masiv. Prandaj në këtë sektor kemi shumë për të bërë, sidomos në atletikë dhe në not, ku ju jeni shumë përpara. Unë kam parë pingpongistët kinezë që luajnë shumë bukur dhe me shkathtësi të madhe.

Partia jonë i ka kushtuar një rëndësi të veçantë rritjes së cilësisë sportive në atletikë e në not dhe në ekipet e djemve kemi arritur disa rezultate. Por na mbetet akoma shumë për të bërë sidomos me ekipet e vajzave, për të cilat Partia interesohet shumë. Ajo kërkon që gruaja të dalë kudo në jetë e jo vetëm në punë, por edhe në art, në kulturë, në sport etj.

Cilësia në sport nuk mund të rritet pa masivizimin

e tij. Megjithëse Shqipëria ka det dhe lumenj, noti është akoma prapa. Prandaj tani i kemi vënë detyrë organizatës së rinisë që si në zonat bregdetare edhe pranë liqeneve e lumenjve të rinjtë të mësojnë notin. Kjo është e domosdoshme si për kalitjen e tyre fizike, ashtu edhe për nevojat e mbrojtjes, në mënyrë që, sido që të vijë puna, ata të mos kenë frikë nga ujërat e lumenjve, as në verë dhe as në dimër. Te ne në verë bëhet një propagandë më e gjerë për këtë çështje. Bashkimet Profesionale dhe Bashkimi i Rinisë organizojnë qendra dhe shtëpi pushimi jo vetëm për çlodhjen e punonjësve, të rinisë e të pionierëve, por edhe për të zhvilluar sa më shumë sportin e notit.

Zhvillimi e masivizimi i sportit që tani kanë marrë hov të madh te ne, kombinohen edhe me punën fizike të të rinjve. Me mbarimin e vitit shkollor të rinjtë dhe të rejat shkojnë nëpër aksione, ku, krahas punës fizike, zhvillojnë edhe aktivitete të shumta e të larmishme sportive. Kjo dhe të gjitha masat e tjera që ka marrë dhe do të marrë Partia kanë bërë e do të bëjnë që gjithnjë e më shumë të rriten dëshira dhe numri i njerëzve që merren me sport. Garanci edhe për këtë është vija jonë e drejtë marksiste-leniniste.

*Duke e marrë fjalën gjatë bisedës, anëtarët e delegacionit kinez, pasi vlerësuan përparimet dhe sukseset e arritura në sport në vendin tonë, shprehën gëzimin e madh që iu dha rasti të takohen me shokun Enver Hoxha dhe të dëgjojnë bisedën e tij plot frymëzim për ta.*

*Shoku Enver Hoxha, pasi falënderoi mysafirët dhe ngriti një dollë për shëndetin e tyre, ndër të tjera tha:*

Unë ju siguroj përsëri se te populli shqiptar, te njerëzit dhe rinia shqiptare, te punonjësit tanë të kooperativave të konsumit dhe atletët shqiptarë, ju do të keni miqtë dhe vëllezërit tuaj më të ngushtë.

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim që gjenden në AQP*

# VETËM MBI BAZËN E MARKSIZËM-LENINIZMIT ZHVILLOHET E THELLOHET REVOLUCIONI SOCIALIST NË TË GJITHA FUSHAT

*Nga biseda me delegacionin e punonjësve  
kinezë të bujqësisë*

**14 qershor 1966**

*Pasi u përshëndet me mysafirët kinezë, shoku Enver Hoxha i pyeti ata për përshtypjet që kishin për bujqësinë në vendin tonë. Në fjalën që thanë mysafirët shprehën përshtypjet e tyre të mira për çka panë në vendin tonë, sidomos për shtimin e prodhimit bujqësor e blegtoral, për zgjerimin e mekanizimit të punimeve bujqësore, për forcimin e kooperativave bujqësore, për rritjen e nivelit të të ardhurave të kooperativistëve dhe të jetesës së tyre dhe për frymën e lartë revolucionare që karakterizon masat punonjëse të vendit tonë. Ata thanë se kudo në Shqipëri iu rezervua një pritje e ngrohtë, e në mënyrë të veçantë theksuan pritjen shumë të përzemërt që u bëri shoku Enver Hoxha. Pastaj shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Ju i vlerësuar shumë sukseset që janë arritur te ne dhe sidomos punën e kooperativistëve tanë. Naty-

risht, në krahasim me të kaluarën në bujqësi janë bërë përparime të mëdha. Por këto nuk na dehin, sepse në këtë sektor kemi akoma shumë për të bërë, sidomos në drejtim të shfrytëzimit më racional të pasurisë së përbashkët dhe të zbatimit të agroteknikës.

Të shikojmë, për shembull, çështjen e shfrytëzimit të tokës që është një pasuri e madhe. Në krahasim me të kaluarën sipërfaqja e punueshme e saj është rritur mjaft, megjithatë akoma ka mundësi të hapen toka të reja jo vetëm nëpër kodra dhe në lartësi më të mëdha, por edhe në zona fushore. Neve na duhet të bëjmë shumë edhe për të ndrequr përpjesëtimet midis llojeve të bimëve dhe midis bujqësisë e blegtorisë. Këto përpjesëtime dhe kombinimi i degëve të ndryshme të ekonomisë kanë ecur më mirë në ndërmarrjet bujqësore sesa në kooperativat bujqësore, ku akoma ekziston një zhvillim, si të thuash ekstensiv, sidomos i blegtorisë. Akoma nuk janë sistemuar dhe nuk janë përcaktuar si duhet tokat sipas kërkesave që kanë bimët e ndryshme bujqësore si dhe nuk është përcaktuar se çfarë lloj kafshësh janë më rentabël për ekonominë kolektive socialiste dhe cilat më të përshtatshme për oborret e vogla kooperativiste.

Rëndësi të veçantë për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë kanë shfrytëzimi në maksimum i agroteknikës, i plehrave organike dhe kimike, i kanaleve ujitëse, i mënyrave më racionale për përdorimin e tyre, që ju të gjithë, si specialistë të bujqësisë, i dini më mirë. Lufta që kemi zhvilluar e zhvillojmë në këtë drejtim ka bërë që të rrënjoset te të gjithë një kuptim i drejtë për agroteknikën dhe vëmë re se çdo vit e

më shumë shtohet interesimi i punonjësve të bujqësisë, dëshira e zjarrtë për ta kuptuar dhe për ta vënë atë në zbatim. Por me gjithë sukseset e arritura, e themi me ndërgjegje se jemi akoma larg shfrytëzimit në shkallë të gjerë të agroteknikës.

Zhvillimi me të vërtetë socialist i bujqësisë nuk mund të bëhet pa ngritjen e mëtejshme të nivelit ideologjik dhe politik të fshatarësisë sonë, në radhët e së cilës ekzistojnë shfaqje mikroborgjeze të pronës dhe ku mbeturinat idealiste e bestytnitë e trashëguara nga e kaluara në ndërgjegjen e njerëzve janë më të theksuara. Ngritja ideologjike bën të mundur që fshatarësia kooperativiste ta konsiderojë pronën kolektive si të vetmen bazë të ekonomisë e të mirëqenies, kurse pronën e vogël të oborrit kooperativist si një gjë të përkohshme, vetëm si një mjet ndihmës për plotësimin e disa nevojave, të cilat në të ardhmen do t'i përballojë ekonomia socialiste.

Por a është ngritur ndërgjegjja e fshatarëve tanë në atë nivel që vetë ata ta braktisin qysh tani oborrin kooperativist? Jo! Në punën e fshatarësisë sonë kooperativiste vihen re akoma të mëta, sidomos në drejtim të shfrytëzimit të kohës së punës dhe të rritjes së rendimenteve. Prandaj Partia jonë bën një punë intensive të vazhdueshme politike e ideologjike që kooperativisti të mendojë jo vetëm për veten e vet, por për gjithë zhvillimin ekonomik të kooperativës dhe të vendit. Puna e Partisë në këtë drejtim shoqërohet edhe me rritjen më tej të ndihmës së qytetit, të klasës punëtore dhe të shtetit të diktaturës së proletariatit ndaj fshatarësisë kooperativiste, ndihmë të

cilën e kërkon zhvillimi i pandërprerë e në të gjitha drejtimet i fshatit tonë socialist.

Për Partinë tonë çështja e bujqësisë dhe e zhvillimit socialist të saj ka një rëndësi të dorës së parë, sepse shumica e popullsisë të ne është fshatare dhe merret me bujqësi e me blegtori. Ne kemi një fshatarësi revolucionare, patriote, e cila ka qenë baza kryesore e Luftës sonë Nacionalçlirimtare. Ajo pranoi pa hezitim vijën e Partisë, e kuptoi drejt aleancën me klasën punëtore dhe u vu nën udhëheqjen e saj. Edhe pas Çlirimit fshatarësia jonë vazhdimisht i ka kuptuar drejt dhe i ka zbatuar me entuziazëm orientimet e Partisë. Është fakt që në fshat qoftë për realizimin e Reformës Agrare, qoftë për kolektivizimin, i cili u bë me maturi dhe me shumë kujdes, nuk pati ndonjë moskuptim ose ndonjë rezistencë. Duke zhvilluar bujqësinë në rrugën socialiste, duke e bërë atë më të përparuar e më rentabël, ne shkojmë drejt ngritjes së mëtejshme të nivelit material e kulturor të fshatarësisë. Krahas me rritjen e mirëqenies së saj në kuptimin marksist-leninist të fjalës, Partia i kushton kujdes të veçantë edhe rrënjosjes dhe kalitjes së ndërgjegjes socialiste.

Zhvillimi i fshatit në vendin tonë nuk është kudo njëjloj, si në fushat ashtu edhe në zonat kodrinore e sidomos në ato malore. Ne kemi kooperativa bujqësore të forta e të mesme ekonomikisht, por kemi edhe të dobëta. Një gjendje e tillë, në qoftë se nuk tregohet kujdes, është me pasoja. Partia interesohet për përparimin e vazhdueshëm të kooperativave të forta të fushës, por njëkohësisht kujdesohet që ky zhvillim

ekonomik të mos prekë frymën revolucionare në punë dhe në mendime të fshatarësisë, sepse ka rrezik që nën flamurin e zhvillimit socialist të na krijohet një shtresë fshatarësh kooperativistë, të cilët të mendojnë vetëm për vete. Ne luftojmë që në fshatin tonë të shfrytëzohet çdo mundësi dhe të krijohen pasuri të reja gjithnjë më të mëdha, por ky zhvillim të ndihet në të gjitha kooperativat, duke përfshirë edhe kooperativat malore dhe ato akoma të dobëta. Prandaj e mbajmë gjallë në të gjithë fshatarësinë tonë frymën e lartë të solidaritetit revolucionar. Për këtë kemi gjetur edhe forma bashkëpunimi të ngushtë, vëllazëror socialist, në mes kooperativave të forta ekonomikisht, që kanë marrë një zhvillim të mirë për arsye të kushteve materiale të tokës dhe të investimeve që ka bërë shteti ynë socialist, dhe kooperativave bujqësore që akoma s'e kanë atë zhvillim. Këto forma mbështeten në parimet e ndihmës reciproke socialiste.

Në rrethin e Korçës, që vizituar ju, disa kooperativa fushore kanë marrë iniciativën të ndihmojnë kooperativat malore me krahë pune e me kafshë, si dhe me mjete teknike, pavarësisht se ato ndodhen larg tyre. Puna dhe lufta do të na mësojnë për lidhje më të frytshme, për një kooperim socialist midis kooperativave të zonave fushore me ato malore. Kjo do të bëjë të mundur që e gjithë fshatarësia jonë të kuptojë se ndihma e madhe që i është dhënë dhe do të vazhdojë t'i jepet këtej e tutje në një shkallë akoma më të gjerë nga shteti, është një ndihmë socialiste që nuk synon të përmirësojë vetëm jetën e kooperativave fushore, por edhe të atyre kodrinore e malore, ngritjen



e përgjithshme të të gjithë bujqësisë së vendit tonë dhe se për këtë qëllim duhet të kontribuojnë jo vetëm shteti ynë socialist, por edhe vetë kooperativat bujqësore më të përparuara. Prandaj po përpiqemi ta kombinojmë sa më mirë këtë ndihmë të përgjithshme në drejtim të bujqësisë dhe është fakt që në këtë zhvillim që ka marrë ajo ndihet se ekziston një frymë e lartë solidariteti revolucionar.

Kështu ndodh në vendin tonë, ndërsa në vendet revizioniste, largimi nga rruga socialiste e zhvillimit e ka katandisur bujqësinë në një gjendje të mjeruar. Le të shohim konkretisht rrugën e zhvillimit dhe gjendjen e bujqësisë në dy vende revizioniste, në Bashkimin Sovjetik dhe në Jugosllavinë titiste. Në këto dy vende, ku sundojnë hrushovianët dhe titistët, bujqësia u zhvillua në rrugë të ndryshme. Titistët, për shembull, rrugën e kolektivizimit të bujqësisë e braktisën me kohë. Edhe ato të pakta zadruga që u ngritën fill pas çlirimit u prishën. Bujqësia jugosllave qëndroi në dy forma: në formën e fermave shtetërore, e cila, natyrisht, shërbente si mbështetja kryesore e regjimit shtetëror, dhe në formën e pronës së vogël private. Të dyja këto forma u zhvilluan plotësisht në rrugën kapitaliste, por sidomos forma private e pronës fshatare mori që në fillim tiparet e bujqësisë kapitaliste, që çonte në varfërimin e mëtejshëm të fshatarësisë së varfër e të mesme dhe në forcimin e pasurimit e mëtejshëm të kulakëve. Këta të fundit tani dominojnë plotësisht në bujqësinë jugosllave.

Pra, tradhtarët jugosllavë e futën bujqësinë në rrugën kapitaliste pa përdorur fare maska socialiste,

kurse në Bashkimin Sovjetik është vërtetuar e kundërta. Atje në kohën e Stalinit u realizua kolektivizimi i bujqësisë me një luftë të ashpër klasore. Të gjithë e dimë se si pushteti sovjetik, duke u mbështetur në fshatarësinë e varfër, në aleancë me fshatarësinë e mesme dhe me klasën punëtore në krye, e dërrmoi kulakërinë. Por, siç dihet, më vonë e morën fuqinë në dorë revizionistët modernë. Ky është një fenomen i ri, pasi në Bashkimin Sovjetik nuk e morën fuqinë kulakët e vjetër, por të rinjtë, revizionistët modernë, domethënë njerëzit jo me origjinë kulake, por elementë me origjinë punëtorë ose fshatarë të varfër apo të mesëm, që kishin përçafuar ideologjinë e kulakëve dhe të borgjezisë. Ky fenomen, natyrisht, nuk ndodhi menjëherë, por ndoqi një proces, që ishte një proces regresiv. Ai u ndihmua nga shumë rrethana, të cilat nuk mund t'i analizojmë këtu, por e vërteta është se ky proces mori formën e degjenerimit kapitalist pas vdekjes së Stalinit, kur revizionistët morën fuqinë në dorë.

Hrushovi, qysh në fillim, nën flamurin e socializmit, ndërmoi një varg veprimesh për krijimin dhe për zhvillimin e kësaj shtrese të re kulakësh në sektorin e bujqësisë sovjetike. Revizionistët, duke nxitur dhe duke forcuar ndjenjat e pronës së vogël private që ekzistonin si mbeturina të së kaluarës në ndërgjegjen e fshatarësisë kolkoziane, arritën që t'i zhvillojnë këto pak nga pak, në mënyrë jo të bujshme, duke filluar nga kopshtet personale dhe duke arritur deri te kolkozet milionerë. Pastaj Hrushovi mori masa për likuidimin e SMT-ve, për shitjen e mjeteve të mekani-

kës bujqësore kolkozeve të pasura që kishin para, të cilave shteti u jep jo vetëm traktorë, por edhe kredi.

Këto dhe masa të tjera që po marrin revizionistët sovjetikë kanë bërë që bujqësia sovjetike nga socialiste që ishte në kohën e Stalinit të shndërrohet në një bujqësi kapitaliste të një shteti borgjez. Ky proces tani duket fare qartë.

Kjo përvojë e hidhur na bën të mendojmë thellë për çështjen e zhvillimit të bujqësisë sonë socialiste. Dhe ne kemi nxjerrë e do të nxjerrim mësim serioze për të forcuar luftën tonë politike dhe ideologjike, për t'i shkukur nga rrënjët ndjenjat e pronës private dhe mbeturinat e ideologjisë kapitaliste, të cilat ekzistojnë akoma jo vetëm në masën e kooperativistëve, por edhe në disa komunistë. Organizata e Partisë në fshat vërtet përbëhet nga fshatarë që janë më të përparuar, por edhe tek ata ekziston rreziku i këtyre mbeturinave. Prandaj Partia shtron me forcë domosdoshmërinë e kalitjes së vazhdueshme politike dhe ideologjike të komunistëve dhe të fshatarësisë kooperativiste në përgjithësi, sepse vetëm kështu sigurohet zhvillimi i bujqësisë në rrugën socialiste.

Tani në Kinë po zhvillohet një revolucion në fushën e kulturës. Mao Ce Duni ka shpallur se qëllimi i këtij revolucioni është që të zhduken nga rrënjët ideologjia borgjeze kapitaliste, mbeturinat e klasës së përmbysur në ideologji, në kulturë e arsim, që njerëzit në Kinë të rriten e të edukohen me idetë marksiste-leniniste të proletariatit, me një moral të lartë proletar. Arritja e objektivave që i ka vënë vetes ky revo-

lucion do të ketë rëndësi historike jo vetëm për Kinën, por për gjithë lëvizjen marksiste-leniniste<sup>1</sup>.

Në vendin tonë, nën udhëheqjen e Partisë dhe me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të klasës punëtore dhe të masave punonjëse, prej kohësh, po zhvillohet e po thellohet revolucioni si në frontin politik e ekonomik, ashtu edhe në atë ideologjik e kulturor. Çdo parti marksiste-leniniste në pushtet e ka të domosdoshme të marrë masa në drejtim të kulturës dhe të ideologjisë, të zhvillojë e të thellojë pa ndërprerje revolucionin kulturor, që është vazhdimi i revolucionit proletar në frontin ideologjik. Kjo ka të bëjë me edukimin ideologjik e kulturor të masave të gjera punonjëse, sepse kultura e vërtetë socialiste nuk është pronë vetëm e disave, sepse jo vetëm disa duhet të dinë, kurse të tjerët të bëjnë si të thotë «i dituri» dhe të mos mendojnë me kokën e tyre. Vija e çdo partie mbështetet në përvojën kolektive të proletariatit, në luftën revolucionare të tij, që e kanë përpunuar shkencërisht mësuesit tanë të mëdhenj Marks, Engels, Lenini dhe Stalini. Vija e drejtë e çdo partie është dhe duhet të jetë pronë e të gjitha masave, të cilat duhet ta mbrojnë e ta përdorin drejt në mënyrë krijuese e jo si

---

1 Në fillim Partia jonë e mbështeti Revolucionin Kulturor të Kinës për objektivat revolucionarë që shpalli. Por, duke e parë këtë revolucion në proces, ajo arriti në konkluzionin se ai nuk zhvillohej në bazë të mësimeve të marksizëm-leninizmit. Mbi të gjitha Partia Komuniste e Kinës nuk ishte në udhëheqje të tij. Koha provoi se ky revolucion, siç vuri në dukje më vonë shoku Enver Hoxha, nuk ishte as revolucion, as i madh, as kulturor, as proletar.

automat. Revolucioni Kulturor te ju ka për qëllim të rivendosë e të konsolidojë pushtetin proletar, i cili, me aq sa dimë, është dëmtuar rëndë dhe është rrezikuar seriozisht të binte tërësisht në duart e armiqve të brendshëm, revizionistëve modernë, elementëve të borgjezisë, të kapitalistëve, të feudalëve që, siç po dëgjojmë, ishin infiltruar dinakërisht në radhët e Partisë Komuniste të Kinës dhe të organeve shtetërore, në radhët e shkollave të larta dhe të shtypit kinez. Një gjë e tillë as ka ndodhur dhe as do të ndodhë kurrë te ne, sepse vija e drejtë, marksiste-leniniste e revolucionare e Partisë sonë nuk ka lejuar asnjëherë që armiqtë e jashtëm e të brendshëm dhe ideologjia e tyre të zënë vend në radhët tona e të na rrezikojnë. Kjo nuk do të thotë se te ne s'janë bërë edhe gabime. Çështja qëndron në faktin se ne nuk kemi lejuar që këto gabime të trashen e të mbulohen për një kohë të gjatë, por i kemi goditur menjëherë dhe, ndaj atyre që i kanë bërë gabimet me qëllime të caktuara, siç janë elementët tradhtarë e revizionistë, pasi u është çjerrë maska, janë marrë masa të rrepta, të drejta, revolucionare.

Edhe te ne, në etapa të ndryshme, armiqtë e klases dhe të Partisë janë përpjekur ta devijonin Partinë nga vija e drejtë marksiste-leniniste, ta futnin atë në vështirësi. Por ajo i ka zbuluar ata kurdoherë, ka mobilizuar e udhëhequr masat e gjera të popullit dhe u ka dhënë armiqve grushtin që meritonin. Kjo dhe besnikëria e zbatimi me konsekuencë i marksizëm-leninizmit nga Partia jonë kanë bërë të mundur që revolucioni socialist në Shqipëri të mos ndalet për

asnjë çast, por të thellohet dhe të zhvillohet me sukses në të gjitha fushat.

Ardhja në fuqi e armiqve të infiltruar në aparatet shtetëror dhe në radhët e Partisë Komuniste të Kinës e të udhëheqjes së saj do të ishte një fitore e madhe për imperialistët e revizionistët dhe një humbje kolosale për popullin kinez, për partinë tuaj dhe për gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare, prandaj Partia jonë do ta përkrahë këtë revolucion që ai të zhvillohet në rrugën marksiste-leniniste, sepse ecja e Kinës në këtë rrugë është një fitore e madhe për socializmin dhe komunizmin në të gjithë botën dhe për luftën tonë kundër imperializmit me atë amerikan në krye e kundër revizionistëve modernë me revizionistët sovjetikë në krye.

Edhe ju po bëni luftë për të kapërcyer vështirësitë që ju kanë shkaktuar në bujqësi revizionistët sovjetikë, imperialistët e ndryshëm me ata amerikanë në krye, revizionistët e brendshëm dhe fatkeqësitë e natyrës.

Puna dhe lufta e partive marksiste-leniniste dhe eksperiencia e proletariatit ndërkombëtar kanë provuar dhe na kanë rrënjësuar bindjen se mbi bazën e marksizëm-leninizmit nuk ka vështirësi që të mos kapërcëhet. Vetëm besnikëria ndaj mësimëve të marksizëm-leninizmit dhe zbatimi i tyre me konsekuencë, me siguri do të bëjë të mundur që kjo luftë e vështirë të kurorëzohet me sukses.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

## NJERËZIT KALITEN DUKE PUNUAR

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

16 qershor 1966

Për këtë çështje mendoj të procedojmë kështu: në fillim mund të bëhen pyetjet, pastaj t'ia japim fjalën shokut Koleka dhe, si ta shikojmë, mund të diskutojmë në disa seanca.

*Pasi u bënë një varg pyetjesh nga shoku Enver Hoxha dhe nga shokë të tjerë të Byrosë Politike, të cilave iu përgjigjën përkatësisht ministrat, që ishin ftuar, shoku Enver Hoxha tha:*

Në shpjegimet e tjera që do të na jepni nuk është nevoja të na përsëritni shifrat, po na thoni mendimin tuaj lidhur me këto që ka paraqitur Komisioni i Planit të Shtetit, me cilat prej tyre jeni dakord dhe me cilat jo. Nuk është e thënë që një shok të mund

---

1 Në datat 15, 16 dhe 22 qershor 1966 u bë mbledhja e Byrosë Politike të KQ të PPSH, e cila diskutoi rreth projektdirektivave të planit të pesëvjeçarit të katërt (1966-1970) që do t'i paraqiteshin për aprovim Kongresit të 5-të të Partisë.

të japë përgjigje menjëherë për çdo gjë që kërkohet, sepse mund t'i duhet kohë për të bërë edhe llogaritë. Për propozimet që u bënë dhe do të bëhen, mendoj t'u lëmë këtyre shokëve 4-5 ditë kohë t'i studiojnë, se ato duhet të shihen me kujdes, dhe pastaj të vendosim definitivisht.

Ne mbase kemi dëshirë të shtojmë akoma mjaft gjëra të tjera në këtë plan, po duhet të kemi parasysh të ruheni nga investimet e mëdha që janë jashtë mundësive tona, prandaj, para se të shtojmë diçka, ta gjykojmë mirë, brenda mundësive financiare dhe ekonomike që kemi, në radhë të parë duke u bazuar në frymën revolucionare dhe në sakrificat që duhet të bëjmë. Si ta kemi bërë këtë, atëherë mund të shtojmë ndonjë gjë të re mbi këto që parashikon ky projekt.

Nuk dëshiroj të futem në detaje, por mendoj se disa gjëra, para se të vendosim, duhen parë më mirë. Çështjen e zgjerimit të uzinës mekanike në Patos mund t'ia lëmë në dorë Qeverisë për ta studiuar edhe një herë. Po të jetë e nevojshme, të parashikohet zgjerimi i saj, në mos po të hiqet nga plani.

Jam dakord me propozimet që bëhen për prodhimin e disa makinerive dhe të veglave të punës, për zgjerimin e Uzinës së Gozhdëve dhe Bulonave në Kavajë, si dhe për ta hequr nga ky plan parashikimin për zgjerimin e uzinave mekanike të Korçës dhe të Vlorës. Për sa i përket prodhimit të drapërinjve dhe të kosave, specialistët tanë duhet të bëjnë më tepër përpjekje, se këto vegla janë të domosdoshme për bujqësinë. Po të jetë nevoja mund të impor-



tojmë edhe ndonjë gjë të vogël që mund të duhet për të rritur prodhimin e tyre.

Për pllakat e zdrukthit dhe prodhimet e tjera të kësaj natyre më duket se ka konservatorizëm. Kemi kohë që themi se këto materiale mund të përdoren në ndërtimet për të zëvendësuar një pjesë të lëndëve të tjera, por nuk po shohim të bëhet gjë.

Lidhur me prodhimin e karton katramatit më duket se nuk është i drejtë mendimi se duhet ndërtuar një fabrikë tjetër e madhe. Për këtë mund të jenë të mjaftueshme disa pajisje të thjeshta që mund të sjellim për zgjerimin e fabrikës që kemi, prandaj jam i mendimit që të rishikohet edhe një herë kjo çështje.

Ndërtimi i hidrocentraleve në fshatra duhet parë mirë, në mënyrë që këto të kenë një shpërndarje më të drejtë. Të mos ndërtohen vetëm në zonat më të zhvilluara, por edhe në ato fshatra ku ka ekzistuar errësira shekullore.

Lidhur me mbjelljen e bimëve të arave në zonat e mbjella me ullinj dhe me pemë, mund të pranohet më propozimin që na është paraqitur. Tokat e mbjella me ullinj fillojnë nga prodhimi pas 15-16 vjetësh, prandaj gjatë kësaj periudhe ato mund të mbillen fare mirë me bimë të tjera. Në rast se tokat me ullinj do të mbillen, atyre do t'u hidhet edhe pleh dhe ky do të ndihmojë edhe për ullirin.

Në qoftë se tokat me foragjere i mbjellim me bimë prashitëse të kemi parasysht edhe shërbimet më të mëdha që duhet të bëjmë.

Për sa u përket strukturës së ndërtimeve dhe investimeve mendoj të shikohen edhe një herë nga Kë-

shilli i Ministrave, duke pasur parasysh që nga ndërtimet socialkulturore, banesat etj. dhe nga investimet joprodhuese të planifikohen ato që janë më të nevojshme.

Në qoftë se e gjujkojmë që hekurudha Rrogozhinë-Fier është e nevojshme, mendoj që të ndërtohet. Kurse asfaltimi i rrugës Rrogozhinë-Fier mund të mos bëhet para se të ndërtohet traseja e hekurudhës. Jam i mendimit gjithashtu të asfaltohet rruga Korçë-Bilisht, sepse kjo ka rëndësi edhe nga ana politike, edhe prodhime mund të tërhiqen më shumë nga ajo zonë.

Është e nevojshme të rishikohen edhe investimet që parashikohen për ujitjen e fushës së Korçës. Mos është më mirë që këto investime të bëhen gjatë, pse ka rrethe të tjera që kanë nevojë më tepër se Korça? Sipas mendimit tim, në caktimin e investimeve për ujitjen duhet të kemi parasysh dy gjëra: nga njëra anë, të rritim prodhimin dhe, nga ana tjetër, të ruajmë njëfarë proporcioni midis rretheve. Unë kam qenë dakord për ujitjen e fushës së Korçës, por edhe ndërmarrja e kësaj veprë duhet gjykuar në këtë frymë.

Përdorimi i pompave më duket se duhet të jetë më ekonomik se sa ndërtimi i hauzeve dhe i rezervuarëve, prandaj të bëhen llogaritë dhe, atje ku ka leverdi, investimet që parashikohen për rezervuarët të përdoren për pompa e motopompa, kurse rezervuarët të ndërtohen aty ku gjykohet se janë më të nevojshëm. Fshatarësia ka eksperiencë në këtë punë, kështu që ajo mund t'i ndërtojë vetë veprat e vogla të ujitjes,

në qoftë se rrethet do të mund të ndihmohen duke u dhënë disa gjeometra dhe materiale ndërtimi. Nga ana tjetër, të kihet parasysh që të shfrytëzohen, sa të jetë e mundur më shumë, traktorë DT-54.

Mendoj që sasinë e mallrave që janë parashikuar të sillen nga importi të mos e ulim, kurse sa do të shpërndajmë është çështje tjetër.

Për gjimnazet, jam i mendimit që të mos hapim të reja, por edhe që t'i kthejmë 14 shkolla në teknikume, siç parashikohet, as kjo tani nuk mund të bëhet, sepse do të na duhen një numër i madh inxhinierësh e teknikësh për të dhënë mësim, prandaj them që kjo çështje mund të shikohet më mirë. Ne të hapim teknikume aq sa na lejojnë mundësitë.

Lidhur me materialin e paraqitur kam edhe një mendim: ne drejt u kemi rënë në kokë disa sëmundjeve të rrezikshme, një nga të cilat është edhe burokratizmi, por lufta kundër tij nuk ka mbaruar, prandaj vazhdimisht duhet të bëjmë përpjekje të mëdha në këtë drejtim. E them këtë sepse, sipas mendimit tim, udhëheqja akoma vazhdon të merret edhe me disa gjëra të vogla, që nuk i përkasin asaj. Kjo vjen, midis të tjerash, për arsye se ne nuk i mësojmë të tjerët si të punojnë dhe nuk i vëmë përpara përgjegjësi kur nuk i realizojnë detyrat. Dihet se udhëheqjes i dalin përpara probleme të mëdha dhe praktika tregon se, që të reflektosh thellë mbi ato, duhet mjaft kohë. Por, në qoftë se ne do të merremi edhe me gjëra të vogla që u përkasin shkallëzimeve përkatëse, nuk do t'i zgjidhim dot në kohë dhe si duhet problemet që na preokupojnë në tërësinë dhe në the-

llësinë e tyre, do t'i shqyrtojmë ato në mënyrë jo të pjekur dhe, si pasojë, edhe masat që do të merren nuk do të jenë të efektshme.

Të marrim çështjen e hapjes së tokave të reja. Jam dakord me shifrën e parashikuar në projektplan. Këtu nuk shtrohet problemi nëse kemi apo jo toka të tjera për të hapur, sepse, siç e thanë të gjithë shokët, ne kemi me mijëra hektarë, por problem shumë i madh për ne është që këta mijëra hektarë t'i hapim dhe t'i vëmë menjëherë në shfrytëzim, t'i bëjmë rentabël. Një tjetër problem është edhe çështja e perspektivës, ku do të arrijmë ne me hapjen e tokave të reja. Kjo na ngarkon detyrën të studiojmë e të caktojmë me kujdes, së pari, ku do t'i hapim këto toka. Sigurisht do të synohet të hapen atje ku janë më të mira, po mund të na dalë që atje ku këto janë të tilla, të mos ketë fare njerëz, të mos ketë kafshë e mjete pune, mirëpo këta janë faktorë shumë të rëndësishëm për realizimin e kësaj detyre, prandaj, krahas studimit për të përcaktuar ku do të hapen tokat e reja, duhet të studiojmë gjithashtu edhe shpërndarjen e popullsisë. Kur them kemi njerëz apo jo në ato zona, problemi nuk zgjidhet vetëm duke ndjekur politikën e dërgimit të njerëzve nga qyteti në fshat. Natyrisht, edhe këtë do ta bëjmë, por që ta zgjidhim në tërësi drejt këtë problem, duhet të shohim demografinë jo vetëm si zhvillohet, por edhe si e kemi të shpërndarë popullsinë aktualisht në vendin tonë. Realiteti është që fshatrat tona sot janë këto që janë, të grumbulluara rreth disa tokave;

shtrirja e tyre ka qenë përcaktuar nga interesa ekonomike private dhe nga shumë interesa të tjera shoqërore të kohëve kur është zhvilluar kjo shtrirje.

Problemin e shpërndarjes së popullsisë ne duhet ta zgjidhim në perspektivë, jo vetëm për qytetet, po edhe për fshatrat, duke i balancuar forcat me kujdes. Në rast se ne do të bëjmë një studim perspektiv, ka për të na dalë se pas një periudhe, si rezultat i rritjes natyrore të popullsisë, do të ketë më shumë njerëz nga sa janë sot. Ne duhet të mendojmë e të punojmë me perspektivë që këtë shtesë natyrore të popullsisë ta lëvizim dhe të mundim të krijojmë kështu një hartë të re të shpërndarjes së popullsisë së vendit tonë, në bazë të nevojave që do të na nxjerrë ndërtimi socialist i bujqësisë dhe, krahas kësaj, të përqendrojmë edhe mjetet materiale në këtë drejtim. Natyrisht, kjo punë nuk bëhet dot menjëherë, po edhe nuk duhet të presim sa të bëhet studimi, pastaj të veprojmë. Ne duhet të veprojmë menjëherë, po edhe studimi të bëhet.

Ne kemi dërguar edhe më parë njerëz nga qyteti në fshat dhe këtë nuk e kemi parë si një problem të veçantë për të shfryrë qytetet, por sepse e kërkonin situatat dhe nevojat që na kanë dalë. Ky problem qëndron edhe për të ardhmen, por duhet të studiohet në mënyrë të gjithanshme. Kështu, kur t'i japim porosi qytetit të Tiranës, për shembull, që brenda kaq kohe duhet të dërgojë në fshat kaq familje ose kaq të rinj e të reja të pamartuara, të bëhen mirë llogaritë ç'masa duhen marrë që të realizohet kjo detyrë, se ka edhe vështirësi. Njerëzit nuk i bind dot vetëm me

një fjalë. Duhet studiuar patjetër edhe metoda e punës, ç'mjete materiale u duhen dhënë si ndihmë atyre që do të shkojnë në fshat, në mënyrë që, kur të venë atje ku do të punojnë, të kenë mundësi të jetojnë në kushte normale. Ata vërtet marrin përsipër sakrifica, por kanë nevojë edhe për ndihmë e përkrahje. Çështja është që çdo gjë të bëhet mirë dhe e studiuar.

Lidhur me këtë duhet të kemi parasysh edhe anën e ndërjegjes së njerëzve, të sentimenteve, të lidhjeve të tyre familjare etj., që janë probleme mjaft të koklavitura. Të gjitha vështirësitë që dalin ne duhet t'i kapërcejmë, por natyrisht kjo punë nuk bëhet dot menjëherë, prandaj duhet të ketë një orientim të studiuar me kujdes për këtë qëllim. Ne kemi edhe një plus që, kur Partia bën një thirrje, njerëzit tanë ngrihen të gjithë në këmbë dhe i përgjigjen thirrjes.

Pra është e domosdoshme të edukohen njerëzit me këtë frymë që kërkon Partia, të mësohen ata që të punojnë me një metodë pune me perspektivë të gjerrë e me shpirt revolucionar, të cilin tani jo se nuk e kanë, po nuk e vënë në veprim si duhet, për zhvillimin e shpejtë e të shumanshëm të ekonomisë bujqësore.

Tani vihet pyetja: i kemi penguar ne njerëzit tanë që të mendojnë? Jo, nuk i kemi penguar, po puna është se nuk kemi ditur t'i mësojmë që të mbajnë mbi supet e tyre përgjegjësi joburokratike, po përgjegjësi të tilla me sakrifica të shumanshme që të jenë në gjendje të bëjnë punë me të vërtetë krijuese.

Ne vëmë detyrën që të rriten rendimentet dhe nuk mund të imagjinojmë që gjithë këta punonjës dhe specialistët që kanë 10-12 e më shumë vjet stazh

pune në këtë fushë, të mos e njohin agroteknikën. Edhe sikur të mos e njihnin, e kanë mësuar, sepse këtij çekani Partia i ka rënë shumë herë, prandaj duhet dhe ne do të bëjmë hapa përpara.

Ne jo vetëm me diskutime, po me përpjekje e me punë konkrete të kapërcejmë vështirësitë, t'i mësojmë njerëzit se si, duke djersitur e duke punuar pa u lodhur, të marrin që tani nga 30 kuintalë drithë për hektar. Të gjithë duhet të vrasim mendjen për të realizuar çdo detyrë dhe të mos shkojmë nga pikëpamja «të marrim sa të marrim» dhe me kaq të kënaqemi, të flemë mendjen. Pra çdo gjë të arrihet me punë, me përpjekje dhe jo ndryshe.

Duke e parë çështjen në këtë frymë, edhe plehun kimik duhet ta administrojmë mirë, por të mos lihet pas dore plehu organik. Sigurimi i plehut kimik duhet të mos ulë luftën, përpjekjet dhe hovin revolucionar të punonjësve të bujqësisë, të mos errësojë domosdoshmërinë për t'u hedhur bimëve në sasinë e duhur edhe pleh organik, ose ta nënvleftësojnë këtë lloj plehu, duke menduar se tani do të kemi me bollëk pleh kimik. E them këtë se ekziston ky rrezik. Çdo gjë, pra, të realizohet me punë, me marrjen e masave të shumanshme, duke shfrytëzuar në radhë të parë në maksimum gjithë plehun organik që kemi, pastaj, si të jenë bërë të gjitha këto, atëherë t'i hidhet bimës edhe plehu kimik, me kujdes dhe në dozat e nevojshme. Gjersa ne u themi kooperativistëve t'ia hedhin çdo bimë me masë e me kujdes plehun organik, aq më shumë ekonomi duhet të administrohet plehu kimik.

Të marrim një problem tjetër, atë të përgatitjes së kuadrit. Kur vihet detyra që uzinat të punojnë me turne, disa herë na thuhet: «S'kemi teknikë dhe specialistë të mesëm» dhe kjo çështje na paraqitet sikur problemi del për herë të parë. E vërteta është që kjo çështje është ngritur edhe përpara, edhe plane janë bërë për këtë, por nuk është zgjidhur plotësisht, vetëm për fajin tonë. Ne nuk e kemi organizuar mirë punën me vajzat dhe me djemtë e rinj që kanë mbaruar shkolla ose jo, që t'i përgatitnim për të marrë menjëherë në dorë tornot e reja që na kanë ardhur e për t'i vënë ato në punë. Në këtë drejtim është vepruar ngadalë. Çështjen e kam që, kur studiojmë një problem, këtë punë ta bëjmë mirë, të caktojmë detyra të qarta dhe të parashikojmë edhe masat që duhen për t'i zbatuar ato, në mënyrë që problemin udhëheqja ta konsiderojë të mbyllur, për pesë vjet, ta zëmë. Kjo kërkon që problemi, si nga Partia ashtu edhe nga aparatet e shtetit, të zbërthehet me rigozitet. Nuk ka asnjë arsye përse të na silltet këtu, në Byronë Politike, ky problem i pastudiuar. Pra, më parë të studiohet sa njerëz duhen në bazë të fronteve të punës, pastaj të merren masa që direktivat e Partisë të zbatohen plotësisht.

Na paraqitet përsëri për diskutim problemi i domateve të hershme për eksport. Po përse të na vijë këtu kjo çështje vazhdimisht? Kiço Ngjela<sup>1</sup> duhet të

---

<sup>1</sup> Ish-ministër i Tregtisë. Më vonë u shkarkua nga kjo detyrë, u përjashtua nga Partia dhe u dënua për krime kundër shtetit.



marrë vetë përgjegjësi të plotë përpara Partisë dhe Qeverisë për zgjidhjen deri në fund të këtij problemi. Ai le të interesohet ku të dojë për të siguruar xhama ose plastmase për serrat. Direktivat për këtë çështje janë dhënë prej kohësh, prandaj s'ka përse ta shqyrtojmë këtë problem shumë herë në Byronë Politike.

Shumë i rëndësishëm dhe i gjerë është gjithashtu problemi i ndërtimit, por po shoh se ne me zor po largohemi nga disa forma pune, norma dhe metoda që kanë ekzistuar, që na kanë penguar dhe vazhdojnë akoma të na pengojnë. Ne, anëtarët e Byrosë Politike, nuk jemi që të mos studiohet kjo apo ajo çështje që ka të bëjë me zgjidhjen e problemeve që i dalin këtij sektori, po udhëheqja e Partisë kërkon nga drejtuesit e sektorit të ndërtimit që të bëjnë një transformim rrënjësor në mendjen e tyre, në këtë drejtim. Direktiva që jepet nga lart, nga Komiteti Qendror ose nga Qeveria, duhet të zërthehet gjer në fund, gjithashtu të merren gjer në fund edhe masat organizative që do të sigurojnë vënien e saj në jetë. Po marr si shembull ndërtimin e shtëpive të banimit. Shokët e ndërtimit kanë maninë që kudo të bëhen pallate. Ndërtesa të mëdha e të bukura ne do të bëjmë, po këto të ngrihen sidomos në rrugët kryesore të qyteteve, kurse në lagjet dhe në periferi të ndërtohen edhe shtëpi më të thjeshta, por që të jenë komode. Këtë kombinim ta bëjmë në mënyrë që nevojat t'i zgjidhim në përputhje me mundësitë. Kurse në minierat dhe në disa kantiere mund të ndërtohen godina me materiale më pak të kushtueshme. Për këtë çështje na janë dhënë mendime të ndryshme. Mendime duhet të ketë patjetër nga të gji-

thë, se pa mendime dhe debate puna nuk ecën përpara, po mendimet dhe propozimet që dalin, të shqyrtohen thellë, të nxirren konkluzione prej tyre dhe pastaj të bëhen përpjekje që të zbatohen. Ndryshe është e zorshme për ne të merremi vazhdimisht me disa probleme, me të cilat duhet të merren dhe t'i zgjidhin të tjerët.

Prandaj, studimi i problemeve të mëdha duhet të bëhet më mirë dhe më me perspektivë nga sa është bërë gjer tani, por jo në mënyrë shabllone e burokratike. Të gjithë njerëzit, aparatet e në radhë të parë Partia duhet t'i venë gjer në fund kësaj çështjeje, në mënyrë të organizuar dhe frontale.

Duke qenë realistë dhe duke parë me vëmendje jo vetëm kushtet tona materialo-ekonomike, po edhe frymën e lartë të mobilizimit të njerëzve tanë, mendoj se plani është përgatitur mirë dhe objektet e parashikuara në të besoj se mund të realizohen dhe ne duhet të përipiqemi me të gjitha mjetet që të realizohen. Vetëm është e domosdoshme të bëhet një punë më e madhe organizative, politike dhe ideologjike, e të mos kënaqemi me aq sa është bërë gjer tani.

Çështjen e kam këtu, populli ynë është vërtet entuziast për vijën e Partisë, po ky mobilizim, ky patriotizëm dhe kjo frymë e lartë revolucionare që ekzistojnë në masat tona të popullit dhe të Partisë, të mos qëndrojnë në vend, po të vijnë duke u rritur, të bëhen një jetë e vërtetë për gjithë njerëzit tanë. Interesat e atdheut e kërkojnë të jemi vazhdimisht në këmbë, tepër të vëmendshëm, të rritim edhe më tej përpjekjet tona se, po të mjaftohemi me rezultatet e arritura, ka rre-

zik të na zërë gjumi. Këtë ne nuk duhet ta lejojmë. Njerëzit tanë, sa herë që u ka bërë thirrje Partia, kanë shkuar atje ku ka pasur nevojë atdheu dhe kjo është një gjë e mirë, pozitive, por, po t'i futemi në thellësi kësaj çështjeje, ne do të gjejmë edhe brenda në Parti clementë që e kanë humbur ndërgjegjen socialiste të klasës. Por Partia jonë punon vazhdimisht, ka marrë e merr masat e nevojshme dhe zhvillon luftën e pandërprerë klasore që te ne të mos ndodhë kurrë tragjedia që ndodhi në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Si mund të shpjegohet ndryshe kjo tragjedi, përveçse me largimin nga rruga e klasës punëtore të kuadrove, gjeneralëve dhe mareshalëve të Bashkimit Sovjetik? Vërtet këta luftuan, po tani janë bërë mbështetja e revizionistëve, e këtyre armiqve dinakë që bëjnë sikur mbajnë flamurin e marksizëm-leninizmit. Kjo gjendje është krijuar atje nga një metodë pune jo e drejtë. Po të ishte ndjekur metoda e Stalinit në zhvillimin e luftës së klasave, po të mbahej si më parë nga njerëzit fryma e lartë e sakrificës, po të mos ekzistonte mendjemadhësia te kuadrot dhe mendimi se ne kemi luftuar, prandaj tani duhet të rrojmë rehat, të mos bëjmë më sakrifica etj., etj., atje nuk do të kishte ndodhur kjo katastrofë. Ne në asnjë mënyrë nuk duhet të lejojmë të nxjerrin kokë shfaqje të tilla të rrezikshme.

Është e drejtë ajo që tha shoku Mehmet për të jetuar thjesht. Natyrisht, unë nuk e kam çështjen që të ulim sasinë e orizit ose të sheqerit nën nivelin e tanishëm, por njerëzit, klasën punëtore dhe, në radhë të parë, anëtarët e Partisë, duhet t'i mësojmë të bëjnë më

shumë sakrifica. Të mos harrojmë pastaj fshatarësinë tonë që është revolucionare dhe patriote, e cila e do me gjithë shpirt Partinë. Por kjo ka nevojë të shohë se si qëndrojnë aty ku kërkohen më shumë sakrifica, në radhë të parë komunistët dhe drejtuesit, kryetari i kooperativës, sekretari i organizatës-bazë, prandaj të kemi kujdes ta ruajmë të pastër shembullin pararojë, se ka disa komunistë në fshat që përpiqen të futen në ndonjë qoshe në punë me ditë fikse, nëpër zyra, depo etj. e jo në prodhim, jo në frontet më të vështira të punës. Ne e kemi gjetur diagnozën e sëmundjes, e dimë përse ngjasin këto, po akoma nuk e kemi pastruar si duhet atë, prandaj mendoj se duhet bërë një luftë shumë e madhe. Këtë luftë ne duhet ta shoqërojmë politikisht dhe ideologjikisht. Ne duhet t'i mësojmë anëtarët e Partisë të bëjnë një jetë sakrifica, të cilat nuk bëhen për një ose për dy njerëz, po për Partinë, për popullin, për atdheun, për socializmin. Në qoftë se vendosim që kooperativës bujqësore të mos i japim kredi për ditë-punë, secili ta kuptojë mirë që një gjë e tillë nuk duhet të bëhet. Vetë kooperativistët të vënë të gjitha energjitë e tyre në punë, të rrinë edhe pa gjumë, ditën dhe natën dhe të kryejnë detyrat, të sigurojnë kështu për vete dhe për fëmijët e tyre një gjendje më të mirë. Shteti krediti do të japë për traktorë dhe për mjete të tjera, por jo për ditën e punës. Këtë kooperativisti e ka për detyrë dhe duhet ta bëjë për vete dhe për atdheun. Edhe shumë nëpunësve dhe kuadrove të lartë ne u bëmë shkurtime në pagat. Kjo ishte një detyrë dhe një masë e drejtë partie.

Në këtë luftë të madhe që udhëheq Partia, kontradikta do të ketë, shokë, do të ketë njerëz me kërkesa të ndryshme, bile edhe të pakënaqur, prandaj të mos mendojmë se këto çështje do të na kalojnë lishio, por vësh-tirësitë që do të na dalin ne do t'i përballojmë. Rëndësi ka të ruajmë të pastër e të fortë nënën, Partinë, se kryesorja është Nëna. Ne do të përpiqemi t'i sjellim në rrugë të drejtë ata që gabojnë, po frikë nga të tillë njerëz nuk duhet të kemi. Ne duhet të shohim përpara, të ardhmen, sigurimin e atdheut dhe të Partisë. Ky është një problem i madh.

Ne, shokë, jemi në rrugë të drejtë revolucionare. Edhe projektplanit që po përgatitim është revolucionar, prandaj, me shtesat që propozohen, kam besim se do të bëhet akoma edhe më shumë se kaq.

Ne kemi fakte të shumta se të gjitha realizimet e mëdha të gjertanishme në vendin tonë janë bërë me sakrifica, me heroizma. S'ka dyshim se këtë frymë, këtë mobilizim ne do të vazhdojmë ta mbajmë gjallë për realizimin me sukses të planit të ri pesëvjeçar. Rol të madh vendimtar në këtë çështje luan Partia, udhëheqja e saj gjer në bazë, e cila do të mobilizojë, si kurdoherë, masat e gjera punonjëse. Duke vepruar kështu, të gjithë do të ngrihen në këmbë, do të shpërthejë vrulli i madh revolucionar i masave. Rëndësi ka çështja që Partinë dhe popullin t'i mbajmë në këmbë. Asnjëri nuk pëson gjë duke qenë vazhdimisht i mobilizuar, përkundrazi njerëzit kështu kaliten më shumë.

Këto kisha për të thënë, shokë. Shokëve të Komisionit të Planit të Shtetit, sikurse thashë, mund t'u japim disa ditë afat t'i studiojnë me kujdes vërejtjet që

u bënë e do të bëhen dhe të na i paraqesin për t'i shqyrtuar dhe për të vendosur definitivisht projektin që do t'i paraqesim Plenumit të Komitetit Qendror.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**LUFTA E ARMATOSUR — E VETMJA RRUGË  
E POPULLIT QË DËSHIRON LIRINË  
DHE PAVARËSINË E TIJ**

*Nga biseda me ambasadorin e Republikës Demokratike  
të Vietnamit*

**18 qershor 1966**

*Pasi u përshëndet përzemërsisht me ambasadorin  
vietnamez, fjalën e mori shoku Enver Hoxha:*

Jam shumë i gëzuar që po takohem sot me ju, përfaqësuesin e qeverisë së Republikës Demokratike të Vietnamit. Ne kemi ndjekur dhe ndjekim çdo ditë me vëmendje të madhe luftën heroike të popullit vietnamez, sukseset e tij dhe jemi shumë të gëzuar kur dëgjojmë çdo ditë për disfatat që pësojnë imperialistët agresorë amerikanë dhe për shpartallimin e trupave kukulla në jug të atdheut tuaj.

*Pastaj e mori fjalën ambasadori i Republikës Demokratike të Vietnamit, i cili tha:*

Komiteti Qendror i Partisë sonë më ka porositur t'u shpreh mirënjohjen Qeverisë dhe Partisë suaj për përkrahjen dhe për ndihmën që na keni dhënë dhe na jepni në luftën tonë. Ai më porositi gjithashtu që t'i

them Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë se nga ana jonë do të bëhen të gjitha përpjekjet për të luftuar dhe për të fituar mbi imperialistët amerikanë për të qenë kështu të denjë për përkrahjen që ju i jepni luftës së popullit tonë.

*Më poshtë ambasadori i RD të Vietnamit e njohu hollësisht shokun Enver Hoxha me situatën në Vietnamin e Jugut; me luftën heroike të popullit vietnamez kundër agresorëve amerikanë dhe reaksionarëve vendas; me planet dhe me përpjekjet e reja të imperialistëve për të zhvilluar e për të shkallëzuar më tej luftën në Vietnam dhe për të shpëtuar nga situata e rëndë nëpërmjet intensifikimit si të agresionit ushtarak ashtu edhe të «ofensivës paqësore» etj.; me disfatat e mëdha që po pësonin armiqtë në frontin e luftës dhe me kontradiktat e thella që kishin shpërthyer në radhët e qeveritarëve kukulla të Vietnamit të Jugut.*

*Pastaj përsëri e mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Ju falënderoj, shoku ambasador, që më njohët në mënyrë kaq të gjerë, të hapët dhe shoqërore me gjen-djen në Vietnam. Në emër të Komitetit Qendror ju lutem t'i transmetoni Komitetit Qendror të Partisë suaj dhe shokut Ho Shi Min falënderimet revolucionare të Komitetit Qendror të Partisë sonë për këtë ekspozë shumë të frytshme për ne, të cilën e konsiderojmë si shprehje të solidaritetit komunist që ekziston midis dy vendeve tona dhe të vlerësimit të drejtë që i bën Partia e Punonjësve të Vietnamit Partisë dhe popullit shqiptar, që janë solidarë me luftën heroike të popullit dhe të partisë suaj.

Ju vetë personalisht e keni parë që në vendin tonë



politikisht, ideologjikisht, shpirtërisht populli dhe Partia jonë janë plotësisht solidarë me luftën tuaj dhe në ballë të përpjekjeve për mbrojtjen e çështjes së drejtë dhe të shenjtë të popullit vietnamez dhe të Partisë së Punonjësve të Vietnamit, qoftë në Veri, qoftë në Jug. Këtë solidaritet internacionalist ne e konsiderojmë si një çështje jetike, jo vetëm për Vietnamin, po edhe për vetë vendin tonë, për të gjithë popujt e botës dhe për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. E theksoj këtë se aktualisht detyra kryesore e partive me të vërtetë marksiste-leniniste është lufta kundër imperializmit, revizionizmit modern dhe gjithë reaksionarëve që mbështetin agresionin imperialist amerikan kundër popullit vëlla vietnamez.

Ju e thatë vetë se përveç luftës agresive barbare me armë që bëjnë imperialistët amerikanë dhe reaksionarët vietnamezë, po aq, bile edhe ca më shumë e rrezikshme, është edhe «ofensiva paqësore», e cila tregon hapur dhe shumë qartë dobësinë e madhe që i ka shkaktuar lufta heroike e popullit tuaj imperializmit amerikan. Kjo është një disfatë e madhe jo vetëm e tij, por edhe e të gjithë atyre që e përkrahin këtë «ofensivë paqësore».

Ne jemi të bindur se «ofensivën paqësore» e trumbetojnë me të madhe dhe e kanë si flamur revizionistët sovjetikë, në radhë të parë, sepse ata kanë deklaruar dhe zbatojnë politikën e «bashkekzistencës paqësore», veçanërisht me imperializmin amerikan. Ne konstatojmë me kënaqësi se populli vietnamez, me në krye Partinë e Punonjësve të Vietnamit, pavarësisht nga taktikat që kjo përdor, qëndron i palëkundur në

luftën kundër imperializmit amerikan dhe reaksionarëve vendas dhe është kundër asaj që ata e quajnë «ofensivë paqësore». Ky qëndrim është garancia për arritjen e fitores dhe drejtohet kundër të gjithë atyre që përpiqen t'i vënë gur nën rrota kësaj lufte të drejtë të Vietnamit, e cila zhvillohet me armë dhe me mjete të tjera politike. Por armiqtë tanë nuk do të kenë sukses.

Mund të bëjnë lloj-lloj planesh amerikanët apo revizionistët modernë për dështimin e Vietnamit, por këto plane do të shkatërrohen përpara vendosmërisë dhe luftës suaj. Në qëndrimin konkret ndaj kësaj lufte dallohen e do të dallohen çdo ditë e më mirë kush janë pro popullit vietnamez e kush janë kundër tij.

Partia jonë konkretisht nuk di shumë hollësi mbi presionet që u bëjnë revizionistët modernë, me në krye ata sovjetikë, qëndrimeve të vendosura të popullit dhe të komunistëve vietnamezë, por Partia jonë e merr me mend dhe nxjerr konkluzionet e duhura nga gjithë politika dhe veprimtaria e tyre. Nga artikujt gati të përditshëm të organit të Komitetit Qendror të Partisë suaj kundër agjentit të vjetër të imperializmit amerikan, Titos, ne nxjerrim konkluzionet tona. Për ne është e qartë si drita e diellit kush është Titoja, ku ha bar ai, me cilin është mik, ashtu siç është e qartë se cilët janë ata që e quajnë «komunist» këtë renegat, dhe cilët janë ata që puthen e përqafohen me të. Nuk ka se si populli heroik vietnamez dhe partia juaj të mos shohin në këtë ndeshje kolosale që po bëhet se kush janë miqtë e tyre të vërtetë dhe kush janë armiqtë.

Lufta e ashpër që po zhvillon populli vietnamez është një provë e shkëlqyer që tregon se lufta e armatosur kundër pushtuesve agresorë amerikanë është i vetmi mjet shpëtimi për këtë popull që dëshiron lirinë dhe pavarësinë e tij, të cilat, sikurse e thatë ju, janë kërkesat kryesore të domosdoshme dhe jetike për një popull. Faktet kanë treguar dhe tregojnë se kur popujt dhe partitë marksiste-leniniste, që udhëheqin popujt në luftën për çlirim, e kanë të qartë se vetëm me këtë mjet dhe në asnjë rrugë tjetër arrihet fitorja, atëherë ata s'ka fuqi e vështirësi që t'i ndalojë në kurorëzimin e çështjes së tyre të drejtë. Tek organizimi dhe tek udhëheqja e luftës së armatosur kundër okupatorëve dhe reaksionarëve vendas qëndron politika më e drejtë e një partie që synon çlirimin e përhershëm të popullit të vet. Vetëm kjo luftë e siguron një popull të mos mposhtet kurrë. Të mendohet për mjete të tjera, do të thotë që liria dhe pavarësia t'i jepen një populli si një dhuratë për mëshirë, por kjo nuk mund të bëhet kurrë, sepse lirinë nuk ta fal kush, ajo fitohet vetëm me luftë, me përpjekje dhe me sakrifica.

Për Partinë tonë është e qartë se imperialistët amerikanë po bëjnë çmos që ta zgjerojnë luftën. Për këtë qëllim ata nuk kursehen, nuk marrin parasysh humbjet e mëdha në materiale, në fonde dhe në njerëz, sepse ndryshe humbasin prestigjin e tyre politik. Prandaj ata do të vazhdojnë t'i shtojnë aksionet barbare për të siguruar qëndrimin e tyre në Vietnam dhe për ta mbajtur atje të ndezur vatrën e luftës, si një bazë për ta përhapur në zona të tjera dhe për të zhvilluar veprimtarinë e tyre agresive, diversioniste e

hegjemoniste kundër popujve e vendeve të ndryshme të atij rajoni, ose të rajoneve të tjera.

Imperializmi, revizionizmi modern dhe reaksionarët në botë po përdorin të gjitha mjetet dhe rrugët si të dalin nga ky qorrrokak, prandaj është kaq shumë e dëshiruar për ta «ofensiva paqësore». Populli ynë thotë që imperialistët e bëjnë këtë jo nga malli, por nga halli. Ata po e shikojnë që populli dhe Partia e Punonjësve të Vietnamit qëndrojnë të patundur në të katër pikat e tyre. T'i pranojnë këto katër pika imperialistët amerikanë, do të thotë që ata të qërohen nga Vietnami, gjë që do të bëjë që të bjerë në greminë prestigji i tyre. Sipas mendimit tonë, revizionistët sovjetikë dhe gjithë këlyshët e tyre përpiqen tani t'i bindin Shtetet e Bashkuara të Amerikës për njëfarë kompromisi. Qëllimi është që t'u shpëtojnë nderin agresorëve amerikanë, por këta nuk lëshojnë, sepse duan të kenë gishtin brenda në Vietnam. Mirëpo kërkesat e drejta të qeverisë së RD të Vietnamit janë të paprekshme, ato nuk janë fjalë boshe, por shprehin vullnetin e popullit vietnamez, i cili është i vendosur të luftojë dhe të fitojë lirinë e pavarësinë me gjakun dhe me sakrificat e tij kolosale.

Ne jemi të bindur se imperialistët amerikanë dhe armiqtë e tjerë të lirisë dhe të pavarësisë së popujve me siguri do të dështojnë në planet e tyre. Të gjitha kontradiktat e ashpra, që ekzistojnë dhe do të ekzistojnë në radhët e armiqve imperialistë dhe reaksionarëve vendas në Vietnamin e Jugut, janë rezultat i disfatave të mëdha të njëpasnjëshme që po pësojnë imperialistët amerikanë dhe politika e tyre me kukullat vendase.

Këto kontradikta në mes armiqve janë shkaktuar në radhë të parë nga lufta e popullit, nga partizanët vietnamezë. Elementët kukulla po përpiqen tani si e si të gjejnë një rrugë kompromisi. Sikurse thatë ju, ushtria e qeverisë kukull është një mbështetje për ushtrinë amerikane në Vietnam, por përpjekjet për sheshimin e kontradiktave, për të arritur në njëfarë kompromisi midis budistëve dhe pasuesve të Kao Kisë për formimin e një «qeverie civile» me Kao Kinë në krye, kundër asaj të gjeneralëve, janë manovra të imperialistëve amerikanë dhe të reaksionarëve vendas për të mbështetur ofensivën e tyre të paqes. Ne mendojmë se këto përpjekje janë rezultat i vetë situatës së brendshme që është krijuar në Vietnam. Edhe ne, po të ishim në vend të partisë suaj dhe të Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut, do të mundoheshim të përfitonim sa më shumë nga këto kontradikta dhe situata për të goditur, për të shpartalluar dhe për të likuiduar me radhë batalionet amerikane, sepse në këtë mënyrë ju goditni, shpartallonin e likuidonin moralin dhe rezistencën e kukullave dhe të të gjithë reaksionarëve vietnamezë.

Kur mbytet vapori, minjtë fillojnë të dalin jashtë për të shpëtuar. Po ku të shkojnë? Kështu po ndodh tani në vendin tuaj me kukullat vietnameze. Vapori amerikan dhe i Kao Kisë në Vietnamin e Jugut tani është duke u mbytur, prandaj minjtë, ku janë e ku s'janë, përpiqen të dalin jashtë, të shpëtojnë nga mbytja. Kështu ka ngjarë edhe në vendin tonë afër mbarimit të Luftës Nacionalçlirimtare. Në afërsitë e qytetit të Tiranës ndodhet një fshat që quhet Mukje.

Kur reaksionarët shqiptarë dhe kuislingët, të grumbulluar rreth organizatave tradhtare të «Ballit Kombëtar» dhe të «Legalitetit», panë se po mbytej «vapori italian», me të cilin ata kishin bërë «udhëtim» të përbashkët, u detyruan të largohen nga ai dhe erdhën në Mukje për të biseduar me ne. Ne dërguam në këtë fshat delegacionin tonë të Frontit Nacionalçlirimtar, të kryesuar nga dy veta, njëri nga të cilët ishte anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë dhe tjetri anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Këtyre u dhamë udhëzime të qarta për çështjet që do të diskutonin dhe i porositëm t'u thoshin qartë përfaqësuesve të «Ballit» e të «Legalitetit» që, në bazë të situatës dhe meqenëse ata dëshironin (mbasi vetë kishin kërkuar të bënin bisedime me ne), të hidheshin në luftë. «Po lufta mbaroi» — u përgjigjën përfaqësuesit e këtyre organizatave tradhtare. Porosia e Partisë ishte që t'u thuhej: «Jo, lufta nuk ka mbaruar, sepse pushtuesit italianë do të zëvendësohen me doemos me ata gjermanë. Ju gjer tani ishit bashkuar me italianët dhe na keni luftuar ne, politikisht dhe me armë. Tani që ne i thyem italianët, me të cilët ju ishit bashkuar, keni ardhur këtu. Mund të na thoni zotërinj, përse keni ardhur?». «Për të krijuar një qeveri të përbashkët» — u përgjigjën ata. Përfaqësuesit e delegacionit të Frontit Nacionalçlirimtar kishin marrë direktiva të qarta që t'u bënin thirrje atyre të rrëmbenin armët, të merrnin pjesë bashkë me ne në luftën e armatosur të pamëshirshme kundër nazistëve pushtues gjermanë, «të pastrojmë së bashku të gjithë tradhtarët, pse do të kemi akoma shumë për të luftuar, pastaj, si t'i thyejmë armiqtë, kemi kohë për të krijuar

qeverinë». Këto ishin direktivat e Komitetit Qendror të Partisë sonë për Mbledhjen e Mukjes.

Por të dërguarit tanë në Mukje që ishin oportunistë, ose më mirë të themi tradhtarë, i shkelën këto direktiva të qarta të Komitetit Qendror dhe ranë dakord me kuislingët, ballistët, zogistët etj. për të formuar një të ashtuquajtur «komitet për shpëtimin e Shqipërisë» dhe vendosën të shpallnin «pavarësinë e Shqipërisë» dhe vendi ynë të bëhej kesisoj, sipas tyre, një shtet i demokracisë borgjeze. Kjo do të thoshte që në një qeveri të tillë provizore të futeshin edhe ata që gjer në atë kohë kishin bashkëpunuar ngushtë me pushtuesit fashistë italianë kundër Frontit tonë Nacionalçlirimtar, pra që të shkonte kot gjaku që populli ynë, me Partinë në krye, kishte derdhur rrëke për vite të tëra. Në ato kohë lufte mjetet e ndërlihdjes dhe të informacionit ne i kishim të dobëta e të vështira, megjithatë pas dy ditësh morëm vesh mbi rezultatet e bisedimeve të Mukjes, mbi kapitullimin e dy përfaqësuesve tanë ndaj manovrave të reaksionit shqiptar. Ne e demaskuam menjëherë në popull këtë kompromis të turpshëm, grisëm marrëveshjen famëkeqe të përfunduar në kundërshtim me direktivat e Komitetit Qendror të Partisë, dy përfaqësuesit komunistë që dërguam në Mukje i përjashtuam nga Komiteti Qendror dhe nga Partia, vazhduam luftën me të njëjtën vendosmëri si edhe gjer atëherë dhe ruajtëm të pacenuar rolin udhëheqës të Partisë sonë në këtë luftë popullore.

Sigurisht, për përcaktimin e një taktike të drejtë rëndësi ka analiza klasore marksiste-leniniste e situatave dhe e ngjarjeve konkrete të secilit vend. Ne mendoj-

më se populli vietnamez dhe Partia e Punonjësve të Vietnamit me luftën që po bëjnë janë duke ecur drejt fitores, kurse armiqtë tuaj dhe tanët dobësohen dhe do të dobësohen gjithnjë e më shumë. Fronti Kombëtar i Çlirimit të Vietnamit të Jugut, që ka një eksperiencë të madhe në luftën kundër imperialistëve, do të gjejë momentin e përshtatshëm dhe do të dijë t'i shoshitë si duhet njerëzit që duhet të afrojnë sot, që nesër këta të mos bëhen në asnjë mënyrë të rrezikshëm dhe të mos pengojnë realizimin e platformës e të qëllimit final të partisë suaj.

Po të shikosh dokumentet e Partisë sonë, qoftë të periudhës së Luftës Nacionalçlirimtare, qoftë të 4-5 vjetëve të parë pas Çlirimit, do të konstatosh se ne deri në Qeveri kishim njerëz pa parti. Të tillë gjatë luftës kishim edhe në udhëheqjen e Frontit Nacionalçlirimtar, për shembull, tregtarë e klerikë të ndryshëm, ashtu sikurse edhe ju keni sot budistët.

Në lidhje me këta elementë Partia jonë kishte bërë qysh në fillim një punë të madhe për t'i afruar në Frontin Nacionalçlirimtar, për t'i bindur për luftën e hapët që duhej të zhvillonin kundër pushtuesve të huaj. Në luftë e sipër u bë edhe diferencimi. Disa prej tyre, që në fillim nuk e pranuan platformën e Frontit Nacionalçlirimtar, u lidhën me pushtuesit dhe u vunë në shërbim të tyre kundër popullit e Partisë sonë. Disa të tjerë e pranuan platformën e Frontit, morën pjesë në luftë, bile pati ndër ta që u zgjodhën edhe në udhëheqje të Frontit. Por, pavarësisht nga kjo, Partia në asnjë rast nuk lejoi që të cenohej roli i saj udhëheqës në Front, përkundrazi e forcoi pa ndërprerje këtë rol. Edhe pas



Çlirimit me këta elementë që kishin marrë pjesë në luftë Partia ndoqi një politikë të matur e të drejtë, vazhdoi punën për edukimin e mëtejshëm të tyre dhe disave iu besuan edhe detyra me rëndësi në Qeveri dhe në organet e zgjedhura nga populli. Në punë e sipër shumica e tyre u edukuan dhe u lidhën ngushtë me Partinë e me popullin, por pati edhe nga ata që nuk duruan dot më tej, u lidhën me komplotistët dhe së bashku me imperialistët anglo-amerikanë komplotuan kundër pushtetit popullor. Kur u zbuluan, ata u çuan në gjyqet e popullit, ku morën dënime sipas fajeve që kishin bërë.

E tillë është eksperiencia jonë për këtë problem të rëndësishëm, i cili te ne, siç vërtetoi jeta, është zgjidhur drejt, në favor të popullit dhe të socializmit. Busull e pagabueshme që na ka orientuar për të ndjekur këtë vijë të drejtë ka qenë dhe është marksizëm-leninizmi, të cilin ne e kemi zbatuar, do ta zbatojmë dhe do ta mbrojmë gjer në fund me konsekuencë e me besnikëri të pafund.

Lufta heroike me sakrifica të panumërta e popullit dhe e partisë suaj është një shembull për të gjithë popujt e botës. Këta jo vetëm duhet ta admirojnë luftën e popullit tuaj, por duhet që gjakun e pastër që ka derdhur e po derdh populli vietnamez ta konsiderojnë si një kontribut për çështjen e madhe të revolucionit botëror. Prandaj, duke e parë kështu problemin, popujt, partitë e vërteta marksiste-leniniste dhe gjithë revolucionarët e botës duhet të jenë kurdoherë përkrah luftës suaj të drejtë, t'ju mbështetin e t'ju ndihmojnë me të gjitha forcat dhe mundësitë.

Edhe një herë dëshiroj t'ju shpreh, me këtë rast,

ndjenjat më të pastra, më të përzemërta e vëllazërore të Komitetit Qendror të Partisë sonë, të popullit shqiptar dhe të miat personale ndaj popullit heroik vietnamez. Të jeni të sigurt se zemrat tona rrahin bashkë me ju, dhe ju shprehim bindjen e plotë se fitorja e popullit heroik vietnamez dhe e Partisë së Punonjësve të Vietnamit do të arrihet me siguri duke çuar në shkatërrimin e bandave të imperializmit amerikan, i cili do të marrë një goditje kolosale nga lufta e popullit tuaj.

U çoni të falat dhe përshëndetjet e mia shokëve të udhëheqjes së partisë dhe të shtetit vietnamez dhe ju uroj nga zemra suksese të tjera të mëtejshme.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha «Kun-  
dër revizionizmit modern»  
(Përmbledhje veprash)  
1965-1967, f. 350*

*Botohet sipas shënimeve të  
mbajtura në këtë takim që  
gjenden në Arkivin Qendror  
të Partisë*

**KUNDËRREVOLUCIONI DO TË SHKATËRROHET  
VETËM ME REVOLUCION DHE JO DUKE BËRË  
KOMPROMISE ME IMPERIALISTËT  
APO ME REVIZIONISTËT**

*Nga biseda me një delegacion të Partisë Komuniste  
të Cejlonit*

**20 qershor 1966**

*Pasi e priti mysafirin dhe ky zuri vend, fjalën e  
mori shoku Enver Hoxha:*

Partia jonë kurdoherë i ka quajtur shumë të frytshme takimet me përfaqësuesit e partive motra marksiste-leniniste, sepse kështu njihemi mirë me eksperiencën e njëri-tjetrit, koordinojmë më drejt luftën e përbashkët kundër imperializmit, revizionizmit modern e gjithë reaksionit, forcojmë dhe kalitim unitetin marksist-leninist të partive tona për t'i kryer me nder detyrat në plan kombëtar e ndërkombëtar.

Shpeshherë në Komitetin Qendror na drejtohen pyetje nga anëtarët e Partisë, sidomos nga kuadrot që ndjekin Shkollën e Partisë, ku mësojnë edhe historinë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ata na pyesin edhe për gjendjen në partinë tuaj, në vendin tuaj, për luftën

që bën Partia Komuniste e Cejlonit, dhe ne, me sa ka qenë e mundur, i kemi mbajtur në dijeni mbi luftën që keni bërë ju kundër revizionistit modern, Kumarasiri, për mbrojtjen e vijës së drejtë të partisë suaj. Këto takime na shërbejnë për t'u njohur më mirë me luftën e njëri-tjetrit. Një rast tjetër për takim midis dy partive tona do të kemi nga vjeshta që vjen, kur të bëjmë Kongresin e Partisë sonë, ku do të ftojme edhe një delegacion të partisë suaj. Besojmë se ftesa jonë do të pranohet dhe se do të nderohemi me ardhjen e këtij delegacioni.

Partia jonë lindi në luftë, u rrit në luftë dhe kurdoherë në luftë e në përpjekje ka fituar e fiton eksperiencë. Por ne e ndiejmë dhe 'e dimë se përpara kemi beteja të tjera, për fitoren e të cilave do të na shërbejnë si eksperiencia jonë, ashtu edhe eksperiencia e gjithë proletariatit botëror, eksperiencia e të gjitha partive marksiste-leniniste, pra edhe ajo e partisë suaj.

Qëndrimi i drejtë i partisë suaj ndaj Partisë sonë pas Kongresit të 22-të të PK të BS na ka inkurajuar mjaft. Ky qëndrim ishte një ndihmë e madhe për ne, për arsye se çështja e luftës kundër revizionizmit modern është jo vetëm çështje e përbashkët e partive marksiste-leniniste, por edhe e të gjitha partive të vërteta proletare, të cilat duhet t'i bëjnë atij një luftë të përbashkët. Kjo luftë kundër revizionizmit nuk mund të kuptohet e shkëputur nga ajo kundër imperializmit botëror, me atë amerikan në krye, nuk mund të kuptohet jashtë luftës anticoloniale, luftërave të çlirimit nacional të popujve. Të gjitha këto përbëjnë hallkat e një lufte të vetme, të revolucionit botëror.

Revizionizmi modern është shumë i rrezikshëm, ai është një variant i ideologjisë së kapitalizmit dhe në shërbim të tij, i fshehur prapa frazeologjisë marksiste-leniniste.

Por marksistë-leninistët nuk u tremben vështirësive, luftës kundër revizionistëve të çdo ngjyre dhe çfarëdo parulle që ata hedhin. Marksistë-leninistët kurrë nuk e kanë zhvilluar luftën e tyre në qetësi. Ata kanë qenë dhe janë kurdoherë në luftë dhe në rreziq e megjithatë luftojnë pa u përkulur kundër demagogjisë, intrigave, sharjeve e plumbave të armiqve dhe gjithnjë kanë fituar për arsye të drejtësisë së vijës së tyre, të qartësisë në qëndrimet, qoftë në strategji, qoftë në taktikat që ndjekin. Me punën e tyre organizative, politike, ideologjike ata lidhen gjithnjë e më shumë me masat, i frymëzojnë dhe i udhëheqin ato në rrugën e gjatë, të vështirë, por të lavdishme të revolucionit.

Ja, për shembull, partia juaj luan një rol të madh në udhëheqjen e popullit, të klasës punëtore, të sindikatave dhe të fshatarësisë cejloneze. Nuk ka rëndësi gështja se partia juaj sot ka pak anëtarë. Edhe Partia jonë, që lindi në zjarrin e luftës kundër fashizmit, kur u themelua, ishte një parti e vogël në numër, por lufta e paepur e kaliti atë dhe e bëri të pamposhtur. Ju e dini se po të kesh parti proletare të fortë, e cila i bën njerëzit të mendojnë dhe të rrojnë kurdoherë me frymë revolucionare, ata çajnë edhe malet, përballojnë çdo vështirësi e pengesë, shqyrtojnë drejt situatat dhe, kur shohin se situata revolucionare është pjekur, u nxjerrin themelet borgjezisë dhe agjentëve të saj dhe marrin në dorë pushtetin.

Mund të gabohem, mbasi jemi larg njëri-tjetrit, por Partia jonë mendon se në Azi dhe në zona të tjera të botës ekziston një situatë e lartë revolucionare, e cila duhet shfrytëzuar drejt nga partitë e vërteta marksiste-leniniste, për të bërë që të triumfojë çështja e popujve dhe të shkatërrohen planet e përpjekjet skllavëruese të imperialistëve, me ata amerikanë në krye, dhe të revizionistëve modernë, me ata sovjetikë në krye. Ne mendojmë se të gjitha forcat revolucionare dhe marksiste-leniniste duhet të bashkohemi, të forcojmë unitetin e vërtetë marksist-leninist, të cilin e kanë shumë frikë revizionistët modernë. Këta flasin shumë për «unitet», por këtë e bëjnë për të diskredituar unitetin e vërtetë marksist-leninist. Nën maskën e «unitetit», ata luftojnë për hegjemoninë e tyre në radhët e komunizmit ndërkombëtar. Prandaj synimet e tyre ne duhet t'i shpartallojmë. Kjo arrihet me luftë kundër të gjithë armiqve dhe reaksionarëve imperialistë apo revizionistë qofshin. Në këtë drejtim, lufta e partive tona kontribuon e duhet të kontribuojë më mirë për arritjen e asaj dite që në Bashkimin Sovjetik dhe atje ku sundojnë revizionistët të pëlçasë revolucioni. Kundërrevolucionari do të shkatërrohet vetëm me revolucion dhe jo duke u bashkuar e duke bërë kompromise me imperialistët apo me revizionistët. Pikërisht revizionistët modernë janë ata që i duan kompromiset, me qëllim që të vendosin hegjemoninë e tyre, prandaj ne duhet për këtë t'i demaskojmë dhe t'i shpartallojmë.

Në Indonezi partia komuniste pësoi një goditje të rëndë. Kjo ishte një fatkeqësi për popullin dhe për komunistët indonezianë, por edhe një mësim i madh për

ata dhe për të gjithë marksistë-leninistët e botës. Neve na qan zemra për ata qindra e mijëra komunistë indonezianë me Aiditin, Njoton e të tjerë që u burgosën, u masakruan dhe u vranë. Por atje partia dhe marksizëm-leninizmi nuk kanë vdekur. Shokët indonezianë tani duhet të nxjerrin mësimë nga këto ngjarje të hidhura, por mësimë duhet të nxjerrin edhe të gjithë marksistë-leninistët për të qenë të kujdesshëm ndaj borgjezisë dhe elementëve përparimtarë borgjezë, t'i kombinojnë drejt me ta aleancat, por të kemi kurdoherë parasysh se të gjitha aleancat që mund të lidhen me borgjezinë janë aleanca të përkohshme. Ne nuk duhet të kemi besim të plotë te borgjezia nacionale dhe asnjëherë të mos e lidhim partinë komuniste pas qerres së saj, përkundrazi partia komuniste me çdo kusht të ruajë pavarësinë e saj, të ruajë parimet marksiste-leniniste si sytë e ballit, t'i ketë të qarta qëllimet imediate, strategjike e taktike dhe të mos i humbasë kurrë perspektivat.

Ne kemi shumë besim te forca revolucionare e popullit tuaj, i cili është kalitur në vuajtje e në mjerime, është lënë në prapambetje e errësirë dhe gjithnjë ka luftuar për të dalë nga kjo gjendje. Edhe popullin tonë regjimet antipopullore të së kaluarës e kishin zhytur në analfabetizëm, në errësirë e në mjerim, por ai kurrë s'e uli frymën e tij patriotike e revolucionare, vazhdimisht luftoi kundër pushtuesve të huaj dhe armiqve të brendshëm për të fituar lirinë, pavarësinë e për t'u futur në rrugën e zhvillimit shoqëror. Pastaj ju ndihmon fakti që në Cejlon keni një klasë punëtore shumë të madhe në numër, e cila është baza e revolucionit, kurse ne, kur filluam Luftën Nacionalçlirimtare, pothuaj

nuk kishim një klasë punëtore të formuar. Te ne atëherë ishin në fuqi sundimtarët gjakpirës të huaj, si dhe feudalë e tregtarë vendas, siç ndodh sot edhe te ju, që, veç të tjerëve, keni edhe anglezët mbi kurriz. Por edhe populli ynë me gjithfarëlloj pushtuesish është ndeshur, sa ikte njëri vinte tjetri: iknin romakët, vinin barbarët, pas këtyre turqit osmanllinj, iknin italianët, vinin serbët, iknin këta, vinin grekët, austriakët e gjer te fashistët italianë e nazistët gjermanë.

Kundër të gjithë këtyre pushtuesve u ngrit në këmbë populli ynë trim dhe kurrë nuk pranoi të jetonte nën zgjedhën e robërisë. Në luftërat e përgjakshme shekullore u kalitën ndjenjat patriotike e revolucionare të tij, të cilat qenë ai taban i shëndoshë ku u mbështet Partia jonë, kur i bëri thirrje popullit të mobilizohet e të hidhej në luftën vendimtare për liri, pavarësi e socializëm.

Kur u themelua Partia, programi i saj imediat ishte lufta për liri kundër pushtuesve dhe tradhtarëve të vendit dhe bashkimi i popullit rreth Partisë. Natyrisht, kjo nuk u arrit menjëherë e pa vështirësi. Partisë i është dashur të bëjë një punë të madhe me masat punonjëse e në mënyrë të veçantë me fshatarësinë, e cila përbënte pjesën dërrmuese të popullsisë sonë. Megjithëse fshatarësia jonë ka qenë shumë revolucionare, ajo ishte e paorganizuar dhe merita për mobilizimin dhe organizimin e saj në luftë i takon Partisë sonë, e cila diti t'i kuptonte drejt aspiratat e fshatarësisë sonë dhe t'i kanalizonte ato në rrugën e drejtë të luftës për liri e të revolucionit proletar. Pa përpjekje dhe pa mundime asgjë nuk arrihet. Ne kemi pasur edhe një avantazh:



tjetër: borgjezia vendase nuk mundi të krijonte partitë e saj, me të cilat do të përpiquej ta gënjente popullin e ta tërhiqte pas vetes për të realizuar synimet e veta. Kështu politikisht dhe ideologjikisht, si të thuash, ne gjetëm një terren të virgjër në drejtim të formimit ideologjik të popullit, tek i cili dominonte e fortë ndjenja e luftës kundër pushtuesve, feudalëve dhe gjithë sundimtarëve shfrytëzues. E tillë ishte ideologjia e masave tona punonjëse para formimit të Partisë.

Natyrisht kushtet tuaja janë të ndryshme nga ato në të cilat luftuan Partia dhe populli ynë gjatë viteve të Luftës Nacionalçlirimtare. Por ligjet e përgjithshme të luftës e të revolucionit janë të njëjta dhe të pandryshueshme, ato duhen njohur dhe duhen zbatuar me konsekuencë në bazë të kushteve konkrete të secilit vend. Kryesorja është se populli juaj është një popull revolucionar, i etur për liri e progres shoqëror dhe i kalitur në luftën për realizimin e aspiratave të tij. Nga ana tjetër, tani në botë ekzistojnë shumë parti të vërteta marksiste-leniniste, ekziston gjithashtu një proletariati revolucionar i madh e me një eksperiencë kolosale, faktorë këta që përbëjnë një mbështetje të fuqishme për luftërat nacionalçlirimtare të çdo populli e për revolucionin botëror.

Për të gjitha këto që thashë, ne kemi besim te fitorja e popullit tuaj, siç kemi besim te fitorja e çdo populli dhe e çdo partie marksiste-leniniste që luftojnë për kurorëzimin e çështjes së madhe të revolucionit. Ne, ashtu si gjer tani, kurdoherë do të jemi përkrah këtyre popujve dhe partive marksiste-leniniste dhe çë-

shtjen e tyre do ta quajmë vazhdimisht si çështjen tonë.

Partia jonë, me të gjitha forcat e veta dhe të popullit, do të punojë dhe do të luftojë vazhdimisht në rrugën e saj të drejtë marksiste-leniniste kundër imperializmit, kundër hrushovizmit, kundër titizmit, për çështjen tonë të përbashkët, për pastërtinë e marksizëm-leninizmit, për revolucionin, për socializmin, për komunizmin. Asgjë nuk na ka frikësuar ne në këtë rrugë dhe asgjë nuk do të na frikësojë as në të ardhmen që luftën tonë ta çojmë me sukses gjer në fund. Ne e dimë se nuk jemi dhe nuk do të jemi kurrë vetëm e të izoluar, përkundrazi me ne janë popujt revolucionarë dhe marksistë-leninistët e vërtetë në tërë botën. Kështu, të bashkuar me ta, ne bëhemi një forcë kolosale në botë dhe kjo na mbush me besim të patundur për fitoren e sigurt të çështjes sonë.

Ju lutem u transmetoni shokëve marksistë-leninistë cejlonezë përshëndetjet tona më të zjarra revolucionare, besimin tonë të patundur në suksesin përfundimtar të luftës së popullit tuaj.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha «Kundër revizionizmit modern» (Përmbledhje veprash) 1965-1967, f. 360*

*Botohet sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në Arkivin Qendror të Partisë*

## ÇDO SHMANGIE NGA PARIMET E MARKSIZËM- -LENINIZMIT ËSHTË ME PASOJA TË RËNDA

*Nga biseda me ambasadorin e RDP të Koresë*

20 qershor 1966.

*Pas përshëndetjeve të rastit, e mori fjalën shoku Enver Hoxha i cili tha:*

Ju falënderoj për fjalët e mira që thatë dhe për konsideratën e lartë që ushqeni për popullin dhe vendin tonë. Të njëjtat ndjenja ushqejmë edhe ne për popullin korean. Njerëzit tanë ndjekin me kujdes zhvillimin politik, ideologjik dhe ekonomik të vendit tuaj. Nëpërmjet shtypit jemi njohur me eksperiencën e madhe që keni ju në kultivimin e orizit dhe përgjithësisht me sukseset në zhvillimin e bujqësisë dhe të industrisë. Në një film korean kemi parë punën që bëni për ndërtimin e shtëpive të reja, jetën që bëjnë punëtorët te ju dhe këto na kanë gëzuar shumë.

Edhe në vendin tonë janë arritur mjaft suksese. Ju i keni parë vetë ato dhe gjendjen e shëndoshë revolucionare që ekziston te ne. Ato janë rezultat i punës vetëmohuese të popullit tonë, të udhëhequr

nga Partia, i cili krijon të mirat materiale për vete, prandaj e do punën dhe nuk lodhet së punuari.

Këto suksese janë arritur, në radhë të parë, sepse Partia jonë ka ndjekur një vijë të drejtë dhe ka zbatuar me konsekuencë parimet e marksizëm-leninizmit. Çdo shmangie nga këto parime është e mbarsur me pasoja të rënda për popullin dhe për vendin. Këtë na e provon edhe eksperiencia e hidhur e Bashkimit Sovjetik, e Polonisë dhe e vendeve të tjera revizioniste, ku është krijuar një kaos i madh, pikërisht sepse udhëheqjet e këtyre vendeve nuk janë marksiste. Pra dështimet e tyre në ekonomi nuk e kanë burimin as te shiu, as te bora, as në fatkeqësitë e tjera të natyrës, siç thonë revizionistët, por në vijën dhe në ideologjinë e tyre, e cila është ideologjia e borgjezisë, e kapitalizmit.

Tradhtia e revizionistëve ndaj marksizëm-leninizmit ka bërë që vendet e tyre sot të futen hapur në rrugën e transformimeve kapitaliste, që u kanë shkaktuar atyre vështirësi kolosale. Jugosllavia, me gjithë miliardat amerikane, është në kaos të madh ekonomik. Ngjarjet e kohëve të fundit tregojnë se në këtë vend është vendosur plotësisht kapitalizmi, se industria, pa lëre pastaj bujqësia, është në duart e grupeve kapitaliste të vetadministrimit.

Rrugën titiste të shtrirjes së dorës ndaj imperializmit kanë filluar ta zbatojnë tani edhe Bashkimi Sovjetik e vendet e tjera revizioniste, të cilat, si dhe Jugosllavia, për transformimet e tyre kapitaliste kërkojnë edhe ndihmën e borgjezisë imperialiste. Kjo e fundit, që nuk i kurseu paratë për klikën titiste, do

t'u japë «ndihma» edhe revizionistëve të tjerë në atë masë që u intereson vetë kapitalistëve të Perëndimit. Nën maskën e këtyre «ndihmave», këta do t'i hedhin më shpejt kthetrat dhe do t'i mbytin vendet ish-socialiste. Gjatë këtij procesi, ne do të shohim katastrofa akoma më të mëdha në radhët e revizionistëve, por do të shohim njëkohësisht edhe se si do të ngrihet revolucioni.

Disfatat e njëpasnjëshme të revizionistëve modernë provojnë edhe një herë domosdoshmërinë e zbatimit të marksizëm-leninizmit, që është forca jetëdhënëse që na çon përpara, që na kthjellon mendimet, që na ndihmon të përballojmë vështirësitë, të fitojmë mbi armiqtë dhe të ndërtojmë me sukses socializmin. Mund të bërtasë sa të dojë Fidel Kastroja, po ai nuk është marksist, ai është më shumë anarkist sesa një revolucionar dhe kjo duket në çdo veprim që bën, në ekonomi, në kulturë, në drejtimin e shtetit dhe të partisë.

Ju i njihni mirë qëndrimet e Partisë sonë ndaj revizionistëve modernë, prandaj nuk është nevoja të zgjatem. Këto qëndrime nuk janë të rastit, por rrjedhim i një analize klasore që Partia jonë i ka bërë lindjes dhe zhvillimit të titizmit dhe revizionizmit hrushovian. Mbi bazën e kësaj analize ne arritëm në konkluzionin se tradhtia që ngjau në Bashkimin Sovjetik nuk është e rastit, nuk është rezultat i punës së një ose dy personave, siç janë Hrushovi me Mikojanin, ose i grupit të tyre, por i një shtrese të tërë, të cilën mund ta cilësojmë aristokraci burokratike,

e krijuar në radhët e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Kjo shtresë e borgjezisë së re përbën bazën që ndihmoi revizionistët modernë për të marrë fuqinë në dorë në Bashkimin Sovjetik. Pra, revizionizmi atje është një sëmundje me rrënjë të thella që nuk mund të zhduket vetëm me rrëzimin e Hrushovit, prandaj Partia jonë ka thënë prej kohësh se lufta kundër revizionizmit modern nuk mund të mbarojë me rënien e Hrushovit dhe nuk është pajtuar kurrë me ata që mendonin se vetëm rrëzimi i tij do ta ndryshojë gjendjen në Bashkimin Sovjetik. Partia e Punës e Shqipërisë ka zhvilluar e zhvillon me ashpërsi luftën për ta demaskuar haptazi dhe gjer në fund grupin hrushovian, i cili u ngjet atyre të Kautskit, Bernshtajnit, Trockit, Buharinit, Tukaçevskit etj. Revizionistët, që të realizojnë plotësisht planet, kanë nevojë për qetësi, që ne të mos flasim kundër tyre. Por lufta jonë e vazhdueshme nuk ka për t'i lënë asnjë çast të qetë. Jeta provoi tërësisht konkluzionin e Partisë sonë se udhëheqësit e rinj sovjetikë janë vazhdues të rrugës së nisur nga Hrushovi, se ata s'kanë për të hequr dorë nga lufta kundër forcave revolucionare, kundër Partisë sonë dhe partive të tjera marksiste-leniniste dhe, në fakt, nuk e kanë pushuar për asnjë moment këtë luftë. Përkundrazi, me demagogjinë dhe veprimtarinë tradhtarë që përdorin, ata përpiqen të përçajnë e të shkatërrojnë unitetin marksist-leninist të proletariatit ndërkombëtar.

Ne, si marksistë-leninistë, jua themi haptazi çdo gjë që kemi dhe kurdoherë kështu ua kemi thënë edhe armiqve edhe miqve.

Ju thatë se do të vijë koha që edhe partia juaj do të flasë hapur kundër udhëheqësve sovjetikë dhe theksuat se «do të mbajmë qëndrim marksist-leninist, mos kini merak, nuk do të gënjehemi prej tyre». Kjo është puna juaj. Për sa na përket neve, do të vazhdojmë kështu siç e kemi: luftë të vendosur, të hapur e parimore kundër revizionistëve hrushovianë dhe gjithë revizionistëve të tjerë.

Ju e shihni dhe e ndieni nga afër ç'plane të mëdha strategjike kanë revizionistët sovjetikë dhe imperialistët amerikanë edhe kundër vendit tuaj.

Imperialistët amerikanë e kanë kthyer Korenë e Jugut në një koloni dhe njëkohësisht në një plasdarm kundër RDP të Koresë. Japonia që është lidhur e po lidhet me traktate të ndryshme me qeverinë e Koresë së Jugut nuk e bën këtë për të rrethuar Shqipërinë, sepse imperialistët kanë vende të tjera më afër nesh për të na rrethuar, por për të rrethuar vendin tuaj dhe Kinën.

Kundër lëvizjeve revolucionare e vendeve socialiste drejtohet edhe bashkëpunimi sovjeto-japonez, për të mos folur pastaj për bashkëpunimin e madh sovjeto-amerikan. Revizionistët sovjetikë nuk u japin kot imperialistëve japonezë koncesione në Siberi. Për ne kjo gjë është e qartë. Bashkëpunimi ekonomik i tyre nuk është pa një qëllim të caktuar politik. Këto dhe gjëra të tjera ju i shikoni edhe vetë dhe besojmë se, pavarësisht nga marrëdhëniet ekonomike që ekzistojnë tani midis Koresë dhe Bashkimit Sovjetik, partia juaj dhe udhëheqja e saj nuk do ta lënë veten të humbasin vigjilencën revolucionare.

Të dy vendet tona i lidh një miqësi e sinqertë. Por ju i keni po aq mike, në mos edhe ca më shumë nga ne, Republikën Popullore të Kinës dhe Partinë Komuniste të Kinës, duke marrë parasysh se jeni lidhur historikisht me to. Lidhur me këtë më lejoni të them mendimin e Partisë sonë dhe timin. Marrëdhëniet miqësore dhe uniteti revolucionar midis popujve e proletariatit ndërkombëtar lindin e kaliten mbi bazën e marksizëm-leninizmit dhe faktori që i hap rrugën e i çimenton ato është uniteti midis partive marksiste-leniniste. Por ka edhe njerëz që nuk e kuptojnë kështu këtë problem, që nuk i shohin drejt dhe në zhvillimin e tyre ngjarjet që ndodhin në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Kjo është një e metë që duhet eliminuar në rrugë marksiste-leniniste. E kam fjalën që uniteti midis partive marksiste-leniniste duhet të ekzistojë dhe të jetë i fortë sidomos nga ana ideologjike. Vetëm kur ky unitet mbështetet dhe frymëzohet në marksizëm-leninizmin, ai është i pashmëtyrueshëm.

Besoj se më kuptuat drejt për të gjitha. Këto që ju thashë nuk janë tjetër veçse shprehje të sinqeritetit të Partisë dhe të popullit tonë, të cilët kanë qenë e do të jenë besnikë të marksizëm-leninizmit.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*



## KINEZËT U TËRHOQËN SE SHOKËT TANË NUK LËSHUAN

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**22 qershor 1966**

Fjalën që do të mbaj në bisedën që do të bëjmë me Çu En Lain e kam hartuar<sup>2</sup>. Problemet që shtrojnë aty i përmbahen vijës sonë të përgjithshme. Në bisedën që bënë shokët kinezë me delegacionin tonë, i cili shkoi në Kinë në muajin prill<sup>3</sup>, ngritën çështjen e Stalinit dhe çështjen që klasat shfrytëzuese ekzistojnë akoma si klasa në vendet tona. Shokët e delegacionit tonë, duke e pasur të qartë vijën, ngulën

---

1 Në një nga seancat e kësaj mbledhjeje shoku Enver Hoxha parashtroi në vija të përgjithshme edhe disa nga problemet që do të ngriheshin në bisedimet me Çu En Lain, i cili, në krye të një delegacioni të partisë dhe të qeverisë kineze, do të vinte në Shqipëri më 24 qershor 1966.

2 Shih në këtë vëllim f. 85.

3 Është fjala për delegacionin e Partisë e të Qeverisë sonë të kryesuar nga shoku Mehmet Shehu, që vizitoi Kinën nga data 28 prill 1966 deri më 11 maj 1966.

këmbë dhe nuk kishte arsye pse të lëshonin, prandaj gjatë bisedimeve kinezët u tërhoqën, sidomos për çështjen e dytë. Ata u tërhoqën, duke thënë: «Përse t'ua imponojmë shokëve shqiptarë diçka, të cilën udhëheqja e tyre nuk e ka diskutuar?! Që u tërhoqën, mirë bënë, por që të arrinin në konkluzionin se udhëheqja e Partisë sonë nuk paska diskutuar për gjendjen e klasave në socializëm, nuk kanë të drejtë.

Ne e kemi të qartë situatën në vendin tonë, po edhe atyre, mendoj, t'ua bëjmë të qartë. Për këtë qëllim, në një pjesë të fjalimit që do të mbaj gjatë takimeve me ta, unë trajtoj edhe këtë çështje dhe e argumentoj me fakte reale pikëpamjen tonë. Në fjalim theksoj se ne i kemi likuiduar klasat shfrytëzuese, si klasë, nëpërmjet një procesi të gjatë lufte marksiste-leniniste. Kinezët mund të mos kenë arritur në atë që kemi arritur ne, kjo është puna e tyre; në vendet e tjera një gjë e tillë mund të jetë arritur përgjysmë, po kinezëve u tregojmë realitetin tonë, në mënyrë që ata jo vetëm ta kenë të qartë si është gjendja te ne, por, po të duan, le të mësojnë ca edhe mbi metodën dhe eksperiencën e Partisë sonë në këtë drejtim.

Ata folën gjatë me delegacionin tonë edhe për çështjen e Stalinit, por ne nuk jemi dakord me tezat kineze për Stalinin. Çdo parti për këtë çështje ka mendimin e vet, po kështu edhe Partia jonë. Kryesorja është të nxjerrim mësimet të gjithë nga ajo që ndodhi në Bashkimin Sovjetik dhe për këtë është e domosdoshme analiza marksiste-leniniste e ngjarjeve. Shokët kinezë kanë pikëpamjen se këto gjëra atje ndodhën për

arsye se «Stalini ka pasë bërë gabime», se ai ka formuluar tezën që «në Bashkimin Sovjetik janë likuiduar klasat shfrytëzuese», prandaj, sipas tyre, nuk ka vazhduar lufta e klasave, se «kuadrot zgjidhin çdo gjë», se «teknika zgjidh çdo gjë» etj.

Nga analizat që kemi bërë ne, si në teori dhe në politikën e përgjithshme parimore, del, së pari, se Stalini nuk ka bërë gabime parimore. Të gjithë e dimë se Partia Bolshevike, me Leninin dhe me Stalinin në krye, ka goditur pa mëshirë klasat shfrytëzuese, ekonomikisht, politikisht e ideologjikisht. Të mos harrojmë, shokë, gjithë luftën e madhe që u bë atje kundër kulakëve, trockistëve, buharinistëve e të tjerëve. Kjo ishte një luftë e tërë, intensive, prandaj nuk do të ishte e drejtë të themi që Stalini gaboi në drejtim të klasave dhe të luftës së klasave. Nga ana tjetër, nuk mund ta akuzosh Stalinin se «humbi sensin marksist-leninist për rolin e masave», se «nuk u mbështet më tek ato» dhe «se në veprimtarinë e tij ai përdori vetëm masa administrative» etj., siç thonë kinezët. Kjo, në vija të përgjithshme, nuk është kështu. Stalini kishte besim te partia dhe te kuadrot dhe, të kesh besim te kuadrot, nuk do të thotë të mos kesh besim te masat.

Stalinin ne e gjykojmë nga faktet, nga shkrimet dhe nga dokumentet e tij, nga e gjithë jeta dhe vepra që na ka lënë pas, kurse kinezët nuk e analizojnë këtë çështje si duhet dhe thellë për të parë që rreziku në Partinë Komuniste Bolshevike erdhi për arsye se orientimet e drejta politike dhe ideologjike të Stalinin u shtrembëruan nga administrata, nga aparatet e partisë, e cila po burokratizohej, po plakej e skle-

rozohej. Njerëzit e aparateve në Partinë Bolshevike, sipas konkluzionit në të cilin kemi arritur, kanë luajtur rolin më *nëfaste*<sup>1</sup>. Aparatet në Bashkimin Sovjetik krijuan një frymë të tërë të sëmurë, e rrethuan dhe e mbytën udhëheqjen. Aparatçikët flisnin se në parti çdo gjë shkon mirë, se kudo ka unitet etj. dhe nuk e informonin Stalinin për situatën reale, për fenomenet regresive që po zhvilloheshin në vend dhe në parti. Ku me dashje, ku pa dashje, Stalinit i fshihej e vërteta që ai të mos e kuptonte se si rrihte pulsi i partisë, të mos e shihte rrezikun e brendshëm. Nën këtë metodë pune rutine atje u krijua një shtresë e tërë njerëzish burokratë, ndër të cilët ishin edhe nga ata që i donin partinë dhe Stalinin, që në kohë të vështira u hodhën edhe në zjarr me emrin e tyre. Lufta e Madhe Patriotike në Bashkimin Sovjetik luajti një rol të rëndësishëm pozitiv në edukimin e njerëzve, por shumë kuadro, nën prizmin e arsyetimeve që «sakrifikuam», «luftuam», «duhet të kemi favore», «të dëgjohemi» etj., etj., ranë në rehati, e humbën vrullin revolucionar dhe ndjenjën e sakrificës. Këtu ishte e gjithë rrezikshmëria, po këtu, brenda këtyre qëndronin edhe komplotistët.

Ka disa të dhëna shumë simptomatike, të cilat dëshmojnë për vigjilencën e lartë të Stalinit edhe në periudhën e fundit të jetës së tij. Natyrisht, këtë e themi nga ato që dimë ne, se dokumentet si qëndron e vërteta për këtë çështje janë atje, në duart e revizionistëve. Mikoja neve na ka thënë vetë

---

1 Frëngjisht — negativ, të keq.

se ai me Hrushovin donin ta vritnin Stalinin, mbasi ky vitet e fundit, para se të vdiste, kishte dyshuar për këta agjentë anarkistë, të cilët, për të mos u zbuluar, kishin përgatitur atentatin kundër tij. Nga ky fakt dhe nga sa dimë ne del se Stalini nuk e humbi asnjëherë vigjilencën. Ai ka dyshuar te këta agjentë, si Mikoiani dhe Hrushovi, bile ka kritikuar edhe Molotovin, Voroshilovin e të tjerë. Kjo do të thotë se ai ishte vazhdimisht vigjilent.

Jeta i vërtetoi dyshimet dhe kritikën e Stalinit. Kur Hrushovi mori fuqinë në dorë, Molotovi dhe shokët e tjerë, në vend që të reagonin si revolucionarë e të mbronin vijën e Stalinit, mbështetën dhe adoptuan vijën burokratike të njerëzve të aparateve. Ata nuk u dhanë grushte hundëve pasuesve të trockistëve, zinovievistëve e të tjerëve dhe të likuidonin kështu Hrushovin dhe bandën e tij. Kjo tregon për humbjen e hovit revolucionar të dikurshëm të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Në këto situata të reja, shokë, edhe Stalini mund të ketë menduar gabimisht se armiku do të shfaqej në parti në format e zakonshme, siç u shfaqën dikur trockistët, zinovievistët e të tjerë. Por kësaj radhe nuk ndodhi kështu. Armiku fitoi eksperiencë nga disfatat që pësoi. Gjatë zhvillimit të luftës së klasave, të udhëhequr nga Stalini, armiku u tulat, i shpëtoi goditjes, punoi me perspektivë, njohu mirë kuadrot që Partia kishte në krye, të mirat dhe dobësitë e tyre, dhe qëndroi në pritje.

Stalini i kishte vënë theksin luftës kundër imperializmit, pra, kryesisht rrezikut nga jashtë që mund

t'i nxiste këto mbeturina. Në këtë drejtim ai ishte i qartë dhe bënte një luftë të ashpër. Stalini mendonte se po të lindte në Bashkimin Sovjetik një punë armiqësore brenda në parti, kjo do të paraqitej në format e vjetra, trockiste, buhariniste etj. dhe partia, me të në krye, do ta zbulonte dhe do ta likuidonte, mbasi kishte eksperiencë të madhe në luftëra për eliminimin e kompleteve të kësaj natyre. Në këtë pjesë unë trajtoj në mënyrë marksiste pikëpamjen tonë, jap edhe të dhëna nga eksperiencia e Partisë sonë.

Pra, kjo që ngjau në Bashkimin Sovjetik nuk ishte rezultat i veprimtarisë së klasave shfrytëzuese që gjoja nuk ishin likuiduar, siç thonë kinezët, por i shumë faktorëve të tjerë. Një nga këta faktorë është se atje u krijua aristokracia punëtore brenda në partinë marksiste-leniniste dhe me këtë «legalitet» burokratik, duke spekuluar me shprehje të tipit «Komiteti Qendror e di» etj., përfituan dhe morën fuqinë revizionistët modernë. Këtu, pra, qëndron rreziku. Tani, në kuadrin e kësaj kthese regresive që ndodhi, revizionistët bënë edhe fuzionimin me elementët e klasave shfrytëzuese.

Ne jemi larg situatash të tilla. Partinë e kemi të fortë, të gjallë, revolucionare. Lufta te ne ka bërë një efekt të madh revolucionar, fryma e saj është mbajtur vazhdimisht lart. Kurdoherë dhe me konsekuencë u goditën armiqtë e Partisë, trockistët dhe sëmundje të tjera që mundoheshin të qepeshin pas trupit të shëndoshë të Partisë sonë. Por koha tregon se edhe te ne ka elementë që, kur vjen puna t'i preket pak interesi personal, hidhen përtpjetë. Një gjë

të tillë ne nuk e kemi lejuar e nuk duhet ta lejojmë kurrë. Elementëve të tillë, nëse e quajmë veten revolucionarë, ne duhet t'u themi të vijnë në vete, të luftojnë mirë dhe gjer në fund së bashku me Partinë. Në rast se nuk janë të tillë, atëherë le të qëndrojnë e të punojnë jashtë Partisë, por jo të jenë në radhët e pararojës, të Partisë sonë. Partinë ta ruajmë kurdoherë të pastër.

Një nga problemet e rëndësishme që trajtoj unë aty është edhe çështja e «kultit të Stalinit». Duke marrë shkas nga kjo çështje, në material bëj aluzion, duke i rënë derës që të dëgjojë penxherja, sepse në Kinë tani po bëhet një propagandë e shfrenuar anti-marksiste për Mao Ce Dunin<sup>1</sup>. Kjo nuk është një metodë e drejtë leniniste.

E di vallë ai se si po ngrihet atje kulti i tij? Nuk mund të themi se nuk e di, por nuk merr masa për ta ndaluar këtë propagandë. Pavarësisht nga ato që bëhen për të në Kinë, ne nga ana jonë të ndjekim, si kurdoherë, rrugën e drejtë marksiste-leniniste, prandaj nuk jemi dakord me shprehjen që Mao Ce Duni është «dielli» dhe me shprehje të tjera të këtij lloji siç bëjnë kinezët, sepse, si e pompojnë dhe si e shtrojnë ata në propagandën e tyre «maocedunidenë», është idealiste. Ne të mos bienim në pozitat e propagandës kineze në lidhje me kultin e Maos, por të mbajmë seriozitetin marksist-leninist të Partisë sonë dhe, në qoftë se do t'u pëlqejë ky qëndrim, le të bëjnë edhe ata kështu. Partia jonë do të ecë kurdoherë në rrugë të

1 Shih: Enver Hoxha. «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 219.

drejtë. Partia dhe populli nuk mund të varen nga një njeri. Këtu nuk ka çështje sentimentalizmi, po mendoj se kush i fryn kultit të individit, do të thotë se nuk e ka të qartë rrugën e partisë. Moszbatimi i vijës së saj edhe në këtë çështje, ka rreziqe. Këtë ta kemi dhe e kemi të qartë dhe mendoj se ne po e zbatojmë mirë vijën edhe në këtë drejtim, por duhet të jemi kurdoherë e në çdo rast të rreptë si ndaj vetes sonë, ashtu edhe ndaj të tjerëve. Këto që themi dhe që mendojmë se janë të drejta, ne do t'i themi, edhe në qoftë se ndokujt nuk do t'i pëlqejnë. Çdo gjë ta shohim me kujdesin më të madh, jo vetëm për brenda vendit por edhe në kuadrin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



# **PARTIA JONË DO TË VAZHDOJË SI KURDOHERE ME KONSEKUENCË, ME TRIMËRI E ME PJEKURI LUFTËN E KLASAVE**

*Nga biseda me Çu En Lain<sup>1</sup>*

**24 qershor 1966**

Jemi shumë të gëzuar që ju kemi midis nesh. Vizita e delegacionit tuaj, ashtu sikurse vizita e delegacionit të Partisë dhe të Qeverisë sonë që u bë në Kinë pak kohë më parë, kanë një rëndësi të madhe për të dy popujt dhe partitë tona. Edhe jehona në arenën ndërkombëtare e në lëvizjen komuniste ndërkombëtare nuk ka qenë e vogël. Deklarata e përbashkët tregoi edhe një herë forcën tonë të madhe në luftë kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, në luftë kundër revizionizmit modern, me atë hrushovian dhe titist në krye, në mbrojtje të luftërave nacionalçlirimtare të popujve.

Marksizëm-leninizmi që na udhëheq, zbatimi i tij

---

<sup>1</sup> Çu En Lai kryesonte delegacionin e Partisë Komuniste dhe të qeverisë kineze që vizitoi Shqipërinë nga data 24-28 qershor 1966.

me guxim, me konsekuencë, me tej pamje dhe në mënyrë krijuese, pa devijime, në kushtet reale të çdo vendi përbën të vetmen garanci të madhe për ndërtimin socialist, përbën po ashtu për lëvizjen komuniste ndërkombëtare të vetmen forcë udhëheqëse dhe shtytje përpara në revolucion e në luftë për shembjen përfundimtare të imperializmit botëror, të revizionizmit modern dhe të gjithë reaksionit.

Unë dëshiroj sot, në emër të popullit shqiptar, të Partisë së Punës të Shqipërisë, të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë sonë, të falënderoj nxehtësisht nga zemra popullin e madh vëlla kinez, Partinë Komuniste të Kinës, Komitetin e saj Qendror, qeverinë kineze dhe veçanërisht shokun Mao Ce Dun, për pritjen e ngrohtë që iu bë delegacionit tonë kur ishte në Kinë.

Komiteti Qendror i Partisë sonë dhe Qeveria dëgjuan me kujdesin më të madh raportin e hollësishëm të shokëve Mehmet dhe Hysni, rreth punës së tyre në Pekin e kudo ku vajtën në Kinë, studiuam me vëmendje të madhe Deklaratën e përbashkët dhe u shfaqëm plotësisht dakord me gjithë veprimtarinë e delegacionit tonë. Nënshkrimin e Deklaratës ne e konsiderojmë një sukses të madh dhe e çmojmë atë si një dokument që na hap horizonte të gjera pune e lufte revolucionare për suksese edhe më të mëdha në të ardhmen.

Në Shqipëri ndërtohet me vrull e frymë revolucionare socializmi dhe njerëzit frymëzohen e udhëhiqen nga Partia jonë e Punës, marksiste-leniniste. Edhe sukseset tuaja në lëmin e bujqësisë, të industri-

së, të teknikës, të shkencës dhe sidomos në kalitjen e njerëzve, ne i ndjekim me admirim. Këto suksese gëzojnë miqtë e, në radhë të parë, mikun tuaj besnik, popullin shqiptar dhe Partinë e tij të Punës. Këto suksese hidhërojnë dhe egërsojnë armiqtë tanë e, në radhë të parë, imperializmin amerikan, revizionistët modernë hrushovianë dhe gjithë reaksionarët.

Partia jonë dhe gjithë populli shqiptar ndjekin me një ndjenjë të plotë solidariteti marksist-leninist Revolucionin e madh Kulturor Proletar që po zhvillohet te ju, solidarizohen plotësisht me grushtin dërrmues që u jepet revizionistëve modernë. Spastrimi radikal i revizionistëve modernë në Kinë përfaqëson sigurinë e së ardhmes së saj.

Uji fle, armiku s'fle, thotë populli ynë. Mjerë ata që i zë gjumi. Kjo nuk do të ngjasë në partitë marksiste-leniniste dhe në të gjithë revolucionarët, në rast se e mbajnë të mprehtë shpatën e diktaturës së proletariatit, luftën e klasave, vigjilencën revolucionare, në rast se e vazhdojnë pandërprerë luftën kundër imperializmit, kundër revizionizmit modern, kundër reaksionarëve të brendshëm e të jashtëm.

Armiku i klasës është dinak, i egër, prandaj duhet të jomi të ashpër në kulm kundër tij, të pamëshirshëm dhe në luftë për jetë a për vdekje me të. Armiku s'të fal prandaj edhe ne jo vetëm s'duhet ta falim, por ta likudojmë atë me rrënjë. Ndaj armiqve nuk duhet të kemi iluzione dhe as të bëjmë lëshime. Ky ka qenë dhe është parimi që ka udhëhequr e udhëheq Partinë tonë.

Ajo katastrofë që ngjau në Bashkimin Sovjetik, në vendet e demokracisë popullore të Evropës dhe në mjaft parti komuniste e punëtore të botës, nuk duhet të lejohet të ngjasë në vendet dhe në partitë tona. Jo vetëm nuk duhet të ngjasë kurrë, por për ne është detyrë jetike, detyrë e madhe internacionaliste që tok me partitë e tjera marksiste-leniniste të botës, me grupet revolucionare marksiste-leniniste dhe me të gjithë marksistë-leninistët, në unitet mendimi marksist-leninist, në unitet veprimi revolucionar, në krye të popujve, ta ngjitim me luftë korentin, ta përmbysim këtë situatë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, t'i demaskojmë, pastaj t'i mundim, t'i shpartallojmë revizionistët dhe padronët e tyre imperialistë.

Sigurisht, ajo që ngjau në Bashkimin Sovjetik, pavarësisht nga metodat puçiste e fashiste që përdorën revizionistët hrushovianë kur rrëmbyen pushtetin në duart e tyre, nuk ishte një fenomen spontan, por i parapërgatitur me kohë prej tyre. Këtë e tregon fakti se Hrushovi dhe bashkëpunëtorët e tij kryesorë të puçit, para vdekjes së Stalinit, kanë qenë nga udhëheqësit kryesorë që vepronin nën rrogë, që përgatitnin dhe pritnin momentin e përshtatshëm për një veprim në shkallë të gjerë e të hapët. Është fakt se këta tradhtarë ishin konspiratorë të regjur me eksperiencën e kundërrevolucionarëve të ndryshëm rusë, me eksperiencën e anarkistëve, trockistëve, buharinistëve dhe me eksperiencën e revolucionit e të Partisë Bolshevike. Këta nuk bënë asgjë për revolucionin, përkundrazi bënë çdo gjë për të minuar revolucionin dhe socializmin, duke u shpëtuar goditjeve të revolucionit dhe të dik-

taturës së proletariatit. Me një fjalë, këta ishin kundër-revolucionarë dhe vepronin si njerëz me dy faqe. Nga një anë i thurnin lëvdata socializmit, revolucionit, Partisë Komuniste Bolshevike, Leninit dhe Stalinit dhe, nga ana tjetër, përgatitnin kundërrevolucionin.

Vihet pyetja për të gjithë ne: Përse këta nuk u zbuluan e nuk u goditën me kohë? Zbulimi dhe goditja në kohën e duhur kanë rëndësi vendimtare për të mos lejuar që mikrobi i sëmundjes të rritet e të forcohet në një trup të prekur nga sëmundja. Diagnoza e saktë duhet të bëhet medocemos për ta luftuar e për ta shfarosur sëmundjen dhe për të mos e lënë të shfaqet dhe të rrezikojë përsëri.

Partia jonë ndodhet në luftë të ashpër, të pandërprerë, të papërkulur, prej gati 20 e ca vjetësh me radhë kundër revizionizmit modern titist dhe e ka plotësisht të qartë origjinën, vijën, strategjinë, taktikën dhe metodat e zhvillimit e të luftës së kësaj agjente të borgjezisë dhe të imperializmit. Në mënyrë aktive po lufton Partia jonë me të gjitha forcat kundër revizionizmit hrushovian qëkurse ky nxori veshët. Në këtë luftë ajo ka fituar një eksperiencë të madhe, eksperiencë që i është shtuar asaj të fituar nga lufta kundër titistëve.

Vija e ndjekur nga Stalini, gjatë gjithë jetës së tij derisa vdiq, për mendimin e Partisë sonë, ka qenë një vijë e drejtë marksiste-leniniste, revolucionare.

Të marrim çështjen e luftës së klasave. Nuk mund të kritikohet Stalini qoftë edhe një grimcë për qëndrim oportunist ndaj fuqive kapitaliste dhe imperialiste. Përkundrazi, ai ishte me ta në luftë të ashpër, të pa-

mëshirshme, thikë më thikë. Veprat e tij teorike dhe politike si dhe veprimet e Bashkimit Sovjetik në arenën ndërkombëtare e vërtetojnë këtë. Në qoftë se në politikën e Bashkimit Sovjetik, gjatë gjithë periudhës së Stalinit, mund të gjenden pika të dobëta në taktikë, të diktuar nga rrethanat e ndryshme, nga tërheqjet taktike ose nga mospeshimi i thellë për mungesë faktesh dhe analizash të plota të rrethanave të ndryshme, këto nuk bëjnë kryesoren. Kyresorja ka qenë drejt. Kjo ishte një fitore kolosale për Bashkimin Sovjetik, për lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe për popujt që luftuan e luftojnë kundër fuqive imperia-liste dhe fashizmit. Në dritën e evenimenteve aktuale del akoma më qartë se, drejtësia e këtij qëndrimi klasor ka qenë merita e Stalinit, pse, pas vdekjes së tij, bashkëpunëtorët e tij të afërt, tok me hrushovianët në mes, e ulën në baltë këtë flamur.

Le të shikojmë në vija të trasha luftën e klasave brenda në Bashkimin Sovjetik, pas Revolucionit dhe gjatë gjithë jetës së Stalinit. Sipas mendimit të Partisë sonë, në vijën e Partisë Bolshevike në kohën e Stalinit nuk ka gabime parimore, kurse në taktikat, në format e në metodat mund të gjejmë edhe gabime, por edhe këto duhet t'i gjejnë në rrethanat dhe koniunkturat e atëhershme dhe jo t'i shohim me syrin e tanishëm dhe me eksperiencën e madhe të fituar nga partitë tona.

Diktatura e proletariatit, gjatë gjithë jetës së Stalinit, nuk mund të thuhet se u fishk ose se u zbut. Përkundrazi, ajo goditi pa mëshirë politikisht, ekonomikisht, ushtarakisht armikun e klasës dhe e likuidoi

atë pa mëshirë. Pas fitores së Revolucionit, pas marrjes së pushtetit, pas intervencionit dhe NEP-it, klasat shfrytëzuese kapitaliste të qytetit dhe të fshatit në Bashkimin Sovjetik pësuan, si me thënë, një goditje kolosale dhe rrënjësore. Ekonomikisht ato u lanë, si i thonë fjalës, me gisht në gojë.

Por s'mund të themi se diktatura e proletariatit në Bashkimin Sovjetik, sa ishte gjallë Stalini, veprimi në mënyrë të njëanshme vetëm për likuidimin e forcës ekonomike të klasave shfrytëzuese dhe la mënjanë ose zbuti luftën politike dhe ideologjike kundër tyre. Përkundrazi, edhe lufta politike dhe ideologjike ishte kolosale. Këtë e vërteton katërcipërisht lufta konkrete dhe e përditshme, e Stalinit, e Partisë Bolshevike, e gjithë popullit sovjetik, e vërtetojnë shkrimet politike dhe ideologjike të Stalinit, dokumentet dhe vendimet e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, e vërtetojnë shtypi dhe propaganda masive, e atyre kohëve kundër trockistëve, buharinistëve, zinovievistëve, tu-kaçevskëve e mijëra tradhtarëve të tjerë. Kjo nuk mund të mos quhet luftë klase e ashpër politike dhe ideologjike për të mbrojtur socializmin, diktaturën e proletariatit, partinë dhe principet e marksizëm-leninizmit.

Këtu Stalini ka merita të mëdha, ai u tregua një marksist-leninist i madh me parime të qarta, me guxim e gjakftohtësi të madhe, me pjekuri e tej pamje prej revolucionari marksist. Vetëm po të mendojmë ç'forcë kishte në ato kohë armiku i jashtëm dhe ai i brendshëm në Bashkimin Sovjetik, i vetmi vend socialist në botë, ç'dredhi, ç'propagandë të shfrenuar bënte,

ç'taktika djallëzore përdorte armiku, atëherë do të çmojmë si duhet veprimet e drejta të Stalinit në krye të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

A ka pasur gabime, teprime, përcaktime disa herë jo rigorozisht ekzakte? Sigurisht ka pasur. Ne tash mund t'i analizojmë ato dhe t'i vlerësojmë më drejt në kontekstin e tyre, në rrethanat e krijuara dhe ç'konsekuenca do të kishte atëherë po të veprohej ndryshe. Por kryesorja mbetet dhe është e drejtë. Stalini është zor ta kritikosh për shkeljen dhe mosmbrojtjen e parimeve leniniste, është e zorshme ose e pamundur ta akuzosh atë për shfaqje oportuniste në vijë, për miopi politike dhe ideologjike proletare. Vigjilencia revolucionare e Stalinit vërtetohet edhe në vitet e fundit të jetës së tij. Ai zbuloi dhe demaskoi veprimtarinë tradhtarë e revizioniste të Titos dhe të titizmit. Kjo është meritë e madhe e Stalinit.

Para se të vdiste — këtë e ka pohuar vetë Hrushovi — Stalini u tha udhëheqësve sovjetikë se unë kam frikë se ju do t'i gjuhëzoheni imperializmit. Dhe kështu ngjau. A ishte kjo një mungesë vigjilence, nga ana e Stalinit? A ishte kjo një shprehje e rastit, apo konkluzion i një reflektimi të thellë të një revolucionari të madh që shikonte larg dhe vinte në korent partinë dhe popullin që t'i kishin sytë hapur, të ishin vigjilentë dhe të përballonin rreziqet që mund t'i kërcënonin në të ardhmen? Ky konkluzion i fundit për Partinë tonë është i vërtetë.

Atëherë vihet pyetja, kur çështja qëndron kështu, përse Partia Komuniste Bolshevike dhe populli sovjetik i lanë revizionistët sovjetikë të marrin fuqinë?



Marrja e pushtetit nga brenda nga revizionistët modernë sovjetikë, pa armë e pa dhunë, si të thuash, është një fenomen i ri. Stalini në fakt, mendojmë ne, nuk e kishte parashikuar këtë veçanërisht për Bashkimin Sovjetik. Ai nuk nënvleftësoi kurrë egërsinë e elementëve të klasave shfrytëzuese që sa më shumë i afrohen varrit, aq më me tërbim e luftojnë socializmin dhe diktaturën e proletariatit por, në gjendjen në të cilën ndodheshin këto mbeturina, ne mendojmë se Stalini, duke e çmuar të fortë situatën e brendshme, vlerësonte, dhe jo gabim, se imperializmi i jashtëm ishte aleati që mund t'i mëkëmbte këto mbeturina.

Stalini vinte theksin në rrezikun nga jashtë, kurse, mund të themi, nuk e parashikoi në tërë kuptimin e saj rrezikshmërinë e elementëve revizionistë, që, për arsye të shumë rrethanave, subjektive dhe objektive mund të dilnin brenda në parti dhe në shtetin socialist dhe të transformoheshin në një rrymë antimarksisiste, në mënyrë graduale, me dashje dhe pa dashje, në mënyrë të ndërgjegjshme dhe jo të ndërgjegjshme, me plan të organizuar dhe pa plan, veçanërisht në gjirin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe në vetë Bashkimin Sovjetik. Ai kishte bindjen se po të lindte një punë armiqësore antiparti, brenda në parti, kjo mund të zhvillohej, të organizohej në format e zakonshme, por kishte gjithashtu shumë besim se ajo do të goditej e do të likuidohej me format e zakonshme dhe me mënyrat me të cilat u demaskuan dhe u likuiduan të gjitha të tjerat. Fakt është se këtë herë me revizionistët modernë, nuk ngjau si zakonisht me punët antiparti.

Kurse veprimet e Partisë Komuniste Jugosllave dhe të grupit titist, Stalini i shikoi më me mprehtësi dhe arriti në konkluzione të drejta. Këtë e vërtetojnë letrat drejtuar Titos dhe dokumentet e Informbyrosë, dokumente që kanë një rëndësi të madhe dhe kur lexohen, sidomos tash, ne mund të gjykojmë akoma më mirë se sa të drejta kanë qenë pikëpamjet klasore të Stalinit.

Krerët revizionistë hrushovianë i fshihnin shumë mirë këmbët, duke vepruar të mbuluar me flamurin e kuq të Stalinit.

Ne mendojmë se ka pasur kontradikta, ka pasur fërkime në udhëheqjen e Bashkimit Sovjetik dhe nuk mund të pranojmë tezën absurde të hrushovianëve se asnjë udhëheqës nuk mund të hapte gojën për të thënë mendimin e tij, pse kishte frikë nga Stalini. Por, nga sa kemi marrë vesh, Stalini edhe Hrushovin e ka quajtur narodnik, edhe Voroshilovin e ka kritikuar, po kështu edhe Molotovin e të tjerë. Pra, nga një anë duhet të konkludojmë se Stalini nuk ishte miop politik, por, nga ana tjetër, nuk përdorte gjithmonë plumbin dhe terrorin, siç pretendojnë armiqtë, përkundrazi bindjen dhe rrahjen e mendimeve.

Pavarësisht se nuk dimë dokumentet e brendshme që përcaktojnë shumë gjëra, është fakt se Stalini nuk e diktoi rrezikshmërinë e tradhtarëve Hrushov, Mikojan e të tjerë dhe Lufta Patriotike ka luajtur një rol të madh në këtë çështje. Në qoftë se Stalinin mund ta bëjmë fajtor, është fakti se ai në vitet e pasluftës, dhe sidomos në vitet e fundit të jetës së tij, nuk diktoi se puls i partisë së tij nuk rrihte si më parë, ajo e kishte

humbur dhe po e humbiste hovin revolucionar, ishte sklerozuar dhe, me gjithë heroizmat në Luftën e Madhe Patriotike, nuk e mori veten si duhet dhe tradhtarët hrushovianë përfituan. Këtu, mendoj unë, në qoftë se nuk gabohem, duhet të kërkojmë origjinën e dramës që ngjau në Bashkimin Sovjetik.

Ndërtimi i socializmit në Bashkimin Sovjetik dhe lufta kundër armikut të jashtëm, ashtu edhe atij të brendshmit, u zhvillua me një frymë revolucionare të lartë nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe nga Stalini që e drejtonte. Goditjet e pamëshirshme dhe të drejta kundër trockistëve, buharinistëve e të tjerëve, ishin përfundimi logjik i kësaj lufte të madhe klasore.

E tërë kjo luftë komplekse e shumanshme e rriti autoritetin e drejtë të Stalinit dhe të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik. Kjo ishte pozitive, por me metodat dhe me format e punës që u përdorën në drejtimin e partisë, u arrit në një rezultat të kundërt.

Po t'u bëhet një analizë e imët direktivave politike, ideologjike dhe organizative, të Stalinit në drejtimin dhe në organizimin e partisë, të luftës dhe të punës, në përgjithësi nuk do të gjenden gabime parimore, por ne do të shohim që pak nga pak partia u burokratizua, e mbuloi puna rutinë, formalizmi i rrezikshëm që e ndrydhi partinë, që e mbysin frymën dhe hovin revolucionar të saj. Partia mbulohej nga një ndryshk i rëndë, nga një apati politike, duke menduar gabimisht se vetëm koka, udhëheqja vepron e zgjidh gjithçka. Nga një koncept i tillë në punë u

krijua gjendja që kudo e për çdo gjë thuhej: «Këtë e di udhëheqja», «Komiteti Qendror di çdo gjë», «Komiteti Qendror nuk gabon», «Këtë e tha Stalini dhe mbairi». Shumë gjëra mund të mos i thoshte Stalini, po mbuloheshin me emrin e tij. Aparatet dhe nëpunësit u bënë «të plotfuqishmit», «të pagabueshmit» dhe vepronin në rrugë burokratike nën formulat e centralizmit demokratik, të kritikës dhe të autokritikës bolshevike, që nuk ishte më bolshevike. S'ka dyshim se kështu Partia Bolshevike e humbi vitalitetin e saj të dikurshëm, ajo rronte me formula të drejta, por vetëm formula; ajo zbatonte, por nuk vetëvepronte.

Në kushte të tilla masat administrative burokratike nisën të mbizotëronin mbi ato revolucionaret. Masat revolucionare të drejta, të marra kundër armiqve të klasës, pas këtyre metodave e formave burokratike të punës, në vend që të bënë efektin e duhur u kthyen në një efekt të kundërt dhe u përdorën nga burokratët për të krijuar frikën në parti dhe në popull. Vigjilencia revolucionare nuk ishte më operuese, pse s'ishte më revolucionare, pavarësisht se trumbetohej si e tillë. Ajo, nga një vigjilencë partie dhe e masave, po kthehej në një vigjilencë të aparateve burokratike dhe po transformohej në mos tërësisht, nga pikëpamja e formave, në fakt në vigjilencë të sigurimit e të gjyqeve.

Është e kuptueshme se në kushte të tilla, në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik zunë rrënjë dhe zgjeroheshin në radhët e komunistëve e në ndërgjegjen e shumë prej tyre ndjenja e pikëpamje joproletare, jo të klasës. Po zhvilloheshin karrierizmi, servilizmi, sharlatanizmi, përkrahjet e sëmura, morali antipro-

letar etj., që gërryenin partinë nga brenda, shuanin ndjenjën e luftës së klasës dhe të sakrificave dhe nxitnin rendjen drejt një jete «të mirë», të rehatshme, me privilegje, me përfitime personale, me sa më pak punë e mundime. «Punuam, luftuam dhe fituam për këtë shtet socialist, tash le të gëzojmë e të përfitojmë, ne jemi të paprekshëm, e kaluara na mbulon çdo gjë», i tillë mentalitet borgjez e mikroborgjez po krijohesh dhe rrezikshmëria e madhe ishte se kjo po zhvillohej edhe në kuadrot e vjetër të partisë me një të kaluar të mirë dhe me origjinë proletare, të cilët duhet të ishin shembull pastërtic, për të tjerët. Shumë të tillë që përdornin bukur fjalët, frazat revolucionare, formulat teorike të Leninit e të Stalinit, që kornin dafinat e punës së të tjerëve dhe jepnin e inkurajonin shembullin e keq, ndodheshin në udhëheqje, në aparate. Po krijohej në Partinë Komuniste të BRSS një aristokraci punëtoze prej kuadrosh burokratë.

Një proces i tillë degjenerimi zhvillohej për fat të keq nën parullat «e gëzuara» dhe «shpresëdhënëse» se «çdo gjë shkon mirë, normalisht, brenda normave e ligjeve të partisë», që në fakt shkeleshin, nën parullat se «lufta e klasave vazhdon dhe bëhet», se «ruhet centralizmi demokratik», «kritika dhe autokritika vazhdon si më parë», se «ekziston uniteti i çeliktë në parti», «s'ka më elementë fraksionistë dhe antiparti», «kaloi koha e grupeve trockiste buhariniste» etj., etj. Një kuptim i tillë, i deformuar i situatës, dhe këtu qëndron thelbi i dramës dhe i gabimit fatal, konsiderohej edhe nga elementët revolucionarë si një realitet normal në përgjithësi, prandaj mendohej se s'kishte asgjë

për t'u alarmuar, pse armiqtë, vjedhësit, shkelësit e moralit dënoheshin nga gjyqet, anëtarët e padenjë të partisë përjashtoheshin nga partia si zakonisht dhe si zakonisht pranoheshin të tjerë të rinj, se planet realizoheshin, por kishte që edhe nuk realizoheshin, se njerëzit kritikoheshin, dënoheshin, lavdëroheshin etj. Jeta, sipas tyre, ecte normalisht dhe Stalinit i raportohej se «çdo gjë ecte normalisht». Ne jemi të bindur se Stalini, si revolucionar i madh që ishte, po ta njihte realisht këtë situatë në parti, do t'i jepte grushtin dërmues kësaj fryme të sëmurë dhe partia e populli sovjetik do të ngriheshin peshë në këmbë, pse me të drejtë kishin besim të madh te Stalini.

Po pse s'e dha Stalini këtë grusht? Mos vallë se ai pajtohej me këtë situatë të sëmurë, se ai gabonte politikisht dhe ideologjikisht në parimet? Në asnjë mënyrë jo! Ne mendojmë se duhet mbrojtur deri në fund Stalini për këtë. Mund të kritikohet Stalini se në vitet e fundit të jetës së tij i dobësoi lidhjet me masat e partisë dhe të popullit, por kjo ndodhi vetëm fizikisht dhe kurrë ideologjikisht dhe politikisht. Stalini kishte besim te kuadrot, po nuk mund të thuhet se kishte besim vetëm te kuadrot dhe nuk kishte besim ose e kishte humbur besimin te njerëzit e thjeshtë, te masat e partisë dhe të popullit.

Jo vetëm aparatet nuk e informonin drejt Stalinin, deformonin burokratikisht direktivat e tij të drejta, por kishin krijuar një situatë të tillë në popull dhe në parti, saqë edhe kur Stalini, aq sa e lejonte moshë e shëndeti, shkonte pranë masave të partisë e të popullit, këto nuk e informonin atë për të metat dhe

gabimet që ndodhnin, pasi aparatet kishin ngulitur te njerëzit konceptin «ne nuk duhet ta shqetësojmë Stalinin».

Për sa i përket të ashtuquajturit kult të Stalinit tradhtarët hrushovianë e propaganduan me paramendim që ta përdornin gjerësisht kundër marksizëm-leninizmit, siç e përdorën. Ne mendojmë se Stalini nga vepra dhe lufta e tij, ishte një marksist i madh. Ai ishte i thjeshtë dhe nuk kishte nevojë që shtypi e propaganda sovjetike, sa ishte ai gjallë, ta pomonte në ato forma. Në këtë çështje, ne mendojmë se Stalini vetë, personalisht, nuk mori masa të rrepta që ta ekuilibronte në mënyrë marksiste-leniniste dhe të likuidonte anët e shumta negative e të rrezikshme të kësaj propagande, e cila mund të fshehë dhe, siç e treguan faktet, fshihte rreziqe të mëdha, se në propagandën jo të ekuilibruar për Stalinin fshiheshin edhe armiq e tradhtarë si Hrushovi me shokë, që bërtitnin më shumë se të tjerët dhe nën këtë maskë fshihnin komplotin e tyre. Këta tradhtarë, u duk qartë se, pas vdekjes së Stalinit, këtë propagandë të shfrenuar e përdorën si armë jo vetëm kundër Stalinit, jo vetëm kundër Bashkimit Sovjetik, por edhe kundër marksizëm-leninizmit në shkallë ndërkombëtare.

Stalinin s'duhet ta bëjmë përgjegjës për ato faje e gabime që ai nuk i ka bërë, nuk ka dashur të bëhen dhe që, po t'i diktonte, do t'i godiste pa mëshirë si revolucionar. Pra, fajet e rënda bien te shumë të tjerë, të mëdhenj e të vegjël, dhe mbi Partinë Komuniste të BS gjithashtu si tërësi, pse ajo nuk diti të luftojë e të reagojë fuqimisht e në mënyrë revolucionare,

në bazë të teorisë marksiste-leniniste militante kundër deformimeve burokratike, gjë që çoi në deformimet ideologjike dhe politike, në krijimin e rrymës së revizionistëve modernë, të cilët morën fuqinë nga brenda, duke pritur momentin e përshtatshëm, vdekjen e Stalinit.

Mikojani na ka pohuar neve se një herë kishin vendosur t'i bënin atentat, ta vrisnin Stalinin, po pastaj e lanë. Kjo nuk tregon vetëm qëllimet kriminale, të këtyre banditëve, po tregon edhe atë që, kur ata vendosën të vrisnin Stalinin, duhet të kishin qenë në rrezik të zbuloheshin. Ata, po ta kishin bërë këtë atentat, me siguri do të humbitnin dhe do të shkatërroheshin, pse e gjithë partia dhe populli do t'i shqyenin. Ata duruan edhe ca, siç duket. Pra, ky grup konspiratorësh puçistë e tradhtarësh e njihnin situatën në parti, ata njihnin kuadrot, të metat e dobësitë e tyre, ata në qetësi i kishin vënë në pozita kyçe dhe kishin përgatitur me kohë taktikën dhe strategjinë e tyre. Dhe kjo ka një rëndësi të madhe, të analizohet.

Molotovi dhe shokët e tij ishin revolucionarë të vjetër, komunistë të ndershëm, por ishin përfaqësuesit tipikë të asaj rutine burokratike, të atij «legaliteti» burokratik dhe, kur ata deshën në mënyrë të zbehtë ta përdornin atë kundër komplotit evident të hrushovianëve, puna kishte marrë fund me kohë. Burokracia dhe «legaliteti» burokratik u përdorën nga tradhtarët, të cilët me këtë «legalitet» mbuluan komplotin e pallatit dhe manovruan nëpërmjet rrjetit të tyre e gjithë shtresës së burokratëve me origjinë proletare dhe jo me origjinë kulake ose kapitaliste, feudale, për



të marrë në dorë frenat e partisë dhe të organeve të pushtetit.

Që pas vdekjes së Stalinit komplotistët hrushovianë manovruan aq mirë me këtë «legalitet», me «rregullat e partisë», me «centralizmin demokratik», me lotët prej krokodili për humbjen e Stalinit, duke përgatitur këmba-këmbës silurimin e veprës së tij, të personit të tij, të marksizëm-leninizmit, derisa u kurorëzuan në Kongresin e 20-të dhe në flakët që dogjën trupin e Stalinit. Kjo është një periudhë plot mësim për ne marksistë-leninistët se nxjerr në pah falimentimin e «legalitetit» burokratik që është një rrezikshmëri e madhe për një parti marksiste-leniniste, nxjerr në pah metodat që përdorin revizionistët që nga ky «legalitet» burokratik të përfitojnë ata, vë në dukje se si udhëheqës të ndershëm e me stazh, por që kanë humbur shpirtin revolucionar të klasës, bien në kllapat e intrigantëve dhe lëshojnë, tërhiqen para shantazheve, demagogjisë së revizionistëve, tradhtarë të maskuar me frazeologji revolucionare.

Në këtë periudhë tranzitore për konsolidimin e pushtetit të tyre, ne shohim se si hrushovianët, duke i bërë bujë të madhe se veprojnë me «një parti-shmëri të madhe», «të çliruar nga ankthi i frikës së Stalinit», «me forma me të vërtetë demokratike dhe leniniste», punuan aktivisht për të organizuar shpifjet më monstruoze që vetëm borgjezia ka mundur të bëjë kundër Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit. Gjithë kjo fushatë shpifjesh mbështeste dhe përpiquej të vërtetonte, gjoja me dokumente legale shpifjet shu-

mëvjeçare të kapitalistëve kundër marksizëm-leninizmit. Çdo gjë u përdor prej hrushovianëve, u shfletuan arkivat, dokumentet, procesverbalet e një pune që numërohej me dhjetëra vjet, nga të cilat u nxorën mendime e fraza të shkëputura, që i cituan për të interpretuar sipas qejfit të tyre taktikat e përdorura etj., u përdorën deri anekdota, ndodhi të jetës private të njerëzve, me një fjalë metoda tipike të një pune trockiste. E gjithë kjo punë u zhvillua për të atakuar strategjinë e drejtë revolucionare të Stalinit, për të atakuar e për të minuar normat leniniste, për të atakuar ideologjinë marksiste-leniniste, me forma pra pseudolegale, për të diskredituar Stalinin dhe socializmin në Bashkimin Sovjetik dhe në botë.

Vazhdimi e zhvillimi i punës tradhtare të revizionistëve hrushovianë dihet. Ata e kanë hedhur në dorë Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe kanë mbështetjen e një shtrese të madhe të partisë që është burokratizuar, që është transformuar e po transformohet në mënyrë sistematike në borgjezë të rinj. Mbeturinat e klasave shfrytëzuese kapitaliste në Bashkimin Sovjetik nuk mundën ta goditnin diktaturën e proletariatit, pse ishin të pafuqishëm e të shpartalluar, por mungesa e vigjilencës revolucionare, fishkja e luftës së klasës brenda e jashtë partisë, ulja e frymës revolucionare në çdo gjë, mungesa e një pune politike dhe ideologjike të thellë, masive, revolucionare, burokratizimi i partisë, bënë që një shtresë e tërë e partisë të humbiste krejt tiparet e proletariatit, të revolucionarit, të borgjezohej, të krijonte kuadrot e vet në parti e në shtet dhe të merrte fuqinë

në duart e veta. Atë që s'mundën ta bënë dot mbeturinat e klasave shfrytëzuese, e bënë këta dhe tash, në këtë legalitet revizionist në fuqi, bëhet fuzionimi i tyre klasor kundër revolucionit, kundër marksizëm-leninizmit, kundër socializmit.

Megjithëse në vendet e tjera ku sundojnë revizionistët modernë u përdorën të njëjtat metoda e qëllime dhe hrushovianët i ndihmuan me të gjitha mjetet që këta të merrnin fuqinë, për ne marksistë-leninistët është me interes të studiohen strategjia e taktikat që u përdorën nga tradhtarët e marksizëm-leninizmit dhe roli i veçantë që luajtën klasat borgjeze kapitaliste në cilindo nga këto vende. Përse? Sepse ka ndryshime të theksuara në këtë drejtim, ka ndryshime në zhvillimin e luftës së klasave, në intensitetin e luftës nacionalçlirimtare, në rolin e partive në këtë luftë, në vijën e tyre në luftën për arritjen e fitores, për çlirimin e vendit, për marrjen e pushtetit, për organizimin e tij e për konsolidimin e demokracisë popullore. I gjithë ky proces nuk u zhvillua njëjloj kudo. Ai është zhvilluar në mënyra të ndryshme në vende të ndryshme.

Të marrim, për shembull, Jugosllavinë. Ne kemi konkluduar prej kohësh se në Jugosllavi jo vetëm nuk ndërtohet socializmi, por as që kishte filluar ndonjëherë të ndërtohej dhe Partia Komuniste e Jugosllavisë nuk ka qenë parti marksiste-leniniste, jo vetëm qëkurse në krye të saj erdhi Titoja, por edhe në kohën e paraluftës dhe të Kominternit. Ne e njohim nga dokumentet legale të Kominternit punën e madhe fraksioniste e trockiste që zhvillohej në të. Ajo gjoja mori

stabilitet me ardhjen e Titos, por fakt është se Titoja nuk ishte veçse një agjent i vjetër i maskuar trockist i kapitalit.

Popujt e Jugosllavisë bënë një luftë heroike. Ky është fakt. Në Partinë Komuniste të Jugosllavisë kishte komunistë revolucionarë, të cilët luftuan heroikisht. Edhe ky është fakt. Fakt është gjithashtu se Titoja ishte në krye të partisë, në krye të udhëheqjes së luftës, por ai nuk ishte marksist, por një agjent borgjez i maskuar, që diti të kanalizojë për synimet e tij dëshirën dhe hovin luftarak të popullit për çlirimin e Jugosllavisë, që diti për këtë gjë edhe komunistët t'i fuste në këtë luftë dhe njëkohësisht t'i likuidonte, të bënte seleksionimin dhe të krijonte një ekip të tërë drejtuesish luftarakë e politikë me pikëpamjet e tij. Ai, që gjatë luftës, krijoi e konsolidoi shtabin e tij dhe prestigjin e vet. Titoja dhe shtabi i tij ishin nacionalistë shovinistë borgjezë të maskuar, nën drejtimin e politikës angleze. Megjithëse hiqej si marksist dhe pro-sovjetik, po të lexohen ato dokumente të pakta legale jugosllave të kohës së luftës, ne do të shohim se Titoja kishte kontradikta me sovjetikët dhe, pas çlirimit, veçanërisht në çështjen e Venecia-Xhulias dhe të Tries-tes, pavarësisht nëse kishte ose jo të drejtë nga ana etnike për këto vende, por fryma e tij ishte e hapët shoviniste dhe antisovjetike, antistaliniane.

Më vonë u duk qartë natyra e lidhjeve të ngushta e të fshehta me imperialistët dhe ndjekja e një politike hegjemoniste në Ballkan e në Evropën Qendrore nga ana e Titos, natyrisht në koordinim me anglo-ameri-

kanët për të penguar zhvillimin dhe konsolidimin e socializmit në vendet e Evropës Lindore e të Ballkanit dhe shkëputjen e tyre nga miqësia me Bashkimin Sovjetik. Tani Titoja këtë politikë e vazhdon në forma të tjera. Zadrugat (kooperativat bujqësore) e fillimit ishin një bluf dhe këto shpejt u shkatërruan. Pra, socializmi në fshatin jugosllav jo vetëm që nuk u fillua, por u forcua sektori privat, u zhvillua kulakëria. Edhe në industri u bënë konfiskime e shtetëzime, por këto nuk kishin synime socialiste, veçse bëheshin në emër të socializmit. Pronat e borgjezisë ishte e natyrshme se do të kalonin «në duart e popullit» që luftoi, por këto do të shërbenin për konsolidimin e fuqisë së klakës dhe do të bëheshin shpejt, pas prishjes me ne, nën formën e vetadministrimit, prona të klasës së re shfrytëzuese e shtypëse, me Titon në krye. Partia Komuniste e Jugosllavisë pas luftës u bë një ndihmëse e UDB-së, e aparatit shtypës dhe revolucionarët që militonin në të u likuiduan fizikisht me dhjetëra e qindra mijëra të akuzuar si «informbyroistë». Tash është shumë e qartë si zhvillohen punët në Jugosllavi.

Koha dhe momenti nuk na lejojnë, qoftë edhe shkurtimisht, siç bëra për Jugosllavinë, të flas edhe për Bullgarinë, për Rumaninë, për Çekoslovakinë, për Poloninë etj. Ju, sigurisht, i keni analizuar, por fakt është se në cilindo nga këto vende zhvillimi i degjenerimit, megjithëse ka karakter e tipare të njëjta të përgjithshme, prapëseprapë ka nuanca dhe tiparet e tij të zhvillimit, në funksion të atyre kushteve që përmenda më lart.

Për sa na përket neve, unë nuk dëshiroj të flas

për luftën e madhe të Partisë sonë për ndërtimin e socializmit, por dëshiroj të ndalem e të flas pak për procesin e luftës së klasës të zhvilluar nga Partia jonë dhe për rrugën që ka ndjekur ajo në likuidimin e klasave shfrytëzuese.

Atëherë, më lejoni ta vazhdoj<sup>1</sup>, shokë, ekspozenë tonë që ndërpreva dje.

**Zhdukja e klasave shfrytëzuese kapitaliste si klasa, është një proces i ndërlikuar që kryhet me ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit. Megjithatë lufta kundër mbeturinave të këtyre klasave të përmbysura dhe ideologjisë e botëkuptimit të tyre është një proces i gjatë, kompleks e mjaft i vështirë. Si është zhvilluar te ne ky proces e ç'rezultate janë arritur?**

Klasat shfrytëzuese nuk mund të zhdukeshin menjëherë as te ne, as në vendet e tjera socialiste. Është dashur e do të duhet një luftë e ashpër violente me armë, politike dhe ideologjike, një luftë klase e ashpër dhe e vazhdueshme nga diktatura e proletariatit dhe nën drejtimin e papërkulur të partisë marksiste-leniniste për marrjen me forcë të pushtetit politik nga ana e proletariatit nga duart e klasës kapitaliste shfrytëzuese dhe për vendosjen e pushtetit të diktaturës së proletariatit, për të zhdukur bazën ekonomike të klasës shfrytëzuese, për të zhdukur në përgjithësi pronën private, për të zhdukur marrëdhëniet kapitaliste në prodhim dhe për të vendosur pronën

---

1 Biseda vazhdoi të nesërmen.

shoqërore socialiste e marrëdhëniet socialiste në prodhim, për ta kthyer pronën socialiste aktuale në pronë të të gjithë popullit; njëkohësisht dhe tok me këto, për të ndërtuar një superstrukturë të re socialiste, duke spastruar rrënjësisht çdo mbeturinë të politikës dhe të ideologjisë borgjeze e mikroborgjeze në ndër-gjegjen e njerëzve.

Pavarësisht se procesi i zhdukjes së klasave shfrytëzuese është mjaft i vështirë, kjo varet edhe nga disa faktorë, siç janë:

1) Forca dhe organizimi i shumanshëm i klasës shfrytëzuese kapitaliste.

2) Violenca dhe ashpërsia e luftës së armatosur për marrjen e pushtetit nga ana e proletariatit dhe qartësia në vijë, vendosmëria dhe zgjuarsia në zbatimin e saj me konsekuencë e pa lëkundje nga ana e partisë komuniste ose punëtorë marksiste-leniniste që udhëheq luftën e çlirimit, vendosjen e diktaturës së proletariatit dhe ndërtimin e socializmit pas marrjes në dorë të pushtetit dhe thyerjes politikisht e ushtarakisht të klasave shfrytëzuese kapitaliste.

3) Ndërtimi me konsekuencë, duke u bazuar në parimet marksiste-leniniste të një strukture e super-strukture të re socialiste, në bazë të kushteve reale materialiste të vendit, duke ruajtur të mprehtë diktaturën e proletariatit dhe duke pasur vazhdimisht si forcë kryesore lëvizëse deri në zhdukjen e kapitalizmit botëror, deri në komunizëm, luftën e klasave.

Që të kuptojmë në realitet zhvillimin e luftës për zhdukjen e klasave shfrytëzuese në vendin tonë, duhet të njohim gjendjen e këtyre klasave para për-

leshjes dhe gjatë përlëshjes, forcën e tyre ekonomike, politike, ideologjike, influencën e tyre në masat e gjera të popullit, para dhe pas Çlirimit.

1) Shqipëria ka qenë kurdoherë vend i pushtuar nga armiq të jashtëm dhe i shfrytëzuar deri në palcë. «Pavarësia» u fitua vonë, por edhe gjatë kësaj kohe, edhe në qoftë se nuk ishte e pushtuar *de facto*, ajo ekonomikisht dhe politikisht *de jure* ishte e pushtuar. Kjo gjendje diktonte natyrën, forcën, zhvillimin e feudalizmit anadollak të klasës shfrytëzuese të vendit, e cila mbështeste politikën e okupatorëve, politikën koloniale të të huajve mbi një vend me ekonomi shumë të prapambetur dhe ku nuk bëhej as përpjekja më e vogël për të ecur në rrugën e zhvillimit kapitalist. Pra, feudalët si klasë, megjithëse në sajë të armëve të okupatorëve të ndryshëm, ruanin sundimin mbi tokën, mbi çifligjet dhe mbi fshatarësinë, ishin një klasë e degjeneruar që shkonte drejt likuidimit total.

2) Populli shqiptar ishte në luftë të vazhdueshme shekullore, në kryengritje, në revolta kundër okupatorëve, kundër feudalëve, kundër fesë gjithashtu. Mund të themi se kjo ishte një luftë e vazhdueshme antikoloniale, antiimperialiste dhe njëkohësisht një luftë klase antif feudale.

Lufta e popullit tonë, popull fshatar e blegtor, është shumë interesante në drejtimin e çlirimit të dyfishtë dhe të trefishtë më mirë, nga i huaji, nga beu e feudali vendas dhe nga feja, e cila u shërbente dy të parëve. Pra, populli ishte vazhdimisht në luftë me strukturën dhe me superstrukturën e rendit feudalo-



-okupator, ishte në luftë me armë, në luftë pasive, në luftë politike, në luftë ideologjike. Kjo bëri që të mbante gjallë e të pashuar luftën për çlirim, luftën klasore, kundër feudalëve, kjo kontribuoi në shembjen e perandorisë otomane, por minoi për vdekje edhe pushtetin ekonomiko-politik të klasës feudale, e cila filloi të dobësohej në ekstrem nga ana ekonomike, duke kështyer tokat dhe çifligjet një pjesë katundarëve të mesëm dhe një pjesë tregtarëve të qytetit që po mëkëmbeshin.

3) Shpallja e independencës së Shqipërisë më 1912 dhe gjithë jeta e vendit tonë deri në okupacionin italian më 1939, nuk solli ndryshime të mëdha në raportin e klasave. Pas një sërë peripecish pushtetin e mori në dorë Zogu, përfaqësuesi i falimentuar i feudalizmit të falimentuar. Klika e Zogut mbështetej nga një ushtri e vogël mercenare, mbështetej nga Italia fashiste, së cilës i shiti koncesione minierash dhe tokash, i dorëzoi organizimin e ushtrisë e të xhandarmërisë, e lejo të përgatiste vendin tonë për okupimin e ardhshëm dhe si plasdarm për luftërat e ardhshme të fashizmit.

Popullsia në qytete relativisht u shtua me të papunë nga fshati, i cili u braktis e u varfërua akoma më shumë se më parë. Ajo pjesë e bejlerëve dhe e feudalëve që ishin rreth Zogut, rronin me rentën e tokës që u kishte mbetur, këtë vazhdonin ta shitnin te fshatarët e pasur që shtypnin fshatarët e varfër e të mesëm. Këta agallarë fshati dhe qyteti u bënë mbështetje e regjimit të Zogut.

Tregtia në qytete filloi të mëkëmbej, duke speku-

luar tmerrësisht në marrëdhëniet fshat-qytet, në traktacionet uzurare, në blerje e shitje tokash, në shfrytëzimin e rentës së tokës, pa bërë as më të voglin investim në bujqësi. Këta tregtarë spekulatorë që mbështetnin regjimin feudal e gjysmëkolonial nuk ishin as në numër relativisht të madh, as me fuqi ekonomike të madhe. Karakteristikë e tregtarëve të mëdhonj që ishin mbështetje e regjimit ishte fajdeja, monopoli i importit dhe i eksportit, aq sa u linin kush-tet e spekulimit të firmave tregtare fashiste italiane dhe gjendja e mjeruar ekonomike e vendit.

Kjo borgjezi tregtare që po mëkëmbej mendonte shumë pak, ose aspak të investonte kapitale për zhvillimin e njëfarë industrie në vend, prandaj ne shohim që gjatë gjithë kësaj periudhe, asnjë industri qoftë e vogël nuk u ngrit, vetëm me përjashtim të disa fabrikave të vogla cigaresh, të ndonjë fabrike të vogël çimentoje, birre ose vaji, por edhe këto të shoqëruara me kapitalistë italianë. Dumpingu italian varfëronte dyqanet tona, lejonte spekulimin nga ana e tregtarëve fajdexhinj, të cilët, në ortakllëk me Zogun dhe me klikën e tij, thithnin gjithë pasurinë e vendit dhe e eksportnin në Itali e mbushnin xhepat. E vetmja «industri» në vend ishte artizanati, por edhe ky shumë i prapambetur dhe vazhdimisht varfërohej nga varfërimi i popullit, nga taksat e rënda dhe nga dumpingu italian. Borgjezia e vogël e qyteteve ishte në mjerim, i vetmi burim jetese ishte spekulimi i vogël dhe nëpunësia. Për intelektualët i vetmi burim jetese ishte nëpunësia në administratën burokratike të regjimit, burokraci e fali-

mentuar që nuk paguante rrogat e tyre për 10 muaj rresht.

Masa e madhe e popullit, fshatarësia e varfër dhe e mesme, masat e gjera punonjëse të qytetit, të varfrit, punëtorët, zanatçinjtë, ishin në luftë të hapët klase me klikën e Zogut, me tregtarët spekulantë dhe me borgjezinë e pasur gjysmëtregtare, gjysmëfeudale të qytetit dhe të fshatit. As periudha në fjalë, pra, nuk ishte e mjaftueshme si kohë dhe as mbeturinat e klasës feudale dhe borgjezia që ngrihej në fshat e në qytet nuk u treguan të zonjat të forconin pozitën e tyre si klasë dominuese, për arsye të rezistencës klasore të masave proletare të fshatit e të qytetit në radhë të parë dhe të forcës së dobët ekonomike që kishte klasa feudale dhe klasa e re borgjeze, të prapambetjes së tyre të madhe kulturore dhe teknike, të botëkuptimit të tyre anadollak dhe të politikës së tyre prej skillavi përpara kapitalit fashist italian, i cili kishte qëllimet e tij të paracaktuara për kolonizimin e plotë të Shqipërisë, siç e zbatoi më vonë, por që hasi në luftën heroike të popullit shqiptar të udhëhequr nga Partia e tij Komuniste.

Shkurt, ne mund të themi se pushtimi i vendit tonë nga Italia fashiste e gjeti klasën shfrytëzuese kapitaliste të qytetit dhe të fshatit në një gjendje kaotike, të dobët politikisht dhe ekonomikisht; ajo nuk kishte në pronësi industri minerare, sepse ato miniera që ekzistonin ishin krejt koncesione dhënë Italisë; ajo nuk kishte industri, siç e thamë më lart, ajo zhvillonte vetëm tregtinë, uzurën dhe rentën mbi tokën. Kjo borgjezi e re e fshatit dhe e qytetit që po mëkëmbej, e

prapambetur, pa kulturë, pa arsim, koprrace në kuptimin më të ulët, pa një organizim politik dhe e egër e barbare ndaj masave të gjera të popullit, shtrëngonte radhët rreth klikës së Zogut dhe administratës së saj, shumë herë jo se ishte plotësisht dakord me të, por sepse në sajë të kësaj klike, të xhandarmërisë së saj dhe të lidhjeve që ajo kishte me Italinë fashiste, borgjezia e re e vendit tonë mund të vazhdonte spekulimet dhe të pasurohej.

Pra, ideologjia e regjimit të Zogut dhe e klasës shfrytëzuese kapitaliste të vendit ishte kusëria, spekulimi, grabitja, kërbaçi, terrori dhe tradhtia. Nuk mund të bëhet asnjë barazim në zhvillimin si klasë kapitaliste midis klasës shfrytëzuese të vendit tonë me atë të vendeve të tjera kapitaliste të Evropës.

Italia fashiste pas pushtimit të Shqipërisë u përpoq që këto mbeturina të feudalizmit, këtë klasë të borgjezisë tregtare, agallarët e fshatit dhe të qytetit, t'i lidhte pas qerres së vet për interesat e kolonizimit dhe të luftës. Në fakt ajo i bëri me vete dhe i futi në shërbim të vet, kundër Luftës Nacionalçlirimtare të popullit që udhëhiqte Partia Komuniste e Shqipërisë.

Italia fashiste nuk ishte në gjendje as ekonomikisht të bënte investime ekonomike në Shqipëri, por as edhe situatat e luftës nuk ia lejonin një gjë të tillë, prandaj ajo, me pushtimin e Shqipërisë, u interesua, në radhë të parë, për objekte ushtarake, për të aktivizuar disi më mirë nxjerrjen e naftës vetëm në Kuçovë, për të siguruar qetësinë e prapavijave të saj në Shqipëri dhe për të grabitur çka mund të grabiste në vendin tonë. Italia shpresonte në fitoren dhe në

kolonizimin e përhershëm të Shqipërisë. Impulsi që u dha okupatori klasave shfrytëzuese shqiptare ishte vetëm me anën e tregtisë spekulative në mes Shqipërisë dhe Italisë dhe nëpërmjet këtij spekulimi e bëri atë një agjenturë të thjeshtë të saj për të forcuar sundimin italian në Shqipëri, për t'u shitur toka italianëve, për të rekrutuar mercenarë dhe për t'i hedhur në luftë kundër popullit që luftonte.

Kështu që pushtimi italian pasuroi disa spekulantë, që s'menduan kurrë për investime në vend, po për grumbullim ari, për ta fshehur atë ose për ta depozituar jashtë vendit për kohët e këqija që do t'u vinin. Fashizmi u përpoq që kësaj klase t'i jepte në dorë bajrakun e ideologjisë fashiste dhe rreth saj të grumbullonte njerëz e të konsolidonte pozitat politike të kësaj klase. Kjo pësoi disfatën më të madhe nga grushti i luftës sonë. Flamurin e partisë fashiste e zëvendësoi flamuri i «Ballit Kombëtar» dhe i disa partive të tjera kërpuhda. Reaksioni shqiptar u përpoq, nën nxitjen e fashizmit italian e gjerman, të krijonte një «ideologji» klase të tij me këto organizata tradhtarë që organizoi për t'u ardhur në ndihmë okupatorëve dhe për të luftuar Partinë tonë dhe Frontin Nacionalçlirimtar. Kjo ishte tentativa e fundit dhe e dëshpëruar e fashizmit dhe e reaksionit shqiptar që përdorte kundër luftës së popullit tonë, të cilën e udhëhiqte Partia. Kjo tentativë e tyre u mbyt në gjak dhe reaksioni shqiptar, tok me okupatorët, hëngri grushtin e vdekjes përfundimtarë. Klasat shfrytëzuese të vendit tonë pësuan disfatën më të madhe që mund të bëhej, disfatë politike, ushtarake dhe ekonomike, ata e humbën përgjithmonë pushtetin

politik dhe ushtarak. Revolucioni triumfoi. Lufta Nacionalçlirimtare e udhëhequr nga Partia i dërrmoi përfundimisht okupatorët dhe tradhtarët, u vendos regjimi i demokracisë popullore, diktatura e proletariatit.

Pra, Lufta e armatosur Nacionalçlirimtare demaskoi përpara popullit klasën shfrytëzuese të shitur tek okupatorët gjakpirës dhe shtypës të popullit. Politika dhe veprimtaria e Partisë sonë në udhëheqje të popullit e detyroi atë të mbante qëndrime dhe ia çori maskat, e goditi pa mëshirë me armë, i dha goditje të palogaritshme në drejtim të likuidimit fizik të një numri të madh udhëheqësish të tyre (resti u detyrua të arratisesh me vaporët e okupatorëve), bëri diferencimin e thellë e të mprehtë dhe përgatiti kështu terrenin për konsolidimin e diktaturës së proletariatit, për ndërtimin e socializmit dhe për likuidimin e plotë si klasë të klasave shfrytëzuese kapitaliste në vendin tonë.

Si u zhvillua më tej ky proces pas marrjes së pushtetit nga populli? Si e organizoi dhe e drejtoi Partia kufizimin dhe më në fund likuidimin si klasë të klasave shfrytëzuese?

Etapat e ndryshme të këtij procesi të madh janë analizuar në mënyrë marksiste-leniniste në dokumentet e shumta e të rëndësishme të Partisë sonë. Shkurtimeisht po vë në dukje kryesoret.

Procesi politik kundër reaksionit dhe bashkëpunëtorëve të okupatorit vazhdoi të rritej pa u ndërprerë që në ditët e para të Çlirimit. Përveç grushtit të madh gjatë gjithë kohës së luftës, ku klasat shfrytëzuese pësuan goditje të mëdha, gjyqet e popullit që u ngritën në të gjithë Shqipërinë që në ditët e para të Çlirimit, u dha-

**në grushte të tjera të tmerrshme. U arrestuan ku ishin e ku s'ishin të gjithë bashkëpunëtorët e okupatorëve dhe u gjykuan. Disa qindra u pushkatuan, të tjerët u burgosën. Ky ishte një numër i konsiderueshëm armiqsh të klasës, humbja e të cilëve e dërrmoi keqas borgjezinë tradhtare si klasë politikisht dhe fizikisht.**

Demaskimi i pandërprerë politik dhe frika e tmërri nga gjyqet e popullit i shpartalluan radhët e armiqve. Diktatura e proletariatit godiste pa mëshirë armiqtë e popullit, zbulonte komplotet anglo-amerikane, çonte para gjyqeve agjentët e tyre dhe i dënonte.

Goditjet e vendosura, të drejta dhe revolucionare kundër armiqve të popullit, shtuan akoma më shumë entuziazmin dhe besimin e popullit për Partinë, për pushtetin, për armët e diktaturës së proletariatit dhe krijuan te njerëzit një vigjilencë të lartë revolucionare që kalitet çdo ditë, që është bërë një armë e fuqishme politike e masave të gjera kundër armikut të klasës dhe kundër armiqve të jashtëm.

Nuk do të flas gjatë për shtetëzimet e mëdha që u bënë pas Çlirimit, por do të ndalem në ato masa me karakter ekonomik dhe politik që u morën kundër klasës kapitaliste të qytetit dhe të fshatit dhe që çuan më tej procesin e likuidimit të saj si klasë shfrytëzuese.

**Për të gjithë tregtarët dhe industrialistët që gjatë kohës së luftës kishin realizuar fitime të mëdha mbi kurriz të popullit u vunë tatime të jashtëzakonshme. Tatimi ishte një masë ekonomike radikale që çoi në fakt në konfiskimin e gjithë pasurisë së luftshme dhe të paluftshme, deri në mobiljet e shtëpive. Një**

shumicë e madhe e tyre u dënua nga gjyqet dhe u burgos, pse pasuria e konfiskuar nuk mbulonte vlerën e tatimit të vënë dhe vendimi i gjyqit do të rishikohej vetëm kur ky të kishte plotësuar tatimin, domethënë kur të nxirrte floririn nga vendi ku e kishte fshehur. **Kjo ishte një masë me rëndësi të madhe ekonomike dhe politike, pse likuidonte nga mesi një element të rëndësishëm kapitalist, por pa e zhdukur borgjezinë akoma si klasë.**

Ndaj tregtarëve që nuk i përfshinte tatimi i jash-tëzakonshëm dhe që ishin kryesisht tregtarë të vegjël, nuk ndoqëm politikën e likuidimit, por atyre, në kushtet ekonomike dhe politike të kohës, u vumë kontrollet të rreptë e kufizime për të evituar spekulimin. Krahas me krijimin e sektorit socialist dhe forcimin e tij, ne luftonim për transformimin socialist të prodhuesve të vegjël të qytetit. Këtë proces të drejtë tentoi ta devijonte oportunisti Sejfulla Malëshova, duke dashur që «sektorit privat t'i akordohej ndihmë në kredi dhe në materiale nga sektori socialist, nga shteti, dhe sektori socialist të futej në konkurrencë me sektorin privat dhe kështu të bëhej integrimi paqësor i kapitalizmit në socializëm». **Teoria e tij antimarksiste u hodh poshtë nga Partia, u demaskua në popull dhe Sejfulla Malëshova u përjashtua nga Byroja Politike e Komitetit Qendror dhe nga Partia.**

Tregtarëve të mesëm e të vegjël që shitnin mallra industriale të mbetura nga koha e paraluftës dhe e luftës pas një kohe u mbetën raftet bosh, ata jashtë shtetit nuk blenin dot më, pse tregtia e jashtme



dhe me shumicë ishte në dorë të shtetit; artizanati akoma i pakooperuar s'ishte në gjendje t'i furnizonte; kështu që shumica e tyre, pas mjaft përpëlitjesh, u detyruan të mbyllnin dyqanet, të braktisnin tregtinë dhe të punonin në prodhim.

Gjatë kësaj kohe krahas krijimit të sektorit shtetëror socialist u krijua kudo sektori i kontrolluar socialist popullor i kooperativave të konsumit, u organizuan kooperativat e artizanatit dhe kështu gradualisht sektori shtetëror socialist dhe kooperimi eliminoi në përqindjen dërrmuese, siç do ta shohim më poshtë, elementët kapitalistë privatë nga qarkullimi i mallrave. Kështu që mund të themi se në vitin 1955 prodhimi i vogël industrial ishte likuiduar pothuaj krejtësisht dhe vendin ia zuri artizanati i kooperuar. Tregtia e vogël private në pamundësi të jetonte më, i la vendin tregtisë shtetërore dhe kooperativave të konsumit. Dhe disa tregtarë të vegjël frutash, zarzavatesh e mishi që i lamë, u organizuan në kolektiva tregtare<sup>1</sup> të kontrolluar nga shteti.

Kështu është zhvilluar procesi i likuidimit të klasave shfrytëzuese në qytet dhe si rezultat i kësaj elementët kapitalistë, të shpartalluar politikisht dhe ekonomikisht, nuk përbëjnë më një klasë shfrytëzuese

---

1 Kolektivat tregtare u krijuan në vitin 1958 dhe u shkrinë në vitin 1968. Këto kolektiva kanë qenë 3 llojesh: Fruta-perimesh; mishi; bulmeti. Kishin për detyrë edhe përgatitjen e privatëve për në sektorin shtetëror, si dhe forcimin e kontrollit të shtetit mbi sektorin privat.

më vete, siç ishin më parë. Është kjo arsyeja që themi se te ne sot nuk ekzistojnë më klasat shfrytëzuese, sepse ato janë zhdukur si të tilla, por ekzistojnë vetëm mbeturinat e këtyre klasave, elementët e tyre, të cilët, me gjithë goditjet që kanë pësuar, ëndërrojnë për restaurim.

Si është zhvilluar ky proces në fshat? Fshatarësia jonë punonjëse është një fshatarësi shumë patriote dhe revolucionare e zjarrtë. Ajo mori pjesë gjerësisht në Luftën Nacionalçlirimtare. Ajo pati besim të madh te vija e Partisë, së cilës i qëndroi dhe i qëndron besnike. Ajo ishte dhe është me gjithë shpirt për aleancën me klasën punëtore, e ka të qartë dhe e pranon pa as më të voglin ngurrim udhëheqjen e kësaj aleance nga klasa punëtore. Ajo është besnike e diktaturës së proletariatit.

Në këto kushte fshatarësia jonë revolucionare me tradita të lashta, u bë nën drejtimin e Partisë, një nga faktorët vendimtarë të fitores së çlirimit dhe të ndërtimit të socializmit në vendin tonë, dhe veçanërisht në fshat.

Nuk do të zgjatem mbi Reformën Agrare që përfundoi në vitet e para të Çlirimit, reformë që shpronësoi bejlerët, agallarët e fshatit dhe të qytetit, si në tokë edhe në bagëti dhe ua ndau tokën dhe bagëtitë fshatarëve të varfër e njëkohësisht krijoi premisat për formimin e sektorit socialist të bujqësisë.

Në këtë periudhë u zbatua mirë dhe pa lëkundje orientimi i Partisë për izolimin e thellë politik dhe për kufizimin ekonomik të kulakëve, që ishin klasa e fundit shfrytëzuese, mbështetja që ekzistonte për

rezistencë klasore kundër Reformës Agrare dhe më vonë kundër kolektivizimit të bujqësisë. Reforma Agrare nuk la pa kufizuar disi edhe disa fshatarë të mesëm, jo kulakë, por me tendenca pasurimi. Por u bë një luftë e drejtë me sukses për t'i lidhur fshatarët e mesëm me fshatarët e varfër kundër kulakëve dhe për mbështetjen e kolektivizimit. Partia zhvilloi një luftë të drejtë, politike, ideologjike, ekonomike, diferencimi në fshat.

Kolektivizimi i bujqësisë ishte një revolucion i madh në fshat, që vazhdoi disa vjet me radhë. Ai kaloi në disa etapa, u bë i matur, me shumë kujdes, me bindje, pa asnjë shtrëngim e violencë dhe u bë një punë politike e madhe, intensive, e vazhdueshme, u fillua nga fushat, nga zona që kishin kushte ekonomiko-shoqërore më të favorshme. Fshatarësisë iu dhanë ndihma ekonomike të mëdha nga ana e shtetit, iu dhanë kredi bujqësore, u ndërmorën punime bonifikimi, ujitjeje etj., etj. Kështu kolektivizimi përfundoi me sukses. Toka nuk u nacionalizua direkt, por me zbatimin e Reformës Agrare u zhduk pronësia e madhe mbi tokën, u ngushtua së tepërmi baza për zhvillimin e kapitalizmit në fshat dhe kooperimi u bë pa përdorur forma të ndërmjetme të bazuara mbi rentën etj., por drejt me forma plotësisht socialiste.

Në të gjithë këtë proces të madh u zhvillua me sukses të plotë lufta e klasave në fshat. që ecte paralelisht me luftën e klasave në qytet. Kjo luftë klasash çoi gradualisht edhe në likuidimin e kulakëve si klasë kapitaliste shfrytëzuese në fshat.

Disa shifra që tregojnë këtë proces të kufizimit dhe të likuidimit të kulakëve:

Reforma Agrare shpronësoi afërsisht 5 000 kulakë (ekonomi kulake). Më 1947 mbetën edhe afro 2 000 ekonomi kulake. Mbi këto ekonomi kulake tatimi financiar ishte 50-100 për qind më i lartë nga i zakonshmi. Këtu s'flasim për kufizimet e tjera, detyrimet, kufizimin politik.

Më 1950-1951 u larguan nga fshati afërsisht 500 familje kulake. Më 1955 sipërfaqja e tokës së kulakëve arriti në 1,7 për qind kundrejt gjithë sipërfaqes bujqësore të vendit; prodhimi i drithit në 1,9 për qind; qetë e buajt në 2 200 krerë; lopët në 1 900 kokë dhe bagëtia e imët në 20 000 kokë.

Më 1955, nga rreth 2 000 familje kulake, më tepër se 560 prej tyre nuk kishin asnjë kafshë dhe gjysma e numrit të përgjithshëm dispononin 2 deri 3 hektarë dhe jo më shumë se 10 kokë bagëti të imëta.

Në vitin 1962 ekzistonin 1 326 familje kulake, të cilat kishin si total 2 391 hektarë tokë, 1 645 krerë kafshë të trasha dhe 12 432 krerë bagëti të imëta. Ata zinin pra rreth 0,7 për qind të numrit të përgjithshëm të ekonomive fshatare. Gjatë këtyre viteve të fundit kjo përqindje është ulur akoma.

Si konkluzion, edhe në fshat elementi kapitalist nuk përbën më një klasë.

Këtu nuk po flas për luftën e klasave në fshat, që vazhdon e do të vazhdojë, nuk po flas për punën politike intensive të Partisë në drejtim të këtyre elementëve dhe sidomos të të rinjve me origjinë kulake për riedukimin e tyre, për diferencimet etj., etj.

Si konkluzion i gjithë kësaj lufte të madhe, gjendja dhe përbërja e klasave në vendin tonë në vitin 1960 paraqitej si vijon:

Klasa punëtore	22,5 për qind
Fshatarësia kooperativiste	62,7 për qind
Shtresa e inteligjencies	13,6 për qind
Mbeturina të klasave shfrytëzuese	1,1 për qind
dhe nga këta:	
Kulakë	0,8 për qind
Elementë spekulantë në qytete	0,3 për qind

**Mbi të ardhurat kombëtare po në vitin 1960:**

Sektori socialist	99 për qind
Prodhimi i përgjithshëm industrial	99 për qind
Tregtia me shumicë	100 për qind
Tregtia me pakicë	90 për qind
Prodhimi bujqësor	80 për qind

Këto janë rezultatet konkrete mbi gjendjen e klasave në vendin tonë, gjë që na lejon të themi se klasa borgjeze kapitaliste e vendit tonë, si klasë shfrytëzuese themelore, është likuiduar. Por, ekzistojnë elementët, mbeturinat e saj, të cilët fizikisht nuk janë zhdukur dhe nuk është shtruar e nuk shtrohet ky problem. Çështja është që këta elementë që ekzistojnë të mos ngrenë kokë, por t'u nënshtrohen ligjeve të shtetit proletar, të heqin dorë nga veprimtaria armiqësore. Ne u kemi krijuar atyre mundësi të punojnë e të jetojnë si gjithë të tjerët, por pa shuar vigjilencën dhe goditjet në rastet e nevojshme; ndërsa për bijtë e tyre ne kujdesemi që t'i edukojmë me frymën e re.

Për sa u përket luftës politike, luftës ideologjike, edukimit të masave me frymën revolucionare, me ideologjinë e proletarietit, për sa i përket luftës së klasave kundër armikut të klasës, kundër ideologjisë kapitaliste, idealiste, revizioniste, kundër imperializmit dhe edukimit të vazhdueshëm të masave për zhdukjen e ve-seve të këqija, të bestytnive e mbeturinave mikrobor-gjeze, në çdo fushë e në çdo sektor, këto janë probleme të mëdha, të vazhdueshme që duhet të jenë në preokupacionin e parë dhe balli i luftës i partisë dhe i klasës punëtore. Në qoftë se kjo luftë e madhe nuk vazhdohet frontalisht nga partia në krye të masave, atëherë lind rreziku i gjallërimit dhe i rigrupimit të elementëve të klasave armike, rreziku i rilindjes së një klase të re revizioniste, e cila, siç bëri në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste, rrëmben pushtetin në duart e veta dhe e shndërron vendin nga një vend socialist, në një vend kapitalist.

Partia jonë, pra, mendon se, pavarësisht që klasat shfrytëzuese si klasa janë likuiduar, ekziston kurdoherë rreziku i restaurimit borgjez e revizionist, në rast se të zë gjumi mbi dafina dhe në rast se nuk ecet me një temp të madh revolucionar, në qoftë se nuk udhëhiqesh në çdo gjë nga marksizëm-leninizmi, në qoftë se shuan luftën e klasës, në vend që ta zhvillosh atë pa ndërprerje dhe me konsekuencë, në rast se e dobëson, në vend që ta forcosh akoma më shumë diktaturën e proletarietit, në rast se shkëputesh nga populli, në vend që të lidhesh sa më fort me të, në rast se tregohesh i frikshëm, në vend që të jesh trim e i guximshëm dhe në luftë të vazhdueshme, të paepur, pa bërë lë-

shime kundër imperializmit, revizionistëve të çdo ngjyre dhe gjithë shërbëtorëve të borgjezisë dhe të kapitalit.

Partia jonë, si kurdoherë, do të vazhdojë me konsekuencë, me guxim, me trimëri dhe me pjekuri rrugën e saj të drejtë marksiste-leniniste.

Partia jonë, në krye të popullit shqiptar, e ndien përgjegjësinë e madhe që ka në këtë luftë për jetë a për vdekje kundër imperializmit, revizionizmit modern dhe reaksionit. Partia jonë i ka vënë detyrë kryesore vetes së saj që të mbajë kurdoherë lart shpirtin revolucionar, të kalitet, të kalitet dhe të kalitet çdo ditë ideologjikisht dhe politikisht, të mbajë radhët të pas-tra, të spastrojë të kalburit, të fjeturit, llafazanët, karrieristët, burokratët e pandreqshëm, nëpërmjet një lufte të gjallë brenda në parti dhe me vërtetimin real dhe faktik të punës të çdo komunisti në luftë e në jetë.

Ajo që ngjau në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik nuk do të ngjasë kurrë në Partinë tonë, pse Partia jonë bën dhe do të bëjë vazhdimisht, në mënyrë masive, në thellësi e në gjerësi, një punë intensive politike, ideologjike, me qëllim që populli mbarë të kuptojë dhe të zbatojë në mënyrë krijuese çdo direktivë të Partisë, politikën e saj të drejtë dhe të jetojë e të punojë çdo ditë e çdo orë si në luftë, si në revolucion. Vetëm kështu do të thyhet çdo sulm i armikut të jashtëm e të brendshëm, vetëm kështu nuk do të ketë sukses dhe do të shpartallohet që në vezë veprimtaria e çfarëdo armiku që do të tentojë restaurimin e kapitalizmit, sado e stërholluar dhe e maskuar që të jetë. Për një luftë të tillë dhe në një luftë të tillë ne po luftojmë

dhe po e kalitim Partinë e popullin tonë. Parti dhe popull, të ngritur peshë në këmbë, në unitet revolucionar në veprim dhe në mendim, janë të pamposhtur.

Imperialistët dhe revizionistët modernë menduan se Partinë e Punës të Shqipërisë do ta kishin një kafshatë. Por ajo u bë një mal i çeliktë, i pathyeshëm, e pamposhtur, pse ideologjia dhe politika e saj marksiste-leniniste është e pamposhtur dhe mbështetet e zbatohet nga një popull revolucionar, luftëtar dhe i pathyeshëm.

Në euforinë e triumfit të tyre në Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera, revizionistët modernë, me ata sovjetikë në krye, u munduan të na hidhnin hi syve, u përpoqën të na përkëdhelnin, të na gënjenin, por dështuan, hëngrën grushte të forta nga ne dhe u demaskuan keqas. Ata e ruajnë akoma fuqinë materiale dhe manovrojnë me të, por atë morale dhe politike e humbën, jo vetëm ndaj nesh, por edhe ndaj marksistë-leninistëve të botës dhe gjithë popujve përparimtarë.

Revizionistët modernë janë borgjezë kapitalistë dhe shtetet që drejtojnë ata janë transformuar e po transformohen pa asnjë ngurrim, në thelb, në shtete borgjeze kapitaliste. Vetëm revolucioni i armatosur brenda në këto vende, në rast se shpërthen, do ta ndalë dhe do ta përmbysë këtë kurs. Ne po e ndihmojmë dhe duhet ta ndihmojmë kursin revolucionar që të përmbysë këtë kurs kapitalist, antiproletar, antimarksist në lëvizjen punëtore e komuniste.

Ne mendojmë se Kim Ir Seni dhe shokët e tij gabohen në disa qëndrime të tyre mbi revizionizmin



modern sovjetik dhe, në qoftë se nuk do ta ndryshojnë rrugën që kanë marrë, për fatin e keq të Partisë së Punës të Koresë dhe të popullit korean, do të bëhen revizionistë modernë si të tjerët. E vërteta është e hidhur, por duhet thënë sa nuk është vonë. Teoritë e Kim Ir Senit dhe të japonezëve se «Hrushovi që është i keq u hoq, por këta që janë në fuqi japin shpresa të ndreqen dhe një nga rrugët që t'i ndreqim është të bashkohemi me ta», gjoja kundër imperializmit, tregojnë se këta nuk e shikojnë drejt çështjes, këta s'janë më në gjendje të bëjnë analiza të vërteta klasore, këta janë duke hyrë në rrugë të dyshimta.

Të mos flasim pastaj për udhëheqësit rumunë, të cilët jo vetëm janë revizionistë të pafytyrë, por edhe rruga e mesme që përpiqen të mbajnë e që e trumbetojnë si një politikë «të zgjuar dhe elastike», s'është tjetër veçse një politikë e një frike të madhe, që ata e kanë në gjak. Rumunët kanë frikë nga sovjetikët, nga bullgarët, nga hungarezët, prandaj ata janë lidhur me Titon, lidhen me imperialistët, na buzëqeshin neve për oportunitet. Këtë rumunët e quajnë si një rrugë të veçantë «speciale dhe autentike marksiste-leniniste». Sipas tyre, të gjitha janë vija «autentike marksiste-leniniste», ajo e sovjetikëve, e titistëve, e bullgarëve, e Kim Ir Senit, e japonezëve dhe e të tjerëve.

Rumunët bëjnë zhurmë mbi Traktatin e Varshavës dhe tregohen «trima». Kjo është vija e Titos dhe e imperialistëve. Po të largohet Rumania nga Traktati i Varshavës, është mirë. Po ku do të vejë? Nga krevati i një armiku, do të vejë në atë të armikut tjetër. Qoftë në NATO, qoftë në Traktatin e Varshavës, një-

lloj është për ne. Njëlloj është për ne në rast se të dy këto traktate qëndrojnë kështu si janë, sepse ne të dy na luftojnë. Në qoftë se këta bëhen një, prapë ne armiq i kemi dhe këta bashkohen kundër nesh. Edhe në qoftë se që të dy shturen e prishen, ata nuk prishen në interesin e revolucionit. Atëherë ku qëndron qëllimi i zhurmës së udhëheqjes rumune? Në atë që t'i tregojnë Bashkimit Sovjetik se janë «të fortë», pse janë me Titon dhe me imperialistët. Ata bëjnë zhurmë për të mbajtur ngritur rivendikimet territoriale, për të marrë pare nga imperialistët, si shpërblim që veprojnë në dobësimin e forcës së Bashkimit Sovjetik si dhe për të bërë transformimin kapitalist të Rumanisë, para se t'i bëjnë ndonjë sulm sovjetikët. Kartën kineze e përdorin vetëm për këtë oportunitet dhe aq sa nuk u bën dëm politikës dhe strategjisë së përgjithshme të imperializmit.

Rumunët neve po ashtu na buzëqeshin, më kanë ftuar mua, kanë ftuar ministra, punëtorë partie për pushime, na ftojnë privatisht në mbledhjen e Traktatit të Varshavës e të tjera profka. Ne s'i hamë këto. Ne do t'u japim përgjigje të hapëta që t'i kuptojnë se këto manovra që bëjnë, nuk u pinë ujë.

Revizionistët modernë të çdo kallëpi, bëjnë llo-lloj manovrash jo vetëm për të evituar goditjet që marrin dhe demaskimin e mëtejshëm, por për të lënë përshtypjen se ja, «diçka po ngjet, diçka po ndihet në erë», një buzëqeshje andej, një këndeje, një veprim «demokratik», një veprim diplomatik. Të gjitha këto janë format e një diplomacie borgjeze që i ka kaluar koha, por që, ata, në mungesë të të tjerave, u rikthehen dhe

i përdorin në koniunktura të reja, duke i veshur me petka të reja. Këta lakenj janë gati të të puthin dorën tash, që të ta kafshojnë nesër. Por ne nuk pranojmë as të na e puthin, pale pastaj të na e kafshojnë! Ata tmerrohen nga qëndrimet tona, sepse këto qëndrime të drejta, të vendosura, i kanë dërrmuar e shpartalluar. **Vazhdimi me këmbëngulje, me vendosmëri, në mënyrë revolucionare i kësaj politike marksiste-leniniste është vazhdimi i luftës së klasave në arenën ndërkombëtare, është shpartallimi i aleancave imperialisto-revizioniste kundër vendeve socialiste dhe për sundimin e botës nga kapitalizmi i veshur me lloj-lloj petkash dhe maskash.**

Mbledhja e Traktatit të Varshavës nuk paraqet për ne asnjë interes, përveç atij të objektit të demaskimit të revizionistëve, që ne do ta bëjmë.

Kontradiktat midis klikave revizioniste, që po thellohen, bëjnë pjesë në lojën e shahut imperialist, në prerjen, mballosjen dhe lidhjen e urave të reja në mes imperialistëve të ndryshëm dhe revizionistëve të ndryshëm. Tok me procesin e dezintegrimit zhvillohet procesi i integritimit të ri në mes tyre.

Në Evropë, Franca kapitaliste, në interes të saj, vepron kundër hegjemonisë amerikane dhe bën presion mbi Anglinë dhe sidomos mbi Bonin, të cilët do t'i shkëputë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe t'i lidhë pas vetes. Taktika e saj është: afrim me Bashkimin Sovjetik, sa të jetë e mundur, jo vetëm që ta përdorë Bashkimin Sovjetik si një mjet shantazhi kundër Shteteve të Bashkuara të Ame-

rikës dhe Bonit, por njëkohësisht edhe për infiltrimin e influencës së saj në vendet revizioniste të Evropës Lindore.

Kurse Bashkimi Sovjetik, nga ana e vet, duke ruajtur interesat e mëdha me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, luan kartën e Francës si shantazh për rregullimin në rrugë oportuniste të problemit gjerman dhe të atij vietnamez në drejtimin e kapitullimit të Vietnamit dhe të shpëtimit të nderit e të prestigjit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Azi. Ai ka parasysh që, tok me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të realizojë rrethimin e Kinës ushtarakisht dhe politikisht në kushte të reja, domethënë që në sferën e këtij rrethimi të futet edhe Koreja e Veriut. Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës që janë të influencuar radikalisht nga euforia false e kapitullimit të Vietnamit, nuk do të mungojnë ta trumbetojnë këtë kapitullim si «fitore të madhe të bashkekzistencës paqësore dhe të politikës paqësore të Bashkimit Sovjetik dhe të Xhonsonit».

Ne mendojmë se të gjitha këto koniunktura politike në botë, dhe veçanërisht në Evropë, nuk do të zhvillohen në qetësi, pa kontradikta të ashpra në mes imperialistëve të ndryshëm dhe revizionistëve të ndryshëm. Por, këto kontradikta do të krijojnë gjithashtu kontradikta brendapërbrenda klikave me prirje të ndryshme; kontradikta midis klikave dhe revolucionarëve, partive dhe grupeve marksiste-leniniste, që janë formuar e po formohen; kontradikta midis klikave revizioniste dhe popujve ku ata janë në fuqi.

Fakt është se procesi i dezintegritimit të vendeve

revizioniste ka krijuar jo vetëm një kaos politik në popull në disfavorin e klikave në fuqi, por veçanërisht ka sjellë perturbacione në industri, në bujqësi, në ekonomi, në furnizim etj.

Titoja e futi vendin në kaos ekonomik me gjithë miliardat që i kanë dhënë dhe i japin Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të tjerët. Vendet e tjera revizioniste që po transformojnë bujqësinë socialiste në bujqësi kapitaliste (Jugosllavia nuk kishte bujqësi socialiste), hasin në rezistencë e vështirësi politike dhe ekonomike. Likuidimi i kolkozeve dhe procesi i transformimit të tyre në prona kulakësh, ka sjellë degenerimin e bujqësisë, spekulimin e varfërinë dhe tok me to rritjen e valës së rezistencës.

Në industri dhe në sektorin ekonomik klikat revizioniste kanë filluar transformimin e pronës shtetërore socialiste në pronë grupesh kapitaliste, sipas modelit titist ose me ndonjë ndryshim të vogël. Vetëm duke parë ekonominë titiste mund të marrim me mend ç'po ngjet dhe çfarë do të ngjasë në vendet e tjera revizioniste, të cilat shpresojnë të ndihma amerikane që të ecin sipas këtij modeli. Amerikanët i financuan fort titistët dhe ia arritën qëllimit. Populli jugosllav është tash i rraskapitur, gjë që do t'i shtojë kontradiktat dhe rezistencën, por amerikanët do të jenë më kërnacë e më të pamëshirshëm me klikat e tjera, të cilat ndodhen në mes dy zjarreve, të imperialistëve dhe të popujve të tyre. Kjo kontradiktë do të veprojë çdo ditë e më shumë.

Rol vendimtar do të luajnë krijimi i partive komuniste marksiste-leniniste në vendet ku revizionistët

janë në fuqi, prandaj ne duhet t'i ndihmojmë me çdo kusht partitë motra të reja marksiste-leniniste dhe këtë e kemi për detyrë të parë internacionaliste, e lyp detyra revolucionare.

Ne mendojmë se borgjezia e re e ardhur në fuqi me kundërrevolucion, e maskuar me frazeologji marksiste, si në Bashkimin Sovjetik, në Poloni, në Çekosllovakia, në Republikën Demokratike Gjermane, në Hungari, në Jugosllavi, në Bullgari, në Rumani, në Mongoli etj., nuk mund të rrëzohet veçse me revolucion. Revizionistët modernë janë të vendosur ta shtypin revolucionin me armë, prandaj, veçanërisht në ato vende, duhet të krijohen partitë e vërteta revolucionare marksiste-leniniste që ta përgatitin e ta udhëheqin revolucionin. Ne mendojmë se, pa krijimin e këtyre partive që ta kenë bërë të vetën doktrinën e revolucionit proletar, eksperiencën e kaluar dhe të tashmen e luftës revolucionare, që ta kenë të qartë dhe ta zhvillojnë drejt luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, revolucionin nuk mund të kryhet me sukses. Revolucionin do udhëheqje me eksperiencë, të kalitur dhe të vendosur ta çojë atë deri në fund.

Natyrisht, nuk jemi ne që do të eksportojmë revolucionin e që do të japim urdhra se të tjerët duhet të bëjnë kështu ose ashtu. As do të jemi ne që do të ndihmojmë revolucionin në këto vende me ndërhyrje të armatosura. Kjo, për ne, është shumë e qartë.

Por, ne e kemi për detyrë të parë të ndihmojmë revolucionin proletar në të gjitha vendet dhe veçanërisht në vendet revizioniste. Kjo ndihmë jona e shumanshme dhe e shumëllojshme duhet të ketë për bazë dhe

për synim luftën e ashpër e pa kompromis kundër imperialistëve, me atë amerikan në krye dhe kundër revizionistëve modernë, me ata sovjetikë në krye. Marksistë-leninistët në botë dhe partitë e grupet e reja marksiste-leniniste që janë formuar e po formohen, kanë nevojë të madhe për ndihmën tonë politike e ideologjike. Imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë veprojnë në bazë të një strategjie të njëjtë dhe koordinojnë taktikat, pavarësisht nga kontradiktat që kanë dhe që do të shtohen. Ata përgatitin luftën kundër nesh dhe popujve të tjerë paqedashës, luftojnë me çdo mjet e me çdo kusht të përgatitin kundërrevolucionin te ne, të likuidojnë kudo në botë shtabet e revolucionit proletar. «Mosndërrhyrja në punët e brendshme, ruajtja dhe respekti i indipendencës së të tjerëve» etj., s'janë veçse fjalë boshe, demagogji dhe këto e shumë të tjera të këtij lloji po ngrihen në një bluf të madh për të fshehur komplotet, puçet e çdo ndërhyrje tjetër të tyre në vendet dhe në partitë tona. Nga ana tjetër, revizionistët modernë, duke bërë një pseudomoral politik-ideologjik, kërkojnë që ndihmën tonë efektive, të fuqishme dhe të drejtë marksiste-leniniste për revolucionin në botë, ta cilësojnë që më parë si ndërhyrje në punët e tyre të brendshme.

Ç'duhet të bëjnë dy partitë dhe shtetet tona, në radhë të parë, dhe gjithë partitë marksiste-leniniste në botë? Ne mendojmë se duhet të jemi plotësisht të armatosur politikisht, ideologjikisht, ekonomikisht e moralisht dhe të vazhdojmë luftën deri në fitore kundër imperialistëve dhe revizionistëve modernë, luftën

ideologjike, politike, ekonomike dhe, kur ta lypë nevoja e mbrojtjes së vendeve tona e të fitoreve të revolucionit, të bëjmë edhe luftën e armatosur.

Një nga përgatitjet për këtë luftë për jetë a për vdekje, është përgatitja me sukses dhe ndihma që duhet t'u japim revolucionarëve në botë dhe veçanërisht revolucionit në vendet revizioniste. Me këtë ne nuk zvogëlojmë aspak ndihmën kolosale të pakursyer e të plotë që duhet t'u japim popujve që luftojnë dhe partive e grupeve marksiste-leniniste të vendeve të Azisë, të Afrikës, të Australisë dhe të Amerikës Latine. Kjo është nga më kryesoret, por kryesor është edhe revolucioni që duhet të përgatitet dhe të shpërthejë në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste.

Të dyja partitë tona e përqendruan me sukses të madh zjarrin mbi revizionistët sovjetikë dhe titistë<sup>1</sup>. Revizionistët e tjerë, jo se ne i neglizhuam, në bilancin e përbashkët të luftës së partive tona, ne i kemi demaskuar keqas të gjithë. Por, megjithatë, për disa oportunitete dhe sidomos për të mbajtur kontakte me popujt e tyre dhe me marksistë-leninistët e këtyre vendeve, kemi ndërtuar deri tash disa tak-

---

<sup>1</sup> Partia Komuniste e Kinës këtë e bëri me vonesë. Që në prill të vitit 1962, në Ditarin e vet Politik shoku Enver Hoxha nënvizonte: «Komunistët revolucionarë presin që Kina të dalë hapur kundër revizionizmit hrushovian». Por edhe kur doli hapur, si kundër revizionistëve sovjetikë, ashtu dhe kundër revizionistëve jugosllavë, në vijën e Partisë Komuniste të Kinës ka pasur lëkundje të theksuara oportuniste, deri dhe pajtim me ta.



tika e qëndrime. Por ne mendojmë se nuk është e thënë që në disa aspekte të tyre këto duhet të bëjnë nga ana e të dy partive tona objektin e një reflektimi më të thellë, në bazë të situatave të reja që krijohen e mund të krijohen<sup>1</sup>.

E kemi çështjen që këto qëndrime të mos na lidhin duart për të ndihmuar partitë e reja marksiste-leniniste që do të krijohen në këto vende dhe revolucionin që ato duhet të përgatitin<sup>2</sup>.

Revizionistët modernë asgjë nuk i pengon për të organizuar te ne veglat e tyre tradhtarë veçse vigjilenca dhe goditjet tona. Ne themi dhe jemi të bindur se kur imperializmi do të na sulmojë me armë, kur revizionistët sovjetikë e të tjerë do të na sulmojnë me armë, populli sovjetik, popujt e tjerë, nuk do të ecin me ta kundër nesh. Por për këtë ata duhet të përgatiten dhe të përgatiten që më parë për ta penguar dhe për ta shkatërruar me kohë sulmin revizionist.

---

1 Në fakt, Partia e Punës e Shqipërisë prej kohësh ka vënë në dukje se midis saj dhe Partisë Komuniste të Kinës ka pasur divergjencë në taktikë. Lidhur me këtë, që në dhjetorin e vitit 1962, në përgjigje të fjalimit të Li Hsien Nienit, mbajtur në darkën e shtruar në Pekin për një grup specialistësh shqiptarë, shoku Enver Hoxha, në Ditarin e vet Politik shënonte: «Në taktikë ne kemi divergjencë me shokët kinezë dhe këtë nuk ua kemi fshehur».

2 Aluzion për Partinë Komuniste të Kinës, e cila nuk ishte për të ndihmuar partitë e reja marksiste-leniniste që krijohehin, nën pretekstin se do të akuzohen si ndërhyrës në punët e brendshme të vendeve të tjera!

Si duhet organizuar kjo ndihmë, si duhet organizuar kjo luftë në shkallë më të koncentruar, botërore, kundër revizionizmit modern, Partia jonë i ka dhënë disa ide të saj, qoftë drejtpërdrejt partisë suaj, qoftë botërisht me shtyp. Natyrisht, ato mund të mos jenë të plota dhe kurdoherë të sakta, por ne përsëri insistojmë dhe jemi të atij mendimi që të dyja partitë tona duhet të thellohen mbi këtë problem të madh dhe urgjent, të studiojmë dhe të vendosim në bazë të fakteve dhe të situatave të reja që janë krijuar.

Revizionistët modernë punojnë gjallërisht, nxjerrin shumë «teori» dhe bëjnë çdo gjë për të luftuar unitetin marksist-leninist proletar ndërkombëtar, i cili është vdekjeprurës për ta. Hrushovianët, dhe deri te rumunët, e diskredituan idenë e madhe të unitetit marksist-leninist ndërkombëtar, për ta zëvendësuar atë me hegjemoninë e tyre revizioniste. Prandaj, ne duhet të ngremë lart flamurin e madh të Marksit, të Engelsit, të Leninit, të Stalinit, flamurin e unitetit të çeliktë proletar ndërkombëtar dhe të shpartallojmë çdo hegjemoni revizioniste.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## NË LIDHJET ME MASAT QËNDRON FORCA E PARTISË DHE E PUSHTETIT POPULLOR

*Fjala në takimin me zgjedhësit e zonës  
elektorale nr. 200 të kryeqytetit*

8 korrik 1966

Të dashur vëllezër dhe motra,  
Shokë dhe shoqe,  
Të rinj dhe të reja,

Ky takim me ju, zgjedhësit e zonës elektorale nr. 200 të kryeqytetit, banorë të lagjes ku në ditët e përgjakshme të robërisë fashiste, nga gjiri i popullit kryengritës, lindi Partia Komuniste e Shqipërisë, me ju, që, si gjithë populli shqiptar, keni luftuar dhe luftoni si revolucionarë për socializmin, lirinë e pavarësinë e vendit, është për mua një nder i madh, një gëzim i veçantë.

Më lejoni, në radhë të parë, t'ju shpreh mirënjohjen e thellë për besimin që treguat ndaj meje, duke më propozuar si kandidat për deputet në zonën tuaj elektorale. Me këtë rast dua t'ju siguroj se, nën udhëheqjen dhe sipas mësimëve të Partisë, do të vë të gjitha forcat e mia, gjithë jetën time, për të justifikuar besimin tuaj,

do të luftoj kurdoherë si ushtar i Partisë dhe i popullit për çështjen e lirisë e të pavarësisë së atdheut, të lumturisë së popullit, për çështjen e socializmit e të komunizmit, për çështjen e marksizëm-leninizmit e të revolucionit.

Besimi që ju tregoni ndaj meje, besimi që tregon gjithë populli ndaj kandidatëve të Frontit Demokratik, është besimi që kanë masat popullore, në radhë të parë, ndaj Partisë së tyre të Punës, ndaj programit dhe vijës së saj të përgjithshme revolucionare leniniste, ndaj pushtetit të tyre popullor, që janë armët më të fuqishme të popullit tonë, faktorët jetikë të realizimeve madhështore të deritanishme në të gjitha fushat e jetës, garancia e së ardhmes së ndritur, drejt së cilës marshon me hap të sigurt, me ballin lart e sytë të mbuluar, një popull i tërë i bashkuar si një bllok graniti.

Ju, si të gjithë zgjedhësit e vendit tonë, e keni kthyer fushatën e zgjedhjeve të deputetëve për në Kuvendin Popullor, që është një ngjarje e rëndësishme kombëtare, një shprehje e demokracisë së vërtetë popullore, në një aksion të madh politik e patriotik, gjatë të cilit, me hov të paparë në punë, me vrull të lartë revolucionar, po kryeni me nder detyrat në të gjitha frontet e ndërtimit socialist dhe të mbrojtjes së atdheut. Në emër të Komitetit Qendror të Partisë sonë, të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë, si dhe në emrin tim, ju përgëzoj për veprimtarinë e shquar që keni zhvilluar gjatë fushatës elektorale për ta kurrëzuar atë, sipas traditës sonë shumëvjeçare, me sukses të plotë, duke shkuar të gjithë në votimet e 10 korrikut të bashkuar me një mendim e një qëllim dhe duke vo-

tuar që të gjithë për kandidatët e Frontit Demokratik.

Fushata elektorale është një nga periudhat e rëndësishme të gjallërimit të jetës politike të vendit kur zgjedhësit, populli vetë, thotë mendimin e tij, gjykimin e tij, vlerësimin e tij mbi punën e kryer gjatë një legjislature nga Qeveria dhe nga organet e tjera të pushtetit, nga deputetët e vet. Në këto ditë populli gjykon edhe mbi punën dhe vijën e Partisë së tij dhe, më 10 korrik, ai, me ndërgjegje të lartë politike revolucionare, me pjekuri e urtësi patriotike, do të japë, me anë të votës, vendimin e vet. Për të gjashtën herë kandidatët për deputetë për në Kuvendin Popullor, komunistë e të paorganizuar në Parti, do t'i nënshtrohen gjykimin të votës së popullit, që përfaqëson vullnetin, dëshirat dhe aspiratat, patriotizmin që shqiptari shpreh, manifeston ndaj Partisë së tij, ndaj programit të saj.

Çdo pesëvjeçar, çdo legjislaturë e Kuvendit Popullor, e ka ngritur ekonominë, kulturën dhe mbrojtjen e atdheut në një shkallë të re, më të lartë. Por periudha e pesëvjeçarit të tretë, e legjislaturës së pestë, është pa dyshim një nga periudhat më revolucionare, më heroike për popullin e Partinë tonë, deri më sot.

Popull e Parti përballuan dhe mposhtën me guxim e vendosmëri bllokadën e egër të revizionistëve hrushovianë, të titistëve dhe të padronëve të tyre, imperialistëve amerikanë. Popull e Parti bënë hi e pluhur profecitë e revizionistëve hrushovianë që predikonin se te ne udhëheqja «do të shitej për 30 aspra», se Partia «do të gjunjëzohej» përpara diktatit të hrushovianëve, se populli «do të vdiste» nga uria.

Revizionistët mendonin se, me një të tundur të grushtit, do t'i qëronin hesapet me një Parti e një popull të vogël si yni. Të mjerët revizionistë! E matën botën me kutin e tyre. Sa pak e sa keq e paskan njohur ata Partinë e komunistëve shqiptarë dhe popullin tonë, që kurrë nuk kanë rënë në gjunjë përpara armiqve. Edhe në këtë çështje hrushovianët gjykuan si reaksionarë, si tradhtarë, si shovinistë dhe gabuan rëndë.

Si një trup i vetëm, me kushtrimin e Partisë, u ngritën në këmbë të mëdhenj e të vegjël, nbarë populli shqiptar, për të kapërcyer vështirësitë, për të shpartalluar sulmet armike, për të mbrojtur lirinë, socializmin, atdheun, për të mbrojtur dritën e syve të tyre, Partinë e Punës.

Duke mbajtur në një rën dorë kazmën e në tjetrën pushkën Parti dhe popull, komunistë e të paorganizuar në Parti, shpartalluan çdo bllokadë e komplot dhe ecën përpara, treguan shpirtin e tyre të madh revolucionar, vitalitetin, forcën dhe epërsinë e tyre mbi imperialistët e revizionistët. Të mbështetura në forcat e veta, besnike ndaj marksizëm-leninizmit, duke luftuar në dy fronte, si kundër armiqve të jashtëm, imperialistëve dhe revizionistëve, ashtu edhe kundër vështirësive të krijuara nga bllokada, kundër vështirësive të rritjes dhe të natyrës, masat punonjëse të vendit realizuan në përgjithësi me sukses detyrat kryesore të planit të tretë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës.

Si gjithmonë, edhe gjatë legjislaturës së pestë, klasa heroike punëtore e vendit tonë, fjalën që i dha Partisë, popullit, nuk e bëri dysh. Punëtorët e vendit tonë, të minierave apo të uzinave e të fabrikave, të ndërtimit

apo të transportit, të gjithë, gjatë pesëvjeçarit të tretë, i vunë gjoksin punës dhe arritën në prodhimin e përgjithshëm industrial një rritje prej 39 për qind në krahasim me vitin 1960. Një zhvillim të madh kanë marrë sidomos industria e naftës, e qymyrgurit, e bakrit, e hekurnikelit, industria elektrike, mekanike, ajo e material ndërtimit, industria e lehtë ushqimore etj. Vëllimi i të ardhurave kombëtare në vitin 1965 ishte 32 për qind më i madh se në vitin 1960 dhe mbi 5 herë më i madh se në vitin 1938. Ky është një ritëm i lartë zhvillimi.

430 vepra kryesore industriale janë vënë në funksionim gjatë pesëvjeçarit që kaloi. Industria jonë përbën sot bazën kryesore për rritjen e rendimentit të punës shoqërore, për zhvillimin intensiv të bujqësisë, për përmirësimin e jetës së popullit, për forcimin e pavarësisë ekonomike të vendit dhe të fuqisë mbrojtëse të atdheut.

Zhvillimi i vrullshëm i industrisë sonë socialiste ka zgjeruar bazën ekonomike të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, që janë themeli i pa-tundur i pushtetit tonë popullor, dhe ka ndihmuar në luftën për kapërcimin e prapambetjes shekullore të fshatit dhe për të ngushtuar dallimet midis tij e qytetit. Ngritja e përgjithshme sasiore e cilësore e prodhimit industrial ka rritur rolin e industrisë si degë udhëheqëse për gjithë ekonominë e vendit.

Me fitore të mëdha shkon në votimet e 10 korrikut fshatarësia jonë patriote. Nën kujdesin e vazhdueshëm të Partisë, e cila e ka konsideruar dhe e konsideron çështjen fshatare si çështje të madhe të revolucionit dhe të ndërtimit socialist të vendit, fshati ynë hyri në rrugën e kolektivizimit të bujqësisë, që është rruga e

zhvillimit të revolucionit socialist në fshat. Ky është hopi i madh në cilësi që ia ndryshoi krejt pamjen fshatit tonë, i dha hov zhvillimit të forcave prodhuese, solli transformime të mëdha jo vetëm ekonomike, por edhe në zhvillimin politik, ideologjik, social e kulturor të fshatarësisë sonë punonjëse, i dha një shtytje të fuqishme përpara gjithë zhvillimit të ekonomisë sonë socialiste, forcimit të pushtetit popullor e të mbrojtjes së atdheut.

Qysh në vitin 1965 prodhimi i përgjithshëm bujqësor u rrit rreth 2,3 herë, në krahasim me vitin 1938 dhe 36 për qind më tepër se në vitin 1960. Në vitin 1965, kundrejt atij 1960, me gjithë thatësirën e madhe dhe përmytjet, prodhimi i drithërave të bukës u rrit 51 për qind, prodhimi i orizit — 120 për qind e i pambukut — 53 për qind. Punime të mëdha bonifikimi e ujitjeje u kryen e vazhdojnë të kryhen. Sipërfaqja e ujitshme në vitin 1965 arriti në 205 000 hektarë, ose mbi 7 herë më shumë se në vitin 1938. Gjatë pesëvjeçarit të dytë dhe të tretë janë hapur mbi 59 000 hektarë toka të reja. Në vitin 1965, në vendin tonë ne kishim një traktor për 117,5 hektarë tokë të punuar, kurse në vitin 1960 kishim një traktor për 172 hektarë tokë.

Përparime kolosale janë arritur në vendin tonë edhe në zhvillimin e arsimit e të kulturës, sidomos në përhapjen e tyre në gjerësi. Këtë vit arsimor, në të gjitha kategoritë e shkollave, kanë mësuar rreth 430 000 nxënës e studentë, afërsisht një në çdo katër veta. Tani në arsimin e përgjithshëm të detyrueshëm 8-vjeçar përfshihen afro 90 për qind e fëmijëve të moshave përkatëse. Në shkollat e vendit tonë japin mësim 16 000 më-



sues e pedagogë. Numri i specialistëve me arsim të lartë është rritur nga 330 që kishim më 1938, në 4 245 më 1960 dhe në 9 200 më 1965. Numri i specialistëve me arsim të mesëm ishte më 1965 afro 2 herë më i madh në krahasim me vitin 1960.

Me gjithë vështirësitë e krijuara për shkaqet që tani dihen, furnizimi me sende të nevojës së parë për popullin është bërë pa ndërprerje dhe ka ardhur duke u rritur nga njëri vit në tjetrin.

Për arritjen e të gjitha këtyre sukseseve të mëdha në pesëvjeçarin e tretë, një kontribut të shquar kanë dhënë, si gjithmonë, punonjësit e kryeqytetit të atdheut tonë, të cilët vijjnë në zgjedhjet e 10 korrikut me një bilanc të pasur suksesesh. Ata e realizuan planin e prodhimit të përgjithshëm industrial të qytetit për pesëvjeçarin e tretë 103,8 për qind, me një rritje në vitin 1965 prej 24,2 për qind në krahasim me vitin 1960. Ndërtuesit e Tiranës u dhanë banorëve të qytetit mbi 3 500 apartamente të reja. Industria e qytetit tuaj në vitin 1965 prodhoi shumë më tepër se në vitin 1960, makineri, pjesë ndërrimi, enë alumini, pëlhura të leshta, rroba të gatshme, këpucë e sandale, artikuj tekstili, qelqi, qeramike, farmaceutike etj.

Duke marrë pjesë gjallërisht në lëvizjen masive patriotike për shtimin e prodhimit dhe për kursimin e vlerave materiale e monetare, nga duart e punonjësve të Tiranës dolën me qindra e mijëra makineri, pjesë ndërrimi e artikuj të rinj konsumi. E tërë Shqipëria u është mirënjohëse për veprat e lavdërueshme, për motorët diezel «Shqiponja», 15 kuaj-fuqi, për elektromotorët, për makinat shkoqëse të misrit, për motorët diezel

«Tirana» 22 kuaj-fuqi, për sondat e shpimit «18-vjetori i Çlirimit», për pompat «Shkëndija», për lesat e kultivatorët, për pompat squfuroze dhe transformatorët etj., që janë fryt i mendjes dhe i duarve të arta të klasës sonë heroike punëtore të kryeqytetit. Tirana jonë e bukur është rritur me ndërtime e vepra të reja industriale. Madhështor e ngritët ju në qendër të kryeqytetit Pallatin e Kulturës, ndërtimin e të cilit e sabotuan revizionistët hrushovianë, armiq të egër të miqësisë së popujve shqiptarë e sovjetikë. Por ju, si e tërë Shqipëria, triumfuat mbi armiqtë. Në emër të Partisë i uroj popullit ta gëzojë këtë Pallat Kulture madhështor.

Nga ana e Komitetit Qendror të Partisë dhe e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik, ju përgëzoj për fitoret e mëdha të arritura dhe ju uroj të dilni faqebardhë edhe në plotësimin e detyrave të pesëvjeçarit të katërt, duke mbajtur gjithnjë lart e me nder emrin e Tiranës së Qemalit e të Vojos, emrin e Tiranës së barrikadave e të brigadave partizane, të Tiranës ku rreh zemra e Shqipërisë socialiste.

Të gjitha fitoret që ka korrur populli ynë: lirinë e pavarësinë, sovranitetin kombëtar e demokracinë e vërtetë popullore, të drejtën efektive për të vendosur vetë mbi fatet e vendit, likuidimin e shfrytëzimit të njeriut prej njeriut, ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit, të drejtat e punës, të arsimit e të kulturës, barazinë e qytetarëve para ligjeve, sigurimet shoqërore etj., etj., janë fryti i Luftës së tij Nacionalçlirimtare, i punës së tij ndërtimtare, i udhëheqjes së drejtë marksiste-leniniste të Partisë së tij të Punës, i pushtetit popullor dhe i diktaturës sonë të proletariatit. Pa Luftën Nacio-

nalçlirimtare, pa Partinë në udhëheqje dhe pa vijën e saj revolucionare marksiste-leniniste, pa pushtetin popullor, nuk është vështirë të përfytyrojmë se si do të ishte pamja e atdheut tonë sot: liria dhe pavarësia do të ishin një plaçkë tregu në pazarllëqet midis imperialistëve dhe revizionistëve për ndarjen e zonave të influencës midis tyre, populli do të shtypej e do të shfrytëzohej i zhytur në analfabetizëm dhe injorancë, në prapambetje e mjerim. Shqipëria do të kishte pak a shumë pamjen e vendeve të pazhvilluara ku sundon feudalizmi, si në kohën e regjimit satrap të monarkisë zogiste ose të vendeve kapitaliste borgjeze apo revizioniste.

Ja përse mbarë populli te ne është i bashkuar si kurrë ndonjëherë rreth Partisë dhe pushtetit popullor dhe ka shpërthyer kudo në vendin tonë, në male e në fusha, në fshatra e në qytete, një lëvizje e madhe revolucionare popullore për zhvillimin e ekonomisë, për forcimin e atdheut, të lirisë e të pavarësisë, për forcimin e pushtetit popullor, për kalitjen e ndërgjegjes revolucionare.

Por, në punën e madhe që është bërë te ne, natyrisht, ka pasur edhe të meta, ka pasur edhe gabime. «Kush punon edhe gabon», thotë një fjalë e popullit tonë. Çështja është të mos dehemi nga sukseset, por të bëjmë sa më pak që të jetë e mundur gabime, të metat e dobësitë t'i kritikojmë dhe t'i ndreqim për ta çuar punën më përpara. Stalini i madh, në një nga fjalimet e tij në vitin e parë pas fitores së madhe të Luftës Patriotike, theksonte:

*«Thonë se ngadhënjyesit nuk gjykohen, se ata nuk duhet të kritikohen, nuk duhet të verifikohen. Kjo nuk është e vërtetë. Ngadhënjyesit mund dhe duhet të gjykohen, mund dhe duhet të kritikohen dhe të verifikohen. Kjo nuk është vetëm në dobi të punës, por edhe të vetë ngadhënjyesve: do të ketë më pak mendjemadhësi, do të ketë më shumë thjeshtësi»<sup>1</sup>.*

Këto janë mendime shumë të drejta, marksist-leniniste. Në këtë frymë janë edhe gjithë dokumentet e rëndësishme të Partisë sonë, veçanërisht Letra e Hapur e Komitetit Qendror të Partisë, që tërheqin vëmendjen e kuadrove të Partisë dhe të pushtetit për të mos u dehur nga sukseset, për të dëgjuar me kujdes zërin e popullit, për të punuar e jetuar me shpirtin revolucionar e të sakrificës që karakterizon popullin tonë, për të mos u shkëputur kurrë nga populli, për të qenë modestë dhe jo mendjemëdhenj.

Projektdirektivat e Kongresit të 5-të të Partisë për pesëvjeçarin e katërt, që do të botohen pas disa ditësh, janë një pasqyrë e gjallë e zhvillimit tonë ekonomik e kulturor dhe e perspektivave madhështore që i çelen vendit tonë dhe që do të realizohen nga puna e popullit tonë heroik. Si përherë, Komiteti Qendror i Partisë ju fton ju, ndërtuesit e socializmit, gjithë popullin, që, ashtu siç shqyrtoat me frymë revolucionare projekt-

---

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Fjalim në mbledhjen elektorale të rrethit «Stalin» të Moskës, 9 shkurt 1946. «Pravda» Nr. 35 (10117), 10 shkurt 1946.

planin pesëvjeçar me rastin e Thirrjes së Komitetit Qendror të Partisë e të Qeverisë, ashtu të diskutoni gjallërisht projektin e direktivave, të shfaqni me guxim që ju karakterizon mendimet tuaja krijuese, konstruktive, me qëllim që plani i katërt pesëvjeçar të jetë real, mobilizues, revolucionar, t'u përgjigjet ngritjes së përgjithshme revolucionare të popullit tonë, forcave të tij të pashtershme, energjive të tij kolosale, shpirtit të tij të sakrificës e të vetëmohimit.

Në pesëvjeçarin e ri, detyrë kryesore do të jetë vazhdimi i industrializimit socialist të vendit. Duke u mbështetur në burimet e pasurive natyrore, energjetike dhe të punës, në mënyrë të veçantë një zhvillim të madh do të marrin degët e industrisë përpunuese të rëndë e të lehtë. Epërsi do t'i jepet zhvillimit të industrisë së naftës, minierave, energjisë elektrike, metalurgjisë së zezë dhe metaleve me ngjyrë, industrisë kimike, mekanike dhe asaj të materialeve të ndërtimit, si hallka me rëndësi të kompleksit industrial dhe vendimtare për fuqizimin ekonomik të vendit, për zhvillimin e degëve të tjera të ekonomisë. Në përgjithësi prodhimi i përgjithshëm industrial parashikohet të rritet afro 45-50 për qind më shumë se në vitin 1965.

Shumë vepra të reja do ta zbukurojnë gjatë pesëvjeçarit të ri pamjen e atdheut. Ndër të tjera, do të ndërtohen hidrocentrali i madh në Vaun e Dejës, uzina e metalurgjisë së zezë, uzina e plehrave azotike në Fier, uzina e superfosfatit në Laç, hekurudha Rrogozhinë-Fier, vepra të mëdha bonifikimi e ujitjeje etj. Për herë të parë do të prodhohen në vend metale të zeza të petëzuara, acid sulfurik, pleh azotik dhe superfosfat,

sodë e kalcinuar, sodë kaustike, tunxh, pjesë të derdhura prej çeliku, enë të zmaltuara, llamba elektrike, xhama, pllaka fibre, lloje të ndryshme letre e kartoni, pëlhura të pambukta të cilësisë së lartë, penj për qepje etj.

Perspektiva të shkëlqyera i çel plani i ri pesëvjeçar zhvillimit të bujqësisë, e cila përbën hallkën më të rëndësishme për të siguruar plotësimin e detyrave kryesore ekonomike të pesëvjeçarit. Fshatarësisë sonë kooperativiste i takon detyra e lartë patriotike të plotësojë gjithnjë më mirë nevojat e vendit me drithë e me prodhime të tjera bujqësore e blegtorale, të plotësojë nevojat e industrisë sonë me lëndë të parë dhe të shtojë prodhimet për eksport, të përmirësojë gjendjen ekonomike të fshatit e të gjithë Republikës.

Me gëzim sot klasa punëtore, mbarë populli, shikojnë kthesën e madhe që po bën fshatarësia jonë punonjëse në rrugën e intensifikimit të bujqësisë. Si rezultat i vijës së drejtë të Partisë, i ndihmës e i përkrahjes së shtetit, i bashkëpunimit reciprok vëllazëror midis klasës punëtore dhe fshatarësisë, si rezultat i punës së palodhur të fshatarësisë, këtë vit, që është viti i parë i pesëvjeçarit të ri, fshatit i qesh fytyra nga prodhimet e mbara. Le të përmendim vetëm aksionin e madh popullor për të mbjellë sa më shumë patate, ku, fshatarë, ushtarë, punëtorë të bujqësisë, brenda një viti, bënë me sukses të plotë një kthesë vendimtare.

Detyra më e rëndësishme për bujqësinë dhe për gjithë ekonominë tonë gjatë pesëvjeçarit të katërt do të jetë shtimi i prodhimit të drithërave të bukës, duke

synuar që çdo ekonomi, çdo fshat, çdo kooperativë e çdo rreth të prodhojë gjithë sasinë e drithit që i duhet për nevojat e veta dhe të rritë sasinë e drithit që i dorëzohet shtetit për plotësimin më mirë të nevojave të popullit dhe të ekonomisë. Një punë e madhe do të bëhet gjithashtu për hapjen e tokave të reja, si dhe për ndërtimin e veprave të kullimit e të ujitjes. Do të hapen rreth 115 000 hektarë toka të reja dhe aftësia ujitetëse në vitin 1970 do të arrijë në jo më pak se 280 000 hektarë, nga 205 000 që ishte në vitin 1965. Do të rritet edhe më tej parku i makinave e i traktorëve për zgjerimin e mekanizimit në bujqësi e blegtori. Me ndërtimin e uzinave kimike në Fier e në Laç, bujqësisë do t'i jepen sasi të mëdha plehrash kimike. Të gjitha këto do të rritin në mënyrë të konsiderueshme rendimentet e prodhimeve bujqësore e blegtorale dhe do të përmirësojnë më tej jetën e fshatit tonë të ri socialist dhe të mbarë popullit.

Zhvillimi ekonomik, agroteknik, arsimor e kulturor i fshatit tonë po krijon çdo ditë mundësi të mëdha për përparimin e tij në rrugën e ndritur të socializmit që hapi kolektivizimi. Forcimi ekonomik e organizativ i kooperativave, përmirësimi i organizimit, i drejtimit dhe i shpërblimit të punës dhe, sidomos, forcimi e thellimi i demokracisë kooperativiste, për të cilën Partia zhvilloi në çdo fshat një diskutim të gjerë popullor, janë probleme të rëndësishme që duhet të tërheqin vazhdimisht vëmendjen e organizatave të Partisë dhe të organeve të pushtetit.

Në pesëvjeçarin e katërt edhe arsimi e kultura do të zhvillohen në mënyrë të pandalshme. Tani ne ndo-

dhemi në një etapë të re të zhvillimit të arsimit e të kulturës dhe përgjithësisht të revolucionit tonë kulturor. Puna jonë në këtë fushë është pjesë përbërëse e gjithë revolucionit dhe e ndërtimit tonë socialist. Prandaj tani Partia jonë i kushton një kujdes të veçantë përmbajtjes socialiste revolucionare të punës mendore-educative të shkollës, të të gjitha aktiviteteve kulturore, të gjithë krijimtarisë letrare dhe artistike. Puna e të gjitha institucioneve tona arsimore dhe kulturore duhet të përshkohet nga një frymë e lartë luftarake që t'i përgjigjet hovit revolucionar të masave, t'i mobilizojë ato edhe më shumë, t'i çojë peshë në punë dhe në luftë në të gjitha fushat e revolucionit socialist e të ndërtimit socialist. Ajo duhet të përshkohet nga një frymë e thellë partie, marksiste-leniniste, nga një nivel i lartë politik dhe ideologjik. Rrënjësja e një fryme të tillë në ndërgjegjen e punonjësve ka rëndësi vendimtare për thellimin e mëtejshëm të revolucionit ideologjik dhe kulturor, sidomos për edukimin e brezit të ri me ideale revolucionare, të gatshëm dhe të aftë për të marrë denjësisht në duar dhe për të çuar më tutje stafetën e luftës e të revolucionit.

Një zhvillim i tillë i arsimit e i kulturës është një problem i madh partie, shtetëror dhe shoqëror, problem i vetë masave të gjera punonjëse, të punëtorëve, fshatarëve, ushtarëve, intelektualëve dhe kuadrove. Te ne arsimi dhe kultura nuk janë monopol i disa «të diturve», por pronë e të gjithë popullit punonjës. Në një kuptim të tillë të përmbajtjes dhe të karakterit të revolucionit tonë kulturor, një rol të rëndësishëm duhet të luajnë gjithë inteligjencia jonë dhe të gjithë kuadrot,



sidomos ata që punojnë në frontin ideologjik e kulturor.

Shokë dhe shoqe bashkëqytetare,

Çështja e pushtetit popullor, siç dihet, është çështje themelore e revolucionit socialist. Pa përmbysur e pa shkatërruar me armë e me revolucion nga themelet shtetin borgjez apo feudal, pa vendosur diktaturën e proletariatit nuk mund të përmbysen borgjezia dhe klasat e tjera shfrytëzuese, nuk mund të çlirohet njeriu i punës nga shfrytëzimi kapitalist, nuk mund të ndërtohet socializmi. Për të çuar përpara revolucionin socialist në të gjitha fushat, për të mbrojtur fitoret e Luftës Nacionalçlirimtare, për të zhvilluar me sukses luftën e klasave në të gjitha frontet, e sidomos në atë ideologjik, për t'i prerë rrugët revizionizmit dhe orvatjeve të tij për të rivendosur kapitalizmin, për t'i bërë ballë luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit që përbëjnë rrezikun më të madh për lirinë, pavarësinë dhe paqen, sot është detyrë kryesore forcimi i pushtetit, forcimi i diktaturës së proletariatit, forcimi e revolucionarizimi i demokracisë sonë socialiste, respektimi me rreptësinë e duhur i parimeve themelore marksiste-leniniste mbi të cilat është ndërtuar shteti ynë popullor.

Komiteti Qendror i Partisë me Letrën e tij të Hapur, e cila është një dokument me rëndësi historike, me përmbajtje të thellë ideologjike e politike dhe me një vlerë të madhe për të sotmen e për të ardhmen, ka ngritur me forcë çështjen e forcimit të mëtejshëm të

pushtetit popullor, të diktaturës së proletariatit, çështjen e rritjes së rolit, të kompetencave dhe të drejtave të organeve të zgjedhura të pushtetit popullor, që nga Kuvendi Popullor e deri te këshillat.

Pushteti ynë është pushtet që buron nga populli, pushtet që i përket popullit, pushtet që ndodhet në duart e përfaqësuesve të zgjedhur drejtpërdrejt nga populli. Organet ekzekutive, që nga Qeveria dhe deri te komitetet ekzekutive të këshillave popullorë, nuk mund dhe nuk lejohet ta vënë veten mbi organet e zgjedhura, t'i komandojnë ato. Organet ekzekutive të ne, aparati shtetëror, ndodhen nën varësinë e plotë dhe efektive të Kuvendit Popullor dhe të këshillave popullorë të instancave të ndryshme, u nënshtrohen atyre dhe janë të detyruara të japin llogari përpara tyre dhe përpara gjithë popullit. Çdo shtrembërim i këtij parimi cenon karakterin demokratik të pushtetit popullor, cenon thelbin e tij si pushtet i vetë popullit.

Punonjësit e aparatit tonë shtetëror kanë luajtur dhe luajnë një rol me rëndësi për demokratizimin e modernizimin e aparatit tonë shtetëror dhe për këtë populli u është mirënjohës, i nderon e i çmon, por ata duhet t'u shërbejnë masave gjithmonë me modesti, me respekt e gatishmëri, me drejtësinë më të madhe, pa i zvarritur çështjet, pa i sorollatur njerëzit. Të gjithë duhet të mbajnë mirë parasysh në veprimtarinë dhe në sjelljet e tyre se te ne nuk janë administratat dhe nëpunësit që drejtojnë e udhëheqin, por është populli në fuqi ai që drejton, udhëheq e qeveris vendin. Në vendin tonë askujt, qoftë ky funksionar i zgjedhur, qoftë nëpunës i emëruar, nuk i lejohet të qëndrojë mbi popullin, t'i

shpëtojë dhënies së llogarisë para popullit, të shpërdojë përgjegjësinë dhe detyrën që i ka ngarkuar populli. Partia ka dënuar dhe dënon me rreptësi çdo shfaqje të huaj në këtë drejtim, si formalizmin, metodat e komandimit, arrogancën, hatëret, akrobllëkun, mendjemadhësinë, shkëputjen nga masat, mosdëgjimin e zërit të tyre, mbyjtjen e kritikës së masave etj. Partia na porosit të gjithë që jo vetëm t'i njohim mirë parimet e pushtetit tonë popullor, por edhe secili prej nesh të bëhet një luftëtar i vendosur për mbrojtjen e tyre nga çdo shtrembërim. Vetë punonjësit duhet të marrin në duart e tyre luftën kundër shfaqjeve e shtrembërimeve burokratike, për forcimin dhe demokratizimin e vazhdueshëm të pushtetit dhe të vendosin një kontroll të përditshëm e të rreptë mbi punën e organeve e të aparatave shtetërore dhe të gjithë funksionarëve e nëpunësve të shtetit.

Populli drejton nën udhëheqjen e Partisë sonë revolucionare, marksiste-leniniste, prandaj çdo gjë, në parim dhe në praktikë, duhet të jetë marksiste-leniniste, revolucionare. Njerëzit që populli i zgjedh në pushtet, në këshilla, në Kuvend, në komitetet ekzekutive dhe në Qeveri, duhet të kenë parasysh të edukohen dhe të veprojnë brenda kompetencave që kanë, në mënyrë marksiste-leniniste. Pra, pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv që është një i pandarë, i zgjedhur dhe i revokueshëm nga populli, duhet t'i ruajë të pastra dhe t'i zbatojë drejt parimet. Pushteti ynë duhet të jetë sa më i zhdërvjellët, efektiv, revolucionar, aktiv, i lidhur fort me bazën dhe me prodhimin. Kështu duhet të jetë edhe pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv.

Të forcosh pushtetin popullor do të thotë të zgjerosh pjesëmarrjen aktive të masave popullore të fshatit e të qytetit në drejtimin e punëve të këshillave popullore, të dëgjosh me vëmendje dhe respekt të madh zërin e punonjësve, vërejtjet e propozimet e tyre dhe, bashkë me ta, të luftosh për zbatimin e tyre. Fushata e zgjedhjeve që po zhvillohet në tërë vendin, në atmosferën e një pune të gjallë politike masive, ku njerëzit e punës ngrihen dhe diskutojnë me kurajë për problemet e mëdha kombëtare që përballon vendi ynë, është një shprehje konkrete e pjesëmarrjes së masave në punët e shtetit, në punët e shoqërisë, shprehje e demokracisë sonë popullore.

Të forcosh pushtetin popullor do të thotë të forcosh përbërjen e organeve të pushtetit, duke zgjedhur në to njerëzit më të mirë, të ndershëm, revolucionarë, luftëtarë të vendosur për kauzën e socializmit e të atdheut, punëtorë të palodhur që vënë mbi të gjitha interesin e përgjithshëm të popullit.

Si dita me natën ndryshojnë zgjedhjet tona popullore nga zgjedhjet në vendet kapitaliste, si dhe në vendet ku sundojnë revizionistët. Karakteri popullor apo antipopullor i pushtetit, mbi të gjitha, përcaktohet nga fakti se në duart e kujt është pushteti, se në duart e kujt janë mjetet e prodhimit dhe në dobi të kujt shpërndahen të mirat materiale, se në dobi të kujt dhe në dëm të kujt e zhvillon politikën dhe gjithë veprimtarinë e tij pushteti, nga fakti se ç'mundësi kanë masat popullore të ushtrojnë kontroll efektiv mbi veprimtarinë e shtetit dhe të marrin pjesë në drejtimin e punëve të shtetit. Nga këto del qartë në dritë falsiteti dhe de-

magogjija e propagandës borgjeze kapitaliste mbi demokracinë, mbi zgjedhjet e lira, mbi lirinë e fjalës e të veprimit, mbi lirinë e personit. Liri të vërtetë për popullin ka vetëm aty ku në pushtet zgjidhen njerëzit e popullit: punëtorë, fshatarë, ushtarë, intelektualë dhe prin një parti që ka shkruar në flamurin e saj, me gjakun e saj, betimin për t'i shërbyer vetëm popullit dhe u qëndron besnike parimeve të larta të marksizëm-leninizmit, ka vetëm aty ku është vendosur, ruhet e forcohet diktatura e proletariatit.

Armiqtë e popullit punonjës, armiqtë e socializmit, imperialistët dhe revizionistët hrushovianë e titistë, të cilët e kanë halë në sy pushtetin popullor, kanë shpërthyer një luftë të egër kundër diktaturës së proletariatit. Në diktaturën e proletariatit ata shikojnë pengesën e pakapërcyeshme për realizimin e planeve e të komplotëve të tyre antimarksiste, antipopullore, të degjenerimit të pushtetit të popullit, të restaurimit të kapitalizmit. Prandaj ata, imperialistë e revizionistë, të lidhur në aleancë të shenjtë luftime, po përpiqen me të gjitha mjetet të dobësojnë, të minojnë, të përçajnë dhe të përmbysin diktaturën e proletariatit në vendet socialiste, që do të thotë t'i marrin pushtetin nga duart popullit punonjës dhe në vend të tij të vendosin diktaturën e borgjezisë e të grupeve revizioniste që synojnë të njëjtat qëllime përfundimtare: likuidimin e socializmit.

Ne jetojmë në një kohë kur në botë bëhet një luftë e ashpër klasash midis borgjezisë dhe proletariatit, midis socializmit e kapitalizmit, midis popujve të shtypur dhe imperializmit. Kjo luftë gjen shprehjen e saj edhe në vendin tonë. Lufta midis socializmit dhe mbe-

turinave të klasave shfrytëzuese të mundura dhe mbeturinave të ideologjisë borgjeze në ndërgjegjen e njerëzve vazhdon edhe te ne. Kjo është një luftë e ashpër klase. Partia na mëson të nxjerrim mësim nga eksperiencia e hidhur e asaj që ndodhi në Bashkimin Sovjetik dhe në disa vende të tjera, ku në fuqi kanë ardhur revizionistët dhe i kanë hapur rrugën kthimit prapa drejt kapitalizmit. Ne duhet të marrim të gjitha masat për të mos lejuar shfaqjen e revizionizmit, për t'i prerë rrugën restaurimit të kapitalizmit, që të mos ngjasë kurrë në vendin tonë tragjedia që ndodhi në Bashkimin Sovjetik.

Për këtë Partia na mëson të zhvillojmë pandërprerë luftën e klasave, të mos harrojmë se ka njerëz nga klasat shfrytëzuese të mundura që ëndërrojnë dhe përpiqen të kthejnë përsëri parajsën e humbur. Ata janë bartësit dhe përhapësit kryesorë të politikës, të ideologjisë, të moralit dhe të kulturës borgjeze dekadente. Ka gjithashtu edhe nga njerëzit tanë që shfaqin në sjelljet, në qëndrimet e veprimet e tyre në punë, në jetë, në familje e në shoqëri gjithfarëlloj mbeturinash e konceptesh të huaja e të rrezikshme për ideologjinë tonë socialiste. Nën presionin e armikut të klasës, të brendshëm dhe të jashtëm, të politikës dhe të ideologjisë së tij, edhe nga radhët e punonjësve të paformuar e të pakalitur si duhet, lindin elementë të rinj borgjezë, njerëz që degjenerojnë, që kalojnë në pozita antisocialiste dhe i shërbejnë, me dashje ose pa dashje, armikut të klasës.

Ne nuk duhet të harrojmë kurrë faktin se Shqipëria është një vend i vogël, që ndërton socializmin në zemrën e Evropës kapitaliste e të molepsur me revizio-

nizëm, i rrethuar nga imperialistët e revizionistët, të cilët e kanë halë në sy Republikën tonë dhe ushtrojnë mbi ne një presion të gjithanshëm.

Në këto rrethana ne duhet të jemi kurdoherë vigjilentë, të qëndrojmë fort në pozitat klasore proletare, të forcojmë diktaturën e proletariatit, të zhvillojmë ekonominë dhe kulturën e vendit në baza të shëndosha socialiste, të rritim fuqinë mbrojtëse të atdheut, të punojmë, të jetojmë dhe të mendojmë kurdoherë si revolucionarë, duke vënë mbi gjithçka interesat e popullit, të socializmit, të revolucionit. Ne duhet të jemi të përgatitur në mënyrë të gjithanshme nga ana ekonomike, politike, ideologjike e ushtarake për t'i bërë ballë çdo situatë, për të kapërcyer çdo pengesë e vështirësi, për të mposhtur çdo armik e për të ecur gjithmonë përpara në rrugën e socializmit e të komunizmit, për të mbajtur të papërkulur e të pastër flamurin e marksizëm-leninizmit e të socializmit në brigjet e Adriatikut.

Për këtë është e domosdoshme që gjithë punonjësit tanë, komunistë e të paorganizuar në Parti, të udhëhiqen në çdo hap të punës dhe të jetës së tyre nga ideologjia dhe politika proletare marksiste-leniniste e Partisë. Kjo do të thotë që në trajtimin dhe në zgjidhjen e çdo problemi ekonomik apo administrativ, juridik apo ushtarak, kulturor apo organizativ, t'i japësh prioritet anës ideologjike e politike.

Për të çuar përpara me sukses çështjen e revolucionit dhe të ndërtimit socialist, si gjithmonë, duhet të mbështetemi fort te masat e popullit, te punëtorët, fshatarët, ushtarët, intelektualët popullorë, të ndjekim dhe të zbatojmë në jetë vijën e masave. Lidhja e ngushtë

me masat, dëgjimi i zërit të tyre, tërheqja aktive e masave në të gjithë jetën e vendit, kanë qenë dhe janë vija, së cilës Partia jonë i është përmbajtur me rreptësi, si gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ashtu edhe gjatë punës për ndërtimin socialist të vendit. Te lidhjet me masat qëndron forca e Partisë dhe e pushtetit popullor, qëndron garancia e fitores së çështjes sonë të madhe revolucionare, sepse janë masat ato që kryejnë revolucionin, që ndërtojnë socializmin, që bëjnë historinë.

Vija e masave gjen shprehjen e vet edhe në tërë punën drejtuese të organizatave të Partisë apo të masave, të organeve të pushtetit tonë popullor nëpërmjet metodës së punës kolegjiale. Nëpërmjet kësaj metode vijnë në këto organe apo organizata problemet që nxjerr jeta në frontet e ndryshme të luftës për socializmin, shohiten dhe analizohen ato në mënyrë kritike dhe autokritike, bëhet shkëmbimi i eksperiencës e i mendimeve, rrënjohet te njerëzit nevoja e respektimit të mendimeve të të tjerëve, luftohet subjektivizmi, mendjemadhësia dhe egoizmi, vihet në rrugë të mbarë përgjegjësia kolektive. Metoda e punës kolegjiale është metodë komuniste e drejtimit, e cila rrjedh nga vija e masave që ndjek Partia jonë dhe kjo është garancia e sigurt e mbrojtjes së pastërtisë dhe frymës revolucionare të marksizëm-leninizmit, mjeti i fuqishëm për të luftuar kundër shfaqjeve të ideologjisë borgjeze dhe revizioniste, kundër borgjezisë dhe shërbëtorëve të saj të çdo ngjyre.

Organizata jonë e madhe politike e Frontit Demokratik është këto ditë përpara aksionit shumë të rëndësishëm patriotik, fushatës elektorale për në Kuvendin Popullor. Në të gjithë vendin ajo zhvillon një punë



intensive politike, sqaruese, edukuese, në bazë të idesë së madhe, të parullës së madhe të bashkimit të popullit në radhët e saj, nën udhëheqjen e Partisë, për të shkuar të gjithë në votime dhe për t'ua dhënë njëzëri të gjitha votat kandidatëve të Frontit.

Gjallërimi i organizatës sonë të Frontit Demokratik që po vihet re kudo gjatë fushatës së zgjedhjeve, duhet të vazhdojë edhe pas zgjedhjeve. Partia e ka konsideruar dhe e konsideron organizatën e Frontit Demokratik një vatër të madhe patriotike, një bashkim luftarak të popullit, që ka luajtur dhe duhet të luajë gjithnjë një rol të rëndësishëm në jetën politike të vendit, si në fshat ashtu edhe në qytet.

Të ishe anëtar i Frontit Nacionalçlirimtar dje, gjatë luftës së çlirimit, ishte një çështje nderi, patriotizmi. Unë mendoj se të jesh anëtar i Frontit Demokratik sot është përsëri një çështje nderi e patriotizmi, sepse si dje dhe sot anëtarët e Frontit kanë qenë, janë e duhet të jenë luftëtarë të vendosur për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit popullor dhe për ndërtimin e socializmit.

Shokë dhe shoqe,

Populli dhe Partia jonë shkojnë në zgjedhjet e 10 korrikut me fitore të rëndësishme edhe në fushën ndërkombëtare. Para katër vjetësh ne shkuam në votimet për legjislaturën e pestë të Kuvendit Popullor në një kohë kur banda revizioniste e Hrushovit, Brezhnjev, Mikojanit e Kosiginit kishte shpërthyer sulmin e egër

antimarksist dhe antishqiptar kundër Partisë sonë të Punës, kundër Republikës sonë Popullore.

Kaluan katër vjet dhe ja, pas dyluftimit të madh që vazhdon midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit, në shkallë ndërkombëtare, ne shikojmë sot me krenari të ligjshme fitoren e marksizëm-leninizmit mbi renegatët hrushovianë, fitoren e popullit tonë mbi armiqtë e tij.

Shqipëria doli në arenën ndërkombëtare me dinjitet, autoritet e respekt të rritur, me emër të nderuar, me miq e përkrahës të mëdhenj të kauzës së saj të drejtë, sikurse janë popujt e botës, të ngritur në luftën e madhe antiimperialiste, sikurse janë proletarët dhe gjithë punonjësit e shtypur e të shfrytëzuar që janë ngritur e ngrihen kudo në luftën e klasës kundër kapitalizmit e borgjezisë, kundër revizionizmit dhe reaksionit.

Gjendja ndërkombëtare në të cilën zhvillohet fushata jonë elektorale është plotësisht e favorshme për forcat e revolucionit, të socializmit e të lirisë së popujve, për forcat e demokracisë e të paqes dhe e disfavorshme për forcat reaksionare, për armiqtë e popujve e të socializmit, imperialistët amerikanë e revizionistët modernë, për forcat antipopullore kudo në botë.

I gjithë populli shqiptar, me Partinë e tij të lavdishme të Punës në krye, po zhvillon një luftë heroike në arenën ndërkombëtare, kundër imperializmit botëror, me atë amerikan në krye, kundër revizionizmit modern, me atë hrushovian në krye, dhe kundër të gjithë reaksionarëve. Populli dhe Partia jonë janë në radhët e para të luftërave për liri, demokraci, paqe, socializëm dhe ko-

munizëm. Ne bëjmë pjesë si aktivistë revolucionarë në radhitjen e fuqishme të popujve përparimtarë të botës, të komunizmit ndërkombëtar, të demokratëve përparimtarë dhe revolucionarë, të shteteve përparimtare që kundërshtojnë dhe luftojnë me guxim për të shkatërruar përgjithmonë imperializmin botëror, me atë amerikan në krye, dhe gjithë agjunkturën e kapitalit botëror, një nga të cilat dhe nga më kryesoret është revizionizmi modern. Ne bëjmë pjesë në botën e re që ka lindur dhe ecën me vrull revolucionar përpara kundër botës së vjetër, që është kalbur dhe do të vdesë jo në krevat, por me luftë të ashpër revolucionare.

Ne shqiptarët jemi të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që kemi marrë dhe asgjë s'na frikëson, asgjë s'mund të na e lëkundë besimin tonë real në fitoren përfundimtare. Është për këto qëndrime të drejta dhe të guximshme që emri i Shqipërisë socialiste nderohet e respektohet kudo në botë dhe është bërë simbol i rezistencës e i luftës revolucionare për të gjithë ata që luftojnë për lirinë dhe pavarësinë e popujve të tyre, për socializmin. Ky besim i madh i popujve të botës, i revolucionarëve për Shqipërinë socialiste, na ngarkon me detyra të rënda që ne do t'i kryejmë si kurdoherë, pa marrë parasysh sakrificat, pse dihet që lufta kërkon edhe sakrifica.

Është e qartë për cilindo se imperialistët amerikanë po përgatitin një luftë të re botërore, për të vendosur në botë hegjemoninë e tyre. Imperializmi amerikan është në luftë me të gjithë popujt e botës, luftë që ka filluar me kohë, pa u bërë akoma e përgjithshme. Janë rreshtuar gjithashtu, nga njëra anë, forcat agresive luf-

tënxitëse dhe, nga ana tjetër, forcat revolucionare të popujve. Në këtë përleshje të madhe që ka filluar, imperializmi amerikan dhe partnerët e tij, po pësojnë disfata të tmerrshme e të njëpasnjëshme, politike dhe ushtarake. Imperialistët amerikanë, me gjithë mjetet që kanë vënë në veprim në shkallë botërore, që nga bombat edhe deri te paktet agresive ushtarake dhe dollarët, po pësojnë disfatë; të tëra këto mjete nuk u japin atyre asnjë mundësi efektive të thyejnë rezistencën e popujve.

Paktet agresive ushtarake, të lidhura me aq zell nga imperializmi amerikan me klikat e tjera imperialiste të botës për të penguar dhe për të luftuar revolucionin, luftën nacionalçlirimtare të popujve, janë tronditur nga themelet, për arsye të presionit të madh të popujve. Qëllimet dominuese barbare të imperialistëve amerikanë në këto pakte, politika për të pasur nën drejtimin e tyre mish për top dhe humbjet katastrofike në frontet e ndryshme të luftërave agresive që ata po zhvillojnë, i kanë bërë partnerët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të frikësohen, të mos kenë besim në këto pakte dhe aleanca, t'i kundërshtojnë fuqinë dhe hegjemoninë amerikane dhe t'i braktisin, më në fund, këto aleanca, siç bëri Franca golliste. Shembulli i Dë Golit ka filluar dhe do të bëhet një sëmundje ngjitëse në strukturën monstruoze të imperializmit amerikan.

Urrejtja politike dhe qëndrimet kundër dominimit dhe diktatit amerikan, kanë filluar të marrin forma shqetësuese për Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe në partnerët që i kanë ngelur. Kjo pakënaqësi dhe kjo rezistencë për jetë e kësaj borgjezie të madhe kapitaliste botërore po manifestohet ku hapur, ku fshehtas,

por kurdoherë shqetësuese për strategjinë globale amerikane.

Imperializmi amerikan është bërë xhandari më i egër ndërkombëtar. Ai ndërhyr kudo me armë për të shtypur popujt që luftojnë për çlirim. Lufta agresive amerikane kundër popujve të botës është preludi i luftës botërore që përgatitin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është pjesë kryesore e programit të përgatitjes së luftës, përkrah luftës për të mbajtur në këmbë traktatet agresive, luftës politike dhe të shantazhit atomik, luftës së diversionit, të skllavërimit ekonomik dhe të korrupsionit me anë të dollarit.

Në frontin kryesor të strategjisë së tij globale, domethënë në agresionet e ndryshme që imperializmi amerikan po zhvillon kundër popujve, ai po pëson disfata kolosale. Disfata e tij më e madhe është në luftën e Vietnamit. Populli heroik dhe legjendar i Vietnamit i tregoi botës mbarë se një popull i vogël, po i papërkulur, e mundi imperializmin amerikan ushtarakisht dhe politikisht, ai i çori maskën gjakësorit, ia theu të gjitha armët më moderne e më barbare, i likuidoi ushtarë të panumurt, lulen e forcës së tij agresive, zhduku mitin e kalbur të gjoja forcës kolosale amerikane, u dha zemër, kurajë dhe besim gjithë popujve të botës që janë ngritur dhe luftojnë kundër ndërhyrjes amerikane, mobilizoi popujt e shtypur për luftë, për revolucion, në një solidaritet unanimit. Prandaj admirimi dhe solidariteti i popujve të botës është i pakufishëm për heronjtë e Vietnamit, të cilët s'do t'i hedhin kurrë armët deri në fitoren përfundimtare. Heronjtë e Vietnamit janë të ndërgjegjshëm për rolin e madh që u ngarkon historia. Disfata e

plotë e imperializmit amerikan në Vietnam është një fitore e madhe në shkallë botërore, është shkatërrimi i planeve për luftë botërore të amerikanëve.

Populli shqiptar, për të cilin është e shtrenjtë kauza e luftës së popullit vëlla vietnamez, ka mbështetur dhe mbështet pa rezerva, me mish e me shpirt, luftën e tij të drejtë. Ne kemi deklaruar dhe deklarojmë botërisht qëndrimin tonë të vendosur në përkrahje të plotë të katër pikave të qeverisë së Republikës Demokratike të Vietnamit dhe të pesë pikave të Deklaratës së Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut.

Por, krahas luftës heroike që po bën populli i Vietnamit, janë ngritur e luftojnë me armë në dorë kundër imperialistëve dhe shërbëtorëve të tyre popujt e Amerikës Latine, popujt e Afrikës dhe të Azisë. Kudo popujt e të gjitha kontinenteve, proletarë, fshatarë, intelektualë përparimtarë, janë në lëvizje, po ngrihen në revolucion, po kundërshtojnë me guxim terrorin, shtypjen ekonomike dhe politike, po luftojnë shantazhin dhe frikën. Imperialistët agresorë amerikanë dhe ndihmësit e tyre janë të rrethuar nga popujt dhe goditen pareshur, pa pushim. Lufta vazhdon e do të vazhdojë akoma gjatë, por fitorja do të jetë për popujt, për revolucionet. Imperializmi amerikan, xhandari ndërkombëtar, dhe revizionizmi modern, me atë sovjetik në krye, do të shkatërrohen.

Imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror kanë bashkëpunëtorë më besnikë dhe shërbëtorë më të bindur në veprën e tyre antinjerëzore revizionizmin hrushovian, revizionizmin titist dhe pasuesit e tyre. Revizionistët hrushovianë, që rrëmbyen pushtetin në

Bashkimin Sovjetik, janë ajo shtresë e borgjezisë së re kapitaliste që, e maskuar si komuniste, po e kthen Bashkimin Sovjetik në një vend kapitalist. Ata janë lidhur ngushtë me aleanca shpirtërore, politike dhe ideologjike, me traktate të hapëta e të fshehta, me imperializmin amerikan, për dominimin e botës, për të luftuar marksizëm-leninizmin, socializmin dhe komunizmin.

Në momentet e krizës së imperializmit amerikan, Hrushovi dhe shokët e tij, me tradhtinë e tyre ndaj popullit dhe komunistëve sovjetikë, ndaj kampit të socializmit dhe komunizmit ndërkombëtar, i erdhën shpejt në ndihmë imperializmit amerikan për të shtypur revolucionet dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve të botës, për të mashtruar popujt dhe komunistët me demagogjinë e tyre, për të degjeneruar marksizëm-leninizmin në një teori socialdemokrate. Revizionistët hrushovianë dhe shokët e tyre u bënë kështu një agjunkturë e imperializmit amerikan në gjirin e lëvizjes komuniste botërore. E gjithë veprimtaria e tyre konsiston në atë që, tok me gjakësorët amerikanë, të minojnë kudo bazat e socializmit, të organizojnë luftën kundër vendeve socialiste dhe të shtypin me anën e armëve e të demagogjisë, të diversionit, të shantazhit, luftën heroike nacionalçlirimtare të popujve dhe rezistencën e tyre. Kudo ku ndërhyjnë armët amerikane, atje, tok me ta, janë edhe revizionistët modernë, së toku ata luftojnë me amerikanët kundër popullit kongolez, kundër Vietnamit heroik, ata i gjen në detin e Karaibeve, në Amerikën Latine, në Afrikë e në Azi.

Revizionistët hrushovianë, tok me imperialistët amerikanë, janë armiqtë më të egër të popullit të Viet-

namit që lufton. Të dy këta armiq të betuar të popujve përpiqen ta gjunjëzjnë Vietnamin me anën e bombave dhe propozimeve kapitulluese për «bisedime paqësore» me gjakësorët. Përpara katastrofës që po pësojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Vietnam, revizionistët sovjetikë përpiqen si bishti i gjarprit që Vietnami të kapitullojë, të dorëzohet dhe të shpëtojnë kësisoj SHBA nga disfata, sepse disfata e amerikanëve në Vietnam është, njëkohësisht, disfatë e revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye.

Demagogjia e revizionistëve sovjetikë tash është zor të gënjejë njeri. Atyre iu çor maska, ata pësuan disfata aq të mëdha, saqë u detyruan të rrëzonin kreun dhe ideologun e tyre, sharlatanin Hrushov. Por edhe kjo nuk u shërbeu shumë, pse disfatat ndjekin disfatat. Bashkimi Sovjetik po izolohet, po degjeneron, ata po e futin në aventura të përgjakshme. Revizionistët modernë sovjetikë dhe shokët e tyre, tok me imperializmin amerikan, kanë hyrë në një rreth infernal dhe të dy së bashku do të digjen në zjarrin e revolucionit e të luftërave nacionalçlirimtare të popujve.

Revizionistët modernë po shqyhen si ujçit me një-ri-tjetrin, sepse kurrë nuk mund të ketë unitet në mes tyre. Të gjitha klikat revizioniste që janë në fuqi, përpara disfatave dhe demaskimit në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, përpara rezistencës së vetë popujve të tyre, që po shtohet dhe po bëhet kërcënuese, përpara krizave ekonomike që po u shtohen dhe që janë aleati i pandarë i kapitalizmit që kanë restauruar në vendet e tyre, detyrohen të bëjnë, në mes tyre, mbledhje pas mbledhjesh, të fshehta dhe të hapëta, por edhe



me imperialistët e ndryshëm njëkohësisht, për t'i shpëtuar darës së hekurt që i ka zënë në grykë.

Revizionistët sovjetikë përpiqen të ruajnë hegjemoninë dhe dominimin e tyre në Paktin e Varshavës dhe për këtë komplotuan në Bukuresht<sup>1</sup>. Ata e lanë në baltë dhe e tradhtuan çështjen e drejtë të popullit gjerman. Çdo klikë revizioniste punon për hesap të vet, po futet në prehrin dhe në urdhrat e asaj fuqie imperialiste që e paguan më shumë dhe që e garanton më mirë nga revolucioni i brendshëm. Këto klika revizioniste i ngjasin klikës së Zogut që ia shiste atdheun cilitdo që e paguante dhe e ruante nga revolucioni popullor. Por klika e Zogut nuk shpëtoi dot nga vdekja. Kështu do ta pësojnë edhe këto klika tradhtarë revizioniste. Revolucioni do t'i përlajë. Kudo po krijohen parti komuniste marksiste-leniniste. Revizionistët modernë janë vënë në mes të zjarreve që do të shtohen dhe do t'i përpijnë.

Revizionistët hrushovianë, duke ndjekur gjurmët e paraardhësit të tyre, Titos, po përpiqen të bëjnë akrobaci politike në arenën ndërkombëtare. Veprimet e tyre janë tipike borgjeze, kapitaliste, por të atyre shteteve

---

1 Në Bukuresht prej 4 deri më 6 korrik 1966 u mbajt mbledhja e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, në të cilën u aprovua një deklaratë «Mbi forcimin e paqes dhe të sigurimit në Evropë». Ky dokument vinte krejt në kundërshtim me vendimet dhe qëndrimet e mëparshme të përbashkëta të anëtarëve të Traktatit të Varshavës dhe të mbledhjeve ndërkombëtare të partive punëtoresh e komuniste për çështjen gjermane. Të gjithë pjesëmarrësit e mbledhjes tradhtuan interesat e RD Gjermane duke nxitur politikën revanshiste të RFGJ.

borgjeze që janë skllevër të koniunkturave dhe gurë shahu të fuqive të mëdha imperialiste. Në këtë gradë e kanë katandisur revizionistët sovjetikë Bashkimin Sovjetik.

Komunikata franko-sovjetike që u nënshkrua disa ditë më parë në Moskë nga Dë Goli e nga revizionisti modern Podgorni dhe pritjet triumfale që i bënë revizionistët hrushovianë përfaqësuesit të borgjezisë kapitaliste franceze, nuk vërtetojnë veçse fitoren e Dë Golit dhe disfatën e revizionistëve sovjetikë. Dë Goli luajti dhe fitoi në tri tablotë: ai i çeli portat në Bashkimin Sovjetik për kapitalet dhe për kulturën borgjeze franceze, për bashkëpunimin në të gjitha fushat; realizoi shantazhin kundër imperializmit amerikan dhe ia shtoi frikën këtij të fundit; borgjezia kapitaliste franceze tok me revizionistët sovjetikë e vuri nën këmbë dhe e diskreditoi përfundimisht partinë revizioniste të Moris Torrezit dhe të Valdek Roshesë, e cila u bë tashti shërbëtorë e dy zotërinjve kapitalistë — kapitalistëve revizionistë sovjetikë dhe kapitalistëve francezë. Komunistëve të vërtetë marksistë-leninistë francezë nuk u ka mbetur veçse ta braktisin këtë vapor që është zhytur kokë e këmbë në tradhti dhe të luftojnë kundër renegatëve.

Revizionistët sovjetikë e ruajnë dhe do ta ruajnë si sytë e ballit aleancën e tyre me imperializmin amerikan, sepse ai është guri themeltar i politikës së tyre. Dë Goli e di fare mirë këtë, por, sa të fitojë, qar e ka dhe sidomos të aktivizojë shpejtimin e degjenerimit të Bashkimit Sovjetik në një vend kapitalist, preokupim ky i parë dhe i përgjithshëm i të gjithë kapitalistëve të botës, që nga amerikanët e të tjerë.

Revizionistët sovjetikë, që janë dhe ata borgjezë kapitalistë, me vajtjen e Dë Golit në Bashkimin Sovjetik, orvaten edhe ata t'u bëjnë njëfarë shantazhi ekzigjencave prej padroni prepotent të amerikanëve. Por lakenjtë revizionistë sovjetikë e morën përgjigjen e padronit të tyre amerikan me bomba, duke bombarduar barbarisht rrethet e Hanoit dhe të Hajfongut. Amerikanët kanë eksperiencën e Karaibeve. Pas këtij bombardimi barbarët amerikanë e dinë që Brezhnjevët e Kosiginët do të venë t'u puthin dorën si zakonisht. Por populli heroik i Vietnamit e ka të qartë se kush janë revizionistët sovjetikë dhe ç'plane e ç'demagogji të poshtër luajnë ata. Popujt përparimtarë të botës çdo ditë që kalon e kanë të qartë se sovjetikët dhe amerikanët bëjnë çmos që fryma e Tashkentit të veprojë dhe për Vietnamin heroik. Por ata do të dështojnë me turp. Shkatërrimi i plotë i pret revizionistët sovjetikë dhe revizionistët e tjerë. Ata do të kenë fatin e shokëve të tyre titistë dhe vendet e tyre fatin e Jugosllavisë së Titos, që ata e kanë marrë si model, që po e mburrin e po e ngrënë në qiell.

Ç'po ngjet në fakt aktualisht në Jugosllavi? Ajo është shndërruar në një vend kapitalist me të gjitha tiparet e një vendi të tillë. Disa ditë më parë ne asistuan në një akt të ri të dramës jugosllave. Grupi kapitalist i Tito-Kardelit, të cilët përfaqësojnë grupin e fuqishëm kroato-slloven, likuiduan grupin tjetër serbomadh të Rankoviçit, të fuqizuar nga hierarkia e UDB-së dhe nga elementët e tjerë parazitare, që në kombinimin e ri, i shohin të kërcënuara interesat e tyre nga grupe të tjera të borgjezisë së re kapitaliste.

Ky është një zhvillim i natyrshëm që ngjet në Jugosllavinë e sotme kapitaliste, dhe ne do të na shohin sytë dhe do të na dëgjojnë veshët shumë kacafytje të këtij lloji. Jugosllavia ka hyrë në një kaos të madh ekonomiko-politik dhe në një degjenerim të plotë. Këtë gjendje katastrofike as Titoja vetë s'mundi ta fshihte dot, por u detyrua ta pohojë në fjalimet e tij para disa ditësh në mbledhjen e Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë. Josif Stalini e paralajmëroi me kohë udhëheqjen revizioniste të Beogradit për rrugën e shtrembër antimarksiste ku ishte futur. Dhe Partia e Punës e Shqipërisë me një qëndrim të patundur, konsekuent, marksist-leninist revolucionar, për më shumë se 20 vjet rresht, luftoi me vendosmëri kundër trockistëve jugosllavë, i demaskoi dhe i shkatërroi të gjitha komplotet e tyre djallëzore kundër vendit dhe Partisë sonë drejtpërdrejt, i demaskoi para botës, duke i shërbyer kështu lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe luftës nacionalçlirimtare të popujve.

Jeta dhe lufta vërtetuan se qoftë përpara Luftës së Dytë Botërore, qoftë pas ardhjes së Titos në vendin e sekretarit të përgjithshëm të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, udhëheqja e Partisë Komuniste të Jugosllavisë ishte larg tipareve të një udhëheqjeje komuniste revolucionare, marksiste-leniniste. Merret lehtë me mend se në ç'rregë do të udhëhiqej ajo që sot quhet Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë.

Populli jugosllav luftoi heroikisht gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ky është fakt. Fakt është gjithashtu se në Partinë Komuniste të Jugosllavisë kishte komunistë internacionalistë, që luftuan heroikisht. Revizionistët e

Beogradit ditën ta kanalizonin këtë heroizëm të popullit në favorin e tyre, të ngrinin famën dhe të forconin pozitën e tyre, të shfrytëzonin në kohët më të vështira e kur u duheshin komunistët internacionalistë jugosllavë dhe më vonë t'i eliminonin me qindra e mijëra, si gjatë luftës, ashtu edhe pas luftës, këtë herë duke i akuzuar si stalinistë dhe informbyroistë. Krimet e revizionistëve jugosllavë, të cilët Partia e Punës e Shqipërisë ia ka bërë të ditur opinionit botëror me kohë dhe me fakte, ata tashti i pohojnë vetë me gojën e tyre. Populli heroik jugosllav me siguri e di se krimet e tmerrshme, për të cilat sot po flitet më haptas nën nxitjen e qarqeve a grupeve të interesuara, nuk janë vetëm të Rankoviçit, por të klikës revizioniste tradhtarë ku ai bënte pjesë dhe për këtë vetë populli do t'u japë dënimin e duhur gjithë atyre që e meritojnë, si kriminelit Rankoviç ashtu dhe bashkëpunëtorëve të tij të ngushtë e po aq përgjegjës sa ai.

Klika e Titos doli nga lufta me pozita të forta, e maskuar si komuniste, por me një aleancë të fshehtë me Anglinë e Çerçillit, me ndjenja antisovjetike që gjatë luftës, të cilat u bënë më të theksuara pas luftës, dhe që u manifestuan plotësisht sidomos pas kritikave shoqërore që i bënë J. Stalini dhe Byroja Informativë.

Grupi revizionist i Beogradit as që e filloi ndërtimin e socializmit në Jugosllavi. Zadrugat në fshatin jugosllav ishin një gënjeshtër e fillimit, që i lanë shpejt vendin realitetit kapitalist, domethënë forcimit të pronarëve të mëdhenj të tokave, kulakëve dhe varfërimit e likuidimit të fshatarëve të varfër. Fermat shtetërore

jugosllave që u krijuan, s'janë veçse ferma kapitaliste, në interes të klikave në fuqi. Pra, fshati jugosllav nuk e ka njohur as fillimin e ndonjë reforme socialiste, por ai vazhdon të shtypet dhe të shfrytëzohet si në kohën e kralëve serbomëdhenj.

Pasuritë e tjera të borgjezisë kapitaliste serbo-kroato-slllovene etj. pas luftës u konfiskuan nga regjimi i Titos dhe u bënë gjoja pronë socialiste e popullit që kishte luftuar. Ky ishte një bluf i madh, të cilit i doli boja pas 1948-s dhe deri tashti me mënyrën kapitaliste të ashtuquajtur të vetadministrimit. Këto u shndërruan në prona dhe truste kapitaliste të klikës titiste në fuqi dhe të aksionarëve amerikanë e të lloj-lloj firmave kapitaliste që ia kanë hedhur duart në fyt ekonomisë jugosllave.

Që në vitet e para të pasçlirimit u duk qartë politika hegjemoniste reaksionare e klikës renegate të Titos në Ballkan dhe në Evropën Qendrore, politikë e frymëzuar nga imperialistët anglezë dhe amerikanë që kishte për qëllim të pengonte ndërtimin e socializmit në këto vende, për të shkëputur vendet e Ballkanit dhe të Evropës Qendrore nga miqësia dhe aleanca me Bashkimin Sovjetik. Mirëpo Bashkimi Sovjetik, me Stalinin në krye, Partia e Punës e Shqipërisë, si dhe partitë e tjera të demokracive popullore ua shqelmuar dhe ua demaskuan këto plane imperialistëve amerikanë e anglezë dhe agjentëve të tyre titistë. Tradhtarët konspiratorë, agjentë të Tito-Rankoviçit, si Koçi Xoxe, Traiçe Kostovi, Laslo Raiku e të tjerë morën dënimin e merituar nga gjyqet e popullit. Le të reflektojnë marksistë-leninistët e vërtetë dhe popujt e vendeve socia-

liste jo vetëm për komplotet e këtyre kriminelëve, por edhe për shokët e tyre që i rehabilituan këta kriminelë, bashkëpunëtorë të kriminelit Rankoviç.

Këto plane djallëzore të tyre, sa ishte gjallë Stalini, nuk u realizuan. Pas vdekjes së Stalinit dhe me rrëmbimin e fuqisë në Bashkimin Sovjetik nga tradhtarët hrushovianë dhe nga revizionistët e tjerë modernë në vendet e tjera socialiste të Evropës, imperializmi amerikan, së bashku me revizionistët hrushovianë e jugosllavë, po i zbatojnë hap pas hapi këto plane, duke shpartalluar socializmin në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera të demokracisë popullore, duke i kthyer këto në vende kapitaliste dhe duke i bërë vegla qorre të strategjisë globale të imperializmit amerikan për dominimin e botës kundër socializmit, komunizmit, luftës nacionalçlirimtare e paqes botërore.

Partisë heroike të Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë i morën të keqen. Partia dhe populli ynë luftuan, luftojnë dhe do të luftojnë kundër tyre dhe kurdoherë do të fitojnë mbi këta armiq. Jeta ka vërtetuar dhe vërteton drejtësinë e Partisë së Punës të Shqipërisë, vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste dhe heroizmin e saj revolucionar.

S'mund të ketë njeri me pesë para mend në kokë që të mos kuptojë blafin e vetadministrimit jugosllav, të cilit i thurin lëvdata të gjithë revizionistët modernë. Duke u përpjekur nga njëra anë të vërtetojnë me demagogji se gjoja vetadministrimi na qenka «kulmi i demokracisë punëtoare» në prodhim, nga ana tjetër shohim se padronët e vërtetë të këtyre pasurive po grinden midis tyre kush e kush të marrë pjesën më të madhe.

Ky është kuptimi dhe arsyeja e likuidimit të grupit serb të Rankoviçit.

Por a mbaroi me kaq? Jo, ky është vetëm fillimi i mbarimit të klikës së Beogradit. Rivalitetet, shqyerjet në mes tyre do të shtohen, ata mund dhe të gjakosen me njëri-tjetrin. Ky është ligji i tyre, ligji i xhunglës. Mbaroi miti i unitetit titist; kalbësira, tradhtia e blofi çdo ditë po dalin sheshit. Këtë e shikojnë popujt e Jugosllavisë dhe marksistë-leninistët e vërtetë jugosllavë që nuk do të jenë përherë sehirxhinj e pasivë përpara katastrofës që po u ngjet. Heqja e Rankoviçit nuk i gënjen dot lehtë popullin jugosllav dhe revolucionarët jugosllavë, pse Rankoviçët me sistemin e tyre shfrytëzues janë prapë në fuqi. UDB-ja do të vazhdojë të jetë e plotfuqishme, bile ajo do të përsoset me metodat e policisë amerikane, për t'u bërë më e përshtatshme të ruajë regjimin titist dhe kapitalet amerikane të investuara në Jugosllavi.

Gjithë bota, të gjitha shtetet, të gjithë popujt tani e shohin qartë se ç'fshihet nën etiketën e «socializmit specifik jugosllav».

Revizionizmi modern pësoi disfatën e madhe me rrëzimin e Hrushovit. Rënia e Rankoviçit me shokë është një disfatë tjetër për revizionistët modernë. Të tjera disfata janë të pashmangshme dhe të sigurta. Le të shikojnë e le të reflektojnë popujt e Bashkimit Sovjetik edhe të vendeve të tjera ku i çojnë udhëheqësit e tyre revizionistë, tradhtarë, që po u bëjnë varrin popujve të tyre. Por në këtë varr që ata i përgatitin socializmit dhe marksizëm-leninizmit, do të bien vetë brenda.

Konspiratorët antimarksistë sovjetikë që janë



grumbulluar në Bukuresht për Traktatin e Varshavës, duhet ta kenë vënë në rendin e ditës edhe krizën që po ngjet në stanin revizionist të Beogradit. Por para opinionit publik nuk japin asnjë njoftim. Ata i tremben shumë kësaj. Kur është puna për të shpifur kundër Stalinit dhe kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, të gjithë revizionistët modernë ngrejnë buritë. Kurse për ato që ngjasin në gjirin e klikës titiste nuk gjen asnjë fjalë në shtypin e tyre. Heshtje prej varri! Përse? Sepse kanë frikë nga popujt e tyre, pse janë vetë kriminelë dhe konspiratorë.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar janë me të drejtë krenarë, që kurrë s'e përkulën flamurin e madh të marksizëm-leninizmit dhe luftuan e luftojnë me pallë zhveshur kundër tradhtarëve revizionistë modernë.

Shokë dhe shoqe,

Me vendosmëri të madhe ecim ne përpara në rrugën e ndërtimit të plotë të socializmit. Në këtë rrugë ne kemi miq e shokë të shumtë dhe besnikë.

Partia jonë e Punës, në unitet të plotë me partitë marksiste-leniniste, me grupet e komunistëve revolucionarë kudo në botë, të cilëve ajo u ka dhënë dhe do t'u japë gjithë ndihmën e përkrahjen e vet internacionaliste, si deri më sot edhe në të ardhmen, plotësisht e ndërgjegjshme për vështirësitë, pengesat e sakrificat, do të mbajë lart flamurin e luftës kundër imperializmit, kundër revizionizmit modern hrushovian e titist, do të

përkrahë pa rezerva luftën revolucionare çlirimtare dhe antiimperialiste të popujve.

Le ta ngrejmë lart e më lart flamurin revolucionar të Partisë sonë, le të ecim përpara me temp ushtarak, të mobilizuar si kurrë ndonjëherë për plotësimin e detyrave të planit të vitit të parë të pesëvjeçarit të katërt, për të thelluar në të gjitha drejtimet revolucionin tonë ideologjik e kulturor, idetë revolucionare që përfshihen në dokumentet e Partisë.

Le ta bëjmë vitin jubilar të 25-vjetorit të themelimit të Partisë sonë të lavdishme të Punës, udhëheqëses dhe organizatores së të gjitha fitoreve të popullit tonë, vitin e Kongresit të 5-të të Partisë, një vit të iniciativave të mëdha revolucionare që kanë lindur e do të lindin në të katër anët e vendit. Le t'i vëmë gjoksin punës, nën parullën e solidaritetit tonë popullor «një për të gjithë e të gjithë për një», për të çuar përpara çështjen e ndërtimit socialist, të mbrojtjes së atdheut, të forcimit të pushtetit popullor, çështjen e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë dhe të unitetit të çeliktë të popullit me Partinë.

Le ta bëjmë ditën e zgjedhjeve, 10 korrikun, këtë ditë feste të Ushtrisë sonë të lavdishme Çlirimtare dhe mbrojtëse heroike të truallit tonë arbëror e të socializmit, një ditë mobilizimi të madh politik, një shprehje të dashurisë sonë të flaktë për popullin, Partinë, atdheun, socializmin, një manifestim të shkëlqyer të unitetit të popullit rreth Partisë, për kauzën e socializmit e të mbrojtjes së atdheut.

Rroftë populli ynë i lavdishëm!

Rroftë Partia jonë e Punës, flamurtare e marksi-

zëm-leninizmit, e socializmit, e lirisë dhe e mbrojtjes së atdheut!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 164 (5574), 9 korrik 1966*

*Botohet me ndonjë shkurtim sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**USHTRIA TE NE ËSHTE E LIDHUR NGUSHTË ME  
PARTINË E ME POPULLIN DHE MËSON  
VAZHDIMISHT PREJ TYRE**

*Nga biseda me delegacionin e ushtarakëve kinezë*

**11 korrik 1966**

*Pasi u përshëndet me anëtarët e delegacionit, e mori fjalën shoku Enver Hoxha, i cili, ndër të tjera, tha:*

Jam shumë i gëzuar që takohem me përfaqësuesit e ushtrisë çlirimtare kineze. Lufta kundër armiqve ka bërë që të dy vendet tona të lidhen ngushtë me njëri-tjetrin. Kjo është në interes të socializmit, sipas mësimëve të Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit. Partitë tona duhet të luftojnë vazhdimisht që uniteti midis nesh të jetë shembull për të gjithë marksistë-leninistët e vërtetë revolucionarë dhe popujt e botës, që duan lirinë dhe luftojnë kundër imperia-lizmit, kundër revizionizmit modern dhe reaksionit.

Ky unitet i tmerron armiqtë tanë që kanë mbetur të izoluar e të rrethuar nga popujt dhe revolucionarët, prandaj i ka zënë frika dhe kjo frikë, me kalimin

e kohës, do t'u bëhet dhe më e tmerrshme, sepse kanë për të ndier më shumë afrimin e revolucionit. Partive tona dhe të gjitha partive marksiste-leniniste u del detyra ta forcojnë vazhdimisht unitetin në mes tyre, sepse kështu kanë për të korrur gjithmonë fitore mbi armiqtë.

Sot të gjithë revizionistët, reaksionarët e tradhtarët janë lidhur ngushtë me imperializmin amerikan në luftën kundër popujve dhe vendeve socialiste<sup>1</sup>. Revizionistët sovjetikë, titistë, reaksionarët japonezë, indianë, Nasutioni, Suhartoja dhe Çan Kai Shia, të gjithë janë bashkuar në një front me agresorët amerikanë për çështjen vietnameze.

Marksistë-leninistët nuk u tremben kurrë armiqve, sado të shumtë qofshin ata. Sigurisht, kështu vepron ai që është dhe e ndien veten të fortë dhe ka besim të patundur në forcat e veta. Këtë e provon edhe shembulli i Partisë sonë. Në fillim, kur u krijua, ajo ishte e vogël, nuk kishte më shumë se 200 anëtarë, por kishte popullin me vete që e donte dhe e ndiqte me vendosmëri në rrugën e drejtë të luftës kundër fashistëve italianë, gjermanë dhe kuislingëve shqiptarë. Armiqtë, për të ulur simpatinë dhe dashurinë e popullit ndaj Partisë, thoshin se komunistët janë «kalamane», «të marrë», se «nuk luftohet me një mbretëri

---

1 Shoku Enver Hoxha e shtron këtë çështje si një kundërvënie ndaj tezës kineze për të krijuar frontin e përbashkët antiimperialist edhe me revizionistët. Partia jonë i përmbahet tezës leniniste se pa luftuar kundër revizionizmit nuk mund të luftohet si duhet imperializmi.

kaq të madhe» e të tjera. Por historia vërtetoi se, kur ke popullin me vete, luftohet me çdo armik. Dhe ne luftuam e fituam.

Partia jonë niset nga mësimi marksist-leninist, sipas të cilit, të mos kesh frikë prej armiqve të revolucionit e të socializmit nuk do të thotë t'i nënvleftësosh ata dhe të humbasësh vigjilencën, sepse imperializmi e revizionizmi nuk do të heqin dorë asnjëherë nga lufta kundër nesh.

Asnjë nga ju nuk ka qenë më përpara në Shqipëri, me përjashtim të atasheut tuaj ushtarak. Shqipëria, shokë, është e vogël, por për ne shqiptarët është shumë e dashur ashtu siç është. Gjatë gjithë historisë së tij populli ynë nuk e ka kursyer gjakun për mbrojtjen e vendit të vet, por ka luftuar me armë në dorë dhe e ka larë atë me gjak, prandaj armiqtë e shumtë e të mëdhenj, që kanë dashur ta likuidonin fizikisht si popull, nuk ia arritën qëllimit, nuk e zhdukën dhe nuk do të arrijnë ta zhdukin kurrë. Historia i ka bindur shqiptarët se vetëm me luftë përballohet armiku e fitohet mbi të, sepse, po të mos kishte luftuar me heroizëm për vetëmbrojtjen e tij, populli ynë me siguri do të ishte zhdukur. Edhe sot, për të fituar revolucionin, duhet luftuar me trimëri dhe me vendosmëri deri në fund. Të kundërtën e thonë vetëm tradhtarët e marksizëm-leninizmit, hrushovianët, titistët etj., sepse ata janë armiqtë e popullit tonë, armiqtë e të gjithë popujve dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, janë agjentë dhe shërbëtorë të imperializmit.

Partia jonë e vlerëson lart ushtrinë. Ajo është një armë e rëndësishme e diktaturës së proletariatit,

e krijuar, e edukuar dhe e udhëhequr nga Partia. Ushtria te ne është e lidhur ngushtë me popullin dhe nën udhëheqjen e Partisë, është një forcë vendimtare për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e vendit. Duke qenë e lidhur ngushtë me Partinë dhe me popullin, ajo mëson vazhdimisht prej tyre për t'u bërë shembull i disiplinës komuniste të ndërgjegjshme dhe ushtarët tanë shembull ndershmërie në punë e në jetë.

Ideologët borgjezë thonë se ushtria përgatitet vetëm për në luftë. Në këtë mënyrë ata e shkëputin ushtrinë nga jeta dhe hallet e popullit dhe, kur ua kërkon interesi, e përdorin edhe kundër tij. Krejt ndryshe është ushtria te ne. Ajo shërben jo vetëm për mbrojtjen e kufijve të atdheut tonë socialist, por edhe për kalitjen dhe edukimin e punonjësve e të rinisë me frymën luftarake dhe me shpirtin e sakrificës. Ushtari ynë di përse lufton, kurse ai i vendeve kapitaliste nuk e ka të qartë përse lufton. Udhëheqja e Partisë dhe lidhja me popullin e dallojnë ushtrinë tonë si një armë të diktaturës së proletariatit nga ushtritë borgjeze e revizioniste, prandaj ne kujdesemi vazhdimisht për forcimin e rolit udhëheqës të Partisë në ushtri dhe për kalitjen ideologjike e politike të saj, sepse kur i shpëton kontrollit të partisë marksiste-leniniste, rrezikohet vetë karakteri i ushtrisë<sup>1</sup>.

Marksizëm-leninizmi na mëson se faktori vendimtar nuk janë armët, por njerëzit, masa e madhe e

---

<sup>1</sup> Aluzion për tezën dhe praktikant antimarksiste që duke-shin në Kinë, ku ushtria jepej model për të gjithë, edhe për partinë.

ushtarëve dhe e kuadrove të kalitur me ideologjinë marksiste-leniniste. Armët t'i kemi gati, të mësojmë t'i përdorim mirë, por në radhë të parë të kemi zemrën, ndërgjegjen në nivelin e duhur marksist-leninist. Ngritja ideologjike dhe politike, karakteri dhe shpirti revolucionar e bëjnë njeriun trim, me iniciativë, të shpikë, të thyejë taktikat, planet dhe armët e armikut. Të tillë janë njerëzit tanë, e tillë është ushtria që edukohet e udhëhiqet nga partia marksiste-leniniste. Prandaj kanë rëndësi të madhe mësimet marksiste-leniniste për të vënë kudo, edhe në ushtri, politikën dhe ideologjinë marksiste-leniniste në radhë të parë.

Në luftën kundër armiqve imperialistë, revizionistë dhe reaksionarëve të çdo kallëpi, vendet socialiste përpiqen vazhdimisht t'i japin njëri-tjetrit një ndihmë të gjithanshme. Ne e vlerësojmë shumë ndihmën tuaj. Edhe ne, nga ana jonë, përpiqemi t'ju ndihmojmë me aq sa kemi mundësi. Për ndihmën që i japim njëri-tjetrit ne nuk mburremi, sepse dhënia e saj është e natyrshme, e domosdoshme dhe një detyrë internacionaliste.

Shumë mirë bëtë që erdhët në Shqipëri me rastin e 10 korrikut, festës së ushtrisë sonë. Ardhja juaj është për ne një gëzim dhe një ndihmë e madhe, sepse ne gjithmonë kemi qenë të mendimit se këto takime shërbejnë për shkëmbimin e eksperiencës, për të mësuar nga njëri-tjetri. Dhënia e eksperiencës, ndihma morale, shoqërore, ideopolitike kanë rëndësi të madhe për forcimin e ushtrive tona, prandaj, shokë, të shkoni kudo në repartet tona dhe të merrni



kontakt me njerëzit e ushtrisë sonë. Gjatë vizitave që do të bëni ju do të shikoni si po e zhvillojmë në ushtrinë tonë stërvitjen ushtarake, punën për edukimin e saj etj. dhe, ju lutemi, të na bëni vërejtje pa druajtje, hapur. Ai që të do, të kritikon, thotë populli ynë. Miqësia jonë do të forcohet më shumë kur kritika dhe autokritika të përdoren drejt dhe me sinqeritet midis nesh.

Ju do të bëni vizita nëpër vendin tonë dhe do të shihni se ushtarët tanë nuk rrojnë vetëm nëpër kazerma, por janë të lidhur ngushtë me popullin e tyre. Sa më i fortë të jetë populli, aq më e fortë është edhe ushtria; sa më i ngritur të jetë populli ideologjikisht dhe politikisht, aq më e ngritur do të jetë edhe ushtria; sa më të forta të jenë prapavijat ideologjikisht, politikisht dhe ekonomikisht, aq më e fortë do të jetë edhe ushtria.

Gjatë takimeve me njerëzit tanë ju do të keni rast të shikoni edhe jetën e popullit shqiptar, të fshatarëve kooperativistë, të punëtorëve dhe të inteligjencies popullore shqiptare, përparimet që janë bërë në Shqipëri.

Më lejoni ta ngre këtë gotë për vëllazërimin e popujve e për shëndetin tuaj dhe uroj ta kryeni me sukses këtë vizitë në Shqipëri.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

## MARKSIZËM-LENINIZMI QË NA FRYMËZON ËSHTË GARANCI E FITORES SONË

*Nga biseda me delegacionin e punonjësve të naftës  
të RP të Kinës*

**11 korrik 1966**

*Pasi shoku Enver Hoxha i priti përzemërsisht miqtë, kryetari i delegacionit kinez e përshëndeti atë në emër të naftëtarëve kinezë dhe të fëmijëve të tyre. Pastaj e mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Vizita juaj në vendin tonë i shërben forcimit të miqësisë në mes popullit kinez dhe popullit shqiptar. Kjo miqësi duket edhe në ndjenjat e ngrohta aq të natyrshme që ushqejnë punonjësit dhe fëmijët e dy vendeve tona për njëri-tjetrin.

Populli kinez është punëtor e i talentuar. Ai ka luajtur dhe vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në historinë e njerëzimit dhe, sa më pak të mbyllen lufta dhe puna juaj brenda kufijve të Kinës, aq më

shumë do t'i shërbejnë lëvizjes revolucionare në të gjithë botën<sup>1</sup>.

Forca jonë nuk varet nga madhësia e territorit apo nga numri i popullsisë, por nga idetë e marksizëm-leninizmit që na frymëzojnë dhe uniteti i çeliktë Parti-popull. Këto janë garancia e fitores sonë. Dje në vendin tonë u bënë votimet për zgjedhjet e deputetëve të Kuvendit Popullor. Nga të gjithë ata që morën pjesë në votime, vetëm tre veta votuan kundër. Ky fakt tregon edhe një herë se sa të lidhur janë Partia e pushteti me popullin te ne. Një unitet i tillë mund të ekzistojë vetëm në ato vende që janë me të vërtetë socialiste. Por do të ishte gabim të mendonim se vetëm tre veta në të gjithë Republikën janë kundër nesh dhe të tjerë nuk ka. Në vendin tonë ka e do të ketë akoma armiq të egër të pushtetit popullor e të Partisë. Këtë ne nuk e harrojmë kurrë, se ndryshe na zë gjumi. Sot edhe ai që është i lëkundur, edhe armiku, nuk dalin hapur, por mendojnë se është më mirë për ta t'ia japin votat pushtetit në fuqi. Kjo ndodh sepse ata e ndiejnë forcën e diktaturës së proletariatit, kanë frikë nga lufta e klasave që zhvillojmë ne, e cila u tregon vendim, e, kur duhet, u pret edhe kokën armiqve kur këta e mbushin kupën. Prandaj si ne, edhe ju, ta zhvillojmë

---

1 Që në atë kohë, Kina po tregohej e plogët, inaktive, e mbyllur, e kufizuar. Politika e jashtme e saj ishte një politikë velizolimi, e ngurtë, pa dinamizmin e duhur në gjerësinë që e kërkonin momentet, koniunkturat, potenciali dhe rëndësia e saj në arenën ndërkombëtare.

e ta forcojmë vazhdimisht luftën e klasave, sepse ajo na mbron nga çdo e keqe.

Ne përfitojmë nga eksperiencia që keni arritur ju edhe në sektorin e naftës. Dikush mund të thotë se në nxjerrjen e naftës eksperiencë të madhe kanë vendet kapitaliste, sepse ato kanë zbuluar fusha të pasura naftë. Kjo është e vërtetë, por eksperiencia që ka fituar dhe ka realizuar populli kinez në drejtim të shfrytëzimit të naftës në një kohë kaq të shkurtër, me mjete jo aq të perfeksionuara sa të imperialistëve, që kanë më shumë se një shekull që po nxjerrin naftë, është një fitore e madhe. Pra, duke i parë në këtë prizëm, mund të themi se sukseset që keni arritur ju në nxjerrjen e naftës janë një bazë e sigurt për të ecur përpara.

Taçinin tuaj e vizituan kohët e fundit shoku Mehmet Shehu me disa shokë të tjerë. Ata na treguan me hollësi ato që panë atje, na folën për punën, për zbulimin e fushave të pasura të kësaj zone, për shfrytëzimin e tyre racional nga ana juaj, na folën për eksperiencën, zotësinë, heroizmin dhe thjeshtësinë e naftëtarëve.

Ne, komunistët, jemi revolucionarë, por për të mbetur gjithmonë të tillë, sidomos ne, që merremi më shumë me punë mendore, kemi shumë nevojë të jetojmë e të punojmë në shembullin e njerëzve të hekurt të punës e të prodhimit. Edhe ata të marrin mësim e dituri nga ne, por ca më shumë ne duhet të vemë dhe të marrim «diplomën» e tyre, domethënë të kalitemi me punën dhe me qëndrimet e njerëzve të thjeshtë. Jeta vërteton se në qoftë se nuk

e bëjmë këtë, megjithëse jemi anëtarë të Partisë, do të na ndryshken ca vidat, sepse intelektualët, qofshin komunistë, apo të paorganizuar në parti, mund ta harrojnë lehtë thjeshtësinë, t'u rritet mendja, të mendojnë se dituria që kanë u jep gjoja mundësinë dhe të drejtën të zgjidhin vetë çdo gjë pa përfillur masën, e cila duhet t'u bindet atyre. Prandaj të gjithë intelektualët duhet të kalojnë nga shkolla e njeriut të prodhimit, të kaliten vazhdimisht si hekuri që futet në zjarr, rrihet fort, zhytet në ujë, forcohet dhe kështu vegla del e fortë. Në këtë mënyrë të kalitemi të gjithë.

Kudo ka njerëz që mund të kenë zotësi, por, kur në zemrën e në kokën e tyre kanë turbullira, kur u mungon thjeshtësia, janë mendjemëdhenj dhe nuk i përfillin masat, këta nuk vlejnë. Një njeri, ta zëmë inxhinier i naftës, mund të jetë i zoti për të zbuluar fusha të reja naftë. Por, sado i zoti të jetë, sado të gjera të jenë dituritë e tij, vetëm ai kurrë nuk mund ta zbulojë dot në zemër të tokës këtë lëndë të çmueshme, sepse për këtë qëllim duhet të përdoren jo vetëm të gjitha mjetet e veglat që kanë bërë punëtorët, por edhe puna e tyre. Edhe pasi të bëhet zbulimi, do të duhen mijëra punëtorë të tjerë të zotë, të zgjuar, trima e të ndershëm për ta nxjerrë atë. Një kokë vetëm nuk e bën dot këtë punë, qoftë ky edhe shkençëtar. Askush nuk duhet të mendojë se vetëm mund të bëjë gjithçka. Një pikëpamje e tillë të çon në qorr-sokak. Këtë e them edhe nga eksperiencia jonë. Revizionistët hrushovianë dërguan në Shqipëri, gjoja për të na ndihmuar në fushën e naftës, edhe autoritete

të mëdha sovjetike të sektorit të naftës. Ne shpresuam në ndihmën e tyre, por nuk harruam kurrë se vendimtare për zhvillimin e sektorit të naftës do të ishte puna e punëtorëve dhe e specialistëve tanë. Dhe kemi menduar e vepruar drejt. Specialistët sovjetikë i panë, i studiuuan fushat tona, por, sikurse ju kanë vënë në dijeni shokët e industrisë sonë të naftës, megjithëse ne atje kemi harxhuar mjete të shumta materiale, me të cilat do ta kishim çuar edhe më përpara punën për zbulimin e kësaj pasurie të madhe të vendit tonë, na sabotuan. Kjo ngjau se ata, megjithëse ishin njerëz të mësuar, ishin revizionistë, njerëz të poshtër dhe armiq.

Specialistët sovjetikë nuk qenë të parët sabotatorë të nxjerrjes së naftës te ne. Që në muajt e parë pas Çlirimit na u desh të luftonim dhe të lanim hesapet me sabotuesit italianë, me në krye ish-drejtnesin e shoqërisë italiane, dhe të ndesheshim me punën armiqësore të disa inxhinierëve reaksionarë shqiptarë. Por si atëherë, kur pothuajse na mungonin fare mjetet dhe kuadrot, ashtu dhe më pas, kur kuadrot tanë për nga dituria dhe eksperiencia ishin, si të thuash, nxënësit e specialistëve sabotatorë sovjetikë, ne nuk mbetëm pa naftë, për arsye të zotësisë e të vendosmërisë së njerëzve tanë.

Shikoni, pra, shokë, ç'mund të bëjnë klasa punëtore, forca, mendja, gjykimi e guximi i saj. Kjo fut edhe teknikën e naftës në gjithë këtë revolucion të madh që bëhet në vendet tona dhe e lidh me jetën revolucionare të popullit.

Nafta ka rëndësi të madhe për ekonominë e çdo

vendi, se është si gjaku në dejtë e saj. Pa të nuk mund të ecë përpara as ekonomia jonë e një vendi të vogël e jo më e Kinës, që është një vend aq i madh.

Ne kemi vuajtur shumë për naftë. Tani, në sajë të vijës së drejtë të Partisë sonë, në sajë të punëtorëve, të inxhinierëve e teknikëve tanë të naftës, po ecim çdo ditë gjithnjë e më mirë përpara. Ne mund dhe duhet të bëjmë akoma më shumë në këtë sektor, se kemi shumë të meta, kemi akoma gjëra jo të qarta, jo të studiuara e jo të organizuara mirë, në mënyrë që edhe në drejtim të zbulimit të naftës të kemi më shumë sukses, por edhe si cilësi e sasi të nxjerrim më shumë. Të gjitha këto të meta nuk e kanë buri-min aq në mjetet materiale, sesa në mungesën e eksperiencës. Ne kemi akoma eksperiencë të paktë në nxjerrjen e naftës, prandaj na duhet të mësojmë shumë edhe nga praktika jonë, edhe nga eksperiencia e të tjerëve, se si ta vëmë më mirë në efikasitet këtë pasuri që është nga më të mëdhatë e vendit tonë.

Nuk e di nëse shokët tanë të industrisë së naftës kanë pasur mundësinë dhe kohën t'ju vinin në dijeni për gjendjen në këtë sektor dhe të merrnin mendimin dhe eksperiencën tuaj. Duke u bazuar në ato që kemi menduar dhe zbuluar, na duket se kemi një perspektivë të mirë. Në vija të përgjithshme duhet të mendojmë akoma se ç'të bëjmë, por këto në një ditë, natyrisht, nuk bëhen.

Mund që strukturat e fushave tuaja të naftës ndryshojnë nga këto tonat, por njerëzit që merren me naftën kanë dijeni për të gjitha strukturat.

*Duke e marrë fjalën, kryetari i delegacionit kinez vlerësoi lart sukseset e arritura, nën kujdesin e vazhdueshëm të Partisë, në sektorin e naftës te ne dhe foli edhe për rëndësinë që ka shkëmbimi i eksperiencës midis dy vendeve në të gjitha fushat për të mësuar nga njëri-tjetri. Pastaj përsëri e mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Vështirësitë e sektorit të naftës nuk janë të papërcyeshme, por, nga çdo pikëpamje, ky sektor, në krahasim me të tjerët, është shumë i vështirë. Prandaj ne i konsiderojmë naftëtarët si mjekë për fushat e naftës, bile më të zotë se ata, se në mjekësi sot kanë dalë mjete shumë të perfeksionuara, siç janë, për shembull, rrezet «X», «Gama», kombinimet analitike etj., me të cilat mund t'i diktosh dhe t'i përcaktosh saktë sëmundjet e ndryshme në organizëm. Mjeku, gjithashtu, e ka më të lehtë, se jo vetëm disponon mjete për zbulimin e sëmundjes, por ai ka, në radhë të parë, vetë të sëmurin që i flet ku i dhemb, i tregon vendin, kurse naftëtarët kanë të bëjnë me thellësi të panjohura të tokës. Është e vërtetë se edhe për kërkimin e gjetjen e naftës ka mjaft metoda, sido që puna në sektorin e naftës ka të bëjë me mijëra metra nën tokë, me struktura krejt të ndryshme, dhe ka raste që ndërsa në një vend nxjerr naftë, më poshtë nuk nxjerr, kurse më tej gjen përsëri, prandaj ne e quajmë një gjë të madhe shkëmbimin e eksperiencës midis nesh, që do të na ndihmojë shumë të dyja palët për zbulimin e shfrytëzimin e naftës. Ne jemi miq dhe nuk do të kursehem për të ndihmuar njëri-tjetrin. Në kuadrin e ba-



shkëpunimit shkencor vëllazëror, konkluzionet tona dhe tuajat duhet t'i bashkojmë dhe të përfitojmë prej tyre.

Në emër të Partisë dhe të Komitetit të saj Qendror ju falënderoj për vizitën tuaj.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

## DISA PROBLEME PËR REVOLUCIONARIZIMIN E ORGANIZATAVE TË PARTISË

*Fjala në Plenumin e 17-të të KQ të PPSH*

13 korrik 1966

Shokë dhe shoqe të Komitetit Qendror,

Partia jonë është një parti marksiste-leniniste, revolucionare, me parime politike, ideologjike dhe organizative të qarta, të drejta. Ajo, gjithë jetën e saj, është përpjekur dhe i ka zbatuar këto parime në përgjithësi drejt, duke ua nënshtuar kurdoherë dhe në çdo rrethanë një analize të drejtë marksiste-leniniste, duke i përmirësuar e duke i korigjuar, duke ua përshtatur rrethanave, kurdoherë në zhvillimin e tyre dinamik, pa shtrembëruar parimet bazë, duke përdorur forma dhe metoda të reja pune, kurdoherë e më revolucionare. Kjo e ka bërë Partinë tonë të gjallë, dinamike, luftarake, kjo e ka bërë të qëndrojë kurdoherë e lidhur me popullin dhe në krye të masave punonjëse, duke i frymëzuar, duke i drejtuar dhe duke

i edukuar ato me frymën dhe me punën e saj si të luftojnë, si të kapërcejnë vështirësitë, si të fitojnë. Ky është realiteti dhe këtë realitet duhet ta kalitim më tej, me metoda pune nga më revolucionaret.

Nuk do të zgjatëm shumë në këtë mbledhje të ple-numit të Komitetit Qendror për çështjet që do të shtroj më poshtë, pse kjo është një mbledhje posaçërisht për direktivat dhe shifrat kryesore të planit të katërt pesë-vjeçar. Veç kësaj, ne do të bëjmë edhe Kongresin, edhe analiza të tjera të ardhshme në Komitetin Qendror, në Byronë Politike dhe në Sekretariat për probleme me karakter thjesht partie. Them me karakter thjesht partie, po këto janë të lidhura me çdo gjë, pse kanë të bëjnë me kalitjen e mëtejshme të Partisë, që është kryesorja dhe që të gjithë ne, komunistët, duhet t'i kushtojmë kujdesin më të madh, vëmendjen, zemrën dhe mundin e plotë.

S'ka asnjë dyshim se Partinë e kemi të fortë, të devotshme ndaj marksizëm-leninizmit dhe popullit, të guximshme dhe luftarake, e kemi monolite, por ne nuk duhet ta flemë mendjen dhe, kur them ne, nuk kuptoj vetëm udhëheqjen, por gjithë Partinë, edhe punonjësit, se brenda në Parti kemi edhe gjëra, kemi edhe njerëz, kemi edhe forma e metoda pune që pri-shin mjaft punë, që ngadalësojnë kalitjen e mëtejshme, që pengojnë revolucionarizimin e Partisë me ritmet që duhet.

Në hovin dhe në luftën e përgjithshme të Partisë është fakt që këto nuk bëjnë një frenim të rrezikshëm. Por, po t'i futemi më thellë problemit, do të gjejmë se në disa organizata këto janë mjaft të

rrezikshme dhe, në rast se nuk marrim masa partie revolucionare, ato mund të shndërrohen në një rrezik jo vetëm për këto organizata, por për gjithë Partinë.

Letra e Hapur e Komitetit Qendror ishte dhe mbetet një armë e madhe për revolucionarizimin e Partisë. Kjo letër duhet të konsiderohet si një konkluzion analitik, marksist-leninist, që i është bërë punës dhe eksperiencës së Partisë gjatë këtyre vjetëve pune dhe lufte intensive me suksese e fitore dhe me të meta e gabime.

Tok me Letrën, para edhe pas saj, në të gjithë sektorët, u morën masa praktike shumë të rëndësishme, që ngritën peshë në këmbë Parti dhe popull në një entuziazëm dhe hov revolucionar të papërshkruar. Iu dha një grusht i fortë burokratizmit në aparatet shtetërore dhe të Partisë, u bë një riorganizim i mirë dhe në një kohë rekord, me mijëra kuadro shkuan në prodhim, u mobilizuan masat punonjëse dhe hartuan këtë plan të madh dhe real që e rrëzoi planin tonë të zyrave; u ndërmor një aksion kolosal për prodhimin e patates, i cili doli me shumë sukses; me dhjetëra mijëra të rinj e të reja po shkojnë me entuziazëm vullnetarë e të tjera. Gjithë këtë punë e frymëzon dhe e udhëheq Partia.

Por, ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm se edhe më shumë duhet të bënim, pra, më shumë duhet të bëjmë edhe këtej e tutje. Kjo punë e madhe që na pret për realizimin e planit që diskutuam, kjo luftë e madhe që po zhvillojmë si brenda vendit, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare, lyp që hovi revolu-

cionar, i krijuar, jo vetëm të mos ngelë në vend, por të ngjitet, të ngjitet dhe kjo ngjitje ka vlerë, në qoftë se matet me rezultate dhe jo me fjalë. Pra, që të arrihen rezultatet e caktuara duhet punë, duhen sakrifica, heroizma, vetëmohim, pjekuri politike dhe ideologjike, zotësi organizative dhe teknike dhe, mbi çdo gjë, vullnet i hekurt dhe ndërgjegje e lartë socialiste. Pikërisht të gjitha këto virtyte duhet t'i ketë, në radhë të parë, Partia, t'i kenë në radhë të parë komunistët.

Sikurse e them edhe në materialet që do të lexoni pas seancave të Plenumit të Komitetit Qendror, për gjetjen e të gjitha shkaqeve e të rrethanave që shkaktojnë ardhjen në fuqi të revizionizmit në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste, do të na duhen studime akoma më të thelluara, të cilat duhet t'i vazhdojmë, për t'u armatosur fort dhe për të mos lejuar që në Partinë dhe në vendin tonë të ngjasë ajo që ngjau në Bashkimin Sovjetik dhe njëkohësisht të luftojmë më mirë në arenën e komunizmit ndërkombëtar kundër revizionizmit modern.

Sidoqoftë, nga ajo që ngjau në Bashkimin Sovjetik, ne kemi nxjerrë dhe do të nxjerrim mësim të mëdha, të cilat janë bërë dhe do të bëhen armë lufte revolucionare për Partinë dhe për popullin tonë. Pikërisht se nxorëm mësim e se morëm në kohë masat e nevojshme për t'u prerë rrugën atyre fenomeneve regresive që u zhvilluan në Bashkimin Sovjetik, ne kemi arritur fitore dhe fitore të tjera akoma më të mëdha do të arrijmë në të ardhmen, në të gjitha fushat, të brendshme dhe të jashtme.

Burokratizmin, që i zuri frymën Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe lejoi revizionistët hrushovianë të uzurpojnë pushtetin, duhet ta kërkojmë edhe në format dhe metodat e punës së saj. Në parim më të shumtat e këtyre formave dhe metodave që përdorte Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik mund të ishin të drejta, por ato ishin sklerozuar, kishin humbur frymën dhe zbatimin në jetë në mënyrë revolucionare, ato qëndronin statike, kurse njerëzit i kishte mbuluar pluhuri dhe rutina.

Ne nuk e fshehim që kemi përfituar nga metodat dhe format e punës së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, por te ne ato s'kanë qëndruar statike, kanë pësuar ndryshime në cilësi, janë zhvilluar në rrugë revolucionare. Faktet tregojnë se revizionistët modernë titistë, hrushovianë dhe agjentët e tyre brenda, bënë çmos, përdorën çdo taktikë e komplot për ta gjunjësuar Partinë tonë, por ajo i theu me sukses të gjitha valët e tërbuara të tyre.

Metodën dhe stilin e punës së Partisë dhe të pushtetit tonë ne duhet t'i perfeksionojmë, t'i revolucionarizojmë akoma më tej. Të mendojmë thellë dhe vazhdimisht për këtë gjë me rëndësi, të kemi iniciativa të drejta krijuese dhe të mos kënaqemi me ato që kemi arritur, duke thënë se çdo gjë e zbuluam dhe e perfeksionuam. Ky do të ishte një gabim i madh dhe do të na bëhej një pengesë.

Do të marr disa nga këto çështje. Natyrisht, këto janë disa mendime të para të miat që mund të mos jenë shumë ekzakte. Kam ngarkuar shokun Hysni

dhe ai po punon me një grup të gjerë shokësh për këto probleme partie.

Të marrim çështjen e pranimeve në Parti. Ne kemi rregulla të vendosura për pranimet, si në Statutin e Partisë, ashtu edhe në udhëzimet e lëshuara nga Komiteti Qendror. Këto në parim janë të drejta dhe kur zbatohen mirë, kur kërkesat ndaj kandidatit janë të rrepta, atëherë rezultatet janë të mira. Por shumë herë nuk ngjet kështu, prandaj na hyjnë në Parti edhe njerëz që nuk e meritojnë akoma për të qenë anëtarë partie, ose s'e meritojnë fare.

Pse ngjet kështu? Sepse në këto raste rekomandimet, me gjithë këshillimet e vazhdueshme, janë formale ose të bëra duke u shtyrë nga fryma e miqësisë personale e nga akraballëku; se përgatitja e kandidatit bëhet në rrugë krejt formale ose nuk bëhet fare dhe se kjo përgatitje nuk është as e plotë, as e rreptë, as e mjaftueshme, as plotësisht revolucionare. Përveç kësaj, kërkesat për pranimin në Parti nuk mund të quhen të plota, si ngjet zakonisht, vetëm se njëri realizon normën, sepse normën e realizojnë dhe e tejkalojnë me mijëra punonjës, ose se tjetri ka marrë kualifikim teknik, sepse edhe këtë e marrin me mijëra punonjës. Nuk kihet parasysh si duhet se, në radhë të parë, është e nevojshme të vërehen karakteri i kandidatit, sjelljet, morali, ndjenja e sakrificës, qartësia politike dhe ideologjike (pjekuria politike), fryma revolucionare dhe masovike e tij.

Këtë gjykim dhe vlerësim serioz për kandidatin, i cili është gjaku i ri që hyn në Parti, si edhe përgatitjen gjatë stazhit, ne nuk duhet t'ua varim në qafë

vetëm një ose dy vetave. Në ato raste që veprohet kë-shtu ka formalizëm. Në fakt, kandidati, qëkurse pranohet i tillë, e quan veten anëtar partie dhe stazhi ka vetëm emrin, vetëm ngjyra e kapakut të tesarës ndryshon nga ajo e anëtarit. Kalimi i kandidatit në anëtar partie, më të shumtat e herës bëhet duke i drejtuar atij disa pyetje se si e lexon gazetën etj. Duhet të pohojmë se kjo procedurë e «rregullt» nuk ka as frymë, as zbatim revolucionar. Të tërë synojnë dhe mund të hyjnë në Parti, pse të tillë njerëz të mirë kemi me qindra e mijëra, por ndër ta ne duhet të zgjedhim më të mirët.

Si t'i zgjedhim më të mirët? Natyrisht ata që shquhen, por prapë nuk mjafton me kaq. Këta duhet të kalojnë në stazh, i cili, mendoj, të jetë i ndryshëm nga ky i sotmi, në mënyrë që këtij të mirit t'i kaliten cilësitë e mira dhe t'i vihen ato në provë, nëse i ka me të vërtetë dhe nëse i ruan e i kalit ato më tej përpara provave të rënda.

Stazhi i kandidatit, sidomos i atyre me origjinë dhe me profesion intelektual, qytetari, nëpunësi, në radhë të parë, por kjo nuk duhet të ekskludojë të gjithë kandidatët, duhet të bëhet atje ku do ta caktojë Partia (organizata-bazë dhe komiteti). Stazhi duhet të konsistojë, kryesisht, në punë të vështirë, në profesionin e tij ose jashtë profesionit të tij, mundësisht dhe kryesisht jashtë vendit ku kandidati ka familjen, ose ku bën jetën e zakonshme.

Detyra e dytë kryesore gjatë stazhit duhet të jetë edukimi ideologjik intensiv i kandidatit, për të cilin ai duhet të provohet kur të hyjë në Parti. Pavarësisht



nga rekomandimet, stazhin duhet ta vëmë nën drejtimin e organizatës dhe të kolektivit punonjës, ku kandidati do të dërgohet të punojë dhe të dihet nga të gjithë se ky person përgatitet për të hyrë në Parti, prandaj ai duhet të jetë në ballë të punës, të tregojë heroizëm dhe guxim në punë, të jetë i disiplinuar, i sakrificës, i rreptë për të mbrojtur drejtësinë, vijën e Partisë, të jetë i pamëshirshëm ndaj vetes, ndaj ndërgjegjes së tij, në qoftë se e ka të sëmurë etj., etj. Kështu ne do të kemi gjak revolucionar në Parti, heronj të papërkulur dhe të sakrificës.

Për të kryer këtë stazh asnjë konsideratë ose arsye nuk duhet të merret parasysh, jo «kam nënën», jo «kam gruan apo kalamanët», «s'më mjafton paga», «jam i sëmurë», e një mijë arsye të tjera. Në qoftë se kandidati këto i bëhen pengesë, atëherë s'ka pse të kërkojë të hyjë në Parti, le të qëndrojë më mirë jashtë Partisë.

Të tillë njerëz ne kemi edhe tani në Parti, të cilët bëjnë një jetë mikroborgjeze, bëjnë një punë rutinë dhe e quajnë këtë revolucionare, kurse kjo është vetëm një punë e zakonshme si të gjithë. Dhe ka nga ata që, kur u thua të shkunden, të prishin gjumin, ose kur i transferon, hidhen përpjetë, kundërshtojnë se po u bëhet «padrejtësi», bile shkojnë deri atje sa të thonë se kanë bërë «sakrifica të mëdha», sepse paskan shkuar në Shkollën e Partisë, ku i ka dërguar Partia me pagë të edukohen. Këta mund të jenë njerëz të mirë, por jo aq të mirë për të qenë në Parti.

Njerëzit e Partisë duhet të jenë të një brumi tje-

tër, prandaj t'i mbrujmë si duhet dhe ata që s'ecin në këtë rrugë, t'i skartojmë, se thartojnë edhe brumin e mirë.

Ky stazh revolucionar për kandidatin nuk duhet të jetë i shkurtër, unë mendoj të mos jetë më pak se tre vjet, që kandidati ta ndiejë mirë ç'do të thotë punë e lodhshme, sakrificë, studim, pse vetëm atëherë ai do të jetë ekzgjent, i rreptë, i pjekur, i dashur me shokët e Partisë që ecin me vendosmëri në rrugën e saj.

Sigurisht, kështu ne do të kemi më pak kërkesa spontane për t'u pranuar në Parti, por ata që do të kërkojnë, do ta kuptojnë me të vërtetë ç'gjë madhështore është Partia, sa nder i madh është të bëhesh anëtar i saj dhe jemi të sigurt se të tillë shokë do t'i kalojnë provat.

Ne kemi ligjin e shërbimit ushtarak. Të gjithë i binden me vullnet e gëzim të madh këtij ligji. Atje, në ushtri, të rinjtë rrinë dy vjet, tre vjet, pa as më të voglin shpërblim ekonomik, vetëm për detyrë patriotike. Ata edukohen atje ushtarakisht, politikisht, ideologjikisht dhe fizikisht. S'ka ushtar të ne që të thotë se bën një sakrificë 3-vjeçare, vetëm thotë se bën një detyrë të lartë patriotike dhe këtë e ka për nder.

Këtë e marr si shembull. Kurse ligji i Partisë për anëtarët e saj duhet të jetë që tërë jetën ta kalojnë në beteja e në sakrifica dhe kjo është një detyrë, një nder i madh për ta.

Neve na duhet t'i japim Partisë gjak të ri të pastër, por edhe brenda Partinë duhet ta kemi plotësisht revolucionare.

Partinë, në radhë të parë, si cilësi, duhet ta kemi të fortë e të kalitur dhe jo të rendim pas numrit. Orientimet e dhëna kanë rëndësi, por në rast se zbatohen shabllon, hartohen plane që përpara për pranime, duke mos u thelluar mirë, pse, sa dhe ku do të pranohen, atëherë rezultatet do të jenë të pakënaqshme. Ne mund të kritikojmë edhe «pse kemi pranuar shumë», «pse kemi pranuar pak ose aspak» për një kohë të gjatë; ne mund të kritikojmë se «kemi pranuar pak punëtorë» ose «disa kooperativistë» ose «shumë qytetarë», por fakt është, mendoj unë, që përbërja e Partisë, shtimi e kalitja e saj duhet të jenë një preokupacion nga më seriozët për të gjithë.

Ne nuk duhet të bëhemi skllëvër të formave që kemi vendosur, por edhe pa forma të drejta, revolucionare, të përtëritura, të gjallëruara nga lufta, nga eksperiencia, nuk mund të bëjmë, siç mendojnë disa shokë, që t'i heqim fare ato dhe t'i lëmë të lirë, të pranojnë sa të duan, si të duan, cilin të duan dhe kur të duan. Jo, në Partinë tonë nuk duhet ta lejojmë kurrë një gjë të tillë. Puna e Partisë është me shumë përgjegjësi, shumë delikate, është një punë shkencore, në të cilën duhen pasur parasysh shumë gjëra, shumë rrethana politike, ideologjike, organizative, humane, fizike, mendore, shpirtërore, ekonomike etj. Në një punë të tillë kaq delikate dhe kaq të rëndësishme, jo vetëm nuk lejohet të ecësh në tym, në anarki apo në spontaneitet, por çdo veprim, çdo hap, çdo formë dhe çdo metodë duhet studiuar, provuar, korrigjuar ose ndryshuar, duke mos u larguar për asnjë çast nga parimet bazë organizative të ndërtimit të Partisë.

Para disa ditësh studiova një material për organizatën e Partisë të rrethit të Vlorës dhe konstatova disa çështje që mund të rregulloheshin dhe duhet të rregullohen më drejt, sepse, megjithëse e flemë mendjen se kemi dhënë orientime, këto, sipas mendimit të shokëve që e kanë studiuar mirë këtë problem dhe sipas mendimit tim, nuk janë dhënë drejt. Raporti i komunistëve me popullsinë në qytetin e Vlorës është për çdo 100 frymë 4,5 komunistë, kurse në fshat për çdo 100 frymë 1,7 komunistë, në një kohë që dihet se popullsia e fshatit është më e madhe se e qytetit, më e shpërndarë, dhe puna atje më e koklavitur.

Por, po të analizojmë më thellë përbërjen e komunistëve të qytetit, do të konstatojmë se në tregti përqindja e Partisë si total na del 20 për qind, kurse në industri, në ndërtim, në transport dhe në sektorin shtetëror të bujqësisë — 12,2 për qind. Me gjithë orientimet e dhëna, këto proporcione nuk janë të drejta. Po të marrim, gjithashtu, raportin e komunistëve dhe të shoqeve komuniste në zonat malore të këtij rrethi, na del se është shumë më i madh nga ai i zonave fushore, gjë që nuk u përshtatet realitetit dhe nevojave. Në rrethin e Vlorës ne kemi 68,3 për qind të komunistëve në qytet dhe 31,7 për qind në fshat.

Pse i përmend këto shifra? I përmend që të ecim më mirë këtej e tutje dhe të mos ndodhë që ta fryjmë Partinë në disa vende e ta lëmë skeletike në disa vende të tjera. Partia është çdo gjë, ajo duhet të ketë një rritje shumë normale, të harmonishme, duke marrë parasysh nevojat, zonat, sektorët, rëndësinë e tyre, përparimin, prapambetjen e shumë faktorë të tjerë.

Detyra kolosale ka Partia mbi supet e saj. Ky plan i madh ekonomik që diskutuam duhet të realizohet me sukses, dhe ne e dimë se realizimi i tij nuk konsiston vetëm në radhitjen e shifrave dhe të përqindjeve në letër, ai është shumë i komplikuar në realizim, sepse ka të bëjë, në radhë të parë, me mobilizimin total dhe të gjithanshëm të Partisë dhe të popullit. Masat janë ngritur në revolucion, ato po revolucionojnë gjithë jetën e vendit, bujqësinë, industrinë, kulturën, shpirtin e njerëzve. S'ka dyshim që kjo është vepra e madhe e Partisë, por në Parti ne kemi edhe njerëz që nuk e ndjekin më hovin revolucionar të masave, po qëndrojnë prapa tyre. Këtu ekziston kontradikta, këta bëhen frenim, sepse, duke dashur të fshehin të metat e tyre, përpiqen të frenojnë edhe të tjerët të ecin përpara. Mjaft prej tyre kanë zënë qoshet, postet, rrojnë me ëndërrimet e së kaluarës, mburren me të dhe, natyrisht, kërkojnë të ruajnë privilegjet, të kritikojnë dhe të mos kritikohen, të qëndrojnë në ballë të vendit, e të tregohen konservatorë për gjakun e ri që duhet të futet në Parti. Unë nuk flas këtu për ata që vjedhin, që shkelin normat e moralit proletar dhe për të tjerë njerëz të këqij që duhen flakur pa hezitimin më të vogël jashtë Partisë, sepse kanë hyrë kontrabandë.

Disa organizata-bazë tregohen shumë «zemërgjera», ose më shqip, oportuniste ndaj disa anëtarëve të pandreqshëm të Partisë, recidivistë në gabime vije dhe me dënime në Parti, dy herë, tri herë, katër herë, bile dhe pesë herë. Ky qëndrim ndaj një anëtari të tillë mbulohet me atë se «duhet edukuar» dhe nuk mendo-

het se Partia bëri mjaft për ta edukuar, kurse ai nuk deshi të edukohej. Ne nuk duhet të vazhdojmë t'i mbajmë brenda në Parti këta njerëz, vetëm se gjoja për një kohë ata kanë punuar mirë, ose janë «teknikisht të zotë». Ata, duke u përjashtuar nga Partia, nuk janë armiq, ata le të vazhdojnë dhe duhet të punojnë mirë, të japin si qindra mijëra të tjerë, por për të genë anëtarë të Partisë nuk e meritojnë dhe ky dënim moral t'u shërbejë në jetë.

Disa herë shkohet me mendimin se «po t'i përjashtojmë këta nga Partia, na shtohet numri i të përjashtuarve». E pastaj, ç'del nga kjo? T'i mbajmë në Parti këta njerëz me vese kaq të dëmshme që të na prishin edhe të tjerët? Natyrisht, të përjashtosh nuk është mirë, por, që të përjashtosh pak, është e domosdoshme që, qysh më parë, ata që do të pranosh, t'i zgjedhësh dhe t'i edukosh si duhet. Vetë anëtarët e Partisë duhet të jenë në një luftë të përditshme revolucionare kundër të metave të tyre, të përdorin si duhet armët që u ka vënë në dorë Partia kundër të metave të shokëve, të jenë shembull në punë, në jetë e në çdo gjë.

Një nga detyrat vendimtare të Partisë është t'i edukojë anëtarët e saj në mënyrë metodike, marksiste-leniniste, çdo ditë pa pushim. Për edukimin, mendoj se nuk janë të përshtatshme fushatat, sepse, kur bie fushata, të metat dhe botëkuptimet e huaja në ndërjegjen e njerëzve, ku më shumë e ku më pak, shfaqen përsëri.

Gjithashtu nuk është e rekomandueshme që në një parti të pastër dhe monolite si kjo jona, të për-

jashtojmë me fushata, ose të pranojmë me fushata. Të tilla veprime mund të lejohen vetëm atëherë, mendoj unë, kur Partia kalon ndonjë krizë të shkaktuar nga ndonjë punë armiqësore fraksioniste. Rruga e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë për kalitjen e anëtarëve të saj është rruga dhe metoda revolucionare në punë dhe në këmbënguljen e rreptë edukative, politike dhe ideologjike të anëtarëve të saj. Këtu dallohen të mirët, duken të mefshtit dhe rrëzohen të këqijtë. Kështu Partia edukohet nga të mirët, por edhe nga të këqijtë që «rrëzohen nga treni». Pësimet bëhen mësim.

Dua të theksoj veçanërisht kujdesin e madh që duhet të tregojë Partia për anëtarët e saj me stazh dhe me luftë të madhe. Ky është thesari i Partisë që duhet të ruhet i paprekshëm dhe i pastër si sytë e ballit. Por Partia duhet t'i edukojë edhe këta që të qëndrojnë kurdoherë revolucionarë dhe konsekuentë derisa të vdesin dhe të vdesin duke luftuar heroikisht, me aq sa munden, sepse ka e do të ketë edhe nga ata që fizikisht do të plaken, ky është ligj, por ligj është dhe bëhet ligj për ne komunistët që, shpirtërisht, derisa të vdesim, të qëndrojmë revolucionarë. Partia nuk duhet t'u fërkojë krahët këtyre shokëve, por t'i ruajë, duke i futur në punë të vazhdueshme revolucionare. Kjo nuk do të thotë të mos i respektojë dhe të mos i dojë sinqerisht për luftën e tyre, por ajo të mos lejojë në asnjë mënyrë që këta shokë, me një të kaluar partie të mirë, të kthehen në parazitë, në mendjemëdhenj, në arrogantë, ose të kërkojnë përfitime e privilegje të paligjshme për veten e për nje-

rëzit e tyre dhe t'ia hipin në qafë ose të bëhen fre për Partinë. Kjo është mjaft e rrezikshme, sepse krijon në Parti shtresa të privilegjuara me mbeturina mikroborgjeze, antiproletare.

Përse po i përsëris sot edhe një herë këto gjëra kaq të njohura për Partinë dhe për udhëheqjen e saj, mbi të cilat Partia dhe udhëheqja vazhdimisht kanë vënë kujdesin më të madh dhe është fakt se kemi korrur suksese? Unë i përsëris dhe besoj nuk bëj keq, për arsye se Partia ka përgjegjësinë e madhe përpara popullit tonë, se ajo ka mbi supet e veta barrë kryesore dhe të rënda që duhet t'i mbajë me sukses, se në punën tonë ka edhe të meta e gabime që ne duhet t'i zhdukim me guxim, me punë dhe hov revolucionar.

Komiteti Qendror dhe Qeveria duhet të shkrihen në punë, ta ndiejnë vazhdimisht pulsën e Partisë dhe të popullit dhe të marrin masa efikase, të drejta, të shpejta. Por kjo nuk është e tëra. Në këtë rrugë duhet të veprojnë edhe udhëheqja e Partisë edhe ajo e pushtetit në bazë. Prapë edhe kjo jo vetëm nuk është e tëra, por do të jetë e çalë në qoftë se nuk bëjmë që në këtë ritëm dhe në këtë rrugë të ecin e gjithë Partia dhe të gjithë punonjësit.

Te disa shokë drejtues të bazës ka disa pikëpamje që s'janë të drejta. Cilat janë këto? Do të them disa gjëra që s'janë të reja, por që akoma çalojnë.

Disa shokë, sidomos punëtorë partie, vazhdojnë t'u vënë më shumë rëndësi shifrave sesa njerëzve, edukimit të komunistëve dhe të punonjësve. Ata nuk mbajnë parasysh sa duhet se janë njerëzit ata që realizojnë të mirat materiale dhe zbatojnë me heroizëm



vijën e Partisë, por, gjithashtu, janë njerëz edhe ata që vjedhin, që vrasin, që shkelin ligjet etj. Një pakujdesi e tillë e veçantë sjell si pasojë që rregullat, format e punës, të edukimit etj., zbatohen shabllon në disa organizata, ato zbatohen pa shpirt e pa jetë, nuk bëhen përpjekje që ato t'u adaptohen situatave, rrethanave, por pritët që t'u venë udhëzime nga lart, për çdo gjë.

Disa shokë të tjerë marrin rrugën e kundërt dhe thonë se tani kemi iniciativë, prandaj është burokraci të informojmë qendrën. Por, kur u futesh thellë këtyre «iniciativave», do të shikosh se ka edhe punë të përciptë. Të marrim, për shembull, zgjedhjet në Parti, që u bënë disa kohë më parë. Tërë jetën ne kemi bërë zgjedhje partie. E kush nuk e di rëndësinë e tyre dhe të dhënies llogari përpara Partisë? Këto përpara i bënim çdo vit, më pas vendosëm të bëhen në 2 vjet një herë, për më mirë. Por ç'ngjet në disa rrethe dhe në disa organizata partie? Edhe pas gjithë kësaj shkundjeje revolucionare dhënia llogari dhe zgjedhjet në disa organizata u bënë prapë formale, njerëzit që do të referonin as që ishin përgatitur si duhej. Pra, ky eveniment i madh për Partinë dhe popullin as që u dëgjua fare e në shumë raste u bë sa për të kaluar radhën. Disa komitete partie rrethesh, si pa gjë të keq, përdorin formulën «le të vetëveprojnë organizatat-bazë». Iniciativa duhet të kuptohet drejt, sepse nuk do të thotë që komiteti i Partisë i rrethit nuk duhet t'i ndihmojë e t'i kontrollojë organizatat-bazë në përgatitjet që bëjnë për mbledhjen për dhënie llogari e zgjedhje.

Disa thonë se «çështja e zgjedhjeve në Parti është çështje e brendshme e Partisë». Kjo nga ana organizative është e vërtetë. Nuk është populli që do të zgjedhë udhëheqjen e Partisë, por populli sytë dhe zemrën i ka te Partia, ai do që në udhëheqje të Partisë të zgjidhen komunistët më të mirë. Prandaj përse ky sektarizëm i dëmshëm, përse ky eveniment kaq i rëndësishëm për jetën e Partisë të mos lidhet politikisht me masat, që këto të ngrihen në këmbë, të marrin zotime, të bëjnë propozime, vërejtje e kritika për punën dhe për njerëzit? Kurse, pastaj, për udhëheqjen vendos dhe e zgjedh konferenca e Partisë.

Por edhe pasi mbaron punimet konferenca e Partisë asgjë s'pipëtin në popull, ç'u bë, ç'u vendos, kush u zgjodh, pikërisht sikur Partia të ishte në ilegalitet. Disa hiqen se vijën e masave, lidhjen me masat, i kanë kuptuar dhe i zbatojnë, por janë larg t'i kenë kuptuar dhe t'i zbatojnë si duhet. Sektarizmat, ngurrimet, frika për të dalë para masave i dëmtojnë lidhjet e Partisë me masat, prandaj, si të tilla, duhet të zhduken. Vija e masave nuk mund të kuptohet dhe as të zbatohet pa forcuar, pa zgjeruar dhe pa organizuar më mirë lidhjet e Partisë me masat dhe me organizatat e masave.

Nuk do të flas për zhvillimin e luftës së klasave, që duhet mbajtur dhe forcuar vazhdimisht, por dëshiroj të theksoj dy momente për këtë problem. Po t'i hedhim një sy si zhvillohet kjo kundër armiqve të jashtëm dhe presionit të tyre, do të dalë se këtu ka shumë boshllëqe serioze që duhet të plotësohen sa

më parë nga propaganda e Partisë. Por, sidoqoftë, me të meta, ajo bëhet nga kuadrot me anën e propagandës, sepse e kanë më të lehtë, meqenëse për këtë u vijnë në ndihmë edhe artikujt e shtypit, sado që edhe gazeta shpeshherë mbetet te disa formula të gatshme e të rrumbullakosura.

Mirëpo, kur vjen puna për ta bërë praktikisht luftën e klasës në fushën ideologjike, sidomos kundër mbeturinave në ndërgjegjen e njerëzve, kjo nuk bëhet lehtë, sepse një luftë e tillë e klasash, kërkon të bësh analizën marksiste-leniniste të vetvetes, pastaj të tjetrit, të rrethit shoqëror, të nxirren konkluzione të drejta dhe për të gjitha këto duhet guxim bolshevik, ngritje politike, ideologjike etj.

Dua të shtoj këtu edhe diçka tjetër. Kur është çështja për të kritikuar të metat e ndonjë punonjësi, as që hezitojmë ta nxjerrim këtë përpara kolektivit. Dhe kjo është shumë e drejtë. Kur vjen çështja për një komunist të thjeshtë, atë ne e kritikojmë në Parti dhe kjo është gjithashtu e drejtë, por disa herë harrojmë ta çojmë atë përpara kolektivit ku ai i ka bërë gabimet. Këtu bëjmë gabim. Kur vjen pastaj çështja për të kritikuar drejtuesin ky nuk kalon fare përpara masës. Edhe kjo është shumë gabim. Kjo është një formë e mbetur, pa vlerë, e dëmshme dhe disa herë mund të bëhet e rrezikshme, sepse në byrotë e komiteteve të Partisë ose të organizatave-bazë, mund të ketë familjaritet dhe drejtuesi që gabon e ka bërë zakon të hajë jo një, por dyzet kritika, faqja t'i bëhet shollë dhe asgjë të mos i bëjë efekt. Prandaj në këto çështje dhe në shumë të tjera, megjithëse kemi

bërë kthesë, kjo kthesë duhet të bëhet akoma më shumë rrënjësore, sepse këto punë të mëdha që kemi përpara duhen kryer me sukses për të mirën e popullit dhe të ardhmen e tij. Ne duhet të reflektojmë thellë për atë që ndodhi në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ku revizionizmi ka marrë fuqinë. Jeta në parti atje dukej si normale, pranoheshin në parti anëtarë të rinj, disa përjashtoheshin, bëhej kritikë dhe autokritikë që cilësohej «bolshevike», por që e kishte humbur bolshevizmin e saj etj., prandaj të mos na zërë gjumi mbi dafina dhe mbi rutinë.

Në format e punës organizative të Partisë, të agjitacionit dhe të propagandës, të edukimit komunist, për të mos folur veç për secilën nga këto, ne kemi akoma shumë rutinë dhe një shabllonizëm të dëmshëm. Ne kemi marrë dhe do të marrim masa për t'i gjallëruar këto, por kjo nuk do të jetë kurrë e mjaftueshme dhe e plotë, në rast se punonjësve të Partisë, veçanërisht e në radhë të parë, nuk u punon koka, nuk i zhvillojnë këto direktiva të qendrës, nuk i pasurojnë ato me eksperiencën e pasur të Partisë dhe të punonjësve, nuk marrin iniciativa të studiuara vetë.

Përse pritet nga udhëheqja e Partisë në disa rrethe që, për jetën e brendshme të kësaj apo të asaj organizate partie, duhet të bëjë analiza më parë Byroja Politike ose Sekretariati i Komitetit Qendror dhe të mos i futen vetë thellë, herë pas here këtij problemi kapital? Kjo është rruga që duhet të ndiqet. Kështu ndihmohet e forcohet më mirë Partia, sepse diagnoza bëhet në vend dhe nga kuadrot e vendit që rrojnë dhe luftojnë çdo ditë e çdo orë në terren, sesa nga

një grup shokësh që venë nga lart, që natyrisht nuk janë as të huaj as edhe pa eksperiencë për këto probleme, por, sidoqoftë, analizat e thella të vetë rrethit do të jenë më të plota, më instruktive dhe konkluzionet e detyrat që do të caktohen do të gjejnë zbatim në jetë në mënyrë më revolucionare sesa kur këto t'u diktohen me vend e pa vend nga lart. Kjo është njëkohësisht një ndihmë e madhe për udhëheqjen e Partisë për përgjithësimin e eksperiencës së Partisë dhe të marrjes së masave, si konsekuencë dhe në bazë të kompetencave e të detyrave që ka Komiteti Qendror.

Ka disa punëtorë partie, dhe këta s'janë pak, të cilëve nuk u mungon as besnikëria, as vendosmëria për punë, që janë njerëz me eksperiencë dhe të sakrificës, por që e kanë zor të lëvizin nga formulat ose metodat shabllone të vjetruara dhe vazhdojnë të bëjnë ndryshime shumë të javashme në stilin e tyre të punës. Por më e keqja qëndron në atë që disa nga këta shokë besnikë të Partisë, sigurisht të përmirësueshëm, hiqen si specialistë dhe të tjerët i mburrin se janë specialistë në sektorët e tyre.

Ose të marrim punën e sektorëve të agjitacionit dhe të propagandës së Partisë. Kjo punë me kaq rëndësi vuan nga formalizmi dhe rutina, nga metoda e frymës së vjetruar dhe, pavarësisht se mund të mos ketë gabime të rrezikshme, gabime dhe lëshime ka plot. Në pamje duket sikur ajo i përshtatet situatës revolucionare, por, po ta vërejmë me kujdes, fryma revolucionare e Partisë dhe e masave në punë i ka lënë pas agjitacionin dhe propagandën e Partisë dhe kjo bën të mos dallohen të metat.

Komunistët heroikë, punëtorët heroikë me parti dhe ata të paorganizuar në Parti, kooperativistët, rinia, gratë, bëjnë me mijëra shpikje, racionalizime që revolucionarizojnë mendjet, prodhimin. Po a ecin krahas me ta, në mos më përpara, punonjësit e Partisë për propagandën dhe agjitacionin? Jo, duket që s'ecin me kohën. Te këta nuk ka as racionalizime, as novatorizma. Të marrim disa shembuj tipikë. Në mure gjen parulla e pllakate të katër-pesë vjetëve më parë. Ngjarje të rëndësishme ndodhin, parullat as që lëvizin. Në fabrika s'gjen parulla mobilizuese, edukuese, ose gjen disa të vjetra të vlefshme për një kohë të kaluar, por që sot të vënë në gjumë. Shikoni gazetatat e mureve, janë për të qarë, si një shami xhepi dhe në një kohë kur në fabrika e kooperativa ne kemi me qindra e me mijëra kuadro me shkollë e me praktikë, kuadro të mrekullueshëm. Mund të thonë disa shokë, se s'na mungojnë as koka as idetë për këtë gjë, por duhen fonde, duhen lekë.

Të marrim më parë çështjen e lekëve, pastaj të ideve. Nuk është aspak e vërtetë se nuk ka fonde, se nuk ka lekë për agjitacionin, për propagandën dhe për kulturën, por ato duhet të përdoren mirë dhe të japin efekt. Mund të duhen dhe duhen fonde më të mëdha. Atëherë mendoj që Komiteti Qendror t'u akordojë organizatave të Partisë fonde më të mëdha për këtë punë dhe ja se si t'ua akordojë këto. Në kohën e luftës, kur partizanët kërkonin armë, Komiteti Qendror u tha: godisni, vrisni armiqtë okupatorë dhe u merrni armët! Edhe tani Komiteti Qendror t'u thotë organizatave të Partisë: ua rrëmbeni armiqtë

të klasës, vjedhësve, sabotatorëve, prishësve të pronës socialiste lekët dhe fondet që ata vjedhin dhe i përdorni këto për cdukimin e njerëzve! Rrugë tjetër më të mirë nuk ka jashtë proporcioneve të drejta të caktuara në planet dhe në buxhetet shtetërore.

Të vijmë tash tek idetë. Shokët që merren me agjitacionin dhe me propagandën e Partisë, qoftë në qendër, qoftë në bazë, jo se janë njerëz pa kokë dhe pa idera, se pastaj vaj halli, jo, ata janë shokë nga më të mirët, besnikë të Partisë, shokë të zgjedhur si për qëndrimet politiko-ideologjike të tyre, ashtu edhe të palodhur në punë, por, megjithatë, idetë e tyre nuk kanë qenë kurdoherë të shkëlqyera. Mund të thonë që nuk bëjnë përjashtim nga të tjerët. Unë mendoj se duhet të bëjnë përjashtim nga të tjerët, por kjo nuk ka ngjarë, se ata kanë qenë stereotipë në formulat e punës, jo fort të lidhur me masën dhe mjaft herë me karakteristikat e intelektualit mendjemadh.

Këtu u fol se nuk kanë shkuar si duhet agjitacioni dhe propaganda. Kritika është e drejtë dhe nuk do të lë pa përmendur përgjegjësinë e madhe që ka Fadili [Paçrami], sepse ai ka qenë përgjegjës direkt për këtë punë në Komitetin Qendror. Puna e tij ka qenë me të meta dhe për këtë disa herë është kritikuar. Duke qenë se vazhdon të punojë po në të njëjtin sektor dhe me përgjegjësi të madhe si sekretar i Komitetit të Partisë në kryeqytet, ai vetë duhet t'i bëjë vazhdimisht analizë punës së tij, e sidomos vetes.

Pa e bërë çështje, në një mbledhje të Sekretariatit unë i kam folur në mënyrë kritike atij, që, në

radhë të parë, të kryejë mirë detyrën e rëndësishme që i ka ngarkuar Komiteti Qendror, detyrë shumë e shenjtë dhe e koklavitur dhe që, po të flasim me termat e skenës, të cilat i ka aq shumë qejf Fadili, është një jetë jo me tre akte, si dramat që bën ai, por me mijëra akte. Për punëtorin e Partisë kryesorja është të drejtojë e të zgjidhë mirë problemet që nxjerr jeta, të edukojë dhe të kalitë njerëzit. Me këtë nuk dua të ul rolin që luan teatri në edukimin e njerëzve, por çdo gjë duhet ta vëmë në vendin e duhur.

Fadili thotë se dramat i shkruan natën, se ato nuk e pengojnë në punë. Por unë dua t'i them atij se nuk vuan nga thjeshtësia, përkundrazi. Ai bëri autokritikë këtu, por dramat e tij vuajnë në vijë. Këtë ia kam vënë në dukje. Shokët që merren posaçërisht me këtë punë, të diskutojnë edhe më gjerë me të, por si Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë, e kam për detyrë ta këshilloj Fadilin që të merret ekskluzivisht e në radhë të parë me detyrën e rëndësishme që i është ngarkuar. Unë kurdoherë jam gati, ashtu si edhe për çdo shok tjetër, ta ndihmoj me mundësitë e mia modeste.

Në këtë mbledhje Plenumi të Komitetit Qendror ne diskutuam shifrat e projektplanit dhe direktivat. Diskutimet ishin me një vlerë të madhe. Unë, gjithashtu, solidarizohem plotësisht me projektplanin e pesëvjeçarit të katërt dhe me direktivat e Komitetit Qendror. Jam dakord me sugjerimet, me mendimet dhe me propozimet e shokëve të Komitetit Qendror. Ato i bëjnë planin dhe direktivat tona më solide, reale dhe



të realizueshme. Të gjitha këto mendime e propozime të studiohen nga Qeveria dhe nga Komisioni i Planit të Shtetit për t'u inkluduar tok me të gjitha ato mendime e propozime që do të vijnë nga baza dhe që do të jenë të arsyeshme, pas diskutimit në popull të direktivave të Komitetit Qendror për planin e kaktërt pesëvjeçar.

Ne, ushtarët e Partisë, udhëheqja e saj, besnike deri në fund e vijës marksiste-leniniste, shohim me admirim, me krenari të ligjshme dhe me dashuri të pafund forcën kolosale të Partisë sonë të lavdishme, trimërinë dhe guximin e saj të pashoq, në luftë dhe në përpjekje, tej pamjen e saj të guximshme e të urtë që e çon përpara pa hezitime dhe në rrugë të drejtë gjithë punën e popullit tonë.

Sa madhështorë, të pamposhtur e krijues janë forca e Partisë sonë marksiste-leniniste dhe heroizmi i popullit, zotësia, zgjuarsia, guximi i punonjësve të vendit tonë, që bëjnë dhe do të bëjnë gjithë këto mrekulli! Ne jemi krenarë që jemi ushtarë të kësaj armate të lavdishme që udhëheq Partia jonë, prandaj të jemi të parët në ballë të luftës, në ballë të sakrificave, në ballë të punës, të jemi shembull thjeshtësie e besnikërie ndaj vijës së Partisë. Të jemi luftëtarët më të guximshëm për të mbrojtur Partinë dhe popullin nga çdo rrezik, për të mbrojtur unitetin, për të mbrojtur marksizëm-leninizmin.

Edhe një herë po e përsëris: punë të mëdha, të lavdishme, të rënda, por të shenjta kemi përpara. T'i përvishemi punës, se as puna, as lufta, as çfarëdo

sakrifice nuk na kanë trembur dhe nuk do të na trembin kurrë.

Partia kurdoherë do të fitojë.

Rroftë Partia!

*Botuar për herë të parë me  
ndonjë shkurtim në librin:  
Enver Hoxha. «Raporte e  
fjalime 1965-1966», f. 484*

*Tiranë, 1971*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## SISTEMIN ARSIMOR TA PËRMIRËSOJMË DUKE U BAZUAR NË KRITERE SHKENCORE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**14 korrik 1966**

Parimet mbi të cilat është vendosur sistemi ynë arsimor janë të drejta, por është e nevojshme të bëjmë përpjekje që këtë sistem ta përmirësojmë më tej, pra parimet t'i ruajmë, t'i zbatojmë dhe t'u bëjmë vazhdimisht përmirësime, të bazuara në kritere shkencore.

Jam i mendimit që në këtë periudhë zhvillimi të vendit tonë si bazë për arsimin e përgjithshëm të kemi shkollën tetëvjeçare. Ky është një hap i madh përpara, sepse ne e kapërcyem atë fazë ku merrnim si bazë arsimin fillor. Shkolla tetëvjeçare mendoj të mos ndahet nga fillorja, kurse nga shkolla e mesme mund të ndahet. Arsimi fillor mund të nisë kur kalamani të ketë mbushur 6 ose 7 vjeç. Jam i mendimit të fillojë në moshën

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit arsimor në vendin tonë.

6 vjeç, por, para se të vendosim, kjo çështje duhet parë sidomos lidhur me faktorët ekonomiko-shoqërorë dhe me gjendjen shëndetësore të fëmijëve tanë, se nuk është një problem i lehtë për ta vendosur, prandaj në grupet e punës që do ta studiojnë këtë çështje, të ketë edhe mjekë, edhe nxënës që sot janë në moshë të pjekur, por që disa e kanë filluar shkollën 6 vjeç e disa të tjerë 7 vjeç. Të kemi parasysh se çështja e një viti ka rëndësi në jetën e njeriut.

Kjo periudhë, si të thuash, të jetë ajo e formimit bazë të një kulture të përgjithshme, të detyruar, minimale, të domosdoshme për çdo njeri. Lëndët mësimore gjatë kësaj periudhe duhet të caktohen me kritere rrep-tësisht shkencore, në funksion të gjendjes fizike të kalamaneve, të zhvillimit të përgjithshëm të intelektit të të voglit, në funksion të zhvillimit të përgjithshëm të njohurive të epokës në të cilën rrojmë, në funksion të gjendjes dhe nevojave të zhvillimit të shumanshëm të vendit tonë, pa harruar perspektivën dhe nevojat e këtij zhvillimi.

Ne kemi udhëzuar që në programin e shkollave të bëhen ndryshimet e nevojshme, sepse lëndët e mësimin që u jepen nxënësve të kësaj periudhe mund të jenë të llogaritura sipas disa koncepteve të kohëve të tjera, të vjetra. Pastaj të mos harrojmë se në hartimin e programeve për çdo lëndë ndikon shumë edhe trupi mësimor, jo vetëm me pikëpamjet që kanë mësuesit që i përgatitin, por sidomos me konceptin e shkollës ku ata vetë janë formuar. Dihet që mësuesit tanë të vjetër, të cilët janë edhe hartuesit kryesorë të këtyre programeve, vërtet kanë bërë një punë të lavdërueshme dhe janë

shumë të nderuar për ndjenjat e tyre si patriotë e si arsimdashës, por mbartin edhe ndonjë ndikim që nuk shkon për shkollën tonë socialiste, prandaj ndryshime në programet mësimore të bëjmë, por çështja është që të shohim mbi ç'baza bëhen, a janë të studiuara? Në këtë vështrim duhet të kemi parasysh t'u krijojmë mundësinë nxënësve që, pas tetëvjeçares, të mund ta vazhdojnë më tej shkollën, pa pengesa e boshllëqe. Veç të kemi kujdes që me programet që përgatitim as të mos i nxjerrim «eshkë» as të mos i sëmurim, duke i ngarkuar rëndë, me qëllim që t'i bëjmë «të ditur».

Të gjitha lëndët që jepen në shkollën tonë frymëzohen e duhet të frymëzohen nga marksizëm-leninizmi, kurse lënda e marksizëm-leninizmit, si lëndë e veçantë, do të jepet sipas një programi të studiuar, në përshtatje me moshën e nxënësve dhe në raport me nocionet e kulturës së përgjithshme që marrin. Në universitetet dhe në shkollat e tjera të larta kjo lëndë do të zhvillohet në një nivel më të lartë e me një program më të zgjeruar.

Lidhur me këtë çështje, mendoj që në shkollat tona të ketë një lëndë të veçantë, mësimin e moralit komunist. Programi i kësaj lënde të synojë që t'u mësojmë nxënësve disa parime elementare të moralit tonë, si, për shembull, të sillen mirë në familje, në shkollë e në shoqëri, të duan atdheun dhe Partinë etj. Edukatën morale të nxënësve në shkolla ne sot ia kemi lënë krejt organizatës së rinisë dhe familjes, kurse puna e këtyre duhet të jetë një plus i punës që duhet të bëjë edhe shkolla. Edhe në shkollat borgjeze ka mësim të moralit,

bile nxirren apostafat libra të veçantë për të edukuar njerëzit me moralin e klasës në fuqi.

Gjatë periudhës tetëvjeçare mund të lindin disa prirje të veçanta të nxënësit, prandaj edhe këto duhet të shihen, por synimi kryesor do të jetë dhe duhet të jetë, mendoj unë, përfitimi dhe përvetësimi i plotë i lëndëve që u jepet, formimi i karakterit dhe i virtyteve të shëndosha, gjë që duhet të fillojë të bëhet qysh në klasat e fillores. Këtë formim duhet ta kryejë shkolla, duke harmonizuar brendinë e lëndëve, didaktikën, edukimin moral në shkollë dhe jashtë saj, me një fjalë duke praktikuar një pedagogji krijuese marksiste-leniniste, sa më të përsosur, e cila sot çalon në shkollat tona tetëvjeçare e të mesme, pa bërë pastaj fjalë fare për shkollën e lartë.

Ta kemi kurdoherë si orientim që të ngjallim te nxënësit një interesim të veçantë për punën. E kam fjalën për punën jashtë asaj të zakonshmes që bëjnë si nxënës. Prej tyre të kërkojmë që të mësojnë mirë, t'i bëjnë me seriozitet detyrat që u jep mësuesi, por, veç këtyre, të kenë edhe interesa të tjera. Në shkollë ata të mësohen që të jenë praktikë, të marrin kontakt me jetën që i rrethon, me veglat e punës, me prodhimin, me lulet, me bimët, me kafshët, dhe, nëpërmjet të gjitha këtyre, të ngjallet tek ata dashuria për një punë jashtëshkollore, në mënyrë që të kuptojnë se jeta dhe puna e tyre nuk konsistojnë vetëm në bankat dhe në librat e shkollës. Në këto të fundit zhvillohet dhe formohet vetëm intelekti i tyre, i cili do t'u shërbejë më vonë për diçka të madhe, që konsiston te lufta dhe te puna që ata do të kenë në jetë. Pra, puna jashtëshkollore

me nxënësit të zhvillohet në një mënyrë të tillë të gjallë dhe interesante, që ata, edhe pa e kuptuar këtë parim të madh, ta bëjnë zakon që t'i lidhin mësimin me punën në mënyrë të harmonishme për forcën e vogël të gjykimit të tyre.

Mund të mendohet që viti i fundit i shkollës tctë-vjeçare të përdoret për të nxitur dhe për t'i orientuar prirjet e nxënësve, por mendoj që kjo punë të mos bëhet me kompartimente e me klasifikime, si, për shembull, shkollat e fshatit për bujqësinë, shkollat e qytetit për industrinë e për zanatet. Mbase jam gabim, por mendoj se do të ishte shumë herët për një gjë të tillë.

Orientimi i shkollave, në vazhdim të tetëvjeçares dhe deri në fillimin e studimeve të larta, lyp një vëmendje shumë të madhe, një studim serioz. Më parë duhet të përcaktohen drejt shumë kritere bazë, të cilat nuk mund të caktohen *as a priori*, as me hamendje, ose me dëshirë, por duke studiuar me kujdes shumë rrethana objektive dhe reale, shumë nevoja imediate dhe të perspektivës etj. Pikërisht, në përcaktimin e këtyre gjërave qëndron vështirësia e problemit, sepse, në rast se i përcaktojmë drejt këto, çdo gjë do të zgjidhet si duhet.

Cilat mund të jenë këto kritere të përhershme bazë?

Këto mund të jenë kritere politike, ideologjike, kulturore, ekonomike, të tëra të shikuara dhe të zgjidhura në prizmin shkencor marksist-leninist, që t'i shërbejnë ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit. Pra, ne duhet të krijojmë një sistem edukimi të shumanshëm të njeriut tonë socialist, që ai, gradualisht dhe pa ndër-

prerje, të pajiset me virtytet revolucionare, të mendojë si revolucionar, të punojë si revolucionar, të edukohet e të përfitojë nga shkenca pararojë si revolucionar dhe, në çdo rrethanë, në çdo etapë, të dijë ta përdorë diturinë e tij në mënyrë revolucionare, ta kthejë këtë në një shprehje të natyrës e të jetës së tij revolucionare, në shërbim të kolektivit, të socializmit dhe të komunizmit.

Që t'u arrihet këtyre çaqeve, ne duhet që nëpërmjet një sistemi edukimi të vazhdueshëm, të realizojmë politikisht, ideologjikisht dhe materialisht ngushtimin e dallimeve në mes punës mendore dhe asaj fizike. Domethënë, sistemi ynë arsimor në periudhën e shkollës tetëvjeçare e të mesme dhe në periudhën universitare të rrënjosë *de facto*, ose të ketë hedhur rrënjë të shëndosha të rinjtë, se nuk mund të kuptohet, nuk mund të luftohet e të jetohet jashtë këtij realiteti.

Mendoj se politeknizimi i shkollave të mesme është në parim një sistem i drejtë që mund të ngushtojë dallimet në mes punës mendore dhe punës fizike; që i bën këto plotësuese për njëra-tjetrën dhe të puqen në një të vetme të pandarë; që nxit, njëkohësisht, në raport të barabartë dëshirën për mësim dhe atë për punë, krijon me të vërtetë kuptimin e drejtë që edukimi dhe përvetësimi i diturive t'i shërbejnë punës dhe që të dyja së bashku krijojnë, zhvillojnë e zbukurojnë jetën e njeriut dhe të shoqërisë sonë socialiste. Te ne ende nuk ekziston një kuptim i tillë as te gjimnazistët, as te teknikumasit. Gjimnazisti mendon se të ndjekësh gjimnazin është gjëja më e bukur, kurse të ndjekësh teknikumet duhet të bësh punët më të rënda. Teknikumasi ka pikëpamjen se gjimnazistët janë më të favorizuar.



Të gjithë jemi të mendimit se politeknizimi i shkollave të mesme është rruga më e drejtë, mirëpo në kushtet tona reale ai nuk mund të zbatohet përnjëherësh. Kur themi politeknizim, të mos mendojmë teknikumin e tetë viteve përpara, por të përfytyrojmë një shkollë të një niveli më të lartë edhe nga pikëpamja teorike, në mënyrë që ai që do ta mbarojë këtë shkollë të jetë i zoti ta ndjekë me sukses shkollën e lartë. Mendoj se po ta organizojmë politeknizimin e shkollës në mënyrë të tillë, nxënësit do të na dalin më të përgatitur, prandaj ky sistem duhet të zhvillohet më mirë në vendin tonë. Por të kemi kujdes, nuk duhet të shpejtohemi për të vendosur profilin e gjerë ose të ngushtë në teknikumet. Ne kemi e do të kemi nevoja edhe për profile të gjera, edhe për profile të ngushta, sepse arsimi teknik do të përfshijë masa të gjera të rinjsh e të rejash dhe jeta do të na i kërkojë të dy profilet. Kjo duhet të jetë perspektiva, e cila, natyrisht, nuk arrihet pa marrë masa të studiuara dhe pa i realizuar ato me etapa graduale. Për këtë edhe shokët dhanë mendimet e tyre.

Pikërisht këtyre etapave dhe studimit të tyre duhet t'i kushtojmë kujdes dhe një punë të veçantë, sepse duhet të kihet parasysh shumë faktorë të tjerë të rinj, siç janë:

**Së pari,** zhvillimi ekonomik i vendit tonë në etapa të ndryshme dhe, lidhur me këtë, nevojat për punëtorë të thjeshtë, për punëtorë të kualifikuar, për teknikë e për kuadro të lartë në çdo sektor të ekonomisë.

**Së dyti,** demografia e vendit dhe, në funksion me këtë, brezi i rinisë që hyn e del çdo vit nga shkolla.

**Së treti,** fluktuacionet dhe lëvizjet e popullatës nga

qyteti në fshat e anasjelltas, në funksion të zhvillimit të ekonomisë në sektorët e ndryshëm, sidomos në lidhje me profesionet e fituara në shkollë, nuk mund të bëhen kurdoherë të organizuara, me përpikëri. Këtej del problemi që duhet të na tërheqë vëmendjen për të dhënë një orientim të caktuar. Në përgjithësi të rinjtë e fshatit t'i orientojmë nga bujqësia dhe ata të qytetit nga zanatet, por të kemi parasysh se edhe fshati ka nevojë për zanatçinj, ashtu siç është e nevojshme që të rinj nga qyteti të venë të punojnë me kompetencë në punët bujqësore në fshat. Qyteti, industria dhe zanatet, në çdo etapë, do të kenë nevojë për një numër limit punëtorësh dhe specialistësh të profileve të ndryshme, kurse të tjerët duhet të orientoohen drejt fshatit. Por kjo në asnjë mënyrë të mos na lidhë duart që fshati të varet plotësisht nga qyteti për njerëz të profesioneve të ndryshme.

Nuk duhet menduar se për njerëzit e zanatit, për njerëzit me shkencë e me kulturë të lartë, burim kryesor janë vetëm banorët e qytetit. Kjo nuk do të ishte një prirje e drejtë, prandaj duhet t'i ruajmë proporcionet në çështjet që thamë, domethënë në demografinë, në zhvillimin ekonomik të vendit, në fluktuacionet etj. Të mos krijojmë privilegje dhe kasta për qytetin, në një kohë kur ne luftojmë për ngushtimin e dallimeve në mes fshatit dhe qytetit jo vetëm nga ana ekonomike, por edhe nga anët e tjera politike, ideologjike, kulturore, të zhvillimit të profesioneve të ndryshme etj.

Së katërti, politeknizimi i menjëhershëm i shkollave lyp edhe kuadro. Po të ecim me një plan të mirë, është e vërtetë që këta mund t'i gjejmë, por që të heqim

menjëherë një numër të konsiderueshëm inxhinierësh nga prodhimi për nevojat e shkollave, më duket se nuk është një punë e lehtë, prandaj na vihet detyrë të marrim të gjitha masat e të punojmë sipas një plani të menduar mirë për ta zgjidhur këtë problem, e jo të ndryshojmë menjëherë profilin e shkollës pa pasur kuadro.

Mendoj se ne duhet të reflektojmë seriozisht për formimin e një plejade kuadros të tillë dhe pikërisht për t'i formuar si duhet këta, mendoj se situata aktuale nuk na lejon të kthejmë shumë gjimnaze në teknikume, përkundrazi, duke i mbajtur akoma për një periudhë, programet t'i bëjmë të tilla që të forcojmë te nxënësit e gjimnazeve shprehitë dhe mësimin e punës, jo vetëm të punës fizike, por edhe praktikat teorike të shkencave ekzakte. Këta, kur të mbarojnë universitetin, do të zotërojnë si duhet teorinë shkencore dhe zanatin, kështu që do ta kemi më të lehtë për të zgjedhur midis tyre mësues që do të japin mësim në mënyrë të kualifikuar në teknikumat tona të profileve të ndryshme.

Ne kemi nevoja të shumta për kuadro të mesëm, goftë në bujqësi, goftë në sektorin e industrisë dhe të artizanatit. Për bujqësinë nevojat janë të shumta, të mëdha. Në këtë drejtim ne nuk kemi punuar me një studim dhe sistem të mirë. Nuk ka qenë e mundur që forcat tona mësimore të pakta të përqendroheshin, sepse kemi pasur nevoja të mëdha në të tërë sektorët. Tani është koha të mendojmë dhe ta organizojmë më mirë këtë punë. Kuadrot e mesëm për bujqësinë ne do t'i shtojmë vetëm nëpërmjet teknikumeve bujqësore-veterinare, por mendoj se teknikume të tilla kemi

pak. Hapja e të tjerave është më e kushtueshme se e gjimnazeve, por këto shpenzime mendoj se ne duhet t'i bëjmë. Pranë teknikumeve që do të hapim në rrethet bujqësore, atje ku do ta dojë nevoja, shteti të ngrejë edhe konvikte. Nxënësit që do t'i ndjekin këto shkolla, të vijnë me të hollat e tyre ose me bursën e kooperativës bujqësore, sipas kriterëve të vendosura. Ne duhet të mendojmë edhe për kuadrin pedagogjik, me qëllim që këto shkolla të jenë në gjendje të nxjerrin specialistë të zotë për të gjithë sektorët e bujqësisë. Nesër neve, për shembull, mund të na duhen specialistë për ullirin, prandaj kur t'i hapim këto teknikume, të kemi parasysh edhe perspektivën e zhvillimit të sektoreve të ndryshëm.

Për sa u përket teknikumeve me karakter industrial dhe artizanal, mendoj se nevojat janë të mëdha dhe të shumanshme, kurse shkollat për këtë qëllim janë të pakta, prandaj është e nevojshme t'i shtojmë gradualisht shkollat teknike. Mënyrat e shpejta dhe të pastudiuara, ose të parakohshme, për shumë arsye objektive, duhen lënë mënjanë. Krahas kësaj duhet menduar edhe për teknikë të ulët, sepse nevojat e ekonomisë sonë për ta janë të mëdha, bile kolosale. Ky problem nuk mund të zgjidhet vetëm me sistemin e nxënësve në ekonomi, se nëpër ndërmarrje përgatitja e teknikëve të ulët bëhet në disa drejtime të kufizuara dhe jo për nevojat e gjithë vendit, por ne duhet të hapim edhe shkolla të ulëta profesionale, duke pasur parasysh nevojat e tërë Republikës.

Këto çështje, natyrisht, duhen studiuar në lidhje me nevojat tona reale dhe jo vetëm në drejtim të indus-

trisë ose të minierave, por edhe në drejtim të artizanatit, në të gjithë gamën e tij shumë të gjerë dhe njëkohësisht shumë të varfër në punëtorë të kualifikuar dhe teknikë të ulët.

Mendoj, gjithashtu, se në disa drejtime, në të cilat nevojat janë shumë të mëdha, si, për shembull, në punimet e drurit, ne mund dhe duhet të ngremë një teknikum ku të përgatitim edhe marangozë, karpentierë etj. Në një teknikum të tillë koha e mësimëve mund të jetë më e shkurtër se në teknikumet e tjera, si të gjykohet më e arsyeshme, por të tilla teknike janë përherë të nevojshme. Në këto mund dhe duhet të dërgohen pa përjashtim nxënës edhe nga fshati.

Sistemin e shkollave të tipave të ndryshëm ta organizojmë në një mënyrë të tillë që të mos na mbetet asnjë i ri apo e re pa shkollë dhe pa profesion. Është e ditur se ata që mbarojnë teknikumet e kanë më të përcaktuar zanatin, prandaj e kanë më të lehtë kur fillojnë punën, kurse nxënësit që mbarojnë gjimnazet vërtet kanë një kulturë të përgjithshme më të gjerë, por zanatin nuk e kanë. Sistemi i gjimnazeve që kemi tani, me një program që parashikon punë prodhuese për një periudhë të shkurtër, gjimnazistin e edukon dhe e përgatit që ta dojë punën, por nuk e përgatit për zanat.

Pra, ne duhet të kemi një orientim të përcaktuar më mirë për gjimnazet, me qëllim që lidhjet e gjimnazistit me punën dhe me prodhimin të shkojnë kreshendo. Sot gjimnazistët bëjnë një ditë punë praktike në javë. Jam i mendimit që lidhja e nxënësve me

punën të mos bëhet si gjer tani. Mbase do të ishte më mirë sikur të mblidhen të tëra ditët e parashikuara për punën prodhuese që bëjnë gjimnazistët gjatë vitit, këtyre t'u shtohen edhe disa ditë që mund të teprojnë nga rishikimi i programeve mësimore dhe t'i bëjnë në mënyrë të përqendruar, duke shkuar secili të punojë në torno etj. Pastaj në kohën e pushimeve shkollore ata shkojnë nga një muaj edhe në aksionet e rinisë, kështu që secilit do t'i bëhet më shumë se dy muaj punë prodhuese në vit.

Përveç kësaj, do të jetë mirë që, pasi të mbarojnë shkollën 12-vjeçare, nxënësit të bëjnë një vit punë në prodhim. Pra, puna në prodhim, aksionet, përgatitja ushtarake, të gjitha këto mendoj se janë masa të mjaftueshme për të kalitur rininë shkollore në punë. Natyrisht, këto janë vetëm ide që duhen studiuar akoma, para se të vendosim.

Pra, sistemin e shkollës 12-vjeçare mendoj të mos e lëvizim, por, duke i krasitur programet nga gjërat e panevojshme, të krijojmë mundësi më të mëdha edhe për punë profesionale njëkohësisht. Kjo do të na japë mundësinë që nxënësit të fitojnë disa nga shpehitë e punës që kur janë në shkollë. Veçse duhen marrë masat që ata të mos bredhin për punë andej-këtej nëpër uzina, ku t'i thonë jo ka vend, jo s'ka, por periudhën e punës profesionale ta kalojnë në vende të caktuara apostafat për këtë qëllim. Kur të shihet kjo çështje, del nevoja të studiohet së bashku edhe me drejtorët e ndërmarrjeve, edhe me mjeshtra e punëtorë, duke u nisur nga praktika që ekziston tani. Të shihet, gjithashtu, si punojnë ata punëtorë të rinj që kanë kryer një tekni-

kum ose një shkollë të ulët profesionale, si e sa i vënë në zbatim ato që kanë mësuar në shkollë, që të mundim nga kjo të përcaktojmë më mirë kohën e mësimimit etj.

Shkolla e lartë të jetë e hapët si për ata që do të mbarojnë gjimnazet, ashtu edhe për ata që do të mbarojnë teknikumet. Fakultetet në universitet t'i rishikojmë në lidhje me nevojat që kemi për kuadro të lartë. Proporcionet e rritjes graduale të kuadrove të lartë për sektorë të ndryshëm dhe për etapa të ndryshme duhet t'i studiojmë më mirë. Të mos mendohet sikur të gjithë ata që do të mbarojnë studimet e larta do të venë atje ku do t'i emërojmë ne, sepse dalin edhe probleme shoqërore të ndryshme, si martesat e të tjera, që nuk zgjidhen me forcë.

Në shkollat e larta përgatitim kuadro kryesisht për prodhimin dhe kështu duhet të vazhdojmë edhe në të ardhmen, por duhet të përgatitim gjithashtu edhe pedagogë për shkencat shoqërore e për shkencat ekzakte dhe, siç e thashë, të përgatitim edhe mësues për nevojat e teknikumeve e të shkollave të ulëta profesionale, prandaj duhet menduar edhe për zgjerimin e arsimit të lartë, ku do të përgatitet kuadri që do të japë mësim posaçërisht për këto shkolla. Këta jo vetëm duhet të dinë mirë teorinë, por edhe praktikën. Me këtë dua të them se ai që ka mbaruar për agronom dhe jep mësim në një teknikum bujqësor, duhet të ketë dhe të fitojë edhe praktikën e agronomit të arave. Çështjen këtu nuk e kam te kërkesat thjesht pedagogjike si mësues e pedagog, por tek edukimi rrënjësor i trupit mësimor në mënyrë të gjithanshme, politike, ideologjike, profe-

sionale, teknike, në përshtatje me konceptet e vërteta për mësimin dhe për punën, në bazë të arsimit dhe të kulturës proletare.

Ne duhet të mendojmë gjithashtu edhe për përgatitjen e specialistëve të degëve të ndryshme për nevojat aktuale e sidomos për perspektivën, si, për shembull, për kiminë industriale, për gjeologjinë etj., se me zhvillimin e shkencave të ndryshme do të na duhen kuadro të profileve të ndryshme. Disa mund t'i specializojmë edhe jashtë shtetit, por synimi ynë të jetë që këta kuadro t'i përgatitim në vend.

Prandaj të mendojmë më mirë për përgatitjen e kuadrove për prodhimin. Megjithëse ne nxjerrim vazhdimisht kuadro të lartë dhe na duket sikur nxjerrim shumë, mendoj se, po të shohim nevojat që kemi, do të na dalë se ky numër nuk është i mjaftueshëm. Në këto kushte, kur vendi ka shumë nevoja për kuadro, mendoj se nuk mund ta zbatojmë për të gjitha degët një propozim që është bërë për të vendosur edhe konkursin për pranimet në shkollë, veç kriterëve të tjera. Konkurse mendoj se duhet të kemi, në ato degë, ku kërkohen disa prirje të veçanta, siç është fusha e arteve, ose në ato degë ku nxënësit synojnë të shkojnë më shumë, jashtë nevojave të vendit, të nxitur nga arsye subjektive jo të shëndosha. Pra konkursi mund të jetë një nga kriteret e pranimit të nxënësve në shkolla, atëherë kur këtë e kërkojnë nevojat objektive të interesit të përgjithshëm të ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Këto janë, në përgjithësi, disa mendime të miat që, natyrisht, duhen diskutuar e rrahur nga të gjitha



anët, së bashku edhe me mendimet e shokëve të tjerë. Çdo gjë ta pleqërojmë mirë, të diskutojmë me specialistë të arsimit dhe të degëve të ndryshme, me teknikë, me punonjës të ndërmarrjeve etj., sepse çështja është për një problem shumë të gjerë dhe të rëndësishëm. Pra, ky problem mbetet për t'u diskutuar.

Mendimet që u parashtruan këtu nga të gjithë shoqët janë shumë interesante, prandaj Ministria e Arsimit dhe e Kulturës t'i studiojë me kujdes nga ana e saj, të reflektojë për të gjitha ato dhe pastaj, përfundimet në të cilat do të arrihet, t'i shohim përsëri.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## NË KËSHILLIN POPULLOR TË ZGJIDHEN NJERËZIT MË TË MIRË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

15 korrik 1966

Në bazë të studimeve që kanë bërë shokët e Presidiumit të Kuvendit Popullor, del nevoja që të kemi këshilla popullorë në çdo fshat. Për këtë, nga sa diskutuan edhe shokët, të tërë jemi dakord, por, në qoftë se kemi dy fshatra të vogla me pak shtëpi dhe që nga pikëpamja territoriale janë fare afër, atëherë këto mund të kenë një këshill të përbashkët. Në këtë rast çështja duhet parë në vend, duke marrë parasysh edhe konfiguracionin e terrenit, edhe eksperiencën e fituar nga veprimtaria e këshillave popullorë të fshatrave.

Shokët e Presidiumit mendojnë, gjithashtu, që, veç këshillit të fshatit, të ketë edhe një këshill për fshatrat e bashkuara në një kooperativë bujqësore. Në koopera-

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth relacionit «Mbi funksionimin e këshillave popullorë dhe disa masa për përmirësimin e strukturës së tyre».

tivën e bashkuar, në fakt, është nevoja që të ketë një organizëm për të drejtuar punët e pushtetit, për fshatin e bashkuar. Në këtë këshill duhet të zgjidhen njerëzit më të mirë. Pra, pasi zgjidhen më parë këshillat e fshatrave që përbëjnë kooperativën e bashkuar, zgjidhet pastaj këshilli popullor i fshatrave të bashkuara, i përbërë nga njerëzit më të mirë. Nuk është e domosdoshme që në këshill të ketë përfaqësues nga çdo fshat, rëndësi ka që aty të zgjidhen njerëzit më të mirë. Këtij këshilli mund t'i caktohen disa kompetenca, për të cilat ai do të përgjigjet përpara popullit. Megjithatë shiheni këtë çështje dhe le të vendoset si t'u duket më e arsyeshme organeve kompetente.

Jam dakord me mendimin e shokëve që të mos krijohet lokalitete në të gjitha zonat. Po të jetë nevoja, atje ku duhet, mund të ngremë ndonjë lokalitet të ri, por ka edhe nga ato që duhen suprimuar.

Gjithashtu jam dakord që kryetari i këshillit popullor të paguhet nga fshati ose nga kooperativa bujqësore e bashkuar, kurse nga shteti të paguhet vetëm ata të kryesisë së lokalitetit e lart, ashtu sikurse e kemi pasur gjer tani.

Kryetari i këshillit popullor të fshatit dhe ai i këshillit të fshatrave të bashkuara duhet t'i nënshtrohen kritikës dhe autokritikës, të zbatojnë detyrat dhe ligjet e shtetit. Natyrisht, kryetari i këshillit popullor nuk do të marrë urdhra nga kryetari i kooperativës bujqësore të bashkuar, por, si kryetari i kooperativës, ashtu dhe masat që e kanë zgjedhur, të mos mbyllin sytë kur kryetari i këshillit popullor të fshatrave të bashkuara nuk e kryen detyrën. Ky, si gjithë të tjerët, duhet të

jetë vazhdimisht nën kontrollin e masave. Pra, edhe për këtë besoj se jemi dakord.

Për lagjet e qyteteve jemi dakord që të mbahet ajo strukturë që është sot.

Këto që u thanë janë kryesoret, megjithatë i studioni edhe një herë, të pyeten edhe shoku Mehmet [Shehu] me shokun Hysni [Kapo] dhe, po të jenë dakord edhe ata, po të mos ketë as pengesa nga ana ligjore për ato që u propozuan, të bëhet kështu siç u tha këtu.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## ANALIZA E THELLË E SHKAQEVE TË GABIMIT EDUKON EDHE KOMUNISTËT E TJERË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**15 korrik 1966**

Për forcimin e Partisë fola në Plenumin e Komitetit Qendror<sup>2</sup>, por lidhur me këtë çështje kisha diçka për të shtuar. Rëndësi të veçantë ka, në radhë të parë, që të zhvillohet lufta e klasave edhe brenda në gjirin e Partisë. Kjo luftë të mos kuptohet sikur ka të bëjë vetëm me dhënien e dënimit për komunistin që gabon, se nuk është kjo kryesorja. Dhënia e dënimit është një çështje e dorës së dytë e të tretë. Ajo që ka rëndësi të dorës së parë është që, kur një komunist gabon, organizata duhet të analizojë thellë shkaqet dhe ori-

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua për disa probleme që dalin nga mbledhjet për dhënie llogari e zgjedhje në organizatat e Partisë të terrenit dhe të ushtrisë, si dhe për disa çështje të ndërtimit të Partisë.

2 Është fjala për Plenumin e 17-të të KQ të PPSH. Shih në këtë vëllim, f. 190.

gjinën e gabimit, në mënyrë që kjo të vlejë për të gjithë organizatën e Partisë. Një analizë e tillë e thellë bën që të përcaktohet drejt edhe masa e dënimit që duhet marrë për komunistin që gabon dhe, nga ana tjetër, edukon edhe komunistët e tjerë.

Zhvillimi i luftës së klasave duhet të na çojë me doemos në forcimin e radhëve të Partisë. Mund të kritikohet një komunist, kur gabon ose kur bën një veprim që nuk përputhet me cilësitë e komunistit, po mund të kritikohet edhe një organizatë-bazë, kur ajo ka të meta e dobësi të theksuara, të cilat ulin frymën luftarake. Në qoftë se në një organizatë-bazë shtrojmë, për shembull, çështjen se kanë nxjerrë kokë përsëri tarafe, këtu nuk është nevoja të rrimë e të analizojmë gjatë e gjerë se si rilindën këto tarafe, sepse këtë analizë e kemi bërë më parë, por të marrim masa të menjëhershme për t'i eliminuar ato dhe për të shëndoshur gjendjen. Kësaj organizate t'i thuhet se nuk është në rregull, t'i numërohen arsyet dhe t'i kërkohet të forcojë unitetin. Po të ketë komunistë që, me gjithë këshillat dhe kritikën që u janë bërë, nuk duan të ndreqen, atëherë të shihet çfarë mendojnë komunistët e tjerë për këta dhe për gjendjen e krijuar. Çështjet të diskutohen mirë dhe organizata të marrë vendimet e nevojshme. Të mos tororiten ata komunistë që janë në rrugë të shtrembër, por, kur nuk ndreqen, çështja e tyre të diskutohet edhe në popull.

Ne themi që Partia është zemra e popullit, prandaj le t'ia lëmë popullit t'i gjykojë vetë komunistët e sëmurë të një organizate-bazë, të cilët janë ndarë në tarafe, sepse puna e tyre pasqyrohet edhe në popull. Në qoftë

se të gjitha përpjekjet që janë bërë nuk kanë dhënë fryt dhe gjendja përsëri vazhdon të mos përmirësohet, komiteti i Partisë i rrethit nuk duhet të harrojë masat e tjera të rrepta që duhen marrë deri në shpërndarjen e organizatës-bazë. Natyrisht, kjo masë merret shumë rrallë, vetëm në atë rast kur nuk ka shërim gjendja. Një organizatë-bazë e tillë e sëmure deri në atë shkallë sa të na dëmtojë rëndë unitetin e Partisë dhe të popullit neve nuk ka ç'na duhet, prandaj ajo të shpërndahet dhe të rikrijohet me elementë më të mirë. Kur merret me vend një masë e tillë, jep rezultate jashtë-zakonisht të mira.

Raportin që kanë paraqitur shokët e ushtrisë mund ta studiojë edhe shoqja Fiqret [Shehu] dhe të bisedohet me Drejtorinë Politike të Ushtrisë se ç'lëndë e veçantë mund t'u bëhet kuadrove ushtarakë që ndjekin Shkollën e Partisë, me qëllim që të lidhet ngushtë teoria që jepet në shkollë me punën praktike të ushtrisë. Diçka e veçantë, përveç lëndëve të tjera, duhet të bëhet edhe për ata kuadro që dërgohen në Shkollën e Partisë nga Ministria e Punëve të Brendshme. Çështja është që këta shokë ta ngrenë në një nivel më të lartë shkencor punën që bëjnë në repartet ku ata do të shkojnë pas përfundimit të shkollës.

Organizata e Partisë në ushtri luan një rol të pазëndësueshëm për revolucionarizimin e tërë jetës së ushtrisë. Dihet që ushtria ka rregull, ka disiplinë të rreptë, por çështja është që ky rregull e kjo disiplinë të zbatohen me përpikëri e në mënyrë të ndërgjegjshme. Ju shokë që punoni në ushtri e dini më mirë, se këtë e keni mësuar nga praktika, si duhet zbatuar detyra

e caktuar nga komanda. Pasi caktohet një detyrë ose jepet një urdhër, veprohet menjëherë për zbatimin e tyre, por organizata-bazë e Partisë kujdesin e parë ta ketë nëse u kuptua rëndësia e kësaj detyre ose e këtij urdhri nga ushtarët dhe ç'duhet të bëjë për të siguruar zbatimin e plotë të tyre.

Për çdo vendim që merret ose urdhër që jepet, që në fillim të bëhet shpjegimi nga ana politike dhe ideologjike. Krahas këtij shpjegimi që bëhet për ta kuptuar më thellë, politikisht dhe ideologjikisht, vendimin apo urdhrin, duhen marrë edhe masat organizative për të siguruar zbatimin e tyre. Komisari propozon konkretisht masat politike dhe organizative, pyet nëse këto janë të mjaftueshme dhe kërkon kush dëshiron të diskutojë. Në diskutime shfaqen mendime se ç'mund të bëhet tjetër, ç'mund të shtohet ose të hiqet nga masat organizative që propozohen etj. dhe kështu ushtarët e një njësie arrijnë në mendimin e përbashkët se si të zbatohet sa më mirë urdhri apo vendimi.

Ka rëndësi, gjithashtu, t'i përcaktohet secilit detyra dhe roli për zbatimin e urdhrin. Në lidhje me punën konkrete që bëhet, të zhvillohet edhe kritika dhe auto-kritika.

Për disa çështje të ndërtimit të Partisë jam dakord me mendimet që u dhanë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



# KARAKTERISTIKA E STUDENTIT TË SHKOLLËS SË PARTISË ËSHTË VLERËSIMI I PUNËS DHE I QËNDRIMIT TË TIJ

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

15 korrik 1966

Me këtë rast, dëshiroj të them ndonjë mendim për karakteristikat që u bëhen studentëve, kur mbarojnë Shkollën e Partisë.

Në karakteristikë mendoj të shënohen të dhëna sa më të plota për gjithë kohën dyvjeçare të qëndrimit të studentëve në shkollë, ku të dalin qartë cilësitë e karakterit të tyre. Në këto karakteristika të pasqyrohet qëndrimi i studentëve, që nga serioziteti dhe këmbëngulja për të përvetësuar programin mësimor e deri te kujdesi për higjienën personale, pastrimin e dhomës,

---

1 Në një nga pikat e rendit të ditës të kësaj mbledhjeje u diskutua për masat që duhen marrë për të përmirësuar punën për edukimin e anëtarëve të Partisë dhe të kuadrove të saj.

të rrobave; që nga sjelljet me shokët e deri te ndjenja e kursimit etj.

Në fillim të vitit shkollor mendoj se duhet bërë një takim me të gjithë studentët që vijnë në Shkollën e Partisë, për t'i sqaruar në hollësi se si do të vlerësohet puna e tyre në shkollë. Të kërkohet që të gjithë pedagogët dhe studentët të tregohen revolucionarë, të ndershëm, njerëz me vullnet e me këmbëngulje për t'i përfunduar me sukses mësimet. Natyrisht, e gjithë kjo punë duhet të bëhet nën drejtimin e organizatës së Partisë të shkollës dhe të drejtorisë.

Karakteristika e shokëve që mbarojnë Shkollën e Partisë të konsiderohet si vlerësim i punës dhe i qëndrimit të tyre gjatës kohës së studimeve. Atje të thuhet për secilin se gjatë dy vjetëve të vazhdimit të shkollës është treguar i zellshëm ose jo për të mësuar, ka pasur këto dhe ato anë pozitive, po ka pasur edhe këto shfaqje jo të mira, ka bërë këtë apo atë gabim, ka pasur këto dhe ato pikëpamje etj. Para se të largohen studentët nga shkolla, karakteristika e tyre u lexohet dhe ata të jenë në dijeni se ajo do t'i dërgohet komitetit të Partisë të rrethit. Një punë e tillë do t'u vlejë si atyre që mbarojnë shkollën, ashtu edhe të tjerëve që do ta vazhdojnë atë më vonë.

Partia i çon komunistët në Shkollën e Partisë për t'i ngritur teorikisht, prandaj ata të punojnë, të djersijnë dhe kushdo që dërgohet atje të mësojë, të bëjë përpjekje për të dalë me rezultate shumë të mira. Partia, natyrisht, duke u bazuar në karakteristikat e mira të atyre që mbarojnë shkollën, do të bëjë edhe emërimin

e tyre në punë, njërin mund ta dërgojë sekretar partie apo instruktor, tjetrin kryetar të komitetit ekzekutiv, komisar brigade, pedagog të marksizmit në Universitetin e Tiranës, kuadër me përgjegjësi në një nga organizatat e masave etj. Shkolla e Partisë përgatit kuadro partie.

Për kuadrot që e vazhdojnë Shkollën e Partisë me korrespondencë, në karakteristikën e tyre të shënohet edhe nëse kanë qenë korrekt me afatin. Në qoftë se ndonjëri prej tyre nuk paraqitet në afatet e caktuara për të ndjekur leksionet dhe për të zhvilluar seminarret, çështja e tij duhet të shtrohet në organizatën-bazë. Radhën e parë organizata mund ta gjykojë se është i mjaftueshëm një këshillim por, t'i thotë se, po nuk vajte herë tjetër rregullisht në shkollë, autokritika që do të bësh nuk do të ketë më vlerë dhe organizata, pasi të bëri një herë vërejtje, po e përsërite fajin, mund e do të marrë edhe masë, bile të rëndë. Këtij shoku t'i thuhet se ky është paralajmërimi i fundit që po i bën Partia, kësaj radhe mundet të mos e heqin nga ajo detyrë që i është besuar, por herën tjetër Partia do të dërgojë në vendin e tij një komunist që është dalluar kurdoherë në punë dhe që ka një karakteristikë më të mirë gjatë kohës së studimeve në Shkollën e Partisë.

Mund të ndodhë që në një seminar dy-tre veta të tregohen të fjetur. Në raste të tilla, këta duhen detyruar të studiojnë edhe natën dhe të nesërmen të shkojnë në seminar të përgatitur. Kuadrot që dërgohen në Shkollën e Partisë kanë për detyrë të studiojnë, prandaj duhen vënë para përgjegjësisë, të disiplinohen dhe të

mësojnë mirë. Këtë studim me vullnet e me këmbëngulje ta vazhdojnë edhe pasi të kryejnë Shkollën e Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**DËSHIRAT E STUDIUESVE DHE TË  
SHKENCËTARËVE TANË U REALIZUAN  
VETËM NË PUSHTETIN POPULLOR**

*Letër drejtuar profesor Spiro N. Kondas*

**19 korrik 1966**

I nderuari profesor Spiro N. Konda,

E mora letrën tuaj të 6 korrikut 1966 dhe dëshiroj t'ju njoftoj se jam në dijeni të studimeve tuaja, të cilat i kam ndjekur me vëmendje.

Nëpërmjet kësaj letre, ju shpreh falënderimet më të përzemërta për punën tuaj të palodhur e të gjatë, të frymëzuar nga ndjenjat e dashurisë për atdheun.

Përpjekjet dhe kontributi juaj, si në veprën e parë «Albanët (shqiptarët) dhe problemi pellazgjik», ashtu dhe në të dytën «Studime parahistorike», kanë një rëndësi të veçantë për studimet shkencore në fushën e historisë tepër të lashtë të atdheut tonë të dashur. Partia dhe pushteti ynë popullor kurdoherë kanë treguar dhe do të tregojnë një kujdes e interesim të madh për studimet në këto fusha kaq të rëndësishme.

Veprat tuaja do të ndihmojnë gjithashtu në fushën e albanologjisë për të vërtetuar vjetërsinë e popullit shqiptar e për të vënë në dukje akoma më mirë traditat e thesaret e kulturës së tij të lashtë.

Armiqtë e vendit tonë në të kaluarën nuk mundën të thyejnë vullnetin dhe dëshirën tuaj për t'i shërbyer mëmëdheut. Dëshirat tuaja gjetën mundësi zhvillimi vetëm me vendosjen e pushtetit popullor dhe në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë së Punës të Shqipërisë, e cila, ashtu si gjithë popullit, edhe juve, si gjithë studiuesve e shkencëtarëve tanë, ju dha energji të reja. Puna dhe përpjekjet tuaja të palodhshme le të shërbejnë si një shembull frymëzimi.

Edhe një herë ju uroj suksese në punën tuaj, shëndet e pleqëri të lumtur!

Ju përshëndes me respekt të thellë.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## JUGOSLLAVIA TITISTE NË RRUGËKRYQ

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

**2 gusht 1966**

Ajo që ngjau, dhe çka do të ngjasë më vonë në Jugosllavi, është rezultati logjik i tradhtisë, nga ana e klikës titiste, të interesave të popujve të Jugosllavisë dhe të marksizëm-leninizmit. Lufta heroike nacionalçlirimtare që bënë popujt e Jugosllavisë u shfrytëzua nga klika titiste jo për të sjellë lumturinë dhe socializmin në Jugosllavi, por për të rrëzuar kralin serb dhe për të vendosur kralin kroat Tito, për të rrëzuar borgjezinë e vjetër serbokroate dhe për të vendosur mbi shpinën e popujve të Jugosllavisë borgjezinë e re me maskën «komuniste», «socialiste». Në këtë rrugë ku i futi klika titiste, popujve të Jugosllavisë iu desh të derdhnin gjak, të vuanin, të torturoheshin, të gënjuheshin nga kjo klikë renegatësh, e cila pas shumë vjetësh arriti në katastrofën e sotme, që do të pasohet nga të tjera. Popujt e Jugosllavisë do të derdhnin akoma gjak, do të vuajnë akoma më shumë, pse, në rast se kjo ka qenë faza e

rivendosjes së kapitalizmit në Jugosllavi, faza që po kalojmë do të jetë faza e rivaliteteve politike, ekonomike dhe me armë. Lufta e brendshme në Jugosllavi sapo ka filluar, por ajo do të vazhdojë të zhvillohet për pushtet, për hegjemoni dhe komplotet e raprezaljet do të ndjekin njëra-tjetrën. Do të zhvillohet lufta e udbashëve serbë kundër ustashëve kroato-slllovenë, lufta se kush të ketë në dorë ushtrinë jugosllave, lufta e ashpër në mes klaneve serbe kundër klaneve kroato-slllovene, lufta e republikave të vogla dhe të varfra kundër republikave të mëdha dhe të pasura, lufta në mes kombësive të ndryshme, dhe këtë do ta përforcojë lufta fetare, e cila do të bëjë punën e vet.

Jugosllavia titiste po kthehet në një «fuçi baruti». Jugosllavia ndodhet në rrugëkryq. Vetëm revolucionin proletar i armatosur, i udhëhequr nga një parti e marksiste-leniniste e vërtetë dhe revolucionare, mund ta shpëtojë dhe do ta shpëtojë Jugosllavinë nga katastrofa.

Është e qartë se grupi i serbit Rankoviç me aparatit e UDB-së dhe i mbështetur kryesisht nga borgjezia e re serbe, nga një numër i madh kuadrosh në ushtri dhe në republikat e ndryshme, nga kuadro me pikëpamje të njëjta ideologjike ose të komprometuar nga organet e Rankoviçit, tentuan të rrëmbenin të gjithë pushtetin në Jugosllavi. Kjo klikë dështoi përkohësisht, por armët ajo s'i ka hedhur, dhe zor t'i hedhë, me gjithë masat e rrepta që merr klika kundërshtarë Tito-Kardel-Bakariç.

Klika serbomadhe e Rankoviçit sigurisht punonte me kohë në këtë drejtim, dhe duhet të ishte e sigurt se



do ta realizonte puçin në mënyrë të qetë e normale, pa «thyerje» të shumta. Titoja në fakt ishte në dijeni të këtij veprimi dhe e mbulonte këtë me ndërgjegje, derisa kjo veprimtari e klanit serbomadhi nuk dilte jashtë drejtimit të tij. Titoja luante rolin e akrobatit në mes rivaliteteve të klaneve dhe Rankoviçi ishte plot besim se pas vdekjes, natyrale ose të forcuar të Titos, këtij ai do t'i zinte vendin sipas së famshmes «Konstitutë të re».

Mirëpo një evolucion i tillë «i qetë dhe normal» nuk ishte i mundur të zhvillohej në një Jugosllavi, ku ishte vendosur kapitalizmi, ku mbretëronte ligji i xhunglës, ku shovinizmi u zhvillua në kulm, në një Jugosllavi të kolonizuar politikisht dhe ekonomikisht nga imperialistët e ndryshëm, dhe në radhë të parë nga ata amerikanë. Atje imperialistët bëjnë politikën, sepse kanë investuar kapitale të mëdha që duhej t'i mbronin nga çdo e papritur, dhe t'u jepnin atyre fitimet e mëdha të paracaktuara, fitime që dalin nga thithja e gjakut të popujve të Jugosllavisë.

Për shkak të kësaj gjendjeje të brendshme të Jugosllavisë, klika gjakatare Tito-Rankoviç-Kardel-Bakariç etj., nuk mund të jetonte gjatë në «unitet», pavarësisht se pjesëtarët e saj kanë qenë, janë dhe do të jenë kurdoherë në unitet të plotë kundër marksizëm-leninizmit, kundër PPSH dhe partive të tjera marksiste-leniniste, kundër RPSH dhe vendeve të tjera që qëndrojnë të vendosura në rrugën e socializmit.

Tradhtia ndaj marksizëm-leninizmit nga ana e klipes titiste solli, dhe do të sillte medoemos, përçarjen në gjirin e saj, do të zhvillonte, sikundër zëvilloi, nacionalizmin e shovinizmin në mes pjesëtarëve të saj dhe,

si rrjedhim, grupimet e ndryshme kombëtare në Jugosllavi që përpiqeshin të afirmoheshin, të forconin pozitën në shtet, në ekonomi, në ushtri, gjithsecili në kurriz të tjetrit dhe të më të dobët. U ringjall dhe u përcaktua rruga e rivaliteteve të vjetra nacional-shoviniste serbo-kroate.

Këto grupe kapitaliste që po formoheshin në gjirin e titizmit, është detyruar t'i njohë edhe Titoja, i cili, për ta maskuar këtë realitet, përdor një fjalë partie: «grupazhe». Por fakt është se Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë nuk luan as më të voglin rol, dhe nuk ka as më të voglën influencë në këtë përleshje, sepse ajo me kohë ka degjeneruar, është zhveshur edhe nga autoriteti më i vogël. Asnjëri nuk kishte besim dhe nuk mbështetej te Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, përveç Rankoviçit, i cili, si sekretar organizativ, e kishte atë çifligun e vet dhe e kishte shndërruar në një aparat thjesht ndihmës të UDB-së. «Riorganizimi» aktual i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë që po trumbeton klika Tito-Kardel-Bakariç natyrisht s'është gjë tjetër veçse likuidimi i kësaj vegle të UDB-së rankoviçiane dhe krijimi i një ofiçine të re sigurimi në mbrojtje të klikës së ustashëve kroato-sllovenë. Grupimet kapitaliste, që u formuan gjatë kësaj periudhe të parë në Jugosllavi, kishin përkrahjen e imperialistëve të jashtëm, të amerikanëve, të revizionistëve sovjetikë, të anglezëve, të italianëve etj., në bazë të lidhjeve të tyre specifike. Lufta midis këtyre grupeve kapitaliste brenda në Jugosllavi zhvillohet dhe do të zhvillohet me qëllim që cili prej tyre të ketë në dorë ushtrinë, sigurimin e shtetit dhe forcën ekonomike ka-

pitaliste, por çdo sukses, qoftë edhe i përkohshëm, i cilitdo grupim që do të ketë epërsi, duhet të mbështetet nga ai shtet imperialist që ka hedhur në dorë pozitën më të fortë ekonomike dhe ka agjenturën më të fortë në Jugosllavi. Është pra e qartë se shteti imperialist që sundon në Jugosllavinë titiste dhe që bën atje ligjin, janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Interesat e imperializmit amerikan, si politike ashtu dhe ekonomike, kërkonin që agjentura e tij jugosllave me Titon në krye jo vetëm të tradhtonte marksizëm-leninizmin dhe socializmin, jo vetëm të komplotonte dhe të minonte vendet e tjera socialiste, por brenda në Jugosllavi të vendoste decentralizimin dhe vetadministrimin, të vendoste format më të përshtatshme për rivendosjen e kapitalizmit, për investimet e lira kapitaliste, në ata sektorë të ekonomisë që ishin më frytdhënës për imperialistët, si nga ana ekonomike ashtu edhe politike. Kapitalizmit amerikan dhe të huaj, natyrisht, as nuk mund t'u interesonte dhe nuk do t'u interesojë që të investojnë në ato republika të Jugosllavisë, ku kapitalet e tyre nuk japin fitime të mëdha. Aq u bën amerikanëve dhe agjenturës së tyre jugosllave me Titon në krye, në rast se Mali i Zi, Bosnje-Hercegovina, Maqedonia apo Kosova e Metohia mbeten republika dhe krahina të varfra, të pazhvilluara, vende burimesh për lëndë të parë dhe krahë pune të lirë për republikat e pasura dhe për trustet amerikane.

Nga ana tjetër, imperializmi amerikan, si çdo imperializëm, për të sunduar duhet të përçajë. Decentralizimi që u vendos në Jugosllavi, ishte, me fjalë të tjera, politika amerikane e përçarjes, e likuidimit të hegjemo-

nisë serbomadhe të re, që ndiqte traditat ekonomike, politike dhe shoqërore të hegjemonisë së vjetër të krallëve serbë. Nga ngjarjet që po zhvillohen në Jugosllavi, duhet, pra, të rezultojë se klika e Rankoviçit, që mbështetej nga borgjezia serbomadhe, kishte mbështetjen e UDB-së, por më pak mbështetjen e amerikanëve.

Decentralizimi dhe vetadministrimi titist do të minonin pozitat tradicionale sunduese të shovinizmit serb, të kapitalit serb, që kishte mbajtur në fre dhe në mëshirën e tij gjithë popujt e tjerë të Jugosllavisë, do të dobësonte fuqinë administrative dhe policeske të klikës serbe të Rankoviçit në fitim të klikës tjetër kapitaliste kroato-slllovene dhe të imperializmit amerikan.

Prandaj klika serbomadhe e Rankoviçit e kuptoi rrezikun dhe u fut në lëvizje për ta frenuar seriozisht dhe për ta likuiduar, kur të merrte pushtetin, këtë formë «të re administrimi të ekonomisë dhe të shtetit» jo pse nuk ishte «socialiste», por se në realitet ishte një formë kapitaliste që shfazorizonte dhe minonte hegjemoninë «historike» serbe.

Në këtë luftë për pushtet klika kroato-slllovene, duket qartë, kishte mbështetjen amerikane. Siç duket, për ta neutralizuar këtë pengesë, klika serbe e Rankoviçit hyri në tratativa të fshehta dhe u afrua me klikën rusomadhe revizioniste të Kremlinit dhe ishte në rrugën e krijimit të një aleance cariste moderne, të frymëzuar nga traditat e vjetra shoviniste të pansllavizmit. Këtë e la të kuptohej qartë Titoja kur e akuzoi Rankoviçin se përdorte të ashtuquajturat prej tyre «metoda staliniste». Këta tradhtarë i marrshin të keqen Stalinit, por vihet pyetja, ku ishte ky Tito, një anti-

stalinist i tërbuar, që 15 vjet me radhë nuk i pa këto metoda të ashtuquajtura staliniste dhe nuk mori masa kundër tyre? Metodat e UDB-së kanë qenë metoda tipike fashiste jugosllave të vendosura nga Titoja, kundër të cilave Stalini, si marksist i madh, ka luftuar me të gjitha forcat, derisa vdiq. Por çështja nuk është te metodat; Titoja, kështu, në mënyrë të maskuar, donte të denonconte lidhjet e Rankoviçit me klikën tradhtare të Kremlinit.

Ngjarjet e bëjnë më të qartë se kreditë që vërshonin nga ana e sovjetikëve në Jugosllavinë titiste, kishin për qëllim të fuqizonin klikën serbe të Rankoviçit, të cilën ata nuk mungonin ta trumbetonin «më pozitive, më nga e majta», për të dominuar dhe për të vënë nën këmbë klikën tjetër kroato-slllovene, e cila, siç duket, ka fituar pozita sunduese në ekonomi, duke mos qenë e pafuqishme edhe në ushtri, sepse ka Titon në anën e saj dhe, mbi të gjitha, ka besimin e plotë të amerikanëve.

Pra, rivalitetet që po zhvillohen në Jugosllavi janë të lidhura ngushtë me rivalitetet e ujqve të jashtëm që duan të sundojnë në kurrizin e popujve të Jugosllavisë, domethënë me rivalitetet midis SHBA-së dhe revizionistëve sovjetikë në radhë të parë.

Kjo është një luftë për vdekje.

Imperializmi botëror dhe revizionizmi sovjetik, tok me agjentët e tyre në Ballkan dhe në Evropën Qendrore, kërkojnë të krijojnë në Ballkan e në Evropën Qendrore gjendjen e paraluftës së Parë Botërore dhe të kohës midis dy luftërave botërore, kërkojnë të rivendosin zonat e interesave të tyre kapitaliste, të rivendosin ale-

ancat dhe sferat e vjetra të influencës, kërkojnë të futin në grindje dhe të gjakosin popujt e Ballkanit e të Evropës Qendrore me njëri-tjetrin, të ngjallin armiqtë e vjetra.

Kjo është rruga e tyre, kurse ne, popujt dhe komunistët e vërtetë të Ballkanit e të Evropës Qendrore, duhet t'ua prishim dhe do t'ua prishim këto plane armiqve tanë të tërbuar.

Në këtë luftë për pushtet në gjirin e titizmit midis klaneve, të mbështetura respektivisht nga amerikanët dhe nga revizionistët sovjetikë, ne shohim të radhiten dhe të sqarohen edhe marrëdhëniet politike, ku të diktuara, ku të shtyra nga prirjet nacionale ose nga llogari të ashtuquajtura socialiste, por që s'janë veçse revizioniste ose llogari të falsifikuara me qëllime të caktuara. Ne shohim që klikat revizioniste në fuqi në Ballkan, në Evropën Qendrore dhe Lindore po lëvizin. Disa lakenj të bindur të revizionistëve sovjetikë, këto vitet e fundit sidomos, u puthën e u puthën aq shumë me titistët jugosllavë, sa që mend u bashkuan. Tash këta lakenj presin urdhrin nga Moska, që të fillojnë rivendikime shoviniste ndaj Jugosllavisë. Të tjerë, antisllavë në gjak, mbështetin Titon dhe vazhdojnë të çirren se Jugosllavia është socialiste, jo pse Titoja nuk është sllav, por se ai, në radhë të parë, është proamerikan, properëndimor, pse ai u puth me latinët demokristianë dhe lidhi marrëdhënie diplomatike me Vatikanin. Të tjerë, që duan të shkëputen përfundimisht nga prangat revizioniste sovjetike, i bëjnë serenada Titos dhe vazhdojnë ta quajnë shpëtimtar të tyre.

Pra, nga një anë, imperializmi amerikan luan kartën e vet me klikat e veta, dhe, nga ana tjetër, revizionistët sovjetikë, me klikat e tyre luajnë kartën e tyre. Fakt është se, aktualisht, Amerika me klikën e saj fitoi në Jugosllavi dhe sovjetikët me Rankoviçin humbën.

Cili është roli i renegatit Tito në këtë mes?

Titoja ka qenë plotësisht solidar në të gjitha krimet që janë bërë në Jugosllavi, ai është frymëzuesi dhe drejtuesi kryesor, ai është një tradhtar me damkë i popujve të Jugosllavisë dhe i marksizëm-leninizmit, ai ka qenë plotësisht solidar me Rankoviçin derisa ky dhe klika serbe i qëndronin besnikë drejtimit të tij dhe nuk rrezikonin politikën e tij proamerikane të brendshme dhe të jashtme. Politika e Titos është e lidhur me një mijë fije dhe përfundimisht me imperializmin amerikan.

Ajo ka synuar kurdoherë dhe synon jo vetëm shpartallimin e socializmit kudo, por veçanërisht shpartallimin e Bashkimit Sovjetik, i cili sot është shndërruar në një shtet borgjez kapitalist nga udhëheqësit revizionistë hrushovianë. Klika titiste, në shërbim të amerikanëve, është në gjendje që të shpartallojë edhe federatën jugosllave për hir të një interesi të madh të imperializmit amerikan, që të japë shembullin «pozitiv» të «socializmit specifik» për shpartallimin e Bashkimit Sovjetik në republika të veçanta, të shpartallimit të Çekoslovakisë në çekë e sllovakë etj. «Përça e mbretëro» është ligji i sundimit për imperializmin.

Titoja është një nga artizanët e katastrofës në Bashkimin Sovjetik, prandaj në rivalitetin për vendosjen

e hegjemonisë botërore midis amerikanëve dhe revizionistëve sovjetikë, Titoja ka mbajtur e do të mbajë kurdoherë anën e amerikanëve, prandaj ai qëndroi në anën e klikës kapitaliste kroato-slllovene me tradita antiruse dhe properëndimore.

Titoja, sigurisht, është menduar shumë kur mori vendim të ndahej nga klika serbe, sepse asaj ia ka shumë frikën, por këtë u detyrua ta bënte se klika serbe e Rankoviçit po i shpëtonte drejtimit të tij dhe të amerikanëve e do të krijonte në Jugosllavinë kapitaliste një situatë të re, ku Titoja do të qërohej dhe vendin e tij do ta zinte Rankoviçi, i cili do të përpiqej pastaj të manovronte në mes amerikanëve dhe revizionistëve sovjetikë.

Klika Tito-Kardel-Bakariç e di mirë dhe do ta ndiejë vazhdimisht frikën dhe rrezikun serbomadh që i turret. Për këtë arsye, ne do të asistojmë në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj situate, e cila do të acarohet në kulm, bile nuk mund të përjashtohen shpartallimi i federatës dhe goditjet me armë.

Jugosllavia ndodhet në rrugëkryq: ose do të shqyhet ndërmjet klikave rivale kapitaliste të brendshme dhe të jashtme, ose populli jugosllav do të çohet dhe duhet të çohet në këmbë, në revolucion përsëri, me në krye marksistë-leninistët e vërtetë jugosllavë, t'i shfarosë këto klika gjakatare dhe ta sjellë Jugosllavinë në rrugën e heronjve të luftës nacionalçlirimtare, në rrugën e Arso Jovanoviçit dhe të të masakruarve të Goli Otokut, në rrugën marksiste-leniniste, në rrugën socialiste të vërtetë. Rrugë tjetër s'ka dhe këtë rrugë vetëm



popujve vëllezër të Jugosllavisë dhe marksistë-leninistëve jugosllavë u bie që ta zgjedhin, dhe vetëm ata do ta zgjedhin.

*Botuar për herë të parë si artikull redaksional në gazetën «Zëri i popullit», nr. 184 (5594), 2 gusht 1966*

*Botohet sipas librit: «E vërteta marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin», vëll. VI, f. 106. Tiranë, 1967*

## KUSH PËRGJIGJET PËR KRIMET E GJENOCIDIT NË KOSOVË?

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»<sup>1</sup>*

31 gusht 1966

J. B. Tito dhe klika e tij, për të shpëtuar lëkurën e vet, për të shpëtuar sistemin e shtypjes, të shfrytëzimit e të terrorit që po tronditet nga themelet, «sakrifikoi» bashkëpunëtorin më të ngushtë, Rankoviçin, të cilit i veshi të gjitha fajet dhe e ngarkoi me të gjitha dështimet, gabimet, krimet dhe disfatat e gjertanishme të regjimit titist.

Me shkarkimin e Rankoviçit nga të gjitha funksionet shtetërore dhe të partisë në Jugosllavi, në gjirin e klikës titiste shpërtheu haptazi lufta për pushtet midis klaneve kroato-slllovene e serbomadhe, që kanë përkrahësish përkrashjen e imperialistëve amerikanë e të revizionistëve sovjetikë. Kjo është një shprehje e qartë e

---

<sup>1</sup> Disa fakte e hollësi që përmban ky artikull janë shtuar nga redaksia e gazetës «Zëri i popullit», kur u botua si artikull redaksional.

kontradiktave të thella klasore e nacionale që brejnë prej kohësh dhe po shembin mbretërinë e Titos, shprehje e kalbëzimit, e degjenerimit dhe e dekompozimit të sistemit titist.

Ngjarjet e fundit treguan edhe një herë se Jugosllavia titiste ndodhet në rrugëkryq. Tradhtia ndaj marksizëm-leninizmit nga ana e klikës së Titos që e ktheu Jugosllavinë në një shtet borgjez kapitalist me të gjitha tiparet e veta, solli, dhe do të sillte medoemos, përçarjen në gjirin e saj, se ajo do të zhvillonte, sikundër zhvilloi, nacionalizmin e shovinizmin në mes të pjesëtarëve të saj dhe, si rrjedhim, grupimet e ndryshme kombëtare në Jugosllavi që përpiqeshin të afirmoheshin, të forconin pozitën në shtet, në ekonomi, në ushtri, gjithsecili në kurriz të tjetrit dhe më i forti kundër më të dobët. U ringjall dhe u përcaktua rruga e rivalitetëve të vjetra nacional-shoviniste serbo-kroate.

E tërë politika nacionale e klikës së Titos gjatë këtyre njëzet e ca vjetëve ndaj kombësive të ndryshme është karakterizuar nga shtypja e pabarazia, nga shfrytëzimi dhe diskriminimi ekonomik e kulturor. Në mënyrë të veçantë titistët kanë zbatuar terrorin më të egër, më gjakatar, gjymtimet dhe asgjësimin fizik mbi popullsinë shqiptare në Jugosllavi. Popullsia shqiptare në Jugosllavi me shtypjen e përgjakshme që ka pësuar nga regjimi skllavërues titist, nga politika e tij shoviniste shkombëtarizuese, është një aktakuzë e fuqishme, e pakundërshtueshme kundër rendit policor të Beogradit. Mbi kurrizin e saj janë bërë persekutime të tipit fashist, tortura fizike e shpirtërore, është zbatuar gjerësisht krimi i gjenocidit.

Klika e Titos, pas plenumit të 4-t të së ashtuquajturës Lidhje e Komunistëve të Jugosllavisë, po përpiqet me të gjitha mjetet të shpëtojë regjimin titist nga katastrofa, drejt së cilës po rrokulliset duke u orvatur t'ia ngarkojë përgjegjësitë e rënda për gjendjen pa rrugëdalje të krijuar në Jugosllavi ish-kryetarit të UDB-së, bashkëpunëtorit më të ngushtë të Titos, Rankoviçit. Në gjithë Jugosllavinë po bëhen përpjekje për ta vënë UDB-në, këtë organizatë famëkeqe gjakësorësh, më mirë në shërbim të regjimit terrorist titist, duke hequr prej saj, sa për sy e faqe, ndonjë kriminel tepër të komprometuar. Kështu, me urdhër të Titos, u bënë disa «spastrime» në gjirin e hierarkisë drejtuese të UDB-së. U hoqën disa ministra të punëve të brendshme në ato republika e krahina ku politika shoviniste e shtypjes dhe e shfarosjes nacionale ka qenë më e egër dhe ku mundësia e shpërthimit të zemërimit popullor ka vënë në rrezik vetë ekzistencën e regjimit titist. Kështu ndodhi në Serbi, në Mal të Zi, në Maqedoni, në Bosnje e Hercegovinë e gjetkë. Kështu, sipas lajmeve të shtypit jugosllav, edhe në krahinën e Kosovës janë bërë ndryshime në udhëheqjen e UDB-së. Përgjegjësit e gjertanishëm të UDB-së në Kosovë Miça Mijushkoviç e Stanislav Gerkoviç u shkarquan, duke u zëvendësuar nga të tjerë «specialistë» të UDB-së, këlyshë besnikë të Titos, si Xhevdet Hamza e Dushko Ristiçi. Por popujt jugosllavë nuk mashtrohen. Aq më tepër nuk mashtrohet populli shqiptar në Jugosllavi. Kjo fushatë gjoja «spastrimesh» është një luster për të mbuluar krimet e pashlyeshme e të pafalshme të regjimit titist, për të larë nga përgjegjësitë

klanin Tito-Kardel-Bakariç, që doli përkohësisht i fituar nga lufta për pushtet. Ajo bëhet, më në fund, për ta paraqitur Titon si «shpëlimtar të situatës», që gjoja kujdeset për të rivendosur «rendin e ligjshmërinë» e asgjësuar nga vetë sistemi titist dhe udbashët fashistë, të cilët gjithmonë kanë vepruar nën drejtimin e Titos dhe klikës së tij.

Por asnjë manovër nuk e shpëton dot klikën titiste. Krimet e gjenocidit që janë zbatuar kundër popullsisë shqiptare në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit, në Maqedoni e në Mal të Zi, janë produkt i politikës së nacionalizmit e të shovinizmit të egër që ka zbatuar regjimi titist. Për ato duhet të përgjigjet, në radhë të parë, vetë Titoja dhe, bashkë me të, e tërë klika e tij, që nga peshkaqenët e mëdhenj Rankoviç, i cili është i lyer gjer në grykë me gjakun e popullit shqiptar në Jugosllavi, Kardel, Bakariç, Ll. Kolishevski e të tjerë, e deri tek ata më të vegjlit, si Dushan Mugosha, Xhavit Nimani, Ali Shukriu, Gjoko Pajkoviçi, Çedo Mijoviçi, Çedo Topaloviçi, Sinan Hasani, Xhevdet Hamza e të tjerë.

Partia e Punës e Shqipërisë, duke u nisur kurdoherë nga pozita të drejta parimore marksiste-leniniste, ka demaskuar me kohë dhe me vendosmërinë më të madhe të gjitha krimet e shëmtuara që klika tradhtare e Titos ka vazhduar të kryejë në dëm të popujve të Jugosllavisë dhe në mënyrë të veçantë në dëm të popullsisë shqiptare në atë shtet.

Ne kurrë nuk kemi ndërhyrë dhe nuk do të ndërhyjmë në punët e brendshme të Jugosllavisë, përkundrazi. Është klika revizioniste e Titos ajo që e ka ngritur

në sistemin ndërhyrjen në punët e brendshme të Shqipërisë e të vendeve të tjera, ajo që për më se njëzet vjet nuk ka lënë gjë pa bërë në luftën e saj kundër popullit shqiptar, kundër PPSH, kundër RPSH dhe kundër rendit shtetëror e shoqëror socialist të vendosur në Shqipëri. Ndërhyrjet e klikës titiste në Shqipëri, veprimtaria e saj e vazhdueshme komplotuese e diversioniste, aleancat e saj me armiqtë më të tërbuar të popullit shqiptar, që nga fashistët, ballistët, zogistët e deri tek imperialistët amerikanë, monarko-fashistët grekë e revizionistët hrushovianë kundër RPSH, janë të njohura tanimë nga gjithë bota. Natyrisht, të gjitha këto ndërhyrje të klikës së Titos në punët e brendshme të Shqipërisë kanë hasur në kundërshtimin e vendosur të popullit tonë, janë bërë copë e thërime nga vigjilenca dhe uniteti revolucionar i popullit shqiptar, që është bashkuar me Partinë e tij si mishi me kockën. Por, në rast se klika revizioniste e Titos përcjell në varr me aq ceremoni e pompozitet provokues një tradhtar të tillë me damkë dhe armik të njohur të popullit shqiptar e të PPSH si Panajot Plaku, aq më tepër ne i kemi të gjitha të drejtat të ngremë zërin tonë për të mbrojtur interesat jetike të popullsisë shqiptare në Jugosllavi, e cila jeton nën terrorin e klikës së Titos e të UDB-së, nën rrezikun e përhershëm të shkombëtarizimit e të shfarosjes masive.

Krimet, vrasjet e asgjësimi fizik i popullsisë shqiptare në Jugosllavi nga ana e klikës titiste, si dhe politika për shkombëtarizimin e saj, përbëjnë një vijë sistematike, e cila ka filluar qysh në ditët e para të çlirimit dhe ka vazhduar e vazhdon me egërsi gjithnjë e më të llahtarshme edhe sot e kësaj dite. Këto krime e kjo

politikë gjenocidi nuk mund të shlyhen nga kujtesa e asnjë njeriu të ndershëm në botë, e aq më pak nga kujtesa e atyre që i kanë hequr dhe i heqin përditë mbi kurrizin e tyre. Kurrë nuk do të harrojë popullsia shqiptare në Jugosllavi ngjarjen e hidhur të vjeshtës së vitit 1944, kur banda Tito-Rankoviç arrestoi në Tetovë 10 000 shqiptarë dhe pushkatoi pa gjyq 1 200 prej tyre, pa bërë fjalë për ata që vdiqën në burgje. Cinizmi, egërsia, tërbimi për të shfarosur shqiptarët kanë karakterizuar gjithmonë veprimet e banditëve titistë. Kur një grup patriotësh shqiptarë protestoi në komandën titiste për këto krime, gjenerali Apostolski, komandant i atëherëshëm i Brigadës së Parë Maqedonase, u përgjigj: «Kjo nuk është asgjë, është një pastrim që bëjmë. Këta që vriten duhet të qërohen». Dhe Vukmanoviç Tempo, i cili ishte i pranishëm atëherë, urdhëroi: «Akoma mbani njerëz nëpër kampe? Ata që keni për të pastruar, i qëroni shpejt». Ky urdhër i përfaqësuesit personal të Titos u zbatua me zell të madh. Në nëntorin e vitit 1944, mijra fshatarë të pafajshëm shqiptarë u pushkatuan rrugëve të Maqedonisë, u dogjën në zjarr, u infektuan me qëllim dhe vdiqën nga tifoja.

Brez pas brezi populli shqiptar në Jugosllavi do të kujtojë me urrejtje të papërmbajtur kundër klikës gjakatare titiste, masakrën e Drenicës të dimrit të 1944-ës, kur divizionet jugosllave, nën pretekstin e spastrimit nga elementët armiq, rrethuan zonën e çliruar të Drenicës dhe masakruan rreth 30 000 burra, gra, pleq e fëmijë shqiptarë. Ngjarja e Drenicës ishte një kasaphanë e vërtetë, një asgjësim sistematik e i organizuar i popullsisë me kombësi shqiptare në këto krahina.

Përse dhe me ç'qëllime titistët u sulën si bisha mbi popullsinë shqiptare dhe e mbuluan përsëri me gjak shqiptar Kosovën e martirizuar? I vetmi «faj» i kësaj popullsie ishte kombësia e saj shqiptare, kurse qëllimi i titistëve ka qenë dhe mbetet asgjësimi i popullsisë shqiptare në përgjithësi. Në këtë rrugë ata ecin pa u ndalur edhe sot e kësaj dite. Mbi 2 000 shqiptarë në Mitrovicë, më se 1 000 të tjerë në Gjilan, mijëra shqiptarë që shkuan si partizanë në brigadat jugosllave për të luftuar fashistët, u vranë me plumbin pas kokës, me urdhër të shtabit jugosllav. Qindra shqiptarë të tjerë të rekrutuar ushtarë nga jugosllavët, u pushkatuan prej tyre gjatë rrugës Prizren-Tivar. 1 200 djem shqiptarë që kishin mbetur nga ky udhëtim tragjik, u pushkatuan në Tivar. Në Gorica të Triestes më shumë se 2 000 djem shqiptarë nga Maqedonia, të mobilizuar në brigada pune, u mbytën me gaze helmuese. Asgjësimi fizik i shqiptarëve në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi kryhej në mënyrë sistematike. Nga të dhënat e dëshmitarëve e të dokumenteve del se më shumë se 40 000 veta kanë rënë pabesisht nga plumbi, bajoneta dhe helmi i agjenturës titiste gjatë viteve 1944-1948.

Por ky terror asgjësues i klikës titiste kundër popullsisë shqiptare në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit, në Maqedoni e në Mal të Zi vazhdoi edhe më i egër e më i organizuar pas vitit 1948. Udhëheqja revizioniste jugosllave, pas daljes së Rezolucionit të Byrosë Informative më 1948, me të cilin u dënua tradhtia e Titos ndaj marksizëm-leninizmit dhe çështjes së socializmit, shtoi shtypjen e egër dhe të gjithanshme mbi popullsinë shqiptare në Jugosllavi, mbi të cilën, si gjatë viteve



1948-1950 ashtu edhe gjatë periudhës 1951-1966, shpërtheu vala e vrasjeve, e arrestimeve dhe torturave më çnjerëzore.

Titistët me të gjitha mjetet nxitin vëllavrasjen midis shqiptarëve, ringjallin jo vetëm gjaqet e vjetra, por, me kombinacione të ndryshme, krijojnë gjaqe të reja. Për zgjerimin e tyre, oficerët e UDB-së, me anën e agjenturës, organizojnë rrëmbime dhe çnderime vajzash e grash kosovare dhe pastaj i shtojnë të vriten, ndërsa ligjet, me qëllim inkurajimi, parashikojnë dënime të lehta. (Kështu, ndërsa gjatë vitit 1965 në krahinën e Kosovës u kryen 41 vrasje dhe 74 plagosje, në gjashtëmujorin e parë të këtij viti u bënë 26 vrasje dhe 46 plagosje të rënda. **Red.**)

Por a mund të shprehen me fjalë dhe të përshkruhen krimet dhe barbarizmat e pashembullta që klika titiste kreu në dimrin e viteve 1955-1956, kundër popullsisë shqiptare gjatë të ashtuquajturit aksion të armëve? Për zbatimin me përpikëri të operacionit kriminal dhe për drejtimin e ekspeditave ndëshkimore, Titoja ngarkoi vetë Rankoviçin, formoi edhe një shtab, në të cilin ishin caktuar njerëzit më të sprovuar në barbarizma, shovinistë nga më të tërbuarit, kriminelë të regjur, që kanë lyer duart me gjakun e popullit shqiptar të Kosovës. Ky shtab udhëhiqej nga Dushan Mugosha, Gjoko Pajkoviçi, kolonel i UDB-së Çedo Mijoviç, Çedo Topaloviçi, Xhavit Nimani, Xhevdet Hamza e të tjerë.

E para që pësoi goditjen e terrorit ishte krahina e Rugovës. Ekspedita ndëshkimore me oficerin e UDB-së Bogolub Rediçin në krye, me pretekstin e

kërkimit të armëve, torturoi barbarisht pothuajse të gjithë burrat e kësaj krahine. Ata i rrihnin për vdekje, i mundonin me anën e korrentit elektrik dhe i linin tërë natën të zhveshur e të z bathur në dëborë. Pastaj i vinin në kolonë dhe i futnin në kanal, ku uji kishte ngrirë nga të ftohtit e madh që i kalonte të 15 gradët nën zero. Në të njëjtën mënyrë vazhduan torturat e masakrat në Junik, në Deçan, në Suharekë, në Llap, në Vuçiternë, në Drenicë, në Mitrovicë etj.

(«Brenda një nate, — tregon ndër të tjera një emigrant kosovar nga katundi Drenoc i rrethit të Gjakovës. — UDB-ja na mori ne. 34 burra dhe na grumbulloi në një kullë, ku gjatë natës oficeri i UDB-së. Drago Kileviç, me katër milicë serbë na rrihnin një nga një në dhomat e kësaj kulle me një llastikë që ishte i mbushur brenda me copa metali, me shqelma, me grushta, me qytën e pushkës dhe me dru. Rrahja nisi me kërkuesën për armë, por kjo qe vetëm fillimi. Pas kësaj UDB-ja në çdo tri-katër ditë merrte në pyetje secilin prej nesh dhe na thosh se çfarë kini bërë para 20 vjetëve...»).

Një emigrant nga Istoku i Pejës ka deklaruar: «Në katundin Dubovc UDB-ja ka bërë tortura të tmerrshme nën pretekstin e armëve. Këto u bënë në postën e milicisë. Nga 50 shtëpi që ka katundi, për 5 muaj me radhë u torturuan 50 burra». Shumë ndër ta, si rezultat i torturave, u vranë ose u sakatuan. Të marrim dëshminë e një emigranti tjetër nga katundi Bogë i Rugovës — Pejë: «Në muajin janar të vitit 1956, oficerët e UDB-së të rrethit të Pejës Bogolup Radiq e Vllado Dazhiq për një ditë na grumbulluan 65 burra në

dyqanin e katundit dhe filluan të na torturonin. Torturat dhe poshtërimet e UDB-së nuk u shtrinë vetëm mbi ne burrat, por edhe mbi gratë shqiptare, gjë që në malësitë tona nuk kanë mundur ta bëjnë as sulltanët e Turqisë e as kralët e Serbisë e të Malit të Zi...». Të tilla dëshmi mbi mizoritë barbare të kriminelëve titistë ka shumë. **Red.)**

Me qindra njerëz vdiqën në duart e xhelatëve të UDB-së, gjatë torturave ose pas disa ditësh. Shumë të tjerë, duke mos qenë në gjendje t'u rezistojnë torturave për të dytën e të tretën herë, i kanë dhënë fund jetës në mënyrë tragjike. Mijëra njerëz mbetën të gjymtuar e të paaftë për punë dhe po vuajnë akoma edhe sot nga plagët e shkaktuara qysh atëherë. Kurse autoritetet jugosllave, për t'i vënë kapak veprimtarisë së vet prej xhelatësh, lëshuan urdhrin kategorik që shqiptarët e gjymtuar gjatë torturave të vjetëve 1955-1956 të mos pranoheshin në asnjë mënyrë nëpër spitale për t'u mjekuar.

Sikur të mos mjaftonin ekspeditat ndëshkuese, operacionet kriminale masive, vrasjet e zhdukja e mijëra shqiptarëve, klika titiste vuri në zbatim edhe metodat më të ulëta të provokacionit. Ajo ka ngritur një rrjet të gjerë organizatash dhe provokatorësh profesionistë. me anën e të cilëve ka likuiduar qindra shqiptarë.

Të burgosurit shqiptarë që ndodhen në burgjet titiste, jetojnë në kushte çnjerëzore. Vetëm në burgun e Nishit ndodhen mbi 2 000 shqiptarë të burgosur. Gjithashtu, edhe në burgun e Sremska Mitrovicës, që është edhe ky burg qendror, ka mbi 700 të burgosur,

një e treta e të cilëve i përkasin kombësisë shqiptare. Ndërsa gjysma e të dënuarve me akuza politike në Srem janë shqiptarë. Titistët i kanë kthyer krahinat shqiptare në Jugosllavi në burgje e kampe përqendrimi të shfarosjes masive. Për këtë dëshmojnë burgjet në Nish e Srem, në Idrizove të Maqedonisë, në Prishtinë, në Gjurakovc, në Suharekë, në Goli Otok etj. Kudo shqiptarët në Jugosllavi jetojnë me frikën e pasigurisë për të nesërmen. Vdekja qëndron varur mbi kokat e tyre si shpata e Damokleut. (Një i burgosur kujton me llahtar: «Kam parë lloj-lloj krimesh kundër shqiptarëve, — thotë ai. — Kam parë krime të atilla që e thernin njeriun në qafë si qengjin. Por ç'kam parë në burgun e Prishtinës një ditë nuk mund ta përshkruaj. Edhe tani tmerrohem kur i mendoj ato krime. Në burg kishin qenë tre shqiptarë. Njeri prej tyre ishte therur copa-copa, dy të tjerët ishin të gjallë, por njerit ia kishin thyer duart dhe këmbët, ndërsa tjetrit ia kishin prerë një vesh, i kishin nxjerrë një sy dhe i kishin prerë njërin mustaqe me gjithë buzë». **Red.**)

Në burgjet e Jugosllavisë, veçanërisht në Kosovë, ka hyrë fjala e fundit e teknikës moderne. Ata janë pajisur me dhoma frigoriferi dhe kaloriferi. Të arrestuarit i futin të xhveshur në dhomën e frigoriferit me një temperaturë shumë gradë nën zero dhe i mbajnë për dy deri tri orë rresht. Pastaj i futin menjëherë në dhomën e kaloriferit. Kjo torturë bëhet me qëllim që të dërrmojë njerëzit nga ana shëndetësore dhe për t'u thyer vullnetin, që të pranojnë akuza të pabaza e të vihen në shërbim të titistëve. Të tilla dhoma ka në burgun e Prishtinës, Nishit dhe Idrizovës.

A nuk të kujton një trajtim i tillë që u bëhet të burgosurve shqiptarë në burgjet titiste, trajtimin e antifashistëve nëpër kampet e përqendrimit të nazistëve gjermanë? Dhe s'ka si të ndodhë ndryshe përdorisa drejtori i burgut të Nishit ka kryer po këtë detyrë edhe në kohën e kralit e të pushtuesve gjermanë dhe tani të titistëve. Po kështu, edhe drejtori i burgut të Sremit është i njohur si çetnik dhe profesionist për vrasje dhe tortura. Në të tilla burgje vuajnë persekutimet më të egra shkrimtari patriot kosovar Adem Demaci dhe qindra patriotë të tjerë, të cilët, bashkë me popullin shqiptar në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit, në Maqedoni e në Mal të Zi, nuk i janë nënshtruar dhe nuk do t'i nënshtrohen kurrë zgjedhës së Titos, dhunës shfarosëse, diskriminimit nacional e gjenocidit, që janë ngritur në sistem shtetëror nga regjimi titist. (Vetëm shtatë ditë pas «kthesës» së Briunit mundi të ikte nga skëterra titiste dhe të vinte në Shqipëri, por me nofulla të copëtuara dhe ulok nga torturat e UDB-së së Budves, një punëtor nga Vuçiterna. Ai u rrah në mënyrë çnjerëzore nga shtatë agjentë titistë vetëm sepse, pas punës lodhëse të ditës, në pushimin e drekës në një park, me dy shokë të tjerë, po këndonte një këngë në gjuhën amtare! Kjo që e mjaftueshme për njerëzit e UDB-së që këtë punëtor ta gjymtonin dhe ta hidhnin në rrugën e madhe. Raste të tilla ka me qindra edhe sot e kësaj dite. Red.)

Ne pyesim: Kush përgjigjet për këto krime të tmerrshme të gjenocidit, që për dhjetëra vjet me radhë, në mënyrë sistematike, kryhen nga regjimi titist kundër popullsisë shqiptare në Jugosllavi? A mos vallë

vetëm Rankoviçi dhe banda e tij udbashe? Jo. Për këto e krime të tjera duhet të përgjigjen jo vetëm ekzekutuesit kryesorë, jo vetëm shërbëtorët, por në radhë të parë ustai i tyre në krime, xhelati Tito, dhe gjithë klika e tij kriminale.

Një nga objektivat e vijës së përgjithshme të politikës nacionale të klikës së Titos, veç vrasjeve e krimeve masive, ka qenë dhe mbetet shkombëtarizimi i popullsisë shqiptare në Jugosllavi me çdo mënyrë e me çdo mjet. Për këtë qëllim ata kanë kombinuar masat administrative dhe terrorin policor me veprimtarinë e dendur propagandistike, e cila synon dhe shprehet me mbytjen e frymës patriotike, me mohimin e autoktonisë («në tokat tuaja jeni të ardhur, prandaj duhet të ikni këtej»), me mënjanimin e masave shqiptare nga jeta politike dhe mohimin e kërkesave të tyre nacionale, me çoroditjen dhe degjenerimin me opium fetar dhe me ndezjen e armiqësive e të vëllavrasjeve, sipas parimit imperialist «përça e sundo».

Gjatë periudhës së fundit dhjetëvjeçare propaganda titiste është përpjekur me të gjitha mjetet «të argumentojë» e të përligjë sllavizimin dhe turqizimin violent të masës shqiptare, orvatjet për të ndryshuar emrat e vendeve nga shqiptarë në sllavë dhe, nën presionin e privacioneve ekonomike, thithjen e shqiptarëve në thellësi të Jugosllavisë dhe shpërnguljen gjoja vullnetare të tyre në vende të huaja.

Parulla e «lirisë për të jetuar ku të duash» dhe «për t'u quajtur si të duash» përbën në esencë imponimin politiko-ekonomik të shqiptarit për t'u larguar nga vendlindja e tij dhe për të jetuar në thellësitë e

largëta të Jugosllavisë, apo për të emigruar në Itali, Austri, Gjermani Perëndimore etj., si skllav i kapitalit monopolist. Po për titistët çdo mjet është i përshtatshëm për të arritur qëllimin. Jo më kot dhe jo rastësisht Gjoko Pajkoviçi, anëtar i KQ të LK të Jugosllavisë, ish-sekretar i LKJ për Kosovën, shpalli si vijë zyrtare të detyrueshme «lirinë» për shqiptarët që të mohojnë kombësinë e tyre. Në sesionin e 2-të të legjislaturës së 3-të të këshillit krahinor të Kosovës ai pati thënë duke bërë aluzion të hapët për turqizimin, ose më mirë të themi shkombëtarizimin e shqiptarëve, edhe këto: «Askush nuk mund të më ndalojë të shkoj në shkollën turqishte nëse dua vetë... Kjo është liria ime, unë mundem me qenë serb, turk, amerikan e ku ta di unë». Kozmopolitizmi i revizionistëve nuk ka kufi, por ky kozmopolitizëm shprehet në një drejtim shumë të caktuar: për t'u mohuar shqiptarëve të drejtën për të qenë shqiptar, nën të ashtuquajturën liri «për të zgjedhur» çfarëdo kombësi tjetër.

Në fushën e ekonomisë titistët, për të detyruar masën shqiptare të shpërngulet për në thellësi të territorit jugosllav, përdorin gjerësisht presionin ekonomik dhe taksat shumë të rënda. Të gjitha krahinat shqiptare në Jugosllavi nga pikëpamja ekonomike janë shumë të prapambetura, pasi të gjitha objektet kryesore industriale janë përqendruar kryesisht në Serbi, në Kroaci e në Slloveni.

Në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit dhe në krahinat e tjera shqiptare pushteti titist u ka dhënë rëndësi vetëm atyre sektorëve ekonomikë, nëpërmjet të cilëve mund të shfrytëzojë pasuritë e mëdha të këty-

re krahinave dhe këto pasuri i dërgon për në thellësi ose në perëndim, duke sjellë varfërimin në masën e popullsisë shqiptare. Me të tilla metoda të shfrytëzimit tipik kolonialist veprohet në minierat e pasura të Trepçes, Devës, Goleshit etj. Në këto miniera personeli administrativ dhe specialist është serbo-malazez. Në qoftë se në këto miniera kërkon shqiptarin, atë e gjen në kategorinë e punëtorit të pakualifikuar. Për shembull, në minierën e Trepçes, 90 për qind e punëtorëve shqiptarë janë të pakualifikuar. Edhe në ato pak objekte industriale dominon elementi sllav, për shembull, nga 400 punëtorët e fabrikës së duhanit në Gjilan, vetëm 90 janë shqiptarë.

Krahinat e banuara prej shqiptarëve janë shndërruar në koloni që po shfrytëzohen intensivisht nga serbët, malazezët e maqedonasit. Papunësia rritet me shpejtësi. Lidhur me këtë Sllobodan Peneziqi, në Prishtinë, ka deklaruar qartë: «Me gjithë përparimet, papunësia nuk zgjidhet, është nevoja që punëtorët të shkojnë në krahina të tjera». Kurse më vonë, Dushan Mugosha, si sekretar i atëhershëm i LK të Jugosllavisë për Kosovën, deklaroi hapur: «Ne ende nuk jemi në gjendje me i sigurue punë një numri të madh njerëzish. Për çdo vit afër 7 000 banorë të kësaj krahine, Kosovës, shkojnë me kërkue punë në viset e tjera të vendit, jashtë Kosovës e Metohisë». Ndërsa çdo vit 14 000 krahë pune të rinj i shtohen armatës së të papunëve. Ky fenomen ka vazhduar edhe më vonë me të njëjtat ritme. Më 20 gusht 1966, Tanjugu njoftonte se në mbledhjen e veçes ekzekutive të Kosovës e Metohisë u konstatua se «numri i njerëzve që futen



në punë në këtë krahinë pakësohet gjithnjë e më tepër dhe janë duke u pakësuar gjithnjë e më tepër mundësitë për marrjen në punë të punëtorëve të rinj. Sipas të dhënave statistikore, në fund të muajit maj të këtij viti kishte 5 000 punëtorë më pak të futur në punë se në majin e vitit të kaluar».

Në këto rrethana shpërnguljet për në thellësi të Jugosllavisë, aktualisht, përbëjnë formën kryesore të shkombëtarizimit të krahinave shqiptare. Për rrjedhim, që nga viti 1958 dhe deri më sot, me dhjetëra mijëra banorë shqiptarë janë shpërngulur nga trojet e tyre për në krahinat veriore të Jugosllavisë, në Vojvodinë, në Kroaci, në Slloveni, veç faktit që deri tani, sipas pohimeve të shtypit, janë detyruar të braktisin vendlindjen e tyre për në Turqi më tepër se 250 000 shqiptarë. Ky është një dëbim në kushte katastrofike që u bëhet shqiptarëve në Jugosllavi.

Shovinizmi i egër serbomadh e antishqiptar i titistëve është shfaqur edhe në fushën e arsimit e të kulturës. Krahinat e Kosovës kanë përqindjen më të lartë të analfabetëve në gjithë Jugosllavinë dhe në Evropë. Me pretekste të ndryshme, titistët vitet e fundit mbyllën një numër të mirë të shkollave të pakta që ekzistojnë në Kosovë e në Rrafshin e Dukagjinit, ndërsa në Maqedoni e në Mal të Zi, me përjashtime të rralla, kanë mbyllur pjesën më të madhe të shkollave shqipe dhe po shkojnë drejt eliminimit të tyre; në vend të shkollave shqipe çelen shkolla turke e serbe.

Rajone të tëra shqiptare, të cilat janë nën administrimin e Malit të Zi e të Maqedonisë, si Ulqini, Tivari,

Plava, Gucia, Tutina, Rozhaja, Ohri etj., nuk kanë shkolla shqipe.

Përpara një gjendjeje të tillë me të drejtë lind pyetja: Kush përgjigjet për shkombëtarizimin e egër, për shtypjen e shfrytëzimin tipik kolonialist të Kosovës, për dëbimet e kosovarëve nga tokat e vatrat e tyre në thellësi të Jugosllavisë apo përjashta Jugosllavisë? Kush përgjigjet për prapambetjen e madhe ekonomike, për diskriminimin e gjuhës, të kulturës, të traditave të popullit të Kosovës? A mos vallë vetëm kriminelin Rankoviç dhe UDB-ja gjer dje e komanduar prej tij? A duhet të përgjigjen për politikën e egër shkombëtarizuese vetëm veglat e shërbëtorët e klikës së Titos? Jo. Për kursin antishqiptar, shkombëtarizues, për shtypjen e gjithanshme nacionale të popullit të Kosovës duhet të përgjigjet, në radhë të parë, vetë klika e Titos, duhet të përgjigjet regjimi titist, nga i cili buron politika shoviniste nacionale e shkombëtarizimit të Kosovës.

Populli shqiptar në Jugosllavi është i bindur nga eksperiencia e tij e gjatë se manovrat e sotme të klikës së Titos, pavarësisht nga fjalët «e ëmbla», pavarësisht nga maskat, kanë vetëm një qëllim: të forcojnë pushtetin e tronditur të klikës titiste. të forcojnë shtypjen nacionale, shfrytëzimin e shkombëtarizimin e Kosovës. Për popullin shqiptar në Jugosllavi, si për gjithë popujt e shtypur të Jugosllavisë, kriza e thellë që ka goditur klikën e Titos është një gjë që pritej, është pasojë e pashmangshme e vetë kontradiktave antagoniste që ziejnë prej vitesh në gjirin e klikës së renegatëve.

Kjo krizë e ka tronditur rëndë klikën e Titos, e cila po e ndien rrëshqitjen e tokës nën këmbë, po e ndien pasigurinë, po ndien t'i afrohet fundi fatal që historia i ka rezervuar çdo renegati. Në një fjalim që mbajti këto ditë, Titoja e shprehu haptazi shqetësimin e frikën për rritjen e valëve të rezistencës, në forma të ndryshme, kundër regjimit të tij. Ai pranoi se vendi nuk është «kompakt», «i bashkuar», «i lidhur», se «njerëzit nëpër republikat kanë filluar të flasin për ndarjen e kombësive». Ky është vetëm fillimi i mbarimit të udhëheqjes titiste. Rivalitetet, shqyerjet në mes të ujëve, do të shtohen, ata do të gjakosen me njëri-tjetrin. Ky është ligji i tyre, ligji i xhunglës. Mbaroi miti i unitetit titist. Kalbësira, tradhtia, blofi çdo ditë po dalin sheshit. Këtë e shikojnë popujt e Jugosllavisë dhe marksistë-leninistët e vërtetë jugosllavë, të cilët nuk do të jenë përherë shirxhinj e pasivë përpara greminës ku po i çojnë titistët e çdo ngjyre. Heqja e Rankoviçit nuk i gënjen dot lehtë popujt jugosllavë dhe revolucionarët jugosllavë. Titoja, Kardeli, Vukmanoviç Tempoja, Koça Popoviçi dhe të tjerë janë po aq kriminelë sa edhe Rankoviçi. Edhe pas largimit të Rankoviçit, UDB-ja, nën drejtimin e Titos, do të përdorë metodat më të egra të policisë amerikane, që do t'u shtohen atyre të UDB-së për t'i shtypur e gjakosur edhe më shumë popujt e Jugosllavisë. Por eksperiencia e hidhur shumëvjeçare nën sundimin e egër të klikës së Titos, e ka bërë popullin shqiptar në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit, në Maqedoni e në Mal të Zi, të jetë vigjilent, të hapë sytë e t'i bëjë katër, për të mos u mashtruar nga de-

magogjia e kurthet e klikës titiste që kanë shpërthyer kohët e fundit në gjithë vendin.

Loja që po bën tani Titoja me anën e një grushti tradhtarësh shqiptarë është një lojë shumë dinake dhe e rrezikshme. Por Titoja dhe tellallët e tij nuk mund të mashtrojnë njeri. Populli shqiptar në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit, në Maqedoni dhe në Mal të Zi i njeh se cilët janë titistët. Ai e di fort mirë se cilët janë ata tradhtarë që kanë lejuar ose kanë bashkëpunuar në krimet e përgjakshme të Drenicës e të Tetovës, të Ulqinit e të Prishtinës, të «aksionit të armëve» e të Pejës. Kur popullsia shqiptare e atyre krahinave ishte e përgjakur dhe e copëtuar nga klika e Titos dhe e Rankoviçit, këta e paraqitnin të zbukuruar regjimin xhelat të Titos. Populli shqiptar i këtyre krahinave nuk do të bjerë në lakun e ri të mashtrimeve të këtyre tradhtarëve dhe të padronëve të tyre, Titos, Kardelit, Bakariçit e të tjerë, por, krahas popujve të tjerë të shtypur të Jugosllavisë, krah për krah marksistë-leninistëve të vërtetë jugosllavë, do të vazhdojë luftën për demaskimin e klikës titiste dhe për mbrojtjen e interesave të veta.

Sado të egra, cinike dhe dinake të jenë masat e sundimtarëve revizionistë të Beogradit, ata kurrë nuk do t'ia dalin në krye të shkombëtarizojnë, të shfarosin e të asgjësojnë popullsinë shqiptare në Jugosllavi. Ky popull, i cili u qëndroi me heroizëm të mrekullueshëm valëve të tërbuara të pushtuesve otomanë e sllavë gjatë shekujve dhe ka ruajtur me guxim e vendosmëri heroike gjuhën, traditat, zakonet, kulturën e vet, personalitetin dhe vitalitetin e tij, të

gjitha karakteristikat e veçoritë e tij kombëtare, përballë të gjitha orvatjeve shkombëtarizuese e asgjësuese, një popull i tillë nuk mund të nënshtrohet e të shfaroset kurrë. Ai është i përjetshëm dhe do të fitojë. Do të vijë dita që Titoja e klika e tij patjetër do të japin llogari deri në fund për krimet e tyre të përbindshme, për gjenocidin e pashembullt në Kosovë.

*Botuar për herë të parë si artikull redaksional në gazetën «Zëri i popullit» nr. 209 (5619), 31 gusht 1966*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## UNITETI I VËRTETË REVOLUCIONAR ARRIHET VETËM NË RRUGËN LENINISTE

*Nga biseda me ambasadorin e Republikës Socialiste  
të Rumanisë*

2 shtator 1966

*Pasi e priti ambasadorin rumun, shoku Enver Hoxha  
vazhdoi:*

Ne na gëzojnë ndjenjat e miqësisë që shfaqni ju ndaj Partisë dhe popullit tonë. Miqësia e vërtetë i shërben ndërtimit të socializmit, rritjes së mirëqenies së popujve dhe ruajtjes së lirisë e forcimit të pavarësisë së vendeve tona, prandaj detyra jonë është ta forcojmë miqësinë në mes nesh, sepse kjo është si në interesin e përbashkët të të dy vendeve, ashtu edhe të lëvizjes revolucionare ndërkombëtare.

Vërtet që keni ardhur para pak kohësh te ne, por vendi ynë është i vogël dhe mund të vizitohet shpejt. Ç'përshtypje keni nga Shqipëria?

*Duke iu përgjigjur pyetjes, ambasadori rumun vlerësoi bukuritë natyrore të vendit tonë dhe sukseset e arritura nga populli shqiptar në ndërtimin e socializmit. Pasi foli edhe për zhvillimin ekonomik të Rumanisë e*

*qëndrimin e saj në marrëdhëniet ndërkombëtare, e mori përsëri fjalën shoku Enver Hoxha:*

Më gëzojnë shumë fjalët e mira që thatë për Shqipërinë e për zhvillimin socialist të saj. Siç thatë edhe ju, në nivelin e zhvillimit të vendeve tona, natyrisht, ka ndryshime. Mendimi im është se Rumania në të kaluarën ka qenë një vend më i pasur, kurse Shqipëria ka qenë më e varfër dhe shumë gjëra i ka nisur nga e para, i është dashur t'i realizojë në vitet e pushetit popullor. Rëndësi ka çështja që Partia kurdoherë dhe kudo të ketë një vijë të drejtë marksiste-leniniste, e cila t'u përshtatet kushteve të vendit dhe të përputhet plotësisht me interesat, dëshirat dhe aspiratat e popullit. Në vendin tonë, në sajë të vijës së drejtë të Partisë, ndërtimi i socializmit dhe rritja e mirëqenies së punonjësve ecin me hapa të sigurt dhe me ritme të mira, natyrisht, brenda mundësive tona. Cilido mik, sidomos një komunist, është në gjendje ta shikojë drejt këtë zhvillim, kurse një që nuk është mik. për të mos folur pastaj për ata që janë armiq, zhvillimin e një vendi të vogël si ky yni, që ka vuajtur tërë jetën, e krahason me zhvillimin ekonomik të vendit të tij që ka kaluar procesin e zhvillimit të plotë kapitalist. Ky krahasim është i gabuar, sepse për zhvillimin ekonomik të tyre vendet kapitaliste kanë pirë me shekuj gjakun e popujve të tjerë dhe të mirat materiale që janë krijuar ose krijuhen në këto vende, qofshin këto edhe të zhvilluara, nuk kanë qenë as nuk janë për masat punonjëse, të cilat vuajnë, por vetëm për borgjezinë, e cila jeton në bollëk përrallor. Prandaj ne, kur bëjmë krahasime, nuk ha-

rrojmë të kujtojmë të djeshmen e vendit tonë dhe atëherë ndryshimet janë si nata me ditën.

Në vendin tonë, sikurse e keni parë e do ta shihni edhe vetë, në përgjithësi kemi suksese, por kemi edhe të meta e vështirësi. Sukseset nuk janë arritur në qetësi, as nga mëshira e të tjerëve, por me luftë dhe përpjekje. Ndhimën që na është dhënë nga të tjerët, të cilën ne asnjëherë nuk e mohojmë, prej kujt do që të ketë ardhur, kurdoherë e kemi konsideruar si faktor të dorës së dytë dhe të tretë. Kjo është e kuptueshme, sepse ndërtimi i bazave të socializmit është vepër e popullit tonë, i cili ka bërë sakrifica dhe i ka kapërcyer me heroizëm vështirësitë. Populli bën çdo sakrificë, duron çdo privacion, kur e ndien dhe e kupton se të gjitha këto i bën për interesin e vet. Prandaj Partia jonë ka punuar e punon që populli të shikojë dhe të kuptojë se ato që krijon vetë me duart dhe me djersën e tij, janë për të, për të mirën e tij, pasi kështu ai mobilizohet e punon më shumë e më mirë, kapërcen vështirësitë me vendosmëri dhe frytet e punës, ato që ai ka krijuar vetë, i ruan më mirë.

Ndërsa në regjimet e kaluara të vendit tonë, pronat shtetërore ishte e huaj për popullin, ajo shikohej si diçka që medoemos duhej shkatërruar ose përvetësuar. Kjo ishte atëherë një nga format e luftës së klasave. Kurse sot, në rendin tonë socialist, gjithçka i takon dhe i shërben vetëm popullit, i cili punon e ndërton për vete. Te ne kush dëmton pronën, dëmton popullin, sepse rritja e mirëqenies së tij në socializëm varet direkt nga puna për fuqizimin dhe mbrojtjen e pronës së përbashkët.



Ndryshimet që kanë ndodhur në vendin tonë gjatë viteve të pushtetit popullor, janë të mëdha. Por ne jemi marksistë dhe sukseset nuk na vetëkënaqin, përkundrazi, këto suksese na nxitin për fitore të reja e më të mëdha. Gjer tani kemi mëkëmbur industrinë, të cilën po e zhvillojmë më tej. Socializmi ka bërë të mundur që edhe bujqësia jonë, e cila në të kaluarën ka qenë shumë e prapambetur, të ecë përpara. Ne kemi arritur ta modernizojmë atë, natyrisht gjer në njëfarë shkalle, dhe përpiqemi vazhdimisht në këtë drejtim, mbasi jemi akoma larg asaj që duam të arrijmë. Populli ynë e kupton se çështja e bujqësisë është kapitale, se shfrytëzimi i të gjitha mundësive në bujqësi është një problem shumë i madh që nuk mund të arrihet me një të vërtitur të kyçit, por kërkon një punë jashtëzakonisht të madhe.

Vendi ynë ka një perspektivë të mirë për rritjen e rendimenteve të produkteve bujqësore. Garancia më e madhe për arritjen e rendimenteve të larta është puna e fshatarësisë sonë, e cila e përqafton shumë shpejt të renë, përparimin.

Bujqësia nuk mund të përparojë pa ecur në rrugën leniniste të kolektivizimit, e cila është e vetmja rrugë që duhet ndjekur për ta futur fshatin në rrugën e socializmit. Ne vazhdimisht marrim masa ta përmirësojmë dhe ta zhvillojmë më tej bujqësinë socialiste në këtë rrugë, kurse shumë nga vendet që i thonë vetes socialiste nuk veprojnë kështu. Disa prej tyre nuk e kanë filluar fare kolektivizimin, disa të tjerë vërtet e nisën dhe kolektivizuan një pjesë të bujqësisë, por tani janë kthyer prapa dhe janë duke

e shkallmuar. Kështu po ndodh edhe në Bashkimin Sovjetik.

Braktisja e rrugës së kolektivizimit të bujqësisë socialiste është e mbarsur me pasoja të rënda. Këtë na e provon tragjedia që ndodhi në Bashkimin Sovjetik ku vuajnë edhe për bukë, prandaj kërkojnë drithë nga imperialistët amerikanë. Kur Bashkimi Sovjetik ishte në rrugë të drejtë, nuk ka pasur të tilla vështirësi, kurse tani pas 49 vjetësh që ka bërë revolucionin proletar, ka mungesa të mëdha edhe për bukën e gojës, që është ushqimi kryesor i domosdoshëm.

Ne gëzohemi për çdo përparim që arrin Rumania. Këtë e them sinqerisht edhe për arsye se traditat e miqësisë midis popullit rumun dhe popullit shqiptar janë të lashta. Këto tradita të mira nuk duhet t'i fshijmë, por t'i ruajmë e t'i forcojmë. Pastaj janë vetë popujt që duan t'i zhvillojnë traditat e miqësisë edhe po të mos duam unë dhe ti, sepse traditat nuk fshihen<sup>1</sup>.

Partia dhe populli ynë dëshirojnë që lidhjet miqësore midis dy popujve tanë të zhvillohen më tej në rrugë të drejtë. Për këtë, natyrisht, duhen bërë për-

---

<sup>1</sup> Traditat e miqësisë së popullit tonë me atë rumun janë të lashta. Patriotët shqiptarë të Rilindjes sonë Kombëtare, që luftonin me pushkë e me pendë kundër armiqve të për-bashkët, pushtuesve turq, gjetën në ato kohë pritje të ngrohtë dhe përkrahje në Rumani, ku zhvilluan një aktivitet të dendur politiko-letrar. Këto tradita të miqësisë u forcuan më tej atëherë kur dy popujt, pas fitores mbi fashizmin, hynë në rrugën e ndërtimit të socializmit.

pjesje të zgjidhen disa mosmarrëveshje që ekzistojnë midis nesh dhe kjo mund të arrihet vetëm në rrugën marksiste, që është rruga më e drejtë. Jashtë kësaj rruge ato nuk ka si të ndreqen, ose mund të arrihet në një ndreqje të përkohshme e të paqëndrueshme, gjë që nuk është në interes të miqësisë së popujve tanë, ajo mund të jetë, si të thuash, një *modus vivendi*, prandaj Partia jonë kurdoherë është përpjekur, përpiqet dhe do të ecë në këtë rrugë edhe për forcimin e miqësisë dhe të unitetit me popullin rumun.

Me rastin e takimit tonë, shoku ambasador, doja t'ju thosha diçka, të cilën ju lutem t'ia transmetoni udhëheqjes suaj.

Pikësëpari, dëshiroj t'ju them se me miqtë, ashtu edhe me armiqtë, në bazë të mësimëve të marksizëm-leninizmit, Partia jonë kurdoherë ka folur hapur. Armiqtë na kanë quajtur dhe na quajnë «brutalë», «pa takt», «pa diplomaci». Diplomaci ne bëjmë, por kur duhet e me kë duhet, por jam i mendimit se mikut, nën pretekstin e diplomacisë, nuk i duhet lënë të vrasë mendjen si e qysh e me ç'kuptim e tha tjetri këtë ose atë çështje. Është mirë që midis miqve çdo gjë të thuhet haptazi, sepse kjo është rruga më e drejtë. Kështu kemi vepruar në kurdoherë edhe me ju, shokët rumunë.

Unë nuk kam pasur rastin të takohem ndonjëherë me shokun Çausheku, por disa herë jam takuar me shokët Georgi Dezh, Emil Bodnarash dhe Kivu Stoika, me të cilët kam biseduar haptazi, pavarësisht

se nuk kemi qenë kurdoherë dakord për probleme të ndryshme me njëri-tjetrin<sup>1</sup>.

Çfarë desha t'ju them, shoku ambasador? Shokët Çausheku dhe Kivu Stoika, kur ambasadori ynë i ri bëri takim me ta, patën mirësinë t'i thoshin që të më transmetonte mua ftesën për të bërë një vizitë në Rumani, në formën që do ta doja unë, zyrtarisht ose privatisht, qoftë edhe për pushime. Kjo është një gjë e mirë, një gjest miqësor, për të cilin i falënderoj këta shokë. Por, pikërisht, lidhur me këtë ftesë, dëshiroj sot t'ju them që t'i transmetoni udhëheqjes suaj në mënyrë shoqërore pikëpamjen tonë. Partia jonë mendon që akoma nuk janë pjekur momentet për vajtjen time në Rumani.

Përse e them këtë?

Së pari, unë kam shkuar disa herë në Rumani, edhe zyrtarisht, edhe jo zyrtarisht. Shoku Mehmet Shehu, kryetar i Qeverisë sonë, gjithashtu ka qenë atje. Por gjatë një periudhe prej shumë vjetësh, përpara se të ndodhnin mosmarrëveshjet, asnjë nga udhëheqësit rumunë nuk ka ardhur në Shqipëri. Këtë ne nuk e kemi bërë çështje, përkundrazi as që e vinim re, sepse në ato kohë normale, për ne reciprociteti nuk kishte ndonjë rëndësi të dorës së parë, megjithëse edhe ky ka rëndësinë e vet, sepse edhe midis miqve ka detyrime reciproke.

Së dyti, gjatë viteve të fundit, siç e dimë, kanë ndodhur shumë ngjarje. Nuk dua të hyj në to, por dëshiroj të theksoj se Partia dhe Qeveria jonë, gjatë

<sup>1</sup> Shih: Enver Hoxha. «Hrushovianët», f. 241.

këtyre momenteve, kanë qëndruar korrektë ndaj Partisë Komuniste të Rumanisë, udhëheqjes së saj dhe popullit rumun dhe nuk i kanë atakuar asnjëherë. Kurse udhëheqja rumune, me Georgi Dezhin në krye, e ka pasë sulmuar hapur Partinë tonë. Këtë gabim e ka njohur udhëheqja e partisë suaj dhe na e ka shprehur nëpërmjet shokut Emil Bodnarash, por edhe vetë shoku Çaushesku ia ka thënë këtë gjë ambasadorit tonë.

Një parti, që ka respekt për veten e saj, duhet në çdo rast t'i njohë fajet dhe gabimet e veta. Njohjen e këtij gabimi nga ana e udhëheqjes së partisë suaj ne e gjykojmë të drejtë. Por, në qoftë se unë botërisht do të shkoja në Rumani, kjo nuk do të ishte e drejtë, sepse pranimi i gabimit është bërë vetëm në mes nesh dhe bota nuk e di që Partia Komuniste e Rumanisë e ka njohur gabimin që ka bërë ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë. Opinioni botëror di vetëm atë që Partia Komuniste e Rumanisë ka atakuar Partinë e Punës së Shqipërisë.

Në këto kushte, sipas pikëpamjes së Komitetit Qendror të Partisë sonë, nuk më bie mua të vete në Rumani, përkundrazi, u bie shokëve rumunë të vijnë në Shqipëri, dhe kjo jo për arsye thjesht reciprociteti, ngaqë unë kam vizituar disa herë me radhë Rumaninë, por kryesisht për arsyen që sapo përmenda. Kjo është njëra anë e çështjes.

Ana tjetër është se edhe për një vizitë të Çausheskut në Shqipëri mendojmë se nuk janë pjekur akoma kushtet. Tani për tani midis nesh kemi mosmarrëveshje, për të cilat duhen bërë përpjekje të shtrohen e të zgjidhen. Sa e si mund të rregullohen këto, koha do

ta tregojë, por ne dëshirojmë që me Partinë Komuniste të Rumanisë të mund të merremi vesh në rrugën marksiste-leniniste. Por, përderisa nuk është bërë një gjë e tillë, mendojmë se vizita e udhëheqësit tuaj te ne nuk do të ishte në interesin e përbashkët të të dyja palëve, sepse në komunikatën që do të botohej medoemos me këtë rast do të figuronte qëndrimi i partisë suaj nga njëra anë dhe ai i Partisë sonë nga ana tjetër, gjë që do të tregonte publikisht se Rumania dhe Shqipëria kanë mosmarrëveshje.

Ju keni qëndrimet tuaja, ato, sipas jush, mund të jenë qëndrime taktike, mund të jenë edhe parimore dhe të bazuara. Por edhe ne kemi qëndrimet tona parimore dhe taktike, të cilat i mbrojmë sepse kemi bindjen e plotë që janë të drejta, marksiste-leniniste.

Të marrim si shembull një çështje, atë të qëndrimit ndaj tradhtarëve revizionistë sovjetikë. Ju e dini ç'dëme na kanë shkaktuar ata jo vetëm neve, por edhe gjithë lëvizjes komuniste. Por partia juaj thotë të mos flitet me emër kundër tradhtarëve revizionistë sovjetikë dhe për këtë qëndrim që mban ajo mund të ketë arsye të thella ideologjike, kurse ne nuk e pranojmë një gjë të tillë, jo për *amour-propre*, as për çështje taktike, por për bindje të thellë ideologjike. Pra edhe në këtë shembull del se midis nesh ka kontradikta.

Si kjo mund të ketë dhe ka edhe çështje të tjera, të cilat lypin kohë e përpjekje që të sqarohen, prandaj Partia jonë mendon se nuk sjell asnjë dobi të dalim me një komunikatë si ajo që thashë.

Por si do të bëhet atëherë? Ne duam të jemi

miq, ne duam ta forcojmë miqësinë. Nga ana tjetër, palët tona kanë secila pikëpamje që nuk pajtohen me njëra-tjetrën. Ne mendojmë se, që të zgjidhet drejt ky problem, duhen sqaruar pikëpamjet përpara se të arrijmë të shkëmbejmë delegacione partie, qofshin këto zyrtare ose private.

Por një delegacion rumun jo partie, por qeveritar ose parlamentar, do të mirëpritej në vendin tonë. Ai mund të flasë në Shqipëri lirisht për vijën e Partisë Komuniste të Rumanisë. Kurse një delegacion shqiptar i po kësaj natyre, po të vijë në Rumani, nuk do të mund të shprehte pikëpamjen e Partisë së vet, në një kohë kur në opinionin botëror ne flasim haptazi, botërisht, kundër revizionizmit modern. Kjo do të shkaktonte që bota të thoshte se shqiptarët vërtet shkuan në Rumani, por rumunët nuk i lejuan të flasin. Për sa u përket ndjenjave të miqësisë për popullin tuaj, është e qartë, delegacioni shqiptar do t'i shprehte ato në çdo rast, por politika e Partisë është në radhë të parë, ajo për ne është e paprekshme, prandaj, pa i sheshuar këto gjëra, është e zorshme të arrihet në këmbimin e delegacioneve me karakter partie.

Atëherë si do të bëjmë?

Mundësi duhet të krijojmë. Për shembull, në Shqipëri kemi shokun ambasador rumun dhe në Rumani ne kemi gjithashtu ambasadorin tonë. Përveç kësaj, në Rumani kanë vajtur e mund të venë shokë tanë. Edhe në Shqipëri mund të vijnë shokë të udhëheqjes rumune për të parë Shqipërinë dhe për të biseduar për një, dy ose tri probleme. Mund të qëllojë që për disa probleme të mos merremi vesh lehtë, por

me durim dhe në rrugën marksiste-leniniste çdo gjë mund të zgjidhet. Përderisa midis nesh ekzistojnë mosmarrëveshje, të cilat nuk mund të mos i shohim, Komiteti Qendror i Partisë sonë mendon se duhet punuar akoma për zgjidhjen e tyre, se vetëm kështu forcohet më shumë miqësia, të cilën ne e kuptojmë vetëm në frymën marksiste-leniniste.

Dëshiroj që mendimet tona t'i transmetohen udhëheqjes suaj, prandaj nuk di në më kuptuat, shoku ambasador. Unë nuk kam dyshim se ju, si ambasador me eksperiencë dhe anëtar i vjetër partie, më kuptuat, por e theksoj se dëshiroj që udhëheqja juaj ta ketë të qartë pikëpamjen e Komitetit Qendror të Partisë sonë.

Këto kisha për të thënë. Ju siguroj, shoku ambasador, se Partia dhe populli ynë do të përpiqen në rrugën marksiste-leniniste për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që ekzistojnë në mes nesh dhe për të forcuar miqësinë me popullin dhe me partinë tuaj. Por kjo s'varet vetëm nga ne.

*Në vazhdim të bisedës, ambasadori rumun shprehu bindjen e vet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke thënë se Partia Komuniste e Rumanisë dëshiron unitetin midis vendeve socialiste dhe se midis partive s'duhet të ketë në asnjë mënyrë mosmarrëveshje që të na ndajnë. Pasi vlerësoi lart traditat revolucionare të popullit shqiptar dhe shprehu respektin për Partinë e Punës të Shqipërisë dhe për udhëheqjen e saj, ai kërkoi t'i jepej ndihma e nevojshme për të kontribuar sa më shumë për forcimin e miqësisë në mes të dy vendeve.*

*Si e siguroi ambasadorin se te ne do të gjente gjithë përkrahjen e mundshme, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*



Shoqërisht ju them: Përpiquni të njiheni me vendin tonë. Të njiheni me vendin do të thotë të njiheni me vijën e Partisë sonë, pavarësisht se në të do të gjeni gjëra për të cilat mund të mos jeni dakord. Për ta njohur më thellë këtë, ka dokumente të qarta të Partisë sonë që shpjegojnë gjithë vijën e saj, në të gjitha fushat, që nga krijimi i Partisë dhe gjer më sot.

Për sa i përket luftës ideologjike të Partisë sonë kundër revizionizmit modern, qëndrimet e saj janë kurdoherë të argumentuara, të faktuara. Ato mund të mos jenë të pranueshme e të qarta për të tjerët, por për ne janë të qarta dhe çdo njeri mund të marrë dijeni mbi to.

Këtu ka disa çështje. Le të marrim atë që thatë, dëshirën që ju keni për unitet. Unë nuk dua të hyj në hollësi, por çështja e unitetit është një problem me të vërtetë i madh e parimor, prandaj duhet luftuar nga pozita të drejta si për arritjen e tij, ashtu edhe kundër përçarësve të tij. Ata që e duan unitetin marksist-leninist në lëvizjen komuniste botërore dhe luftojnë për të, duhet të ndjekin rrugën leniniste. Kjo është e qartë për të gjithë komunistët. Për të arritur në unitetin marksist-leninist, për forcimin e lidhjeve midis partive marksiste-leniniste, duhet studiuar me kujdes Lenini, ku do të mësojmë se si ka luftuar ai kundër oportunistëve si Kautski e Bernshtajni me shokë. Këtë luftë Lenini nuk e ka bërë me trëndafila, por në rrugë të vërtetë revolucionare. Vetëm kjo rrugë revolucionare ka dhënë rezultate për krijimin dhe forcimin e unitetit në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Revizionistët modernë çirren gjoja për unitetin

dhe për qëllimet e tyre përdorin dhe emrin e Leninit, duke i shtrembëruar mësimet e tij. Gjersa revizionistët sovjetikë u përpoqën ta bënë Shqipërinë koloni të tyre, gjersa ata përqendruan trupa në kufirin tuaj dhe rumunët që jetojnë në territorin sovjetik i kanë çuar në Siberi, atëherë a mund të themi se qëndrime të tilla janë leniniste? Është e qartë që jo. Prandaj çështja e mbrojtjes dhe e interpretimit të drejtë të mësimëve leniniste për unitetin, e zbatimit të tyre në situatat aktuale të zhvillimit botëror dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare është detyrë e domosdoshme për të gjithë marksistë-leninistët.

Që përpjekjet tona në këtë drejtim të kurorëzohen me sukses, duhet të udhëhiqemi e të mbështetemi në marksizëm-leninizmin. Në këtë rrugë duhet vepruar nga të gjitha partitë, sepse vetëm kështu i bëhet ballë armikut të egër imperialist dhe jo siç kanë bërë socialistët e Mileranit<sup>1</sup> dhe të Noskes<sup>2</sup>. Kjo do të thotë se në radhë të parë duhet pastruar shtëpia.

---

1 A. Mileran (1859-1943). Duke qenë anëtar i Partisë Socialiste Franceze, më 1899 hyri në qeverinë reaksionare të Valdek Rusosë dhe si anëtar i qeverisë e më pas si kryeministër e president i republikës përkrahu dhe ndihmoi politikën shtypëse të borgjezisë. Pjesëmarrjen e Mileranit në qeverinë borgjeze, që ishte shprehje e qartë e politikës së bashkëpunimit klasor me borgjezinë, udhëheqësit oportunistë të Partisë Socialiste Franceze dhe ata të Internacionales II nuk e dënuan. Vetëm Lenini e demaskoi këtë shfaqje të parë praktike të revizionizmit, që tradhtonte haptazi interesat e proletariatit.

2 G. Noske (1868-1946) — Një prej udhëheqësve të Partisë Socialdemokrate Gjermane. Në periudhën e Luftës së Parë

Si është e mundur të kemi ne unitet me revizionistët sovjetikë, që kërkonin të na futnin thikën në zverk? Ne kemi në dorë dokumente që dëshmojnë se ata kanë komplotuar së bashku me imperialistët amerikanë, me monarko-fashistët grekë dhe me revizionistët jugosllavë kundër vendit tonë. Në qoftë se ju kujtohet dhe po t'i keni ndjekur punimet e Kongresit të 4-t të Partisë sonë, do t'ju bjerë ndër mend se sovjetikët u hodhën përpjetë kur ne deklaruaam botërisht për këtë komplot. Megjithëse në atë kohë ne vetëm sa nxorëm në shesh faktin e kurdisjes së komplotit dhe me emër përmendëm vetëm amerikanët, revizionistët jugosllavë dhe monarko-fashistët grekë, kurse sovjetikët që bashkëpunonin me ta nuk i përmendëm fare se kishim akoma shpresa, ata u zemëruan shumë që nxorëm në shesh ekzistencën e këtij komploti, sepse ishin edhe vetë brenda. Por ne as kërcënimet, as veprimtaria e tyre armiqësore nuk na trembën dhe nuk do të na trembin kurrë.

Partia dhe populli ynë për lirinë dhe për të drejtat e tyre do të luftojnë edhe me armë po të jetë nevoja. Po të duan le të sulmojnë imperialistët amerikanë, revizionistët jugosllavë, neofashistët italianë, monarko-fashistët grekë, ose edhe revizionistët sovjetikë tok me ta. Ne kemi vendosur të luftojmë gjer në fund kundër tyre dhe pikërisht për këtë qëllim kemi punuar për ta organizuar ushtrinë, për ta pasur

---

Botërore tradhtoi interesat e proletariatit duke qëndruar në pozita socialshoviniste, kurse pas saj mori pjesë në qeverinë borgjeze si ministër i Luftës.

të fortë dhe të gatshme në çdo kohë, në mënyrë që kushdo që të na sulmojë në truallin tonë, të gjejë varrin. Si mund të mendohet që të bashkëpunojmë me me armiq të tillë?

Çaushesku i tha ambasadorit tonë në Rumani që, në qoftë se do të takohej me shokun Enver Hoxha, do t'i tregonte atij çfarë i ka pasë thënë Brezhnjevi në lidhje me gabimet që janë bërë kundër Shqipërisë. Brezhnjevi ato që ka për të thënë, po të dojë, le t'i thotë botërisht në gazetë. Platformën se si t'i thotë ia kemi dhënë prej kohësh, sepse ashtu i kanë bërë edhe sulmet kundër nesh, botërisht. Por udhëheqësit revizionistë sovjetikë janë armiq, njëkohësisht edhe demagogë.

Udhëheqja sovjetike përpiqet ta shesë veten për udhëheqje të një partie serioze, që gjoja është gati të njohë gabimet e saj. Por a mund t'i njohin hapur revizionistët sovjetikë gabimet që kanë bërë ndaj Shqipërisë ose intrigat e shumta që kanë kurdisur e vazhdojnë të kurdisin akoma kundër vendeve tona e vendeve të tjera? Jo, në asnjë mënyrë, sepse po ta bënin këtë, nuk do të mund të qëndronin dot në fuqi as edhe një ditë.

Të gjithë e dinë se ata bashkëpunojnë ngushtë me imperialistët amerikanë, por nuk dua të zgjatem më për këtë çështje, se do të kemi rast herë të tjera të takohemi dhe të bisedojmë për probleme të tilla.

Ju thatë se situatat që janë krijuar tani, na detyrojnë të gjithëve të mendojmë me kokën e partive tona. Partia jonë e ka treguar këtë pa druajtje në momente shumë të vështira, dhe kundër armiqve të

fuqishëm, të cilët, për të na thyer, s'kanë lënë gjë pa thënë. Përpara thoshin se shqiptarët janë «gramafoni i titistëve», pastaj thanë se «u bënë të sovjetikëve», tani na akuzojnë se qenkemi «gramafoni i Kinës». Nesër kushedi çfarë do të thonë tjetër kundër nesh. Por këto shpifje nuk i ulin prestigjin, dinjitetin dhe pjekurinë e Partisë sonë. Partia jonë ka vetëm një ilamur, marksizëm-leninizmin, dhe përpiqet e do të përpiqet kurdoherë e me të gjitha forcat e saj ta interpretojë dhe ta zbatojë atë drejt e gjer në fund. Kush është dakord me këtë rrugë, ai është mik me ne. Me ata, me të cilët kemi mosmarrëveshje, por që nuk kemi hyrë në kontradikta antagonistë, do të përpiqemi të merremi vesh në rrugën marksiste-leniniste. Me ata, me të cilët kemi hyrë në kontradikta antagonistë, ne nuk kemi si merremi vesh dhe as kemi pasur e as do të kemi frikë prej tyre.

Luftën kundër Hrushovit ne nuk e filluam kohët e fundit, por qysh kur ai u përpoq të realizonte takimin e parë me revizionistët jugosllavë, kur vajti për herë të parë në Beograd, domethënë qysh në vitin 1955. Njihej në atë kohë miqësia jonë e ngushtë me sovjetikët, por ne reaguam, nuk ishim qojle të tyre.

Dikush mund të mendojë se kontradiktat tona me sovjetikët lindën për çështje personale dhe se fajtor për to ka qenë Hrushovi. Kjo nuk është e vërtetë, shoku ambasador, ato kanë lindur për çështje ideologjike shumë të rëndësishme dhe shkaktar për to nuk ka qenë vetëm Hrushovi, por një vijë e tërë në PK të BS. Çfarë ka qenë Brezhnjevi? Ai gjer disa ditë përpara se të rrëzohej Hrushovi, me rastin e ditëlind-

jes së tij, thoshte se Hrushovi ishte shpëtimtari i Bashkimit Sovjetik dhe i paqes botërore. Kështu thoshte edhe Kosigini, prandaj përpjekjet e tyre për të quajtur Hrushovin shkaktar të kontradiktave me ne, janë vetëm mashtrim.

Edhe një herë ju lutem t'i transmetoni udhëheqjes suaj ato që ju thashë. I uroj vendit tuaj suksese dhe juve shëndet e punë të mbarë.

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në kë-  
të takim që gjenden në AQP*

## VEPRIMTARIA E GJYKATAVE TONA VARET NGA PARTIA DHE POPULLI

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

6 shtator 1966

Ne po diskutojmë sot çështjen nëse duhet të ekzistojë më Ministria e Drejtësisë.

Si një vend socialist në dinamizëm, në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit dhe të eksperiencës që kemi fituar, për Ministrinë e Drejtësisë ne sot kemi arritur në disa konkluzione që i konsiderojmë të drejta, në bazë të të cilave do të duhet të marrim masa përkatëse. Duke u nisur nga kompetencat që ka kjo ministri dhe nga detyrat që kryen në rendin tonë

---

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua studimi i Këshillit të Ministrave lidhur me suprimimin ose jo të Ministrisë së Drejtësisë. Mbasi u diskutua gjerësisht ky problem, mbështetur në parimet e marksizëm-leninizmit dhe në kushtet konkrete të vendit tonë, Byroja Politike arriti njëzëri në përfundimin se Ministria e Drejtësisë duhej suprimuar.

socialist, ne gjykojmë nëse duhet ta mbajmë më këtë dikaster apo jo. Dhe nëse duhet suprimuar apo duhet mbajtur, kjo duhet argumentuar mirë. Në qoftë se vendosim të suprimohet ky dikaster, kjo nuk do të thotë se ne hedhim poshtë të kaluarën, domethënë anën pozitive të tij.

Kushtetutën dhe dhënien e drejtësisë në vendin tonë i kemi të vendosura mbi parime të drejta. Në rast se pranohet që Gjykata e Lartë mund të marrë vendime, po për aktivitetin e saj gjyqësor nuk ndërhyjnë dot askush tjetër, sepse vetëm Ministria e Drejtësisë mund ta udhëhiqka drejtësinë, atëherë del se kjo ministri, që është një pjesë përbërëse e Qeverisë, duhet të ketë kompetenca në këtë drejtim. Një shtruarje e tillë e problemit mendoj se atakon legjislacionin tonë, atakon ligjet deri edhe parimet e Kushtetutës.

Ministria e Drejtësisë, gjatë kohës së ekzistencës së vet, natyrisht, ka luajtur rolin e saj pozitiv dhe kjo jo pse në krye të saj ka qenë njëri ose tjetri, por sepse organet e drejtësisë sonë populllore kanë zbatuar vijën e drejtë të Partisë dhe aspiratat e popullit, që janë sintetizuar dhe e përbëjnë atë, sepse, si çdo sektor të veprimtarisë shtetërore, edhe organet e drejtësisë kurdoherë i ka udhëhequr Partia.

Ministria e Drejtësisë ka pasur të drejtë të bënte kontrole e të nxirrte edhe konkluzione për veprimtarinë e gjykatave kur shikonte se kjo ose ajo punë nuk ecte. Në një rast të tillë ajo e kishte për detyrë t'i sugjeronte kryetarit të Gjykatës së Lartë me fakte, se ligji në këtë apo në atë rast, në këtë



apo në atë vendim që ka marrë gjykata nuk është zbatuar drejt. Por përsëri vetëm kryetari i Gjykatës së Lartë do të vendoste nëse duhej prishur ose duhej lënë në fuqi vendimi që atakonte ministria. Sipas udhëzimeve të Komitetit Qendror të Partisë, të gjitha dyert kanë qenë dhe janë të hapëta për çdo njeri apo organizëm shtetëror e shoqëror që të shkojë në Parti të ankohet, të ngrejë probleme, të japë mendime për punën e kuadrove dhe të institucioneve të ndryshme. Këtë të drejtë e ka pasur edhe Ministria e Drejtësisë për gjykatat dhe puna e saj ka dhënë rezultate pozitive për një kohë. Pra, jo vetëm Ministria e Drejtësisë, po edhe çdo organ tjetër shtetëror, Partia dhe Qeveria e këshillojnë të shikojë me vëmendje si është zbatuar ky ose ai ligj, përse është dëmtuar pasuria socialiste, për shembull, në Sharrat e Pukës, si kanë qëndruar gjykatat ndaj këtij rasti etj., etj.

Në rast se mendohet që po u suprimua Ministria e Drejtësisë na u dobësoka diktatura e proletariatit, kjo do të thotë se nuk kuptohet cilat janë funksionet e njerit dhe të tjetrit organ në sistemin e diktaturës së proletariatit. Ministria e Drejtësisë nuk është shtabi i diktaturës së proletariatit. Ky shtab përbëhet nga Partia, nga Kongresi dhe nga Komiteti Qendror i saj. Këto u kanë dhënë direktiva Byrosë Politike, Qeverisë, Presidiumit të Kuvendit Popullor, Gjykatës së Lartë, Ministrisë së Drejtësisë etj. që të veprojnë në bazë të tyre. Pra, koka udhëheqëse e diktaturës së proletariatit te ne është Kongresi i Partisë dhe Komiteti Qendror i zgjedhur prej tij, prandaj nuk ka përse të dobësohet asnjë hallkë e kësaj diktature në qoftë se suprimojmë

një organ të administratës shtetërore siç është Ministria e Drejtësisë.

Të mendosh se gjykatat në bazë dhe Gjykata e Lartë qenkan të pavarura nga kurrkush dhe të thuash, nga ana tjetër, që ato duhet të jenë të varura nga Ministria e Drejtësisë, kjo do të thotë të mohosh drejtimin e Presidiumit të Kuvendit Popullor mbi Gjykatën e Lartë dhe, ca më keq, të mohosh rolin e Partisë për të orientuar korigjimin e vendimeve që merr gjykata, kur ato nuk janë të drejta, të mohosh, pra, rolin e Partisë dhe të Presidiumit të Kuvendit Popullor për drejtimin e sektorit të drejtësisë.

Si duhet t'i kuptojmë kompetencat e Byrosë Politike, të Presidiumit dhe të Kuvendit Popullor?

Në rast se Byroja Politike do të merrte, për shembull, një raport në lidhje me gabime në veprimtarinë e Gjykatës së Lartë, ajo do të kërkonte që çështja të shtrohet në rrugë shtetërore, mbasi kemi shtet dhe bazohemi në ligje. Prandaj, në një rast të tillë, Byroja Politike, pasi shqyrton çështjen, ngarkon ata anëtarë të saj, të cilët janë njëkohësisht edhe anëtarë të Presidiumit të Kuvendit Popullor, që, kur të venë në mbledhje të Presidiumit, mbasi të kenë folur më parë për vendimin e Byrosë Politike me kryetarin e Presidiumit, që është edhe ai anëtar i Komitetit Qendror, në emër të Byrosë, ta shtrojnë çështjen në Presidium, ku merret vendimi përkatës për punën e gjykatës. Është Presidiumi i Kuvendit Popullor ai që ka të drejtë të thërresë drejtuesit e Gjykatës së Lartë në raport dhe t'u kërkojë atyre llogari për punën, për rastet kur nga ana e tyre janë shkelur ligjet etj. Presidiumi ka,

gjithashtu, të drejtë, po ta gjykojë të arsyeshme, të thërresë mbledhjen e Kuvendit Popullor, të cilit t'i raportojë se Gjykata e Lartë ka shkëlur ligjet, ka cenuar kështu interesat e shtetit të diktaturës së proletariatit dhe, në varësi nga shkalla e gabimit, ka të drejtë t'i propozojë Kuvendit që të merren masat përkatëse. Vendimin e merr pastaj Kuvendi Popullor.

Në bazë të frymës së Partisë dhe të Kushtetutës, të ligjeve të pushtetit popullor socialist, dhe duke përfituar nga mësimet e Leninit dhe nga eksperiencia e Bashkimit Sovjetik të kohës së Stalinit, këtyre organeve, domethënë gjykatave në bazë dhe Gjykatës së Lartë, ligji u ka dhënë kompetenca, të cilat ato kanë të drejtë dhe janë të detyruara t'i zbatojnë.

Ne kemi sanksionuar në Kushtetutë dhe kjo është e drejtë, që gjykatat të jenë të pavarura në vendimet që marrin për gjykimin e çështjeve konkrete. Por dihet se Gjykata e Lartë zgjidhet nga Kuvendi Popullor, ashtu sikurse zgjidhen edhe organet e tjera të tij. Edhe gjykatat në bazë nuk i ka zgjedhur Ministria e Drejtësisë, por populli, prandaj nuk mund të thuhet se gjykatat janë të pavarura dhe të papërgjegjshme edhe nga ata që i zgjedhin. Asnjë nga ne nuk është i pavarur përpara Partisë dhe popullit. Kushtetuta e ka zgjedhur drejt raportin midis të zgjedhurve dhe zgjedhësve.

Pa kujdesin e Partisë gjykatat mund të bëhen fare lehtë organe represive ndaj popullit. Dihet si bëhen te ne ligjet, të cilat organet e drejtësisë janë të detyruara t'i zbatojnë. Në veprimet e gjykatave nuk mund të ndërhyhet në rrugë të padrejta, por parimi i pava-

rësisë së gjykatave duhet të kuptohet drejt. Edhe këto organe kurdoherë janë e duhet të jenë nën kontrollin dhe drejtimin e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe frymëzohen prej saj. Kjo do të thotë se gjykatat tona janë nën kontrollin e ligjeve të shtetit dhe të Partisë, prandaj veprimtaria e tyre nuk varet nga Ministria e Drejtësisë, nuk varet nga asnjë organizëm tjetër, por nga gjithë Partia dhe populli.

Ne themi vija e masave mbi të gjitha, opinioni i përpunuar nga Partia mbi të gjitha. Nga këto parime nuk bëjnë përjashtim as vendimet e gjykatave. Në goftë se kjo që thotë Partia nuk do të kuptohej drejt e nuk do të veprohej kështu në praktikë, atëherë parimi i vijës së masave do të mbetej vetëm një shprehje e thatë, pa vlerë. Gjykatat në rrethe e në bazë nuk janë të pavarura nga vija e Partisë. Gjykatësin, kur ta shohë të nevojshme, mund ta thërrisë dhe duhet ta thërrisë sekretari i Partisë, apo kryetari i komitetit ekzekutiv i rrethit dhe këta t'i shpjegojnë atij, për shembull, situatën që ka krijuar në Parti dhe në popullin e rrethit një ngjarje e hidhur kriminale që mund të ketë ndodhur dhe cili është opinioni i Partisë dhe i popullit për këtë ngjarje. Nuk mund të mendohet kurrë që gjykatat tona, njerëzit e popullit dhe të Partisë të mos influencohen nga opinioni publik, nga opinioni i Partisë, se ato nuk jetojnë jashtë shoqërisë. Gjersa gjykatësi pranon që në gjykatat tona të dëgjohet zëri i një dëshmitari, dhe kjo është e detyrueshme me ligj, atëherë ca më shumë këto organe janë të detyruara të dëgjojnë, në radhë të parë, zërin e gjithë masës dhe, mbi të gjitha, zërin e Partisë. Pi-

kërisht në bazë të këtij opiniononi të shëndoshë gjykatësi mund dhe duhet të vendosë drejt e në mënyrë revolucionare. Kjo do të thotë që gjykatësi të dëgjojë ç'thotë masa dhe njëkohësisht të ketë parasysh ligjet, që në përgjithësi janë të drejta, dhe që te ne nuk mbrojnë interesa të tjera, veç atyre të masave punonjëse.

Nuk përjashtohet që ndonjë ligj edhe të mos jetë i plotë, po këtë mangësi gjyqtari duhet ta vërtetojë pikërisht me opinionin e Partisë dhe të masave. Një gjyqtar me partishmëri të lartë, pasi të dëgjojë me vëmendje opinionin e masave dhe të Partisë, do të merrte kurdoherë vendim në përputhje me frymën e Partisë dhe me interesat e popullit, edhe në rast se ligji mund të ketë ndonjë boshllëk. Ai pastaj menjëherë do të shkonte të raportonte në Parti për vendimin që mori, por njëkohësisht do të vinte në dukje edhe disa pasaktësi që sheh në ligj, për të cilat bën sugjerime si duhen ndrequr, do t'i drejtohej për këtë qëllim bile edhe Presidiumit të Kuvendit Popullor, edhe Qeverisë, për t'u bërë korrigjimi i nevojshëm dhe do t'ua argumentonte këtyre instancave të larta mendimet e tij. Ky është kontrolli i parë vendimtar i masave që nuk e zëvendëson dot as Ministria e Drejtësisë, edhe sikur kjo të kishte kompetenca më të mëdha, as Gjykata e Lartë, as Presidiumi i Kuvendit Popullor, bile as edhe Komiteti Qendror i Partisë.

Kur kryhet një veprim i dënueshëm me ligj, gjykatat nuk kanë si japin një gjykim të drejtë për shkallën e fajit pa e shqyrtuar çështjen. Kur del nevoja pyesin edhe Partinë, kërkojnë ndihmën e saj dhe ajo

ua jep mendimin për këtë çështje. Edhe Gjykata e Lartë, gjersa ka të drejtën e shqyrtimit të ankimit në shkallë të dytë, nuk mund të privohet nga e drejta për të vajtur në bazë që të kontrollojë, të ndihmojë, të orientojë dhe të frymëzojë gjykatat me vijën e Partisë. Në qoftë se Gjykata e Lartë nuk e ka bërë një gjë të tillë gjer tani, mendoj se ka lënë mangut detyrat që i janë ngarkuar.

Vendimet që marrin gjykatat në rrethe, përveç kontrollit nga Gjykata e Lartë, janë edhe nën kontrollin e Presidiumit të Kuvendit Popullor, i cili ka të drejtë të falë një të dënuar me heqje të lirisë, të falë jetën e një të dënuari me vdekje etj. dhe parimisht kjo është e drejtë. Kongresi i Partisë, Komiteti Qendror, Kuvendi Popullor dhe Kushtetuta ia kanë dhënë këtë të drejtë të madhe Presidiumit të Kuvendit Popullor.

Për veprimtarinë e gjykatave ekziston opinioni i Partisë dhe i pushtetit. Janë bërë kërkesa, janë ndryshuar gjer edhe dekrete nga Presidiumi i Kuvendit Popullor kur kanë pasur të bënin me veprimtarinë e gjykatave, mund të jenë bërë edhe gabime, por përgjithësisht është pozitive se megjithatë çështjet nuk kanë mbetur pa u zgjidhur. Shumë prej tyre i kanë zgjidhur Partia dhe Qeveria pa shkuar fare në Presidiumin e Kuvendit Popullor. Pastaj vetë gjykatat kanë qenë të arsyeshme. Ato, duke vepruar si organe revolucionare, nuk kanë lënë që këto çështje të zgjidheshin në kundërshtim me ligjet, me Kushtetutën.

Por, pa shkelur kompetencat, shumë çështje i kanë zgjidhur jo vetëm gjykatat, nëpërmjet konsultimeve

me njëra-tjetrën, por edhe Presidiumi i Kuvendit Popullor, ku anëtarë jemi edhe ne që na kanë zgjedhur Partia e populli dhe ku merren vendime kolegjiale. Në qoftë se, nga një studim i kryer nga ana e Partisë, rezulton se një kriminel, një vjedhës apo dëmtues i pasurisë socialiste etj. nuk goditet në masën e duhur, atëherë ne vijmë në Presidiumin e Kuvendit Popullor dhe kërkojmë nga organet e drejtësisë përse po ndodhin këto gjëra, përse gjykatat po tregohen të buta etj. Pastaj Presidiumi i Kuvendit Popullor u jep orientim organeve të drejtësisë.

Natyrisht, Presidiumi duhet ta bëjë më mirë këtë punë. Për këtë qëllim ne duhet t'i japim edhe disa kuadro të tjerë që t'i ushtrojë si duhet kompetencat që i janë dhënë. Por këto kompetenca nuk duhet të jenë të atilla që t'u zënë frymën gjykatave, ashtu sikurse kompetencat e Komitetit Qendror ose të Qeverisë nuk duhet t'u zënë frymën respektivisht komiteteve të Partisë dhe komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve. Prandaj Presidiumi i Kuvendit Popullor duhet të ketë kujdes që të ruajë esencën e ligjeve dhe të Kushtetutës në bazë të metodës së kontrollit dhe të verifikimit.

Të drejtë të kontrollojë ka edhe Qeveria. Po si? Kur themi Qeveria, nuk kuptojmë vetëm Ministrinë e Drejtësisë, por gjithë anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe, në radhë të parë, Kryeministrin. Brenda ligjeve dhe në bazë të vijës së Partisë, kur Qeveria konstaton se gjykatësit bëjnë lëshime, ajo nuk duhet dhe nuk mund të qëndrojë indiferente, po vepron me të gjitha kompetencat që i jep Partia, jo vetëm si institu-

cion në tërësi, po edhe nëpërmjet çdo anëtar i saj, veç e veç. Ajo ndihmohet për këtë qëllim nga të gjithë punonjësit, duke filluar nga hetuesi. Po kjo nuk mjafton. Qeveria që ka syrin kudo, mund të shohë se në këtë apo në atë rast plani nuk po realizohet, se në këtë apo në atë sektor ka këto të meta apo shpërdorime, prandaj këto i ngre, i bën probleme. Kur një anëtar i Qeverisë konstaton, për shembull, se disa detyra nuk realizohen, mbase për arsye se edhe puna e Partisë nuk ecën si duhet, se aty-këtu ka fenomene negative që bëhen pengesë, çështjen ia referon Qeverisë, e cila e shqyrton problemin dhe propozon të merren masa edhe nga kjo anë. Këtë punë po e bëjnë ditë e natë si Qeveria ashtu edhe anëtarët e saj dhe mendoj se e bëjnë shumë mirë. Kështu ata respektojnë vijën e Partisë dhe nuk dalin jashtë formave të caktuara, megjithatë kush i ka ndaluar, për shembull, anëtarët e Qeverisë që të venë t'u flasin qoftë edhe në mënyrë shoqërore shokëve të drejtësisë? Kryeministri edhe në mbledhje të Qeverisë mund t'u bëjë vërejtje drejluesve të organeve të drejtësisë, kur ndonjë vendim që merret prej tyre nuk është i bazuar.

Qeveria lidhet me gjykatat edhe në forma të tjera. Për shembull, kur hetuesia konstaton se gjykata një fajtor e dënon lehtë, ta zëmë me pesë muaj heqje të lirisë, kur duhet dënuar më shumë, atëherë këtë vërejtje, nëpërmjet dikasterit të saj, ia bën të ditur Qeverisë, e cila njofton organet përkatëse eprore, se filan gjykatës nuk po punon mirë. Ja, pra, një formë kontrolli e Qeverisë për gjykatat. Në qoftë se merr



përsëri një raport të njëllojtë për një rast analog, atëherë Kryetari i Këshillit të Ministrave mund t'i drejtohet edhe Byrosë Politike, edhe Presidiumit të Kuvendit Popullor, të cilit i jep drejtpërsëdrejti edhe mendimin e tij për këto raste. Është e vërtetë që ne nuk kemi kryer studime për drejtësi, por kemi 25 vjet që merremi me zbatimin e politikës së drejtë të Partisë, aprovojmë edhe ligje, prandaj shkolla 25-vjeçare e Partisë, që kemi bërë ne, nuk mund të krahasohet as me disa fakultete juridike.

Lidhja e veprimtarisë së organeve të drejtësisë me Qeverinë, me organin më të lartë ekzekutiv dhe urdhërdhënës, nuk varet pra vetëm nga një formalitet që është në konformitet me parimin që kemi vendosur në zbatimin dhe në kontrollin e drejtësisë sonë. Pavarësia e gjykatave nuk do të thotë pavarësi nga populli dhe nga Partia, prandaj kjo nuk e bën asnjëri të mbyllë sytë në zbatimin e drejtë të ligjeve nga ata që janë ngarkuar me këtë punë.

Gjykatat e rretheve varen nga Gjykata e Lartë, prandaj kjo ka të drejtë të kontrollojë çdo vendim të tyre. Duke pasur të drejtën e shqyrtimit të rekursit, ajo ka të drejtën të futet edhe në çështjet më të hollësishme të gjykatave. Në qoftë se për të zbatuar këtë të drejtë Gjykatës së Lartë do t'i duhen edhe disa kadro, atëherë t'ia japim edhe këta.

Për sa i përket avokatisë prej kohësh kam qënë i mendimit që ky institut të suprimohej. Këmbron avokati te ne? Në esencë te ne parashikohet që drejtësia popullore të mbrojë fill e për pe interesat e popullit, pa harruar edhe interesat e atij që gjykohet.

Kur është kështu, përse të lëmë ne avokatë të tillë si Suat Asllani ose Koço Dilo që, në kundërshtim me provat, me ligjin, me interesat e Partisë e të popullit thërresin në gjyq që hajduti është «i ndershëm», që vrasësi është «i pafajshëm»? Ç'i duhen drejtësisë njerëz të tillë? Në Perëndim është ndryshe, avokati atje mbron njerëz që politikisht dhe ekonomikisht janë të shtypur nga pushteti borgjez. Kushdo e di se Partia çështjet, bile probleme shumë më të rëndësishme e delikate, i zgjidh pa avokat. Atëherë, gjersa në gjykatat tona kemi organizatë dhe njerëz të Partisë, të vendosur e të ndërgjegjshëm, të drejtë dhe objektivë për të zbatuar drejtësinë popullore, përse është e domosdoshme të kemi avokatë? Këta të fundit një kriminel, për shembull, edhe kur faji i tij është i provuar katërcipërisht, përpiqen ta nxjerrin të pafajshëm. Pra nuk veprojnë drejt. Kur është rasti për të marrë parasysh rrethanat lehtësuese në një vepër të kryer, ose kur provat nuk janë të mjaftueshme për të provuar fajësinë, këtë gjë e bën vetë gjykata jonë popullore, njerëzit tanë të drejtësisë, të cilët, duke e gjykuar çështjen me frymë partie dhe me ndërgjegje të pastër, mund të vendosin t'i jepet një dënim më i lehtë një njeriu ose ta deklarojnë të pafajshëm atë kur provat nuk janë bindëse. Atëherë përse të dëgjojmë në gjykatat tona zërin e avokatëve, midis të cilëve edhe ata që përmenda?

Në vendet borgjeze, për shembull, në Francë, ligjet përbëjnë një pyll të madh. Atje është në fuqi Kodi i Napoleonit, po në fuqi atje ka akoma edhe shumë ligje të tjera të hartuara shekuj më parë, nga ata

të shekullit të 16-të e 17-të. I pandehuri në Francë s'ka si të ketë dijeni për të dalë nga ky pyll i dendur i këtyre ligjeve, që të jetë në gjendje të mbrohet e të shpëtojë nga akuza.

Sa ndryshe është gjendja në vendin tonë! Ne luftojmë, së pari, që ligjet të jenë sa më të thjeshta. Për njohjen e tyre, që të kuptohet esenca nga të gjithë njerëzit bëhet propagandë e madhe. Te ne bëhen, gjithashtu, përpjekje për ngritjen politike dhe ideologjike të masave. Plus gjithë këtyre, Partia i rekomandon edhe gjykatës që këtë ose atë ligj ta zbatojë në mënyrë revolucionare, pra, me drejtësi të plotë në interes të popullit. Të gjitha këto avantazhe nuk ekzistojnë në regjimet borgjeze, ku është i justifikuar instituti i avokatisë. Megjithatë ne mund ta studiojmë edhe këtë çështje, po e logjikshme është që të gjykohej në këtë mënyrë. Me heqjen e institutit të avokatisë, si institut i mbrojtjes profesionale, ne nuk cenojmë aspak parimin për të drejtën e mbrojtjes që Kushtetuta i njej të pandehurit. Secili ka të drejtë të mbrohet para gjykatës.

Siç doli nga diskutimet, të gjithë jemi dakord që Ministria e Drejtësisë të suprimohet, vetëm duhet menduar ç'organizim do të krijojmë paskëtaj brenda në Gjykatën e Lartë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**ZBATIMI NË JETË I MARKSIZËM-LENINIZMIT  
KËRKON PJEKURI TË MADHE, GUXIM  
DHE SAKRIFICA**

*Nga biseda me ambasadorin e RDP të Koresë*

**7 shtator 1966**

*Pasi i uroi ambasadorit korean mirëseardhjen dhe e pyeti për shëndetin e tij, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Megjithëse është e para herë që vini në vendin tonë, do të kenë mundësi të njiheni nga afër me realitetin tonë, me masat e punëtorëve dhe të fshatarëve. Kjo do t'ju shërbejë, me siguri, që të shikoni me sytë tuaj dashurinë vëllazërore që ushqen populli ynë për popullin korean, luftën revolucionare të popullit dhe të Partisë sonë për ndërtimin e socializmit, të njiheni më mirë me sukseset e arritura dhe vështirësitë që kemi.

Ne ndjekim me vëmendje dhe jemi në dijeni për përparimet tuaja, si në bujqësi, ashtu edhe në industri. Nga shtypi juaj kemi mësuar se si po zhvillohen te ju këta dy sektorë me rëndësi, rezultatet e të cilëve me siguri do të ndikojnë në rritjen e mirëqenies së masave.

Do të gëzoheshim sikur, shoku ambasador, të na tregoni vetë për gjendjen ekonomike dhe sukseset e popullit korean.

Për ne viti 1966 mund të themi se është një vit i mirë bujqësor, sidomos për sa u përket drithërave. Edhe në oriz parashikojmë të kemi prodhim të mbarë. Rezultatet e kanë burimin kryesisht te mobilizimi i madh i masave punonjëse, të cilat i kanë të qarta perspektivat e mëdha që u hapi Partia. Këtë vit në vendin tonë ka shpërthyer një hov i madh revolucionar nga ana e Partisë dhe e punonjësve, gjë që ka dhënë rezultate të papara. Në sajë të këtij hovi dhe të besimit në vijën e drejtë të Partisë, krahina të tëra, që gjer tani nuk e kanë siguruar asnjëherë bukën, sivjet do ta sigurojnë.

Ky do të jetë vit fitoresh edhe në sektorin e industrisë e të minierave. Po vazhdon me sukses ndërtimi i veprave të mëdha e të rëndësishme, siç janë uzina e plehrave azotike në Fier, e superfosfatit në Laç, e sodës kaustike në Vlorë dhe i shumë të tjerave, në sajë të mobilizimit total të punëtorëve, të cilët punojnë pa u lodhur për realizimin e detyrave.

Krahas sukseseve kemi edhe vështirësi. Ne e kemi provuar dhe e dimë mirë se rruga drejt socializmit nuk është e lehtë, se armiqtë e jashtëm e të brendshëm do të na luftojnë vazhdimisht dhe me të gjitha mënyrat. Por vështirësitë as na kanë trembur dhe as do të na trembin kurrë, sepse Partia jonë është në pozita të shëndosha marksiste-leniniste, sepse populli ynë është një popull trim e revolucionar dhe lidhjet e Partisë me popullin janë të çeliktë e të pathyeshme. Këta

faktorë kanë qenë vendimtarë që edhe në të kaluarën ne kemi përballuar me sukses, me luftë, me përpjekje e sakrifica çdo vështirësi dhe kemi ecur kurdoherë përpara.

Shqipëria është e rrethuar nga armiq të tërbuar dhe ky rrethim nuk është vetëm gjeografik. Nuk është e lehtë të përballohen e të çahen këto rrethime, por edhe e pamundur nuk është. Ne, si marksistë, e kemi të qartë se në vendet imperialiste e revizioniste vetëm klikat në fuqi janë armiq të tërbuar të vendit tonë, kurse popujt e këtyre vendeve janë me ne. Ata i urrejnë shfrytëzuesit dhe, duke u mbështetur në logjikën marksiste-revolucionare, jemi të bindur se një mëngjes popujt do të shpërthejnë, do të shkatërrojnë klikat në fuqi dhe me këtë do t'u japin fund edhe rrethimeve të organizuara prej tyre kundër nesh. Natyrisht, kjo nuk do të ngjasë në një ditë, por jemi të sigurt se popujt do të fitojnë, revolucioni do të fitojë.

Populli shqiptar nuk gëzon vetëm ndihmën e përkrahjen e popujve që ka rreth e përçark, por edhe të të gjithë popujve që luftojnë për çlirim kombëtar e shoqëror. Populli kinez, korean dhe ai vietnamez, i cili po mbron me heroizëm e sakrifica të mëdha lirinë dhe pavarësinë e vet, si edhe të gjithë marksistë-leninistët në botë na kanë ndihmuar ideologjikisht, politikisht dhe moralisht, ashtu siç kemi bërë edhe ne. Politika e drejtë që ndjek vendi ynë ka bërë të mundur që populli shqiptar të gëzojë miqësinë dhe përkrahjen e popujve dhe të marksistë-leninistëve, prandaj ai nuk e ka ndierë dhe nuk do ta ndiejë veten kurrë të izoluar dhe të vetmuar.

Ideologjia revolucionare marksiste-leniniste, e cila është busulla e partive të klasës punëtore, na mëson se një popull dhe një parti, sado të vegjël të jenë, sado armiq të mëdhenj e të fuqishëm të kenë, qofshin këta armiq ideologjikë dhe politikë e me potencial të madh ekonomik dhe ushtarak, nuk mund të mposhten kur qëndrojnë të patundur në parimet e marksizëm-leninizmit. Natyrisht, zbatimi në jetë i marksizëm-leninizmit kërkon pjekuri të madhe, guxim dhe sakrifica. Kush u shmanget parimeve të tij, është e pamundur të ecë në rrugë të drejtë. Partia jonë dhe partitë e tjera marksiste-leniniste e kanë vërtetuar këtë në jetë, prandaj kanë derdhur gjak për mbrojtjen e tyre. Partia dhe populli shqiptar e kanë provuar këtë të vërtetë të madhe në të gjitha situatat e turbullta që kanë kaluar e po kalojnë dhe koha do ta vërtetojë atë përsëri edhe në të ardhmen.

Këtë po e vërteton aktualisht edhe lufta e popullit të Vietnamit. Ajo po provon se popujt nuk mund të mposhten, se çlirimi kombëtar e shoqëror kërkon gjak e sakrifica të mëdha. Qëndrimi i vendosur i popullit vietnamez kundër imperialistëve amerikanë ka fituar dashurinë dhe simpatinë e gjithë revolucionarëve dhe popujve të botës, të cilët bëjnë përpjekje për ta ndihmuar në rrugën e tij të drejtë, në luftën pa kompromis me imperialistët amerikanë, sikurse është pohuar në 4 pikat e qeverisë së Republikës Demokratike të Vietnamit e në 5 pikat e Deklaratës së Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut.

Tani ka forca që po përpiqen ta futin Vietnamin në qorrsokak. Midis atyre që po bëjnë të tilla përpjekje

janë edhe tregtarët e parimeve, revizionistët sovjetikë. Shokët vietnamezë duhet të jenë vigjilentë për të mos rënë në kurthet që po u ngrenë renegatët e Moskës. Ju, shokët koreanë, keni përvojën e synimeve të imperialistëve amerikanë dhe të aleatëve të tyre ndaj vendit tuaj. Por në sajë të luftës suaj të vendosur, në radhë të parë, dhe të ndihmës së aleatëve, të popullit kinez dhe të Partisë Bolshevike me Stalinin në krye, ju luftuat me guxim kundër agresorëve amerikanë, i çuat ata gjer në Pusan. Pastaj u kthyet vërtet gjer në kufi, por, me ndihmën e vullnetarëve kinezë, i çuat përsëri tej paralelit 38 dhe i paralajmëruat që, edhe po ta vazhdonin më tej luftën, nuk do të tërhiqeshit.

Siç thatë dhe vetë, në situatën aktuale ju po bëni përpjekje për mbrojtjen e të drejtave të vëllezërve tuaj të Jugut, domethënë për bashkimin e gjithë Koresë në një shtet të vetëm. Kjo është një aspiratë e ligjshme, që askush nuk mund t'jua mohojë. Ne e kuptojmë mirë se shteti i Koresë së Jugut është pjellë e imperializmit amerikan, i krijuar në bazë të politikës së «shkopit të madh» të presidentit Teodor Ruzvelt<sup>1</sup>, i cili aspironte që imperializmi amerikan të sundonte në Azi. Të njëjtën politikë grabitqare ndjek edhe në rrethanat e sotme imperializmi amerikan.

Është e qartë për të gjithë, dhe veçanërisht për popullin tuaj, që imperializmi amerikan bashkë me militaristët japonezë përpiqen të vendosin sundimin e tyre në Azi dhe t'i futin në një luftë të re popujt e kësaj zone. Imperialistët amerikanë e kanë futur në

---

1 President i SHBA-së nga viti 1901-1909.



luftë popullin vietnamez, por ata përpiqen ta zgjerojnë këtë luftë, duke marrë gjithfarë masash barbare, politike, ekonomike dhe ushtarake në një shkallë të madhe ndërkombëtare.

Për të vendosur sundimin e tyre në Azi, imperialistëve amerikanë dhe militaristëve japonezë u duhet të mposhtin edhe Republikën Demokratike Popullore të Koresë. Për këtë ata po përgatitin terrenin edhe në Korenë e Jugut. Mobilizimi i madh ushtarak që kanë shpallur imperialistët amerikanë në Korenë e Jugut, shtimi i numrit e forcimi i ushtrisë kukull në këtë vend, e cila kuptohet se ka për objektiv kryesor sulmin ndaj Koresë së Veriut, u shërben synimeve të tij për të krijuar një vatër të dytë zjarri në Lindjen e Largët.

Në situatën kur imperializmi amerikan po bën gjithë këto përgatitje për agresion, ne mendojmë se qëndrimet e Partisë sonë dhe të të gjitha partive të tjera marksiste-leniniste ndaj tradhtarëve revizionistë sovjetikë janë të drejta. Të mos flasim për problemet e tjera, për të cilat Partia jonë e ka thënë fjalën e vet botërisht, por edhe në qëndrimin ndaj çështjes suaj duket qartë tradhtia e revizionistëve sovjetikë. Dihet nga të gjithë se ata kanë rënë në kontakt politik dhe kanë bërë gjithfarë tratativash ekonomike jo vetëm me imperialistët amerikanë, por edhe me qeverinë e Japonisë militariste. Ne kemi ndjekur me vëmendje vizitën që ministri i Punëve të Jashtme i Bashkimit Sovjetik bëri në Japoni, si dhe vajtjen e ministrit të Jashtëm japonez në Moskë. Delegacione të shumta, zyrtare, parlamentare etj. po shkëmbehen midis sovjetikëve e japonezëve, kurse qeveritarët revizionistë të Bashkimit So-

vjetik bëjnë propozime për çfarëdolloj marrëdhëniesh ekonomike me qeverinë dhe afaristët japonezë për shfrytëzimin e Siberisë etj. Në një kohë kur sovjetikët flasin shumë për miqësinë me popullin dhe me vendin tuaj, zhvillimi i marrëdhënieve të tilla me imperializmin japonez, i cili mban qëndrime armiqësore dhe kërcënon popullin korean dhe Republikën Demokratike Popullore të Koresë, sipas mendimit të Partisë sonë, është tradhti. Ai që është mik dhe vëlla i sinqertë juaji, kur shikon se vëllai korean ndodhet para një sulmi nga ana e imperializmit amerikano-japonez, nuk ka pse të shkojë në rrugë të kundërt, të ndihmojë armiqët e mikut të vet.

Armiku duhet vëzhguar dhe duhen përgatitur forcat për të zbrapsur çdo agresion të tij, për të përballuar çdo situatë. Ju keni deklaruar botërisht se jeni të vendosur dhe të gatshëm t'i bëni ballë çdo sulmi të armatosur që mund të ndërmarrë ndaj vendit tuaj imperializmi amerikan. Për këtë qëndrim tuajin keni gëzuar dhe do të gëzoni miqësinë dhe përkrahjen e sinqertë të popullit shqiptar, i cili do të jetë kurdoherë me ju në luftën kundër imperializmit.

Disa mund të thonë se miqësia dhe përkrahja e Shqipërisë së vogël nuk ka asnjë rëndësi për Korenë. Ata që nuk kuptojnë dhe nuk vlerësojnë drejt rëndësinë e madhe të miqësisë së sinqertë nuk gjykojnë si marksistë-leninistë, prandaj gabohen. Është më mirë të kesh një mik të vogël, por të qëndrueshëm e besnik, qoftë edhe mijëra kilometra larg, sesa një pseudomik fare afër, në kufi. Ne mendojmë se Partia e Punës e Koresë dhe populli vëlla korean, që i shohin

konkretisht dhe realisht situatat rreth kufijve të vet, duhet të tregohen të kujdesshëm, të orientohen drejt dhe të mbajnë qëndrimet e duhura, për të mos gabuar ndaj kurtheve që i kërcënojnë. Sigurisht kjo është çështja juaj, por ne si internacionalistë e konsiderojmë atë si tonën, ashtu sikurse çështja jonë është njëkohësisht edhe juaja, prandaj çdo mendim që kemi jua themi haptazi, në mënyrë shoqërore.

Ne nuk pretendojmë t'i japim këshilla asnjë partie, sepse kjo nuk ka të bëjë me qëndrimin modest që duhet ta karakterizojë një parti marksiste-leniniste, qoftë kjo e madhe ose e vogël, por si një parti marksiste-leniniste kemi të drejtë të nxjerrim konkluzione dhe këtë të drejtë askush nuk na e heq dot. Në këtë drejtim ne kemi fituar një eksperiencë të madhe. Të gjithë e dimë ç'kanë bërë hrushovianët, titistët, gomulkat dhe të tjerë që të na detyronin të hiqnim dorë nga rruga marksiste-leniniste, e megjithatë të gjitha përpjekjet e tyre kanë dështuar, kurse ne e kemi zhvilluar dhe e zhvillojmë kurdoherë me gjakftohtësi e me durim politikën tonë dhe jeta ka vërtetuar se ajo ka qenë dhe është plotësisht e drejtë.

Marksizëm-leninizmi na mëson se për të provuar që një teori është apo jo e drejtë, kjo duhet të vërtetohet në praktikë. Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini na mësojnë se jo vetëm teoria, por edhe çdo qëndrim duhet të vërtetohet në jetë nëse është apo jo i drejtë. Kjo ka rëndësi edhe në platformën nacionale, edhe në platformën e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Jeta ka vërtetuar se qëndrimet e revizionistëve hrushovianë ndaj Shqipërisë socialiste kanë qenë dhe janë ar-

miqësore dhe antimarksiste. Edhe qëndrimi që mbajnë ndaj vendit tuaj, kur me fjalë hiqen si miq të Republikës Demokratike Popullore të Koresë, kurse në praktikë bëjnë të kundërtën, nuk është marksist, nuk pajtohet me teorinë tonë. Prandaj të gjithë ata që kanë akoma shpresë tek udhëheqja sovjetike dhe orvaten t'i argumentojnë Partisë së Punës të Shqipërisë se hrushovianët nuk janë tradhtarë të marksizëm-leninizmit, gabohen, sepse faktet që janë kryeneçe e provojnë tërësisht tradhtinë e tyre.

Ardhja në fuqi e revizionistëve modernë në një varg vendesh ishte një e keqe e madhe që e dëmtoi rëndë lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe luftën revolucionare të popujve. Por kjo e keqe nuk është e pakapërcyeshme. Partia jonë dhe gjithë marksistët e vërtetë revolucionarë janë të bindur se revolucioni do të fitojë, se marksizëm-leninizmi do të fitojë mbi çdo deviacion e deviator, qoftë ky i vogël ose i madh.

Për të luftuar me sukses imperializmin e revizionizmin është e domosdoshme të forcojmë unitetin midis partive dhe popujve tanë. Miqësia e sinqertë marksiste-leniniste është jetëdhënëse për ne dhe për ju. Partive tona u bie detyra ta kalitin dhe ta forcojnë më tej e vazhdimisht miqësinë që ekziston midis nesh, në rrugën marksiste-leniniste. Nga pala jonë do të keni çdo ndihmë, që edhe ju, shoku ambasador, të jepni kontributin tuaj në këtë drejtim.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

**DETYRA JONË SI PËRFAQËSUES TË POPULLIT  
ËSHTË TË JUSTIFIKOJMË ME PUNË  
BESIMIN E TIJ**

*Fjala në sesionin e parë të legjislaturës  
së 6-të të Kuvendit Popullor*

**10 shtator 1966**

Shokë e shoqe deputetë,

Më lejoni, që në emër të Partisë dhe të Komitetit Qendror, t'ju sjell juve, deputetëve të Kuvendit Popullor, përshëndetjet dhe urimet më të mira për të kryer me sukses detyrat e mëdha e fisnike ndaj atdheut, popullit dhe socializmit.

Fitorja që korri Fronti Demokratik në zgjedhjet e 10 korrikut të këtij viti, ishte shprehja më e qartë e lidhjeve të ngushta të popullit me pushtetin popullor, ishte manifestimi i fuqishëm i unitetit të tij të çeliktë me Partinë dhe vijën e saj marksiste-leniniste. Detyra jonë, e përfaqësuesve të popullit në këtë Kuvend, është që me punën tonë të frytshme të justifikojmë besimin dhe shpresat e popullit tonë, të punojmë me të gjitha

forcat tona për ndërtimin e socializmit, për forcimin dhe mbrojtjen e atdheut.

Në vitet që kaluan brenda legjislaturës së 5-të të Kuvendit Popullor, populli korri shumë fitore, në industri e në bujqësi, në arsim e në kulturë, në mbrojtjen e vendit dhe në forcimin e sovranitetit të atdheut.

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, e kryesuar nga shoku Mehmet Shehu, ka zbatuar me besnikëri vijën e Partisë, ligjet dhe vendimet e Kuvendit Popullor. Ajo ka justifikuar besimin që i ngarkuan përfaqësuesit e popullit në këtë Kuvend, duke drejtuar me sukses punën për realizimin e planit të tretë pesëvjeçar.

Duke vlerësuar kështu veprimtarinë e Qeverisë, Komiteti Qendror i Partisë më ngarkoi t'i propozoj Kuvendit Popullor që për formimin e Qeverisë së re të Republikës Popullore të Shqipërisë, të ngarkohet përsëri shoku Mehmet Shehu, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe i Byrosë së tij Politike, bir besnik i Partisë dhe i popullit.

Komiteti Qendror i Partisë ka besim se edhe në të ardhmen Qeveria, e kryesuar nga shoku Mehmet, do të vërë të gjitha forcat për të realizuar vijën e Partisë dhe detyrat që do t'i ngarkojë Kuvendi Popullor.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 219 (5629), 11 shtator 1966*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## AKSIONET TË SHËRBEJNË PËR KALITJEN REVOLUCIONARE TË RINISË

*Bisedë në takimim me disa nxënës e studentë  
pjesëmarrës në aksionet verore të rinisë<sup>1</sup>*

20 shtator 1966

*Shoku Enver, pasi u takua me të gjithë nxënësit e studentët që erdhën në këtë takim dhe u krijoi atyre qysh në fillim një ambient intim dhe gazmor, tha:*

Puna që bëtë gjatë verës në aksione, e shoh që ju ka përtëritur. Po nuk na thoni si shkuat me punë, si ju duk puna? Kush do të na flasë pak për punën që bëtë ju në aksion?

**PASHKË TARAZHI:** Më lejoni shoku Enver të flas pak.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nga je ti?

**PASHKË TARAZHI:** Jam nga katundi Tarazh i

---

<sup>1</sup> Takimi u bë në zyrat e Komitetit Qendror të PPSH. Morën pjesë në këtë takim 47 të rinj e të reja. Ishte i pranishëm sekretari i KQ të PPSH, shoku Ramiz Alia.

Mirditës, maturante e shkollës pedagogjike «Shejnaze Juka» në Shkodër. Dy vjetët e fundit kam marrë pjesë në aksionet e rinisë dhe kam punuar në kooperativa bujqësore. Kur na dërguan për të punuar në kooperativën e Mjedës në Shkodër, ne u gëzuam, punuam atje dhe u njohëm me të gjithë fshatarët e kooperativës.

Unë, shoku Enver, jam një vajzë jetime. Qysh kur kam qenë 8 muajshe nënën ma vranë diversantët, pikërisht në kohën kur ishte duke u nisur për të shkuar si vullnetare në aksionin e rinisë, në hekurudhë. Jam krenare që tani po ndjek rrugën e saj dhe jap fjalën përpara jush se thirrjes së Partisë do t'i përgjigjem në çdo kohë, kurdoherë që të jetë nevoja dhe do të veproj ashtu siç ka vepruar nëna ime. *(Shoku Enver u emocionua kur kjo vajzë e gjallë, plot energji, po fliste për jetën që dha e ëma për çështjen e Partisë dhe të popullit.)*

**ELI NIKOLLA:** Unë jam nga Korça, kam punuar në Tërovë ku hapëm kanale në fushën që po bonifikohet. Ishte hera e parë që merresha me një punë të tillë. Jetën kolektive nuk e kisha shijuar ndonjëherë. Aksioni neve na dha forca të punonim mirë qysh ditët e para. Në fillim nuk e realizuam dot normën, por pasi u mësuam, vetëm pas tri ditësh, jo vetëm e realizuam, po gradualisht filluam ta tejkalonim normën çdo ditë e më shumë.

Gjatë kohës që punuam në këtë aksion ne kaluam shumë mirë me fshatarët. Përshtypjet që ne u lamë atyre janë shumë të mira. Çdo ditë zhvillonim biseda shumë të vlefshme me ta, shkonim në familjet e tyre



dhe ndihmonim në punët e shtëpisë. Pastaj me fshatarët zhvilluam edhe shumë aktivitete, për shembull, bëmë një marshim me variante taktike në Malin e Thatë, bëmë edhe qitje me pushkë. Unë jap fjalën këtu, përpara jush, se përsëri do të vete në aksion dhe, kur të kem kryer shkollën e të dal në punë, do të shkoj të punoj deri në skajet më të largëta, kudo ku ta dojë interesi i atdheut.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shikoni, vajzat janë më përpara nga djemtë, janë në sulm. Ndonjë djalë nuk do të na flasë?

*ASIM BEDALLI:* Unë jam student në Universitetin Shtetëror, ndjek Fakultetin e Historisë e të Filologjisë. Aksioni për ne u bë një tjetër universitet, me plot kuptimin e fjalës, u bë një shkollë e vërtetë revolucionare. Shumë nga studentët thanë se në Jonufër, siç quhet vendi në Ujin e Ftohtë të Vlorës ku punuam, morëm një diplomë të dytë. Ne nuk punuam dot që në fillim mirë, u ndodhëm përpara vështirësish, nuk njihnim ç'ishte realizimi i normës që na ishte caktuar. Disa, pa e provuar akoma mirë, thoshin se ne nuk e realizojmë dot normën; por kjo ndodhi vetëm ditët e para, se shoqët e shoqet tona filluan shpejt të mësohen me punën dhe t'i kapërcejnë vështirësitë. Nga puna filluan të na bëhen kallo në duar qysh ditët e para, por ishim të kënaqur për punën që bënim, duke menduar se në tokën që punonim, do të mbilleshin ullinj, portokalle, fiq e vreshta. Ne duam të vemi përsëri në aksion dhe të tregojmë se jemi të zotë edhe për punë, edhe për pushkë e jo vetëm për mësim. Pasditeve ne bënim edhe stërvitje ushtarake, pra, në një kohë mbanim në dorë

veç kazmës edhe pushkën, dhe ja tani në shtator, filluam edhe nga mësimi.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shumë mirë, gëzohem shumë për sa më thatë dhe ju uroj për ato që keni bërë. Ne jemi mirë në dijëni të punës që keni kryer, sepse përveç raporteve që na kanë bërë shokët e Partisë dhe të rinisë për këtë çështje, kemi parë edhe një film me aspekte nga aksionet verore të rinisë. Ai ishte shumë prekës dhe mobilizues njëkohësisht, se tregonte trimërinë, zgjuarsinë dhe vendosmërinë tuaj për Partinë dhe për popullin dhe do të vlejë për të edukuar me shembullin tuaj gjithë rininë e vendit tonë, për të vazhduar në këtë frymë punë kaq të mëdha e të frytshme jo vetëm nga ana ekonomike, por sidomos nga ana politike dhe ideologjike.

Kalitja e brezit të ri të Shqipërisë në një rrugë të drejtë revolucionare ka rëndësi të jashtëzakonshme për popullin dhe për Partinë. Ju tani jeni të rinj, po nesër do të futeni në punë, sepse puna është faktori kryesor i mbajtjes së shoqërisë në këmbë. Përpara se t'ju futë në punë, Partia ju armatos që të kuptoni rëndësinë e nevojën jetike të saj. Ka rëndësi të madhe për brezin e ri të vendit tonë që të kuptojë se rruga që ju tregon Partia është e vetmja rrugë e drejtë. Partia tani ju krijon të gjitha mundësitë që të mësoni në shkollë, të kuptoni që shkolla duhet t'ju shërbejë si një armë jo për të përfituar në jetë, mbi të tjerët, por për të luftuar në jetë për të mirën e shoqërisë, gjë që ka rëndësi të madhe. Partia këto mundësi jua ka krijuar sot që të mësoni, në mënyrë që nesër, kur të futeni në jetë, si brezi që do të marrë në dorë gjithë drejtimin e vendit,

të mos ju duket sikur hytë në diçka të panjohur ose të frikshme; prandaj Partia punon që t'ju njohë gradualisht me jetën, me punën, me vështirësitë, me sukseset dhe me të metat e punës sonë. Kjo ka rëndësi të madhe. Pra, krahas mësimit, që edhe ky është një armë për të luftuar në jetë, të arrijmë që ju të mësoni edhe ç'është jeta, ç'është socializmi, ç'do të thotë punë, përpjekje, mundim, djersë dhe fitore. Të gjitha këto nuk duhet t'jua themi vetëm me leksione, por të merrni pjesë edhe vetë në aksione, ku ju do të bashkoni punën mendore me atë fizike. Këtë rinia duhet ta kuptojë në thellësinë e saj dhe ju e kuptoni shumë mirë.

Ne kemi një rini shumë të zgjuar, të vendosur, heroike, të ndershme, por duam që ajo të jetë edhe e kalitur si hekuri në zjarr, të bëhet një armë e fortë në duart e Partisë. Ju të gjithë duhet të kuptoni mirë nevojën e kalitjes, se, kur është njeriu i ri, mundet që vajtjen në aksione të mos e kuptojë si duhet. Ka disa që mund ta kuptojnë si diçka shumë të mirë, por ka edhe të tjerë që e kuptojnë përciptazi, si një shëtitje. Puna është që të kuptoni esencën e kësaj çështjeje, domethënë që bashkë me mësimin është i nevojshëm edhe aksioni, është e domosdoshme edhe puna, sepse kështu çdo gjë do ta kuptoni më mirë. Tani rinia jonë e kupton, kurse këtu e 40 vjet të kaluara, meqë kishim një mur të madh përpara ne nuk e kuptonim, nuk e merrnim dot me mend gjithë këtë perspektivë të madhe që na ka hapur Partia sot dhe nevojën e lidhjes së punës me mësimin. Edhe ashtu siç ishin shkollat atëherë, ne mësonim diçka, ashtu si i mësonim dhe siç ishin ato lëndë, si matematika, kimia, fizika, historia, gjeografia

etj., por nuk shihnim perspektivën, përse na duheshin ato që mësonim. Tani është fakt që ju e keni më të qartë se përse e mësoni matematikën, fizikën ose kiminë dhe formulat e saj, por për ne atëherë perspektivat ishin të mbyllura nga regjimi prapanik i Zogut. Në atë kohë nuk kishin asnjë perspektivë as industria as bujqësia, lëre pastaj kimia ose fizika. Vetëm një gjë ekzistonte në mendjen tonë: të mbaronim shkollën dhe të futeshim në ndonjë punë, ose ndonjëri të përpiquej të merrte ndonjë bursë për të bërë edhe universitet dhe pastaj prapë të hynte në një punë a zyrë. Atëherë, pra, ne nuk mund ta kuptonim siç e kuptoni ju sot, ose sikurse do ta kuptojë ca më mirë akoma brezi i ardhshëm, sa e domosdoshme është shkolla, pa të cilën nuk mund të ecë përpara jeta, shoqëria.

Ju, e kuptoni, e keni të qartë se matematika është një lëndë, pa të nuk ecet, ashtu siç nuk mund të ecet dhe pa gjeometri e fizikë, se po ndërtojmë fabrika, shkolla, hidrocentrale, hekurudha e sa e sa gjëra të tjera e për të gjitha këto duhen inxhinierë. Sot në vendin tonë po ngrihet një industri e madhe moderne kimike dhe kimia sot i duhet çdo fabrike, e cila duhet të ketë kimistë. Në kohën tonë, kur ishim kaq sa ju, ne nuk mund të gjykonim e të mendonim si ju, për arsye se përpara kishim xhandarmërinë dhe spiunët e Musa Jukës, mjerimin e vuajtjet e popullit, kurse tani Partia i ka hapur rinisë sonë perspektiva të gjera mësimi dhe pune. Rinia jonë, qysh në fillim të luftës ka qenë pioniere e ndjekjes me besnikëri të ideve revolucionare të Partisë, ka luftuar, është shkrirë në punë dhe ka bërë vepra të mëdha. Pra, ju e kuptoni tani ç'rëndësi ka pjesëmarrja në

aksione, gjë që nuk duhet parë nga ana romantike, po si një çështje bazë për formimin e kalitjen revolucionare të rinisë sonë.

Pastaj vajtja juaj në të katër anët e Shqipërisë është shumë e mirë, gjithashtu, edhe për faktin se njiheni me përpjekjet e popullit, me sukseset e dëshirat e tij. Edhe këto në kohën tonë ne nuk i njohim, se ishim të mbyllur vetëm në guaskën e familjes dhe rriteshim me pikëpamje mikroborgjeze, ca më tepër fshati për ne ishte një pllakë e zezë. Vuajtjet e fshatarëve këtu e 40 vjet më parë, ne qytetarët, nuk i njohim nga afër. Ju duhet të mos e harroni të kaluarën tonë. Edhe ne nuk e harrojmë. Ju duhet ta dini se përpara gjendja ishte shumë e keqe, kurse tani ajo është krejt ndryshe, tani është e bukur e nesër do të jetë edhe më e bukur. I tillë është dinamizmi i jetës, i zhvillimit ku po e çon Partia vendin tonë.

Ju përsëri do të veni çdo vit në aksione, në fshatra dhe do të shihni sa i bukur është bërë vendi ynë, kudo. Edhe fshati ynë, të mos flasim për qytetin, përparon me shpejtësi. Pastaj sa të ndershëm, sa patriotë, sa të dashur dhe heroikë janë fshatarët tanë! Prandaj marrja pjesë në aksione, juve, nxënësve të shkollës, përveç që ju lidh me punën dhe me jetën e popullit, po ngjall te ju edhe patriotizmin e madh që duhet t'ju frymëzojë vazhdimisht me dashuri të pakufishme për atdheun dhe për popullin, të cilin ju do ta shihni kështu edhe në jetë, edhe në punë.

Ne, rinia e brezit të kaluar, mendonim të rrinim vetëm në qytet, kurse ju nuk e mendoni një gjë të tillë, ju tani thoni se jeni gati të veni ku të ketë nevojë at-

dheu. Shqipëria është e gjitha juaja, e vajzave dhe e djemve të popullit, prandaj edhe ne, po ju sidomos, brezi i ri, do të punoni që të arrihet, në mos plotësisht, po në një shkallë të madhe, të zbutet ndryshimi i madh që ka ekzistuar dhe akoma ekziston në mes qytetit dhe fshatit.

Po si do të arrihet kjo? Kjo do të arrihet kur i gjithë brezi i ri të mendojë qind për qind se Shqipëria nuk është vetëm Tirana, Shkodra apo Vlora. Shqipëria është e gjitha me të gjitha qytetet e fshatrat e saj, me fushat e malësitë, me bregdetin e saj të mrekullueshëm dhe me zonat e thella deri te majat e bjeshkëve tona të larta, me bukuritë e tyre të mahnitshme. Gjithë këtë truall ne do të përpiqemi ta bëjmë të bukur, të lulëzuar, të fortë e pjellor në të katër anët. Këtë dëshirë duhet ta ketë në gjak rinia jonë, në radhë të parë, rinia jonë punëtore, fshatare dhe inteligjencia e re. Sidomos ju, nxënës të shkollave, nguliteni në mendjen dhe në shpirtin tuaj këtë gjë, se Shqipëria është juaja anembanë, prandaj punoni pa u lodhur që ta zbukuroni e ta bëni çdo ditë e më pjellore.

Mos u kënaqni me ato suksese, megjithëse të mëdha, që janë arritur në sektorin e bujqësisë. Ju kudo që shkuat patë shumë gjëra të reja që janë suksese të mëdha për vendin tonë, po këtë pesëvjeçar dhe në tjetrin, të ardhshmin, që ne besoj se do ta jetojmë si të moshuar, kurse ju do të jeni në kulmin e forcave tuaja fizike e mendore, do të bëhen vepra të reja të rëndësishme dhe vetë do të thoni: «Ç'ndryshime kolosale po bën kjo Partia jonë këtu në Shqipëri!». Qysh këtë pesëvjeçar ne do të hapim 115 mijë hektarë toka të reja, kryesisht në

zonat malore e kodrinore. Në pesëvjeçarin tjetër mund të hapen edhe 150 mijë hektarë të tjerë. Këto toka të reja do t'i hapni ju me mendjen dhe me duart tuaja, me mekanizma, me dituri, nën udhëheqjen e Partisë. Kështu do t'i ndërrojmë ne të gjitha malet tona të virgjëra shekullore në toka të bukura pjellore. Aq sa sipërfaqe toke të punueshme kemi tani në fusha, ne duhet të hapim të reja edhe në male, aq sa rendimente marrim sot, këtu, do të marrim edhe në male, medoemos. Edhe në zonat malore ne do të mbjellim misër, patate, do të rritim tufa të mëdha me lopë e dele, edhe atje do të ngrihet e do të forcohet industria e përpunimit të bulmetrave. Jo vetëm në fusha, të cilat së shpejti do të bëhen edhe më pjellore, po edhe në male do të merren rendimente akoma më të mëdha, se edhe mekanizmat do të jenë më të shumtë në të ardhmen. Rritja e prodhimeve bujqësore e blegtorale do të na bëjë të sjellim fabrika të tjera të reja për nevojat në rritje të vendit dhe për eksport. Gjithë ky zhvillim ekonomik do ta çojë edhe më përpara nga sa është sot kulturën e popullit.

E kush do t'i bëjë të gjitha këto gjëra, kush do ta çojë përparimin edhe nëpër male? Ju, shokë dhe shoqe të rinisë. Nuk do të jetë larg dita kur qytetarët dhe fshatarët, të reja e të rinj me zanat, do të venë edhe nëpër zonat malore dhe Partia do t'ju udhëzojë si të punoni për të shtuar begatinë për popullin, si të ndërtoni shtëpi të reja të bukura për veten tuaj, si të krijoni atje fshatra të reja, si të ndërtoni rrugë të reja etj. Pastaj, kudo do të futet edhe në këto zona drita elektrike që do ta çoni ju; atje do të krijoni familjet tuaja,

se dikush nga ju do të marrë motrën, tjetri nënën, dikush gruan e fëmijët, pra nuk do të rrini të punoni vetëm. Sot në një vend të tillë malor mund të kemi një fshat me pak shtëpi, kurse nesër, kur të hapen atje toka të reja, mund të ndërtohen 20 fshatra të reja të bukura. Kjo do të bëjë që vendi ynë, duke përfshirë edhe zonat malore, me punën dhe me duart tona, të bëhet edhe më i bukur. Të tjerët kanë punuar me qindra vjet për t'i bërë, për shembull zonat malore të Zvicrës, të Italisë së Veriut ose të vendeve të tjera, të bukura, po atje veç kanë shfrytëzuar gjakun e popujve të tyre dhe të popujve të tjerë që i kanë kthyer malet në vende të bukura pjellore. Edhe ne do t'i bëjmë me doemos të tilla dhe jo shumë vonë, po brenda 10-15 vjetëve sepse ne kemi një rini të mrekullueshme të udhëhequr në rrugë të drejtë nga Partia. Ky është një aksion kolosal që do të kryhet nga brezi i ri, i cili ka mundësi dhe duhet ta bëjë njëqind herë më shumë e më mirë nga ne të vjetrit, që nuk i kishim kushtet që keni ju sot, nuk kishim këto zotësi që keni fituar ju, prandaj, me siguri ju do t'i bëni. Po t'u hedhim një sy kuadrove të vjetër të Partisë dhe të pushtetit, do të shohim se shumë nga ne nuk kishin bërë shkollë, lëre pastaj universitet, shumë-shumë ata mund të kishin bërë ndonjë filllore ose gjithsej 5-6 vjet shkollë. Po Partia na frymëzoi, na edukoi, na sqaroi dhe, siç e shihni, prapë dhe me kaq pak shkollë edhe ne diçka bëmë, po ato që do të bëni ju dhe brezi i ardhshëm që po përgatitim do të jenë vepra madhështore. Partia megjithatë na mëson të jemi të thjeshtë, të mos mburremi me ato që kemi bërë dhe të tillë të jemi derisa të vdesim. Edhe ju në



punën tuaj kijeni parasysh thjeshtësinë, po mos harroni që puna juaj të vlejë edhe si frymëzim për brezat që do të vijnë.

Mbasi të dilni në jetë edhe ju do të bëheni baballarë e nëna. Shikojeni atë shoqen nga Mirdita! Nëna e saj, Marta, u vra për çështjen e popullit, po sa nder i madh është të jesh vajza e një nëne të tillë, sa nder i madh do të jetë, gjithashtu, edhe për fëmijët që do të lindni ju, të cilët, kur të rriten, do të thonë me krenari: «Nëna dhe gjyshja ime kanë luftuar, kanë ndërtuar, kanë hapur këtë mal, kanë bërë këto hekurudha, prandaj le ta ndjekim edhe ne rrugën e tyre». Ju që tani po hyni në jetë dhe nesër do të merrni në dorë fatet e vendit, me punën tuaj duhet të bëheni frymëzuesit e brezit të ardhshëm, prandaj përpiquni të jeni shembullorë në çdo gjë, në punë, në jetë dhe në mësim dhe të gjitha këto të mësoheni t'i lidhni si duhet, me kuptimin e madh që kanë. Po të kuptohet drejt kjo çështje, atëherë çdo gjë që ka lidhje me të, edhe dëfrimi, edhe kërcimi, edhe biseda do të japin një kënaqësi të veçantë.

Me kënaqësi të madhe ne vëmë re që rinia jonë punëtore dhe fshatare i kupton dhe i zbaton drejt direktivat e Partisë. Partia dhe populli ndihen të lumtur kur shohin që ju, të rinj, ju karakterizon jo vetëm vendosmëria për ruajtjen e fitoreve, dashuria e thellë për punën, po edhe morali proletar. Edhe çështja e moralit ka rëndësi të madhe, sepse në qoftë se morali i rinisë sonë fillon të degjenerohet, çdo fitore do të jetë në rrezik, në rrezik do të jetë atdheu, se imperializmi dhe borgjezia bëjnë çmos që në rini të futet krimbi i degjenerimit, sepse vetëm në këtë mënyrë ata mund të

zgjatin edhe ca jetën e tyre. Atje ku rinia është e shëndoshë moralisht, socializmi nuk ka mortje kurrë, Partia gjithashtu nuk ka mortje kurrë. Partia është një lumë i vrullshëm që mbetet kurdoherë e gjallë se radhët e saj përtërihen vazhdimisht me gjak të ri. Në qoftë se plakemi ne, Partia mbetet e re se vini ju dhe na zëvendësoni. Në qoftë se te ndonjë nga ne ka shenja lëkundjeje, Partia është e paepur, se rinia që mbush sërisht radhët e saj është e papërkulur. Partia punon që brezi i ri të jetë i kalitur dhe i fortë, me qëllim që ata që futen në Parti, t'i japin kësaj gjak të ri dhe të pastrojë radhët nga ata që gjaku ka filluar t'u bëhet ujë. Shih sa rëndësi të madhe ka rinia, sa vendimtare është për Partinë dhe për popullin çështja e saj, sidomos puna për mbajtjen pastër të moralit proletar të saj.

Ju duhet të kuptoni mirë përse duhet të punoni, pse duhet të jeni të ndershëm, të sjellshëm, pse duhet të jeni të ashpër kundër armiqve, përse duhet t'i luftojmë paragjykimet etj., sepse të gjitha këto na pengojnë. Djali duhet ta mbrojë shoqen se mbi kurrizin e saj rëndon një atavizëm shekullor, se, për fat të keq, ka burra, bile nga këta edhe anëtarë partie, që e përdorin keq gruan, akoma e lënë t'u lajë bile edhe këmbët si atyre edhe mysafirëve që u vijnë në shtëpi, sikur të ishte një skllave. Femrën përpara, kur vinte në moshë të martohet, e fejonin me atë që donin nëna dhe babai, pa i marrë mendimin dhe pa e pyetur fare për dëshirat e saj. Partia dhe rinia duhet të punojnë që të edukojnë personalitetin e femrës. Kur vajza vete në punë, djalin që e ka pranë e ka vëlla, po në qoftë se atë e pëlqen, e merr si bashkëshort. Edhe djali në qoftë se e do, apo e

pëkqen, gjithashtu, e merr. Kjo është normale, brenda normave, kurse armiku me propagandën e tij përpigjet të futë degjenerimin, të cilin ne duhet ta luftojmë pa mëshirë.

Duhet t'i mbron shoqet, sidomos ju të rinjtë, se ka edhe njerëz që flasin për gjëra të kota. Shokët e mirë të rinisë të qëndrojnë kurdoherë afër shoqeve për t'i mbrojtur ato nga çdo gjë. Vajzat janë të zonjat të mbrohen edhe vetë, po shokët duhet të luftojnë atavizmin, mbeturinat e vjetra që ekzistojnë akoma me dashje ose pa dashje në kokën e meshkujve dhe që herë pas here nxjerrin brirët në qoftë se nuk i luftojmë. Partia punon që të gjithë, burra, gra, të rinj e të reja të jenë me moral të pastër, të ndershëm. Morali proletar nuk është i huaj për popullin tonë, ai ka qenë kurdoherë i ndershëm, kurrë nuk i lejon shturjet dhe vagabondllëqet. Babai dhe nëna i duan si shpirti vajzën ose djalin, po, kur shohin se shkojnë në rrugë të keqe, bëhen vrer. Prandaj ta ruajmë rininë nga shturjet, të kujdesemi për të, se ka akoma njerëz me gjithfarë mbeturinash.

Degjenerim të madh ka në vendet ku revizionistët janë në fuqi. Këta kapitalistë të maskuar, përpigjen t'i transformojnë vendet socialiste në kapitaliste. Ata bëjnë të gjitha përpjekjet që ta largojnë rininë nga rruga e drejtë, të shuajnë tek ajo çdo frymë revolucionare, se një rini thellësisht revolucionare do të ishte rreziku më i madh për ta, prandaj, që ta heqin atë nga rruga e revolucionit, përdorin çdo mjet të degjenerimit.

Por, Shqipëria ka një Parti, një popull dhe një rini të fortë si çeliku dhe, megjithëse kemi qenë e qëndrojmë që prej 20 e ca vjetësh të rrethuar, sot ne jemi më të

fortë se kurrë. Jo vetëm kaq, po Partia jonë me shembullin e saj bën që edhe revolucionarët në vendet e tjera të shohin dhe të mësojnë nga lufta dhe nga qëndrimet e saj të drejta. Të gjithë frymëzohen nga fakti se si një Parti dhe një popull i vogël, në sajë të vijës së drejtë, i bëjnë ballë furtunës imperialiste dhe revizioniste, ecin përpara dhe korrin fitore. Kjo ne na gëzon, po nuk na e rrit mendjen. Në këtë drejtim ne duhet të punojmë se kemi një përgjegjësi të madhe mbi supe. Kjo gjendje që ekziston sot në Bashkimin Sovjetik nuk do të jetë e përrjetshme; ideologjia e klikës që është atje në fuqi është një rrymë e rrezikshme armiqësore, që urrëhet nga populli, prandaj në mos sot, nesër, do të shpartalohet. Kjo klikë ka hyrë në një rrugë degjenerimi të plotë dhe nuk do ta ketë jetën të gjatë. Popujt dhe marksistë-leninistët në Bashkimin Sovjetik luftojnë në kushte shumë të vështira, megjithatë revolucioni edhe atje do të ngrihet. Ky është ligj. Do të ishte më mirë të mos kishte ndodhur rënia e partisë dhe e pushtetit në duart e revizionistëve, po kjo atje ndodhi se marksistë-leninistët humbën vigjilencën, armiku ia rrëmbeu popullit sovjetik fitoret nga duart dhe tani shkallët duhen ngjitur përsëri me luftë, me vuajtje e përpjekje, me gjakun që përsëri do të derdhet atje, por, më së fundi, do t'u arrihet me siguri qëllimeve.

Në këtë luftë për jetë a për vdekje Partia jonë e Punës dhe Shqipëria e vogël socialiste luajnë një rol të madh në sajë të vijës së drejtë të Partisë dhe të qëndrimit heroik e të urtë të popullit dhe të rinisë sonë, prandaj edhe një herë dëshiroj të përsëris atë rëndësi e rol të madh vendimtar që luan rinia jonë, që

luani ju, brezi i ri i Shqipërisë, për realizimin në jetë të vijës së drejtë të Partisë.

Të gëzuar për pjesëmarrjen në aksione jeni jo vetëm ju, po edhe gjithë populli ynë. Të gjithëve u është shtuar dashuria për ju, që jeni e ardhmja e vendit. Populli ushqen një besim të madh për vajzat dhe djemtë e tij. Nëna dhe babai gëzohen kur u rritet sot fëmija, sepse ajo nuk ia ka frikën punës dhe punon kudo që ta dojë interesi i atdheut. Edhe fshatarët që ju kanë pritur janë jashtëzakonisht të gëzuar për punën, për sjelljet dhe për qëndrimet tuaja revolucionare. Ne kemi shumë të dhëna në këtë drejtim. Për ata ka qenë festë dita kur shkuaat ju, tani bile ata duan t'u veni prapë, nuk ju harrojnë. Me punën dhe me sjelljet tuaja ju keni lënë mbresa të paharruara tek ata. Por edhe ju duhet t'i kujtoni, të mbani miqësi me ta, prandaj t'u dërgoni letra.

Do të vijmë përsëri pushimet vitin e ardhshëm e bashkë me to do të fillojmë aksione të reja, për të cilat Partia do të marrë masa që të organizohen ca më mirë, se, ta themi hapur, si nga ana jonë, edhe nga ana e rinisë dhe e dikastereve, në aksionet e këtij viti puna nuk ka qenë e organizuar si duhet, ka pasur shumë të meta. Edhe nga ju ka pasur disa gjëra të vogla, të ndreqshme, kurse nga ana jonë nuk lejohet të ndodhin të tilla të meta. Mungesat tona influencojnë negativisht, ato pengojnë hovin tuaj të madh revolucionar. Mundësi, mjete dhe eksperiencë tani kemi shumë për punë të kësaj natyre. Eksperienca e fituar, pra, duhet të shërbejë që vitet e ardhshme t'i organizojmë më mirë këto punë së bashku.

Më thanë se në Plenumin e KQ të BRPSH ju keni diskutuar mirë, drejt, keni folur për të mirat dhe për të metat tuaja dhe kjo është një gjë e mirë. Ju kërkuat të merrni përsipër aksione të reja. Për këtë vendosmëri ne nuk kemi pasur asnjëherë dyshim. Kërkesën tuaj për të marrë si aksion hekurudhën Rrogozhinë-Fier, ne do ta shtrojmë dhe do ta shqyrtojmë në Byronë Politike dhe besoj se do të vendoset në favor.

Hekurudha ka rëndësi të madhe për ne, se do të lidhë disa rrethe industriale dhe me bujqësi të përparuar, ajo do të sjellë një përparim edhe më të madh në rrethet ku do të kalojë. Në këtë aksion të madh do të merrren të tjerë tituj sulmues nga ana juaj. Tituj keni marrë ju edhe gjatë punës për prashitjen e misrit, po kjo lloj pune sikur nuk para duket, kurse hekurudha do të jetë një vepër që do të mbetet përgjithnjë. Unë jam i bindur se Komiteti Qendror i Partisë do ta pranojë dëshirën tuaj, ashtu siç jam gjithashtu i sigurt që ju do ta kryeni me nder këtë detyrë të lartë. Po ne nuk kemi për të ndërtuar vetëm hekurudhën gjatë këtij pesëvjeçari, do të kemi edhe shumë vepra të tjera për të ngritur. Ju mos mendoni se rinia punon vetëm në verë për ndërtimin e këtyre veprave, se shokët tuaj punëtorë kanë bërë dhe po bëjnë mrekulli nëpër fabrika e uzina, shokët tuaj fshatarë, gjithashtu, bëjnë të njëjtën gjë në ara, në bonifikime. Ata janë vendosur në mënyrë të përhershme në këto punë, kurse ju nxënësit e shkollave dhe rinia e universitetit shkuat vetëm gjatë pushimeve që porsa morën fund. Sidoqoftë në hekurudhat e në hidrocentralet e reja, ne përsëri do t'ju dërgojmë të puno-

ni, se atje ka edhe mundësi më të mëdha për punë, ditën dhe natën.

Punë kemi shumë, mos u bëni merak, në këtë drejtim edhe rinia do të jetë një nga pjesëtarët më kryesore e më aktive të gjithë këtyre punëve. Të shkoni kurdoherë atje ku të jetë nevoja si në hekurudhë dhe, kur ta ndërtoni, do t'ia dini më mirë kuptimin, se e keni bërë vetë dhe do t'ia ndicni pastaj më mirë lezetin. Kur ndonjëri nga ju do të punojë andej nga Semani dhe nënën do ta ketë, ta zëmë, në Tiranë, ç'kënaqësi e madhe do të jetë për të kur t'ia hipë trenit dhe t'i drejtohet kryeqytetit me 80 km në orë siç do të jenë atëherë trenat! Ju do t'i bëni këto vepra të mëdha, shoqe dhe shokë të rinj, nën udhëheqjen e Partisë.

Mos harroni shkollën. Edhe atje ju duhet të mësoni sa më mirë. Tani po bëhen disa eksperimente si të veprohet në shkolla për çështjen e punës praktike me nxënësit, në mënyrë që mësimet t'i lidhim më mirë me punën. Nuk ka shumë rëndësi forma, këto do t'i gjejmë, rëndësi ka më shumë çështja që, kur të shkoni në uzina, të mos shkoni me pikëpamjen e një nxënësi, i cili mendon se do të jetë përkohësisht në atë punë por, po vure këmbët atje, thuaj unë jam punëtor i kësaj uzine dhe puno me të gjitha forcat e me ndërgjegje. Përpara luftës punëtori çante gurë në Virua dhe merrte vetëm një lek ditën, në shi e në borë. Me këtë lek ai mund të merrte vetëm një kile bukë sa për vete, po me se do të rronte ai tërë ditën së bashku me gruan dhe 5 kalamanët e tij? E kuptoni, të dashur shokë dhe shoqe të rinisë, ç'situatë e vështirë ishte në kohën e Zogut? Ai që ishte nëpunës mund të merrte

vërtet 500-600 lekë në muaj, po rrinte pa pagë 9-10 muaj me radhë. Merreni me mend si rronin njerëzit, shumë shtrënguar, nuk kishin. Po ç'bënin? Shkonin te fajdexhiu Vasil Shahini, te Papadhopulli, ose te Kondili që u gllabëronin 20-25 për qind të rrogës për paradhënien që u jepnin sa për të mbajtur frymën. Edhe këtë paradhënie nuk ua jepnin përnjëherë, po çika-çika. Shikoni ç'ndryshime të mëdha ka tani, të gjitha këto ndryshime i solli Partia. Prandaj kushdo nga ju, kur vete në uzinë për punë mësimore ta quajë veten punëtor, të thotë që atje unë do të punoj ashtu si të më thotë dhe të më mësojë mjeshtri, bile edhe në qoftë se ai do të më japë punë të rëndë, punën do të përpiqem ta bëj mirë që edhe të kalitem, edhe mjeshtrin mos ta pengoj, përkundrazi, ta nderoj.

Edhe një herë dëshiroj t'juja përsëris që çështjen e mësimiit të mos e konsideroni si një detyrë për detyrë, që duhet të mësoj për të mësuar, po kjo të jetë një armë për të luftuar në jetë. Prandaj i vini vetes një detyrë të rreptë që pa bërë mësimet, nuk dal, pa zgjidhur problemet që më ka dhënë mësuesi, nuk lëviz nga tavolina dhe jo të mësoj se nesër do të më ngrejë mësuesi, pra, sa për të marrë notën, po do të mësoj esencën e çështjes që do të më duhet në jetë.

Përse duhet ta dojë nxënësi mësuesin e tij? Jo për arsyen se ai ka në dorë librezën e notave të tij, po për të marrë nga ai ato që di dhe për t'u armatosur me to në jetë që të bëhet i vlefshëm për popullin, për atdheun. Nxënësi duhet ta dojë mësuesin, të afrohet me të, që edhe nxënësi ta ndihmojë mësuesin, ashtu sikurse edhe mësuesi e ndihmon nxënësin. Po si mund ta ndihmojë



nxënësi mësuesin? Pikërisht në kuptimin që kur mësuesi të shikojë sa të fortë, sa të ndershëm, sa të sjellshëm jeni ju, edhe në qoftë se ai do të ketë disa turbullira në kokën e tij, nuk do të mund t'i qëndrojë dot veprimtarisë suaj, por do të ndreqet, dhe nuk përjashtohet që ndërmjet jush të vendosen edhe marrëdhënie të shëndosha, të drejta, shoqërore. Ju thoni se kanë ardhur t'ju shoqërojnë në aksione edhe mësues e pedagogë. Kjo është një gjë shumë e mirë për ju, po sidomos për ata, se edhe ata kishin shumë nevojë të dilnin nga kuptimi thjesht akademik i dhënies së mësimeve.

Nuk është e vërtetë ajo që thonë disa se mësuesi duhet të jetë i vrenjtur që ju të viheni të mësoni. Jo! Në qoftë se mësuesi është i qeshur, i dashur, i sjellshëm, nuk mund të ketë nxënës që të mos i sillen mirë. Një qëndrim i mirë e sjellje e ngrohtë shoqërore e mësuesit edhe ndonjë nxënës që bën çapkënlleqe e bën që të thotë se paskëtaj do të sillem mirë si me mësuesin ashtu dhe me gjithë të tjerët. Këto janë abëcëja e psikologjisë.

Mësuesi i mirë, i zgjuar dhe i thjeshtë nuk është e vështirë të vihet në nivelin e rinisë sonë. Nuk mund t'i vesh rinisë, si themi ne në Gjirokastrë, me pesë rupa në xhep, ashtu siç bëjnë disa që venë dhe flasin në mbledhje të papërgatitur, u thonë pesë fjalë për gjëra që ju i dini shumë më mirë se ata. Rinia jonë nuk e ha këtë. Çështjen e kam që ta ruani unitetin me mësuesit tuaj, të silleni me ta në mënyrë shoqërore, vëllazërore dhe të keni respekt për ta. Fakti është se shumë prej tyre erdhën bashkë me ju në aksione, ju u vëllazëruat me ta, bile tani keni një kuptim tjetër si ju për ta, ashtu edhe ata për ju. Pra, shih sa gjallëri i ka dhënë jetës

suaj puna dhe mësimi së bashku! Vëreni re këtë vit shkollor, pastaj ejani më thoni mua vitin tjetër çfarë gjallërie do të ketë në klasë dhe në marrëdhëniet midis jush dhe mësuesve tuaj. Unë jam i bindur se do të ketë ndryshim të madh, do të ketë një frymë tjetër te mësuesit dhe pedagogët, prandaj shihni sa mirë që bën puna në aksion. Edhe unë bëra mirë që u takova me ju, sepse qe një kënaqësi e madhe për mua. Porsa më tha shoku Ramiz për kërkesën tuaj vendosa dhe e aprovova menjëherë që ta bëja këtë takim.

Çfarë t'ju them tjetër? Mbase dhe ju mërzhita (nga *salla doli spontanisht njëzëri shprehja: «Jo, vazhdoni, vazhdoni»*), megjithatë më vjen keq të ndahem nga ju. Shokët drejtues të rinisë kanë fatin e mirë që punojnë vazhdimisht me të rinjtë dhe të rejtat, nga të cilët dëgjojnë gjithnjë mendime të guximshme. Këta do t'i këshilloja ta dëgjojnë me vërejtje rininë, të mos jenë sektarë.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Sa mirë kanë folur në Plenumin e Komitetit Qendror të BRPSH! Të gjithë ata që diskutuan dje në plenum, ishin më shumë nga këta të aksioneve, ca më tepër vajzat folën shumë mirë, me shumë entuziazëm e gjallëri. Kemi kuadro të mirë në rini.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shihni sa nevojë të madhe kemi për kuadro. Pra, nuk duhet të jemi sektarë, se edhe nga të rinjtë do të marrim e do t'u vëmë detyra të mëdha. Kuadrot më të shumtë të Partisë dhe të pushtetit kanë ardhur nga radhët e rinisë. Mos mendoni se do të presim edhe 25 vjet pa të marrim si kuadro këta shokë dhe shoqe të rinisë që kemi këtu ose shokët e

tyre. Kuadrot nga rinia neve na duhen shumë qy se punët po na zgjerohen, ato bëhen gjithnjë më të komplikuarra e të vështira. Gjithashtu, kuadro janë edhe një nxitje dhe sjellin në çdo punë entuziazëm dhe freski.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha. «Ra-  
porte e fjalime 1965-1966»,  
f. 507. Tiranë, 1971*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## KOOPERATIVA BUJQËSORE DO TA PËRMIRËSOJË JETËN E TË GJITHË FSHATARËVE

*Bisedë me dy fshatarë nga Shmili i rrethit  
të Elbasanit<sup>1</sup>*

20 shtator 1966

*Me kërkesën e tyre, shoku Enver Hoxha i priti me përzemërsi miqtë e vjetër në aparatin e Komitetit Qendror të PPSH. Ai bisedoi me plot mall, i pyeti për shëndetin e tyre dhe të pjesëtarëve të familjeve, si dhe për miqtë e tjerë nga Shmili. Në fillim iu drejtua Ali Gjurës, si më i moshuar që ishte, nëse vazhdonte akoma të punonte.*

*ALI GJURA: Jo, kam dalë në pension. Marr nja 2 000 lekë të vjetra në muaj.*

*SHOKU ENVER HOXHA: Sigurisht kaq parashikon ligji, për aq sa ke punuar. Po banesë ke?*

---

<sup>1</sup> Sadik Ceka, ish-pjesëmarrës i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në shtëpinë e tij është strehuar shoku Enver Hoxha në kohën e luftës. Ali Gjura, kushëriri i Sadik Cekës, aktivist i Luftës Nacionalçlirimtare.

*ALI GJURA:* Po, kam.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po ti, Sadik, si ia çon?

*SADIK CEKA:* Nuk jam keq. Kam 14 dynym tokë, 12 berra, një kalë. Lopë nuk kam.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kush është kryetar i këshillit popullor të fshatit?

*SADIK CEKA:* Vazhdimisht kam qenë unë, po, siç e shikoim, tani jam zënë ulok, sa s'lëviz dot. Për këtë arsye kam bërë kërkesë të zgjedhin një tjetër e të mos punoj më.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Në këtë gjendje shëndetësore, merret me mend, kryetar mund të mos jesh, po anëtar i këshillit për të dhënë ndonjë mendim, ndonjë këshillë, mund të jesh. Si rrojnë fshatarët, rrojnë më mirë se përpara?

*SADIK CEKA:* Nuk jetojnë keq, shoku Enver. Fshatarët në Shmil tani nuk rrojnë më si në të kaluarën kur flinin në fier, se edhe Shmili ka bërë shumë ndryshime. Një pjesë e mirë e fshatarëve kanë bërë shtëpi të reja.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ka shmilas që punojnë në sektorët e sharrave, në pyje?

*SADIK CEKA:* Posi. Në Steblevë, në Bizë dhe në ndërmarrje të tjera shtetërore punojnë shumë fshatarë nga Shmili, kurse familjet i mbajnë në fshat.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Besoj se puna që bëjnë në sharra ose në pyje është një ndihmë e mirë për familjet e tyre.

*SADIK CEKA:* Po, kjo është një e ardhur shumë e mirë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ç'bën Zenel Disha<sup>1</sup>?

*SADIK CEKA:* Mirë është, punon.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ç'fëmijë ka?

*SADIK CEKA:* Ka 3-4 fëmijë, i rron edhe plaka.

*ALI GJURA:* Ç'fëmijë ke ti Enver?

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kam dy djem dhe një vajzë. Djali i madh gjatë verës punoi në Ndërmarrjen Bujqësore të Lushnjës. Tani po punon në uzinën «Partizani», si kovaç, derisa të fillojnë mësimet. Partia po kujdeset që shkolla të na i mësojë djemtë dhe vajzat edhe me punën në ara e në uzina.

Ju vjen atje Sherif Çeka<sup>2</sup>?

*SADIK CEKA:* Po, na vjen.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Më së fundi, pas 22 vjetësh, edhe Labinoti u bashkua në kooperativë. Po ju të Shmilit ç'po bëni? Akoma nuk e keni ngritur kooperativën?

*SADIK CEKA:* Ne jemi malësi.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shikojeni këtë çështje Sadik, se do të jetë me siguri më mirë për ju, pavarësisht se jeni malësi. Bashkimi në kooperativën bujqësore ka shumë anë të mira<sup>3</sup>. Pastaj fshati juaj ka edhe ujë. Duhet rregulluar këto gjëra.

1 Patriot, shtëpia e tij ka qenë bazë e Luftës Nacionalçlirimtare.

2 Ish-anëtar i këshillit nacionalçlirimtar të fshatit.

3 Kolektivizimi i bujqësisë në Shmil filloi në tetor 1966 me lagjen Qerret dhe përfundoi në të gjithë Shmilin në fillim të vitit 1967.

*SADIK CEKA:* Vërtet ashtu është. Shmili është mirë me ujë, përveç lagjes Qerret që s'ka.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kur të ngrini kooperativën bujqësore do të rregullohet me siguri edhe çështja e ujit në Qerretin tuaj. Duke bashkuar forcat, ju do të shfrytëzoni më mirë edhe plehrat, edhe ujin, kështu që do të merrni më shumë prodhime. Pastaj edhe shteti, duke qenë ju të bashkuar në kooperativë bujqësore, ka mundësi t'ju ndihmojë më shumë, si me kredi e me mjete të tjera. Kështu do të vijë një përmirësim më i shpejtë i gjendjes ekonomike të fshatarëve.

Po blegtorinë e keni mirë këtë vit?

*SADIK CEKA:* Mirë e kemi.

*SHOKU ENVER HOXHA:* More, rron Ram Karagjozi?

*ALI GJURA:* Jo, ka vdekur. Ai ka lënë një çun, murator. Ky ka bërë një shtëpi shumë të mirë për vete.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ne kemi ndenjur te Rama gjatë luftës, te Buzani<sup>1</sup>, pastaj edhe tek Ali Disha.

*ALI GJURA:* Kur ju bënit mbledhje në shtëpinë e tij, unë rrija jashtë roje.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po me orenjasit dhe gurakuqasit keni dhënie e marrje?

*SADIK CEKA:* Jo, nuk kemi, se ne jemi lidhur me Labinotin.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Keni shkuar ndonjëherë te Samiu<sup>2</sup>?

---

1 Hasan Buzani.

2 Sami Baholli.

*SADIK CEKA:* Jo, se ka kohë që nuk kemi qenë në Tiranë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Tani Samiun Partia e ka caktuar me punë nënkryetar të Gjykatës së Lartë. Është një shok i mirë, i zoti, i zgjuar dhe i vendosur për Partinë.

Në Elbasan, besoj, shkoni më shpesh. Edhe ai është ndryshuar e zbukuruar me pallate, me fabrika e me rruge të drejta, sa besoj që mezi duket Elbasani i vjetër.

*ALI GJURA:* Shumë i bukur është bërë. Po të dërgosh prej këtej edhe ndonjë shok tjetër të zotin, që të na drejtojë, edhe më mirë ka për të shkuar puna.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Atje Partia ka dërguar sekretar të parë një shok të mirë nga Dibra. Ju keni pastaj edhe shokë të tjerë nga Elbasani që janë ngarkuar të drejtojnë punët e Partisë dhe të pushtetit në rrethin tuaj.

*ALI GJURA:* Unë them të dërgohet që këtej, nga ti.

*SADIK CEKA:* Që të ketë shpirtin tënd, do të thotë Aliu.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ata që janë atje, janë shokë të mirë. Po pa na thoni një çikë, përse keni ardhur në Tiranë?

*SADIK CEKA:* Të shohim edhe ne një herë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kishit ndonjë gjë për të më thënë? Sigurisht ju keni menduar se mund t'i dërgojmë edhe një letër Enverit, po është më mirë kur fjalosesh kështu si tani, me gojë.

*SADIK CEKA:* Unë kisha një hall. Jam kështu siç më sheh. Jo vetëm kaq, po kam një djalë 25 vjeç që është edhe ai krejt i paralizuar, shumë më keq se unë.



Kam, gjithashtu, gruan dhe tri vajza. Vajzën e madhe e kam fejuar, kurse dy të tjerat i kam binjake, afër 8-9 vjeç.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shiko, mos e shesësh vajzën që do të martosh, se, po mora vesh që do të bësh kështu, nuk je miku im.

*SADIK CEKA:* Mos ma thënçin emrin Sadik, si e shitkam unë vajzën time?

*SHOKU ENVER HOXHA:* Vajzës t'i bësh një palë rroba, një palë këpucë dhe të vejë te burri e të trashëgohet, asgjë më tepër.

*SADIK CEKA:* Njashtu pra, nja njëzet mijë lekë plaçka.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Bëni ndonjë gjë sipas takatit. Sikur të të vijë dhëndri dhe të të thotë të bësh kaq ose aq pajë, pastaj të të marr vajzën, i thuaj se vajzë me kushte nuk jep. As nuk është e drejtë, gjithashtu, që nga ana jote t'i thuash tjetrit ta jap vajzën, po më jep kaq ose aq para. Kjo do të ishte një gjë shumë e keqe. Ta fejosh e ta martosh fëmijën tënde duke i kërkuar mikut para, kjo do të thotë ta quash atë si një plaçkë që shitet e blihet.

Kur martohet djali ose vajza, babai dhe nëna sigurisht gëzohen, por e kanë edhe për detyrë të mendojnë që edhe fëmija i tyre të jetë edhe më i gëzuar. Kjo ndodh kur ti si prind ia merr për bazë dëshirën e zemrës, e këshillon, i tregon si duhet të sillt në jetën e re. Martesa është një ngjarje e gëzueshme në jetë.

Po nuk më thatë, ç'hall kishit që erdhët?

*SADIK CEKA:* Na kanë thënë të ngremë koope-

rativën në katund. Para 10 ditësh na erdhi Jashari<sup>1</sup>. Ai më tha se, kur isha në Tiranë, më pyeti shoku Enver si e kam Sadikun, i thashë mirë është dhe më solli të fala prej teje, Enver. Mirëpo tani Jashari tha se Partia po bën thirrje kudo, pra edhe në Shmil, për bashkimin e fshatarëve në kooperativë bujqësore. Këtu në Shmil, më tha ai, Partia ty të ka mbështetje, ti ke qenë njeri i luftës, edhe pas Çlirimit ke qenë vazhdimisht drejtues i pushtetit në fshat, prandaj tani të bie të japësh shembullin i pari për të hyrë në kooperativë. Unë, i thashë, jam dakord shoku Jashar, po kam disa vështirësi, pse nga familja jonë nuk ka kush punon në kooperativë, djalin e kam të paralizuar, vajzën e madhe në tetor do ta martoj, dy vajzat binjake i kam akoma të vogla.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po ja, ke gruan. Ajo do të bëjë ca ditë-punë në kooperativë dhe, veç punës së saj, do ta kesh edhe një copë tokë që do ta punosh e do ta mbjellësh për të plotësuar disa nevoja të familjes.

**SADIK CEKA:** Gruaja do t'i bëjë hyzmet djalit se është krejt ulok, pastaj as unë nuk lëviz dot. Unë nuk jam kundër kooperativës, jam dakord që ajo të ngrihet dhe do të bëj si thotë Partia, por erdha të ta qaj edhe ty hallin. Jashari më thotë se, po nuk dhe shembullin ti, nuk hyjnë të tjerët në kooperativë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po tani kush t'i punon ato 14 dynymët që ke?

**SADIK CEKA:** Villaznit e babës, ata dhe disa shokë

---

1 Jashar Menzelxhiu, në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit.

të mi më kanë ndihmuar. Pastaj më ka punuar edhe vajza e madhe e gruaja sa ishte pa u sëmurë djali. Me to jam mbajtur gjer tani, por, siç të thashë...

**SHOKU ENVER HOXHA:** Që vajza do të të mar-tohet.

**SADIK CEKA:** Në tetor ajo shkon te burri, në Mirakë, kurse fëmijët e tjerë i kam në gjendjen që të thashë. I kërkova Jasharit të më jepnin pak tokë dhe një lopë andej nga Godoleshi, apo në fushë të Elbasanit, se gruaja nuk ka se si punon në kooperativë, nuk ka si na lë vetëm në shtëpi në gjendjen që jemi. Kështu do të ishte më mirë për mua.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kurse ata të fushës do të na thonë neve, pse na e dërguat Sadik Cekën këtu, pse nuk rri ai në Shmil, ku do t'i ketë tre dynymë tokë për të plotësuar disa nevoja të familjes?

**SADIK CEKA:** Në Qerret toka nuk prodhon njëlloj si në fushë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Do të prodhojë edhe toka juaj, mos u mërzi ti. Pastaj kooperativistët e fushës nuk kanë si të pranojnë që të të japin tokë ty nga të kolektivit dhe ti të rrosh i veçuar. E di si do të thonë ata të fushës? «Rri o Sadik se je mirë në Shmil. Fundi, po të duash, hajde futu në kooperativat tona, por jo të qëndrosh si individ».

Po të më dëgjosh mua, më e udhës është që ju të punoni për të ngritur sa më parë kooperativën bujqësore në fshatin tuaj dhe të jesh i bindur se Partia do të mendojë edhe për ty.

**SADIK CEKA:** As në qytet nuk ka mundësi të vendosem?

*SHOKU ENVER HOXHA:* Jo, Sadik, as në qytet. Të kam mik e të dua shumë, por kjo që kërkon ti nuk është e arsyeshme të bëhet, se nuk është e drejtë. Tani po kthehen prapë në fshatra ata që janë larguar pa arsye prej andej dhe jo vetëm ata, por edhe qytetarët, e sidomos të rinjtë, po i këshillojmë të venë në fshat, se atje na duhen më shumë forca pune, kurse këtu do të rrinë aq njerëz për sa ka nevojë qyteti. Kjo çështje ka rëndësi të madhe, sepse fshati i prodhon artikujt bujqësorë e blegtoralë, por, që të kemi sa më shumë prej këtyre prodhimeve, atje duhen njerëz, prandaj nuk kemi si të lejojmë që të na largohet krahu i punës nga fshati.

*ALI GJURA:* Shumë gjë e mirë u bë tani që djemtë dhe vajzat e shkollave po venë në punë edhe në bujqësi.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shumë drejt e ke këtë fjalë, të rinjtë e të rejat të venë në punë, të lërojnë tokat, të pastrojnë kullotat, të bëjnë rrugë etj. Partia i këshillon ata të merren edhe me mësim, edhe me punë.

Kështu, pra, vepro edhe ti Sadik. Sa për atë që ke merak ti, çdo gjë do të rregullohet si më mirë, mos u mërzit.

*SADIK CEKA:* Besimin unë e kam te Partia, te ti dhe te shoku Jashar.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Jasharit ne do t'i japim porosi për punën tënde. Në qoftë se do ta ngreni kooperativën bujqësore, Partia do t'i bindë shokët e kooperativës që organizata e Partisë dhe asambleja e koope-

rativës, në bazë të rregullave, të të përkrahin e të të ndihmojnë. Ti je një shok i vjetër i luftës dhe fshatarët të duan, prandaj të jesh i sigurt se diçka do të bëhet për ty që nuk punon dot, jo se nuk do, por se nuk mundesh. Kurse më vonë do të gjenden mënyra e rrugë për t'u ardhur në ndihmë edhe kooperativistëve të tjerë. Atyre që kanë marrë pjesë në luftë dhe janë invalidë do t'u jepen pensione për kontributin patriotik; do të vijë edhe ajo ditë kur do t'u jepet pension gjithë kooperativistëve, mbasi të plotësojnë një moshë që do të gjykohet e arsyeshme. Pastaj vetë kooperativat bujqësore do të krijojnë kushte për invalidët që, sipas mundësive të tyre, të bëjnë disa ditë-punë në kooperativë. Në këtë mënyrë ata do të mund të marrin diçka për të jetuar dhe këtë jetesë do ta sigurojnë më me lehtësi tani që u bëhet ndihmë kolektivi.

Pra nuk duhet të kesh merak për këtë gjë.

**SADIK CEKA:** Paskam bërë mirë që ia kam dhënë fjalën Jasharit, por bëra mirë që erdha edhe këtu, se paskam pasë nevojë të më flisje e të më bindje si atëherë në luftë. Atij i thashë se për Partinë dhe për shokun Enver unë hidhem në flakë, por, kur të kthehem, do t'i them se tash e di më mirë pse u dashka hedhur në flakë unë i pari.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shumë mirë ke bërë që e ke dhënë fjalën. Rëndësi ka të bashkohen gjithë fshatarët e Shmilit në kooperativë. Krijimi i kooperativës, Sadik, është çështje e madhe, shumë e rëndësishme. Ajo ka qëllim të përmirësojë jetën e të gjithë fshatarëve dhe t'u shtojë lumturinë. Në këtë kuadër do të shihet edhe çështja jote.

Në qoftë se tani shtrohet çështja që në Shmil të bëhet kooperativa, ti duhet të jesh nga të parët që të ndihmosh dhe të influencosh për të mirë. Kur fshatarët të shohin se ti, njeri i sëmurë që nuk ke mundësi të punosh, që edhe djalin e ke të sëmurë, vajzat të vogla, vajza tjetër do të martohet dhe për punë jashtë shtëpisë ke vetëm gruan, atëherë ata do të thonë: more këtu po hyn ky, po ne përse të mos futemi? Po të ishte e keqe kooperativa, Sadiku nuk do të futej.

Kini parasysh se edhe shteti do t'ju ndihmojë, si kooperativë. Shteti ynë e ka ndihmuar fshatarësinë, edhe atëherë, në fillim, kur ishte shumë i varfër. Tani ai është më i fuqishëm ekonomikisht, prandaj do t'ju ndihmojë sa më shumë që të jetë e mundur. Shteti do t'ju japë kredi që të bleni lopë dhe qe, do t'ju sjellë makineri bujqësore që t'ju lehtësojë diçka nga punët e rënda, ju vetë do të hapni toka të reja. Kështu bëhen këto punë.

*SADIK CEKA:* Unë e dhashë fjalën.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ndoshta edhe Ali Gjura ka për t'u kthyer përsëri në Shmil kur të ngrihet kooperativa. Ti, Ali, në qoftë se shkon në Shmil, kur të mbliidhen për të vendosur për kooperativën, t'u thuash fshatarëve të tu: «Ore burra e gra, në të kaluarën ne kemi hequr të zitë e ullirit, mirëpo, që kur e mori Partia në dorë jetën tonë, ne po shohim ditë të mira. Çdo gjë që na tha ajo u bë dhe u bë mirë. Tani na thonë të ngremë kooperativën. E ku ka më mirë se kooperativa! Kur u ngritën kooperativat në fusha para 10-15 vjetësh, ne fshatrave të malësisë Partia na këshilloi të mos nxi-toheshim hëpërhë. Mirëpo tani ju e shikoni ç'po bëhet

kudo në Shqipëri. Edhe në fshatin tonë janë bërë shumë shtëpi të reja, shkolla, dyqane, shumë njerëz punojnë në ndërmarrjet e shtetit, populli rron më mirë, por nga ç'kam parë unë andej poshtë nga fushat, fshatarët e zonës së Elbasanit që kanë hyrë në kooperativë, kanë ecur më përpara se ne, për arsye se tokat e tyre të kolektivizuara prodhojnë më shumë etj., etj. Nga ç'kam parë unë, Ali Gjura, që marr edhe 2 000 lekë të vjetra pension në muaj, e kam zili kooperativën. Tani, thuaju shmilasve, shteti ka mundësi të na ndihmojë më shumë me parmenda, me qe, me plugje, me pleh kimik që do ta prodhojmë vetë me shumicë këtu në vendin tonë, në Fier, ai do të na ndihmojë shumë në çdo drejtim tjetër. Në qoftë se tani marrim 10 kuintalë bereqet për hektar, kur të kemi edhe ujë, edhe pleh, do të marrim shumë më tepër<sup>1</sup>, sepse në të ardhmen, pas ngritjes së kooperativës, edhe ujët që kemi, do të rregullohet më mirë nëpër kanale ujitëse. Në qoftë se atje ku nuk ka ujë, si në Qerret, do të na duhet të bëjmë një hauz, mund ta ndërtojmë fare mirë një të tillë andej nga Buzanët, që ujët të vijë edhe në Qerret. Punë të tilla tani dinë të na i bëjnë shumë mirë inxhinierët, djemtë tanë, që sot i kemi me shumicë, se i ka përgatitur Partia nëpër shkolla. Tani, banorët e Qerretit, duke qenë të veçuar, nuk e bëjnë dot këtë punë, sikundër nuk e kanë bërë gjatë gjithë kohës, prandaj ejani, shokë, të bashkohemi në kooperativë që të na ndihmojë edhe shteti me vegla, me dinamit, me inxhinierë dhe me siguri do ta bëjmë

---

1 Në vitin 1979 në zonën malore të Shmilit u morën 54 kuintalë misër për hektar dhe 24 kuintalë grurë për hektar.

edhe këtë rezervuar e çdo gjë tjetër që do të na duhet. Tani mund të na duket çudi si kemi për ta sjellë ujin në Qerret. Sigurisht, kështu të veçuar si jemi unë e ti, me nga një ka, vërtet nuk e sjellim dot, por, kur të bëjmë kooperativën, do të kemi shumë mundësi ta sjellim dhe atëherë do të kemi më shumë bukë, më shumë misër, mish, lesh, qumësht etj.» Pra, ti, Ali, kështu duhet të flasësh, që fshatarët ta kuptojnë si duhet këtë që thotë Partia. Frytet e kësaj pune do t'i shikojnë së shpejti.

Ja, edhe labinotasit për një kohë të gjatë nuk deshën të futeshin në kooperativë, por e ngritën më së fundi. Labinoti, për sa i përket tokës dhe ujërave, e vërteta është që i ka më të mira nga ju, prandaj edhe ca më përpara duhet ta kishte krijuar kooperativën. Sikur Labinoti ta kishte bërë këtë punë 10-15 vjet më përpara, misri atje tani do të bëhej dy bojë njeriu.

Do të vijë dita që, mbasi ta kenë ngritur kooperativën bujqësore, në Shmil të vijë edhe automobili e traktori. Kështu, pra, bëni edhe ju, siç thotë Partia dhe, kur të vijë përsëri Jashari për ngritjen e kooperativës, ju duhet ta mbështetni atë, se kështu zbatoni porositë e Partisë.

*SADIK CEKA:* Ne do ta mbështetim. Për 6-7 vjet, derisa të më rriten ca vájzat, kam për të qenë në vështirësi, megjithatë unë nuk i dal pengesë kooperativës, se kam 23 vjet që jam me Partinë, e kryetar i pushtetit në fshat për një kohë të gjatë. Edhe gjatë luftës asnjëherë nuk i kam thënë jo Partisë, edhe sot jam po ai Sadik i vendosur për Partinë, prandaj, kur të mblidhemi si fshat, unë kam për të folur i pari para popullit.



Kam punuar dhe dua të vdes me punën e Partisë e të pushtetit.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Jam shumë i gëzuar që e gjetëm fjalën dhe erdhëm në një mendje edhe për këtë çështje. Partia ju ka pasur mbështetje edhe atëherë kur luftonim për ta çliruar atdheun, ju ka mbështetje edhe në këtë luftë të madhe që po bëjmë për ta ndërtuar krejt të re Shqipërinë tonë, jetën tonë.

Sa herë t'ju bjerë rruga këndeje, kthehuni të bisedojmë si miq të vjetër.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## PAS NDARJES ME REVIZIONISTËT NEVOJITET UNITETI I FORCAVE MARKSISTE-LENINISTE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

10 tetor 1966

Jam dakord me vërejtjet e të gjithë shokëve. Këto, së bashku me vërejtjet që do të bëhen në mbledhjen plenare të Komitetit Qendror, t'i kemi parasysh kur të përfundojmë definitivisht raportet që do të mbahen në Kongresin e Partisë.

Me këtë rast, përpara Byrosë Politike, dëshiroj të flas diçka më gjerë nga ç'e kemi trajtuar në raport, për çështjen e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Kjo është me shumë rëndësi, sepse pas ndarjes me revizionistët, në lëvizjen komuniste ndërkombëtare nevojitet uniteti i të gjitha forcave marksiste-leniniste në botë. Pa këtë unitet nuk mund të zhvillohet lufta kundër revizionizmit modern.

Po të shohim historinë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare del se kështu ka ndodhur qysh kur u

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të PPSH, i cili do të mbahej në Kongresin e 5-të të Partisë.

krijua Internacionalja e Parë. Më vonë edhe Internacionalja e Tretë arriti shkëputjen me tradhtarët e klasës punëtore pas një polemike të madhe që bëri Lenini dhe përkrahësit e veprës së tij kundër socialdemokracisë. Kominterni jo vetëm konkretizoi shkëputjen me këtë rrymë armiqësore, po ndihmoi e i dha forcë krijimit të partive të reja komuniste e punëtore që dolën nga përçarja, ai u dha këtyre ndihmë organizative, politike dhe ideologjike. Edhe Informbyroja bëri një punë të madhe pozitive duke demaskuar titizmin. Po të mos ishte Informbyroja, titizmi mund të mos ishte demaskuar ashtu sikurse u demaskua.

Si një parti marksiste-leniniste. Partia jonë e quan detyrë internacionaliste të vazhdojë me guxim e me konsekuencë luftën kundër revizionizmit modern dhe të ndikojë me të gjitha mundësitë që ka për forcimin e unitetit në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Ajo është e vogël për nga numri i anëtarëve, por zbaton me besnikëri dhe deri në fund parimet e marksizëm-leninizmit. Me luftën që ka bërë dhe me qëndrimet e drejta që ka mbajtur, Partia jonë ka arritur t'i thotë mendimet e veta me guxim, pa druajtje dhe në çdo rrethanë në interesin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Fakt është se në gjithë veprimtarinë e saj të drejtë ajo ka vepruar pa pasur asnjë shfaqje të mendjemadhësisë ose të inferioritetit.

Armiqtë e kanë cilësuar Partinë tonë si satelite të Bashkimit Sovjetik e si bisht të Kinës, më vonë na kanë quajtur megalomanë dhe s'ka dyshim se edhe në të ardhmen kështu do të na quajnë, sepse as që janë në gjendje t'i kuptojnë e t'i shpjegojnë veprimet

e saj të guximshme, kurse marksistët e vërtetë, që i kuptojnë gjërat siç janë, do të thonë se Partia e Punës e Shqipërisë është një parti marksiste-leniniste, që i thotë hapur mendimet e veta në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe se këtë të drejtë ajo e ka njëlloj sikurse një parti e madhe. Edhe përpara, edhe në të ardhmen kanë ekzistuar e do të ekzistojnë parti me një numër të madh anëtarësh dhe parti me një numër të vogël anëtarësh, por karakteri, vendi dhe roli i një partie nuk përcaktohen nga numri i anëtarëve. Çështjen që nuk ka parti mëmë dhe parti bijë, parti të madhe e parti të vogël, marksistët e kuptojnë drejt. Partia jonë, si gjer tani, kurdoherë duhet të jetë e matur, t'i peshojë mirë gjërat, ta ruajë guximin marksist-leninist. Këto duhet të jenë karakteristikat dalluese e çdo partie marksiste-leniniste, pavarësisht nëse është e madhe apo e vogël për nga numri. Pra edhe këtu uniteti është i nevojshëm.

Si paraqitet sot uniteti në lëvizjen komuniste ndërkombëtare? Ekziston një koncept për një unitet revizionist, që shfaqet në variante të ndryshme. Një nga këto variante është uniteti që kërkon, për shembull, Kim Ir Seni. Në një fjalim që ka mbajtur ky, del se është për një unitet që të marrë hov nga lufta në Vietnam, domethënë nga lufta që bëhet kundër imperializmit në Vietnam, të marrë shkas bashkëpunimi komunist ndërkombëtar dhe «të likuidohen» mosmarrëveshjet që ekzistojnë në gjirin e komunizmit botëror. Ky lloj uniteti s'është gjë tjetër veçse një variant i unitetit revizionist.

Kemi edhe unitetin e vërtetë marksist-leninist dhe Partia jonë është për këtë lloj uniteti. Ajo lufton të demaskohet uniteti antimarksist dhe të mbrohet uniteti i vërtetë marksist-leninist i partive.

A ekziston sot uniteti i vërtetë e i plotë i mendimit dhe i veprimit marksist-leninist në lëvizjen komuniste ndërkombëtare? Këtë e kemi për detyrë ta gjykojmë. Mendoj se ky unitet edhe ekziston, por jo sa duhet dhe si duhet, për shumë arsye: së pari, për arsye të rritjes së kësaj lëvizjeje e të mungesës së eksperiencës; së dyti, për arsye të pozitive të veçara të çdo partie marksiste-leniniste ose grupi revolucionar dhe sepse për shumë çështje kapitale të përbashkëta nuk ka mendime plotësisht të njëjta; së treti, për arsye të luftës së organizuar dhe të kombinuar që i bëjnë marksizëm-leninizmit revizionizmi modern dhe imperializmi. Pra, edhe ka, edhe nuk ka unitet në atë shkallë që duhet.

Tani nuk është koha të hyjmë në hollësi të kësaj çështjeje, por është e domosdoshme të gjenden forma e metoda për të kapërcyer pengesat në forcimin e unitetit. Lëvizja komuniste ndërkombëtare duhet të udhëhiqet nga marksizëm-leninizmi i interpretuar dhe i zbatuar drejt në konditat e përgjithshme aktuale dhe në pozitë e veçanta të çdo vendi ku vepron partia ose grupi marksist-leninist. Pra këtu nuk shtrohet çështja të udhëheqë ajo ose kjo parti, ai ose ky grup, por të udhëheqin parimet, të udhëheqë marksizëm-leninizmi.

Si do të arrihet ky unitet? Për këtë kërkohet, në radhë të parë, një analizë e situatës aktuale, se janë zhvilluar gjithë këto ngjarje në botë, mirëpo nga ana e

partive marksiste-leniniste nuk është bërë analiza e tyre. Por kjo analizë nuk mund të bëhet vetëm nga një parti, pikëpamja e një partie nuk mund të jetë fener për të gjitha partitë<sup>1</sup>. Pra, duhet konsultim i përbashkët për analizën e situatës dhe nga ky konsultim do të dalin orientime të drejta për luftë në kushtet e përgjithshme të lëvizjes komuniste dhe në kushtet e veçanta të çdo partie.

Cilat janë problemet kapitale që kërkojnë një përcaktim të përbashkët, i cili do të ndihmojë përpjekjet tona për të kalitur unitetin dhe për të forcuar luftën tonë kundër revizionizmit modern?

1) Ndarja definitive me revizionistët modernë kërkon një mbledhje të veçantë që të vëmë një vijë demarkacioni me ta. Kjo mbledhje ndihet e nevojshme sepse vazhdojnë dhe do të vazhdojnë lëkundje nga disa, si koreanët, që thonë se janë kundër revizionizmit, por në praktikë nuk janë<sup>2</sup>.

---

1 Kundërvenie ndaj Partisë Komuniste të Kinës, në udhëheqjen e së cilës kishte prirje për t'i diktuar lëvizjes marksiste-leniniste të botës. Tezat e saj që filluan të propagandohen ishin: «Maocedunideja është shpirti i revolucionit botëror»; «Teoria më e madhe është përmbledhur në veprat e kryetarit Mao»; «Maocedunideja është politika e parë e të gjitha politikave, thelbi i shpirtit, qendra e të gjitha qendrave»!

2 Disa udhëheqës koreanë praktikonin njëfarë doktrine «Monro», domethënë një izolim në vetvete për sa i përket luftës për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Në luftën kundër revizionizmit, ata hiqeshin si «të pavarur në mendime, në veprime e në vendime», por në fakt anonin më shumë nga pozita centriste-oportuniste-revizioniste.

2) Çështja tjetër me rëndësi të madhe është të njihen shkaqet e lindjes së revizionizmit modern. Çdo parti i ka analizuar këto shkaqe, por disa u kanë bërë analizë të thellë e disa janë mjaftuar me një analizë të përciptë. Ka të tjera që ende nuk kanë krijuar bindje për rrezikshmërinë që paraqet ky revizionizëm.

Partia jonë e ka theksuar që duhet t'i njohim mirë shkaqet e lindjes së revizionizmit, që të mundim ta luftojmë atë më mirë. Ky është një problem i madh, i cili kërkon edhe konsultime të përbashkëta, veç punës që bën secila parti për ta thelluar procesin e njohjes dhe analizën, prandaj jam i mendimit se mund të hidhet ideja për konsultime të përbashkëta. Natyrisht, nga kjo ide mund të lindin edhe forma të ndryshme se si t'i organizojmë, por të kemi kurdoherë kujdes se në këto konsultime nuk mund të vijmë me disa fraza të përgjithshme. Për këtë kërkohet një studim i imët i gjendjes, se çdo parti ka pikëpamjet e veta që mund të puqen në vija të përgjithshme me qëndrimin parimor marksist-leninist kundër revizionizmit modern, po ka edhe parti ose grupe që thonë se jemi dakord me këtë qëndrim, mirëpo në fakt vepronë ndryshe, se Kina mendon ashtu siç e dimë<sup>1</sup>. Pra të gjitha këto nuanca e pikëpamje të ndryshme për unitetin duhen njohur e unifikuar në një unitet të vetëm, i cili për ne duhet të jetë patjetër marksist-

---

<sup>1</sup> Shih: Enver Hoxha. «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 283.

-leninist dhe të bëhet baza e luftës aktuale dhe të ardhshme.

3) Është e domosdoshme të përcaktohet mirë qëndrimi ndaj Stalinit, se kjo është një çështje parimore shumë e rëndësishme. Partia jonë kështu e konsideron këtë, kurse shokët kinezë kanë pikëpamjen e tyre. Ata shumë çështje i vlerësojnë me përqindje<sup>1</sup>. Mendoj se është e drejtë që ne ta trajtojmë në raportin e Kongresit çështjen e Stalinit si një çështje parimore dhe për këtë, nga sa doli në diskutimet që u bënë për raportin, të tërë jemi të një mendimi. Kjo mund t'u vijë ca si hidhur shokëve kinezë, por ne nuk duhet të bëjmë asnjë lëshim.

Qëndrimi ndaj Stalinit lidhet edhe me qëndrimin që është mbajtur ndaj Bashkimit Sovjetik në të kaluarën dhe me qëndrimin që do të mbahet në të ardhmen. Çështja e Bashkimit Sovjetik sot duhet të konsiderohet me të drejtë si një çështje kapitale për luftën kundër revizionizmit modern. Në lëvizjen komuniste ndërkombëtare nuk mund ta trajtosh Bashkimin Sovjetik, atdheun e Leninit e të Stalinit, ku socializmi fitoi për herë të parë, sipas qejfit, kur të duash dhe si të duash. Qëndrimi ndaj Bashkimit Sovjetik sot duhet kuptuar drejt, për këtë është e nevojshme të sqarohen shumë gjëra, se në partitë e në grupet marksiste-leniniste ka mendime e qëndrime të ndryshme, ka tulatje para «autoritetit» të madh të Partisë Bolshevike të Leninit e të Stalinit, ka shkarje në po-

---

<sup>1</sup> Mao Ce Duni është shprehur se «30 për qind e veprës së Stalinit është e gabuar dhe 70 për qind është e mirë»!



zitat e propagandës sovjetike, e cila, duke kritikuar Stalinin, indirekt synon të hedhë poshtë eksperiencën e kësaj partie në ndërtimin e socializmit; ka edhe pikëpamje shoviniste ndaj Bashkimit Sovjetik.

Marksistë-leninistëve nuk u lejohet as të tulaten para lavdisë së Bashkimit Sovjetik të kohës së Leninit e të Stalinit dhe të mos ngrenë zërin me forcë kundër revizionizmit modern që mori fuqinë atje, por as të mohojnë veprën e pavdekshme të Leninit e të Stalinit. Për sa i përket ndihmës ndaj Bashkimit Sovjetik, ne gjykojmë si internacionalistë: popujt sovjetikë ndihmohen me të vërtetë kur luftohet me vendosmëri kundër klikës revizioniste që sundon atje, kur atyre u tregon të vërtetën, kur bolshevikët e vjetër i mbështet me kurajë, pse ne kemi besim se do të vijë koha që të dalin edhe në Bashkimin Sovjetik forca të reja marksiste-leniniste, do të luftojnë për ta rindërtuar në të ardhmen pushtetin e diktaturës së proletariatit. Ndihma internacionaliste ndaj Bashkimit Sovjetik ka vlerë vetëm po të bëhet mirë dallimi midis Bashkimit Sovjetik të Leninit e të Stalinit dhe Bashkimit Sovjetik të sotëm, që e kanë futur në rrugën e tradhtisë revizionistët hrushovianë.

Me mënyrën siç po veprojnë shokët kinezë, nuk ka si të organizohet nga pozita të shëndosha lufta kundër revizionizmit sovjetik. Në Kinë po krijohet një frymë ksenofobie e tërbuar, një frymë shovinizmi e antisovjetizmi deri në atë shkallë sa është arrihur të thuhet se gjithë arti ushtarak stalinian duhet fshirë.

E shihni, shokë, se edhe midis nesh e kinezëve

ka fërkime? Këto akoma nuk kanë dalë jashtë Partisë, por një ditë edhe mund të dalin. Kjo varet nga zhvillimi i ngjarjeve, nga qëndrimi që do të mbajnë udhëheqësit kinezë.

Këto çështje, shokë, kanë një rëndësi të madhe për të ardhmen e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, prandaj duhen përcaktuar mirë.

4) Çështje tjetër është ajo e ndihmës më të organizuar politike, ideologjike, teknike e materiale që duhet t'u jepet partive të reja e grupeve marksiste-leniniste, lëvizjeve nacionalçlirimtare, e ndihmës për shumë probleme të tjera të këtij lloji, të cilat janë me rëndësi të madhe për luftën tonë të përbashkët kundër imperializmit dhe revizionizmit. Po si e qysh do të ndihmohet lëvizja nacionalçlirimtare? Ne nuk ndërhyjmë në punët dhe në mundësitë e njërës e të tjetrit në këtë çështje, po përcaktimi i qëndrimeve në radhë të parë në interes të përgjithshëm, nuk ia lidh duart askujt, pra një përcaktim i ri në situatat e reja duhet, është i nevojshëm.

Të gjitha këto dhe të tjera çështje të kësaj natyre njihen, zbatohen në përgjithësi, por në mënyrë jo të koordinuar. Për to ka shumë mendime që puqen, po ka edhe të tilla që nuk puqen, prandaj, po nuk i sqaruar dhe po nuk arritëm të kemi unitet mendimi e veprimi, mund të krijohen kontradikta dhe fillimi i tyre ekziston. Këtë e shohim në mes nesh dhe kinezëve, në mos edhe me të tjerë, por akoma kanë mbetur të pashfaqura. Një gjendje e tillë e dobëson shumë unitetin tonë.

Për partinë marksiste-leniniste është me rëndësi të madhe parimore që ajo të ketë një kuptim të qartë për strategjinë dhe për taktikat e luftës së saj. Strategjia e luftës sonë duhet të jetë e njëjtë për të gjitha partitë marksiste-leniniste, kurse taktikat mund të jenë të ndryshme, por edhe këto duhet t'i shërbejnë strategjisë, zbatimit të parimeve të marksizëm-leninizmit. Të marrim çështjen e 25 pikave<sup>1</sup> të Partisë Komuniste të Kinës. Shokët kinezë me këto 25 pika thanë se hodhën platformën e lëvizjes komuniste, për të cilën nuk u konsultuan me asnjë parti. Ta zëmë se ata presin mendime. Atëherë ne u themi: e jani të mblidhemi, se edhe ne mund të kemi disa pika, edhe të tjerët, gjithashtu, mund të kenë pika dhe të gjitha këto t'i shkrijmë në një platformë të vetme, të cilën ta përpilojmë, ta aprovojmë së bashku dhe ta bëjmë një orientim të përgjithshëm. Kjo është një çështje që ka të bëjë me strategjinë tonë, por taktika që ndoqën kinezët është e gabuar, nuk përputhet me këtë strategji, se nuk mund të përcaktohet platforma e lëvizjes komuniste vetëm prej një partie.

Sa lloje taktikash të veçanta mund të ketë? Të tilla ka shumë, por si partitë marksiste-leniniste e grupet revolucionare që janë në opozitë ose në ilegalitet, ashtu edhe partitë tonë që janë në pushtet, në çdo rast duhet të udhëhiqen nga marksizëm-leninizmi, nga

---

<sup>1</sup> Është fjala për mendimet që hodhën kinezët në artikullin «Propozim në lidhje me vijën e përgjithshme të lëvizjes komuniste ndërkombëtare», botuar në gazetën «Zhenmin-zhibao», qershor 1963.

interesat e përgjithshme të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Të marrim, për shembull, çështjen e kufirit të Kinës me Bashkimin Sovjetik. Kina mund të ngrihet e të thotë që Stalini dhe Bashkimi Sovjetik në këtë çështje kanë bërë gabime dhe kjo ose ajo zonë e Bashkimit Sovjetik është jona, por ajo nuk ka të drejtë. Në qoftë se këtë çështje Kina e trajton pa u konsultuar me njeri, do të thotë se ndërmjet nesh nuk ka solidaritet ndërkombëtar dhe këtë çështje Partia jonë do ta studiojë, sepse ajo nuk është vetëm diçka e brendshme, midis dy vendeve, Kinës dhe Bashkimit Sovjetik. Ajo e kapërcen këtë kuadër dhe ka karakter ndërkombëtar, pavarësisht se hëpërhë qëndron në mes të dy partive, si diçka e brendshme.

Ose të marrim çështjen e Partisë së Punës të Koresë, të Partisë Komuniste të Japonisë dhe së fundi të Partisë Komuniste të Indonezisë. Ne i dimë cilat janë pozitat e këtyre partive. Partia Komuniste e Japonisë, gjer para pak kohësh ishte në pozita shumë të afërta me ne, kurse tani është hedhur në opozitë. Po çfarë ka ngjarë? Ne nuk dimë ç'qëndrime janë mbajtur ndaj kësaj partie nga ana e Partisë Komuniste të Kinës. Në rast se Partia Komuniste e Kinës shihte që Partia Komuniste e Japonisë manifestonte njëfarë prirjeje nga e djathta, ajo mund të kërkonte për këtë çështje një mbledhje partish, mbase jo me të tëra, por të paktën me Partinë e Punës të Koresë, me Partinë Komuniste të Japonisë, me Partinë e Punonjësve të Vietnamit, me Partinë Komuniste të Indonezisë dhe të ndonjë partie tjetër, në atë zonë ose gjetkë, për

të vënë në dukje se në cilat probleme ishin në kundërshtim shokët japonezë. Partia Komuniste e Kinës e propozoi mbledhjen e 9 partive tona, por, kur ne e pranuan këtë propozim, ajo e anuloi, na tha se nuk donin koreanët dhe japonezët.

Partia Komuniste e Kinës propozoi krijimin e frontit të përbashkët antiimperialist duke llogaritur edhe revizionistët brenda në këtë front. A mund të lejohej që ky problem i madh vije, i cili është bazë e luftës sonë, të trajtohej vetëm nga Partia Komuniste e Kinës pa bërë mbledhje, pa u konsultuar, të paktën me 9 partitë tona? Kur ne e kundërshtuam frontin e përbashkët antiimperialist me revizionistët, shokët kinezë u tërhoqën.

Ne e refuzuam propozimin e tyre se ishte anti-marksist, po në fakt ky propozim la një mbresë të madhe te të tjerët, ai u dha armë ku të kapeshin revizionistët. Po të ishim mbledhur, qëndrimi i Kinës nuk do të kuptohej si vendim i shtetit dhe i partisë së madhe. Të tjerët do të shihnin se Partia e Punës e Shqipërisë ka mendimet e veta dhe se çështja e frontit të përbashkët nuk mund të shtrohet ashtu siç e mendojnë kinezët. Pra, do të niste debati. Ata që janë në ujëra revizioniste mund të mos arrinin t'i kthenim nga rruga e tyre, por diçka mund të kishim influencuar. Kurse partitë e tjera që qëndrojnë në pozita të shëndosha, por që mund të kenë ndonjëfarë luhatjeje, do të ishin ndihmuar, se, pas konsultimeve e debateve të përbashkëta, do ta kishin më të qartë qëndrimin që duhej mbajtur ndaj këtij problemi parimor kaq të madh. Mirëpo kjo mbledhje nuk u bë

dhe, në qoftë se do të vazhdohet kështu si gjer tani, nuk është mirë, kjo nuk na lejohet. Ne jemi një Parti e vogël, po kemi të drejtë edhe ne të themi mendimet tona. Pra, këtu ka dy rrugë, ose të thuash mendimin tënd, ose të zvarritesh në bisht të situatës.

Të marrim çështjen e krijimit të partive të reja komuniste marksiste-leniniste. Ne kemi qenë dhe jemi që këto parti e grupe të reja marksiste-leniniste duhen ndihmuar, por kinezët mendojnë dhe veprojnë ndryshe. Ata ndihmojnë kur kanë ndonjë interes të drejt-përdrejtë dhe nuk shohin në radhë të parë interesat e revolucionit. Ndryshe si ta shpjegojmë përkrahjen që i bëjnë Duzes, ndërkohë që nuk ndihmojnë parti të reja marksiste-leniniste? Po pse e përkrahin Duzen, i cili është një titist dhe vepron kundër Partisë sonë? Kam lexuar që ai po bëhet flamur i Kinës dhe ka marrë përsipër të shtypë të gjitha materialet e kinezëve. Të përkrahësh Duzen se shtyp literaturë kineze, t'i bësh preferenca pse tani është me Kinën, kjo nuk është marksiste. Këto nuk mund të jenë taktika të drejta. Pra ka shumë probleme të strategjisë dhe të taktikës që duhen diskutuar e sheshuar.

Me gjithë këto probleme që ka në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, Partia Komuniste e Kinës e eviton mbledhjen e përgjithshme. Po përse e eviton përderisa ajo ishte për mbledhjen e partive dhe pastaj hoqi dorë e tani po organizon mbledhje dypalëshe, një e nga një me çdo parti? Natyrisht, ajo ka të drejtën e saj të bëjë të tilla mbledhje, por ne e kemi për detyrë t'i gjejkojmë këto mbledhje nga rezultatet që arrijnë, nëse janë ose jo për të mirën e përgjithshme. Në fakt po shohim

që nga takimet dypalëshe po dalin deklarata që mbrojnë pikëpamjet kineze, edhe kur këto s'janë të drejta, për shembull, i gjithë preokupacioni i Partisë Komuniste të Kinës është të zhvillojë kultin e Maos deri në atë shkallë sa lëvizja komuniste ndërkombëtare të pranojë se idetë e tij udhëheqin botën, të pranohet nga të tjerët Revolucionari Kulturor kinez dhe vija e Partisë Komuniste të Kinës, me të mirat dhe me gabimet e saj. Kinës i duket sikur ka të drejtë të vendosë për çdo gjë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, njafton që ajo ta shohë të nevojshme. Partia Komuniste e Kinës, megjithëse është shprehur kundër shkopit të dirigjentit, kërkon të jetë vetë shkop dirigjenti, në vend që të zbatojë parimin marksist-leninist të kolegjalitetit, prandaj ajo shkel parimet marksiste-leniniste. Të gjitha këto përbëjnë shumë rreziqe për unitetin.

Të vërtetën le ta shohim në sy. Shokët kinezë me ne kanë filluar divergjencat në heshtje, brendapërbrenda, por është rrezik që këto të zmadhohen, prandaj ne duhet t'u dalim gjërave përpara. Këtë ne e kemi bërë dhe duhet ta bëjmë. Po si mund të veprojmë tani? Mendoj se, sa të gjejmë rastin, të kërkojmë që të flitet haptazi në mes dy partive. Kjo është një detyrë kapitale për ne. Po të zhvillohen diskutimet në rrugë të drejtë marksiste, çështjet zgjidhen, ndryshe do të vijnë duke u thelluar. Eksperienca politike na tregon se kështu filluan kontradiktat tona edhe me sovjetikët, kështu ishin edhe kërkesat e tyre: Me ata u ndamë përfundimisht në Bukuresht dhe në Mbledhjen e Moskës. Me Kinën nuk duhet të arrijmë deri këtu, por edhe mund të arrihet pa dashjen tonë. Pikërisht që të mos

ndodhë kjo, atëherë mbledhjet dy e shumëpalëshe duhet të bëhen në frymën marksiste-leniniste. Është e qartë, ashtu si nuk mund të pranohen *en bloc* mendimet e një partie nga të tjerat, ashtu as pikëpamjet e Partisë Komuniste të Kinës dhe të Partisë sonë nuk ka pse të pranohen *en bloc* nga të tjerët. Të gjitha partitë kanë të drejtë të thonë mendimin e vet për çështje që i interesojnë lëvizjes komuniste ndërkombëtare, prandaj ka rëndësi mbledhja e përbashkët e përfaqësuesve të partive e grupeve marksiste-leniniste dhe marrja e vendimeve të përbashkëta. Po të bëhet mbledhja dhe po të analizohet situata drejt, me frymë të shëndoshë, do të përcaktohen edhe forma pune e detyra më të studiuara për lëvizjen komuniste dhe për secilën parti.

Përsë Partia Komuniste e Kinës nuk është për këto mbledhje? Mos vallë mendon se do të akuzohet si hegjemoniste? Në qoftë se ajo nuk është e tillë dhe do të veprojë duke u mbështetur në parimet tona, të cilat nuk e pranojnë hegjemonizmin e një partie, nuk ka pse të mendojë se mund t'i bëhet një akuzë e tillë. Edhe në qoftë se do të mendojë se mos të tjerët do ta marrin shtrembër pozitën dhe qëndrimin e saj, ky do të ishte një gjykim subjektivist. Partia jonë nuk i shikon subjektivistisht çështjet. Ajo është një parti internacionaliste, i mendon drejt problemet dhe këtë e ka treguar në të gjithë veprimtarinë e saj. Ose Partia Komuniste e Kinës mendon të mos ketë ortak në vendimet që do të merren, por të jetë ajo që merr vendime dhe të tjerët të nënshtrohen. Po të jetë kështu, një pikëpamje e një qëndrim i tillë janë të rrezikshëm. Mund të supozojmë edhe një arsye tjetër: të gjitha përpjekjet e Kinës për



ta evituar mbledhjen e përbashkët, tregojnë se brenda në parti dhe në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës mund të mos ketë unitet. Po të jetë kështu, le të na e thonë. Në fund të fundit, kemi të drejtë të themi: derisa Partia Komuniste e Kinës nuk po bën kongreset dhe plenumet e saj, ç'kërkojmë ne që të jetë për mbledhje ndërkombëtare?

Për sa na përket neve, mendimet që kemi pasur ua kemi thënë haptazi shokëve kinezë.

Në vështrim të të gjitha këtyre që thashë, mendoj se është e drejtë dhe e nevojshme që këtë ide ne ta shtrojmë në vija të përgjithshme në Kongresin tonë, pse kjo është normale, është një nga format e luftës e të veprimtarisë sonë. Këtë ide në parim nuk ka kush e kundërshton, e shumta që mund të bëjnë është që ta lënë atë në heshtje. Por janë ata që do të gabojnë dhe jo ne. Në këto situata, pa marrë pjesë Partia Komuniste e Kinës, ne nuk mund të bëjmë të tilla mbledhje. Po Kina mund të vazhdojë të mos dojë. Atëherë ajo mban përgjegjësi. Por edhe në qoftë se Kina nuk e gjen oportune idenë tonë për nevojën e mbledhjes së përbashkët, ne që e gjujmë nga çdo pikëpamje të drejtë, duhet ta hedhim fjalën. Partisë Komuniste të Kinës ne i kemi dalë nga borxhi, i kemi thënë një herë, dy herë dhe ajo i ka shtyrë propozimet tona.

Problemet që shtrova dhe të tjera si këto janë shumë aktuale për forcimin e unitetit marksist-leninist të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, gjë që nuk i zgjidh veçse mbledhja e përbashkët e partive. Partia Komuniste e Kinës, e cila, nga mënyra se si vepron, duket që nuk gjukon kështu. Ajo mendon se mjafton që të tërë të

aprovojnë ato që po bëhen sot në Kinë, duke kujtuar se me këtë kalitet uniteti. Këtë aprovim e rënie në ujdi me ta kinezët kërkojnë ta sigurojnë duke i trajtuar problemet vesh më vesh, gjë që nuk është aspak e mirë. Ne duhet t'i dalim rrezikut përpara. Këto që propozojmë ne janë forma legale, të drejta.

Përse e them këtë? Shokë të grupeve dhe të partive të tjera flasin e shkruajnë me ekzaltim për çka ngjet në Kinë, por nga ana tjetër, kur vijnë këtu, na thonë se nuk janë dakord me këtë ose me atë mendim të udhëheqjes kineze. Unitet është ky? Po ne, çfarë t'u themi? Nesër përfaqësues të partive të ndryshme do të vijnë në Kongresin e Partisë sonë dhe do të flasin. Kush na siguron ne se midis tyre nuk do të ketë edhe ndonjë që, me ose pa qëllim, nuk do të flasë në mënyrë të ekzaltuar pikërisht për këto çështje të vijës së Kinës, për të cilat ne kemi pikëpamje të kundërta? Po në qoftë se do të ketë nga ata që, me qëllim të mirë ose të keq, do të na pyesin, do të kërkojnë mendimin tonë për çfarë po ndodh në Kinë, atëherë si do t'u përgjigjemi ne? Keq t'u përgjigjemi, keq të mos u përgjigjemi. Përgjigjja jonë më e mirë do të jetë ajo që vëmë në raportin e Kongresit. Aty, t'u themi, do të gjeni pikëpamjen tonë dhe qëndrimin e drejtë marksist-leninist të Partisë sonë.

Kjo ishte, në vija të përgjithshme, ideja ime që doja t'ju parashtroja, që të mos gjendemi përpara të papriturave.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **PARTIA DHE POPULLI YNË KANË RESPEKT TË MADH PËR POPULLIN VIETNAMEZ**

*Nga biseda me delegacionin qeveritar  
të RD të Vietnamit*

**13 tetor 1966**

*Në fillim shoku Enver Hoxha u takua përzemërsisht me miqtë dhe u uroi atyre mirëseardhjen në vendin tonë. Pastaj, pasi kryetari i delegacionit përshëndeti në emër të udhëheqjes së partisë dhe të shtetit vietnamez, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Ju faleminderit shumë për fjalët e mira që thatë për popullin dhe për Partinë tonë. E ndiejmë veten shumë të gëzuar që kemi midis nesh përfaqësuesit e popullit vëlla vietnamez, për të cilin te ne i madh e i vogël ushqejnë një respekt dhe dashuri të madhe. Dashurinë dhe respektin tonë, dhe të të gjithë popujve të botës, ju e keni fituar me luftën tuaj heroike kundër imperia-  
lizmit amerikan, këtij armiku të madh të të gjithë nje-  
rëzimit. Lufta e popullit vietnamez në Veri dhe në Jug, duke u drejtuar kundër këtyre fashistëve të rinj, që, me mjetet më barbare ushtarake, politike dhe ideo-

logjike, duan të mposhtin luftërat çlirimtare të popujve dhe të përjetësojnë sundimin e tyre të egër, i shërben mbarë njerëzimit. Ajo, megjithëse zhvillohet në Vietnam, nuk është e izoluar në vetvete, nuk është vetëm lufta juaj, por e të gjithëve, pra edhe jona. Prandaj populli shqiptar dhe Partia e tij e Punës, pavarësisht se janë shumë larg vendit tuaj, jo vetëm shpirtërisht janë pranë jush, por edhe luftojnë bashkë me ju.

Po si marrim pjesë në këtë luftë ne shqiptarët? Aktualisht, për aq sa janë mundësitë tona, ne bëjmë një luftë të madhe politike për mbrojtjen e Vietnamit, luftë të cilën e zhvillojmë hapur, pa dorashka.

Lufta jonë në favor të popullit vietnamez nuk është e ndarë nga lufta që bëjmë brendapërbrenda vendit tonë për forcimin e pozitave të socializmit. Ajo, gjithashtu, nuk është e ndarë edhe nga lufta e ashpër që zhvillojmë ne kundër gjithë armiqve që luftojnë Republikën Popullore të Shqipërisë dhe, mbi të gjitha, kundër revizionistëve modernë sovjetikë dhe imperialistëve amerikanë, që e drejtojnë gjithë veprimtarinë e tyre armiqësore kundër popujve. Lufta që zhvillojmë ne në të gjitha drejtimet, është jetike për vendin tonë dhe për miqësinë luftarake të të dy popujve tanë.

Lufta që zhvillojmë kundër armiqve imperialistë e revizionistë i ka lidhur ngushtë të dy vendet tona. Populli dhe Partia jonë janë nga miqtë, aleatët dhe shokët më të mirë e më besnikë, të cilët do t'ju mbrojnë gjer në fund, sepse ju luftoni dhe bëni sakrifica të panumërta për një çështje të drejtë. Në vendin tuaj po vriten me mijëra luftëtarë, fshatra të tëra po digjen, masakrohen

gra e fëmijë, pleq e plaka, po shkatërrohen bujqësia e industria vietnameze. Megjithatë populli heroik vietnamez nuk mposhtet. Nga gjaku i derdhur lumë po brumosen dhe po kaliten luftëtarë të rinj, lindin heronj që në luftë e sipër po pajisen me një eksperiencë kolosale.

Lufta juaj, si në Veri ashtu edhe në Jug, frymëzohet e udhëhiqet nga qëllime të larta. Këto kanë bërë të mundur të vazhdohet me sukses gjithë kjo luftë e madhe, të përballohet agresioni i imperializmit amerikan dhe të pësojnë disfatë në Vietnam strategjia e taktika e tij. Lufta e vendosur dhe fitorja e popullit vietnamez do të bëjnë të dështojnë me turp të gjitha intrigat e dallaveret politike e ideologjike me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar që po luhen në kurriz të popullit tuaj. Vetëm vija e drejtë marksiste-leniniste bën të mundur që populli jo vetëm të fitojë në luftë, por edhe ta gëzojë fitoren e arritur.

Partia dhe populli ynë kanë respekt të madh për popullin vietnamez dhe përpiqen të mësojnë shumë nga lufta e tij. Përvoja juaj në këtë drejtim tregon se kur populli është i qartë dhe i vendosur të mbrojë lirinë, pavarësinë dhe socializmin, nuk ka forcë që ta mposhtë. Njohja me këtë përvojë i ka entuziazmuar popullin dhe ushtarët tanë dhe u ka hapur atyre perspektiva të reja, prandaj mendojmë se një gjë e tillë është e nevojshme të bëhet nga të gjithë.

Ne jemi të sigurt se ju do të fitoni mbi imperialistët amerikanë, se lufta juaj do të përfundojë me hedhjen në det të tyre, siç ka ndodhur edhe me imperialistët

francezë në Dien Bien Fu<sup>1</sup> dhe kjo do të jetë një fitore për të gjithë ne. Por edhe pasi të mundet ushtarakisht dhe politikisht në Vietnam, imperializmi amerikan do ta vazhdojë përsëri me forma të tjera, dhe, kur t'ia dojë interesi, edhe me armë, luftën kundër popujve dhe vendeve socialiste. Për ta shkatërruar përfundimisht atë do të duhet që në të gjithë botën të arrihen edhe shumë fitore të tjera, si në Dien Bien Fu. Aktualisht duhet luftuar për ta dobësuar dhe për t'i detyruar agresorët amerikanë të ngrenë duart lart dhe të largohen sa më parë nga Vietnami, por lufta e përbashkët e popujve dhe e partive marksiste-leniniste kundër imperializmit amerikan dhe gjithë armiëve të tjerë do të vazhdojë deri në fitoren e plotë të socializmit në të gjithë botën. Prandaj uniteti luftarak marksist-leninist midis popujve dhe partive marksiste-leniniste ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Ndihma e shumanshme reciproke dhe e sinqertë, shkëmbimi dhe përfitimi nga eksperiencia e njëri-tjetrit janë shprehje të unitetit dhe faktorë të rëndësishëm për fitoren e luftës sonë të përbashkët.

Në këtë prizëm e shohim ne edhe ndihmën për vendin tuaj, të cilën e konsiderojmë si detyrën tonë ndaj Vietnamit që lufton. Ne e kemi ndihmuar luftën tuaj edhe nga ana materiale në përputhje me mundësitë dhe kushtet tona. Kontributi ynë në këtë drejtim mund të jetë i vogël në krahasim me ndihmën që ju japin vende

---

<sup>1</sup> Qytet në veri të Vietnamit. Këtu nga 13 marsi deri më 7 maj 1954 është zhvilluar një betejë vendimtare midis forcave franceze të pushtimit dhe atyre të Frontit të Çlirimit të Vietnamit.

të tjera më të mëdha e më të fuqishme, por të jeni të bindur se ndihma jonë për ju ka dalë dhe do të dalë gjithmonë nga zemra e gjithë popullit dhe e Partisë sonë. Ne, sado që jemi një vend i vogël dhe akoma jo i pasur sa duhet, nuk do të mjaftohemi me ato që japim, por do të bëjmë më shumë. Për këtë arsye në programet tona ndihmën për luftën e Vietnamit do ta vëmë si një nga detyrat e para të Partisë, të Qeverisë dhe të popullit tonë.

Por ndihma e kujtdo për ju, edhe sikur të arrinte me miliarda, nuk barazohet me ndihmën dhe shërbimin tuaj të madh që i bëni çështjes së lirisë së popujve dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Prandaj të gjithë duhet ta shtojmë ndihmën për luftën tuaj të madhe, se, fundi i fundit, ne të tjerët jetojmë relativisht në paqe, në fshatrat dhe në qytetet tona nuk bien bombat me napalm; uzinat e fabrikat tona janë të paprekura, ato punojnë; bujqësia jonë zhvillohet normalisht në kushte krejtësisht të ndryshme nga ato të vendit tuaj.

Si të gjithë marksistë-leninistët edhe ne dëshirojmë që ju, miq dhe shokë vietnamezë, të na vini më shpesh për vizitë në Shqipëri, natyrisht jo për çështje ndihme, sepse këtë e kemi pasur dhe e kemi gjithmonë parasysh vetë, përderisa luftën dhe vështirësitë tuaja i konsiderojmë si tonat. Dhënie e ndihmave e kemi për detyrë, bile është detyra jonë që këto t'i përgatitim dhe t'juaj çojmë gjer në Hajfong<sup>1</sup> dhe s'ka nevojë as për të nënshkruar marrëveshje për to, as për të bërë deklarata publike, sepse as populli juaj, që po vë përballë impe-

---

1 Qytet-port në Vietnam.

rialistëve amerikanë batalionet e tij heroike, para se të hidhet në sulm nuk bën asnjë deklaratë. Jo, te ju nuk ndodh një gjë e tillë, populli e ndien thellë detyrën ndaj atdheut dhe kur e sheh këtë në rrezik nuk pret që dikush t'i bëjë thirrje për t'u hedhur i tëri në mbrojtje të tij. Edhe ne kështu veprojmë, jemi kurdoherë të mobilizuar dhe çështjen e ndihmës për Vietnamin, që lufton, e ndiejmë si një detyrë *sine qua non* të vendit tonë.

*Pasi kryetari i delegacionit qeveritar të Republikës Demokratike të Vietnamit falënderoi në emër të partisë, të qeverisë dhe të popullit vietnamez popullin shqiptar, Partinë e Punës dhe Qeverinë shqiptare për ndihmën e madhe, aktive e të pakursyer dhe foli gjerësisht për gjendjen dhe për perspektivat e luftës në Vietnam, e mori fjalën përsëri shoku Enver Hoxha:*

Në emër të Partisë dhe të Komitetit Qendror të saj, ju falënderoj shumë për parashtrimin e hollësishëm që i bëtë gjendjes në vendin tuaj. Kjo na ndihmon shumë, na plotëson dijenitë që kemi pasur gjer tani mbi zhvillimin e luftës suaj, si në Veri ashtu edhe në Jug, kundër agresorëve amerikanë, mbi situatat, mbi strategjinë dhe taktikat ushtarake dhe politike të partisë suaj.

Ju thatë se për zhvillimin e luftës mbështeteni kryesisht në forcat tuaja, në forcën e madhe të luftës popullore, por njëkohësisht përfitoni edhe nga ndihma e vendeve socialiste dhe e disa vendeve e popujve të tjerë të botës. Ne i kemi të qarta vështirësitë tuaja dhe e kuptojmë rëndësinë që kanë ndihma internacionaliste dhe solidariteti ndërkombëtar për luftën në Vietnam, se jemi internacionalistë. Për këtë arsye e kemi theksuar dhe e theksojmë me forcë se të gjithë popujt e botës,



me të gjitha mundësitë e mjetet e tyre, duhet ta ndihmojnë luftën e popullit të Vietnamit kundër imperialistëve amerikanë.

Por dëshiroj të shpreh me këtë rast pikëpamjen e Partisë sonë për revizionistët modernë, me tradhtarët sovjetikë në krye, të cilën ju lutemi t'ua transmetoni shokëve të udhëheqjes suaj. Nuk do të zgjatem në këtë çështje, se partia juaj i njeh pozitat dhe qëndrimet e Partisë sonë.

Ju e dini mirë se ne kemi luftuar dhe do të luftojmë gjer në fund, gjer në shkatërrimin e plotë të revizionizmit modern. Mosmarrëveshjet që kemi me ta, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me çështjen e Vietnamit, janë të pandreqshme. Me revizionistët sovjetikë Partia jonë nuk ka dhe nuk do të ketë kurrë në asnjë fushë, asnjë bashkëpunim. Ne nuk mund dhe nuk na lejohet të bashkëveprojmë në të njëjtin front me këta renegatë të marksizëm-leninizmit as në fushën e ndihmës për Vietnamin. Partia dhe populli ynë janë dhe do të jenë qind për qind solidarë me luftën tuaj të drejtë dhe do ta përkrahin atë me të gjitha forcat, por në asnjë rast nuk do të kenë pika të përbashkëta me asnjë nga revizionistët modernë dhe sidomos me revizionistët sovjetikë, me këta bashkëpunëtorë të fshehtë dhe të hapët të amerikanëve, të vrasësve të popullit vietnamez. Këtë nuk na e lejon as ideologjia jonë marksiste, as ndershmëria dhe as ndërgjegjja jonë.

Pikëpamja e Partisë sonë është se po ta përkrahnin revizionistët me gjithë mend çështjen e Vietnamit, gjëja e parë dhe më e vogël që duhet të bënin, do të ishte

t'u tregonin vendin imperialistëve amerikanë. Por këtë ata as e kanë bërë dhe as që kanë ndër mend ta bëjnë kurrë, sepse Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kanë aleatë dhe bashkëpunëtorë në komplotet e ndyra për sundimin e botës. Ne shqiptarët jemi e do të jemi në thikë e në pikë me revizionistët sovjetikë, sepse ata kanë një vijë të tërë në kundërshtim me marksizëm-leninizmin. Qëndrimi që ata mbajnë ndaj Vietnamit është pasojë e tradhtisë së tyre të madhe.

«Ndihamat» materiale dhe politike që i japin revizionistët Vietnamit, Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar i konsiderojnë një bluf të madh që bëhet me qëllime të paracaktuara. Ato i shërbejnë njërit prej drejtimeve më të rëndësishme të strategjisë së tyre tradhtare, forcimit të pozitave të tyre në atë zonë për pazarllëqe të reja me imperialistët amerikanë.

Revizionistët sovjetikë tani ndodhen në një rrugëkryq. Dëshira dhe qëllimi i tyre i vërtetë është aleanca me imperialistët amerikanë për sundimin e botës. Por, nga ana tjetër, ata s'mund ta braktisin hapur çështjen vietnameze, sepse kjo do t'u shkaktonte humbje kolosale, plus atyre që kanë pësuar gjer tani. Prandaj premtimet dhe zhurma për «ndihamat» që i japin Vietnamit bëjnë pjesë në taktikat e tyre për jetë ose për vdekje. Në të gjithë hapat që ata bëjnë, synojnë të mos prishet ekuilibri me imperialistët amerikanë dhe të konsolidojnë pozitën e lëkundura të burokracisë revizioniste në Bashkimin Sovjetik. Por strategjia e tyre nuk do të fitojë dhe taktikat e tyre do të demaskohen, sepse janë antirevolucionare e antipopullore. Partia e

Punës e Shqipërisë jo vetëm nuk do të ndjekë kurrë taktikat e revizionistëve, por do t'i luftojë ato vazhdimisht me ashpërsi.

Partia dhe Qeveria jonë i ndjekin me vëmendje të madhe përpjekjet që po bëjnë revizionistët modernë për ta gjunjëzuar Vietnamin dhe për t'ju çuar ju në bankën e bisedimeve me imperialistët. Ne nuk i dimë konkretisht intrigat që ata thurin në prapaskenë në kurriz të luftës suaj, por situatat i gjejkojmë nga të gjitha veprimet e tyre në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ne gjejkojmë kështu: çfarë duan Maureri<sup>1</sup>, të dërguarit hungarezë dhe përfaqësues të tjerë nga vendet e ish-demokracisë popullore dhe nga Bashkimi Sovjetik që vijnë njëri pas tjetrit në Vietnam? Ju i dini qëndrimet tona, ne jemi dhe do të jemi me luftën tuaj gjer në fitore. Një qëndrim të tillë luftarak le ta mbajnë edhe ata. Ne nuk e dimë përse revizionistët e vizitojnë shpesh Vietnamin, por mendojmë se qëllimi i tyre nuk është ndihma, por diçka tjetër. Ata vijnë në Vietnam për të bindur udhëheqjen e partisë dhe të shtetit tuaj të heqë dorë nga lufta e vendosur gjer në fund kundër imperializmit amerikan dhe të krijojnë njëfarë të çare në lëvizjen marksiste-leniniste. Por gjer tani po vëmë re me kënaqësi se gjithë këta «lejlekë» që vijnë në «Qabe», kthehen andej me pendë të varura si pula të lagura kur i zë shiu, sepse kanë dështuar përpara qëndrimit tuaj heroik e të vendosur.

---

1 Ion George Maurer, në atë kohë kryetar i qeverisë rumune.

Revizionistët sovjetikë e të tjerë<sup>1</sup> po trumbetojnë me bujë të madhe se janë gati të dërgojnë vullnetarë në Vietnam. Këtë ata nuk e bëjnë pse janë marksistë apo internacionalistë, por për interesat e tyre hegjemoniste, për të mbuluar ndyrësirat e tyre, për të mbuluar tradhtinë dhe për të gënjer popullin e vendeve të tyre, për të krijuar përshtypjen se gjoja janë në rrugë të drejtë. Ata i bien tamtamt, bëjnë shumë zhurmë, vetëm për propagandë dhe demagogji.

Ju e dini sa shumë i kemi dashur dhe ç'respekt të jashtëzakonshëm kemi pasur dhe kemi ne për bolshevikët dhe për popullin sovjetik, i cili nuk është as sabotator, as i frikshëm, as jointernationalist. Këto kohë po bëhet zhurmë sikur Bashkimi Sovjetik mund të dërgojë vullnetarë në Vietnam. Por ky është një bluf dhe po qe se tradhtarët që janë në fuqi në Bashkimin Sovjetik do të dërgojnë me të vërtetë «vullnetarë», ata nuk do të jenë vullnetarë, por njerëz të tyre, agjentë dhe provokatorë për të sabotuar luftën e popullit tuaj.

Kjo është, me pak fjalë, pikëpamja e Partisë sonë për çështjen e Vietnamit që e kemi menduar dhe e kemi vendosur mirë. Qëndrimin tonë e kemi peshuar në dy drejtime: si për sa i përket ndihmës për ju, ashtu edhe për lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Partia e Punës

---

1 Këtu shoku Enver Hoxha bën aluzion për udhëheqës koreanë, të cilët, para se të deklaroheshin se «do të dërgojmë vullnetarë nga Koreja në ndihmë të popullit vietnamez», duhet të vepronin energjikisht që të mos shkonin «vullnetarë» nga Koreja e Jugut në favor të agresorëve amerikanë, kundër popullit vietnamez.

e Shqipërisë mendon se lufta që zhvillon kund vizionizmit modern jo vetëm nuk e dobëson ndihmë saj për Vietnamin, por, përkundrazi, mbron çështjen e drejtë të tij. Duke demaskuar veprimtarinë e tyre tradhtarë, ne ndihmojmë ideologjikisht edhe çështjen e Vietnamit, edhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare, sikurse dhe lufta juaj i shërben si çlirimit të vendit tuaj, ashtu edhe fuqizimit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Vizitën e delegacionit tuaj ne e vlerësojmë si një ngjarje me rëndësi. Nga ju mësuam shumë gjëra për vështirësitë dhe për sukseset e arritura në luftën tuaj. Ne ju sigurojmë se te Partia jonë dhe te vendi ynë i vogël, megjithëse larg nga pikëpamja gjeografike, keni pasur e do të keni kurdoherë miq besnikë, të sinqertë e marksistë-leninistë që, sido që të jetë koha, e mirë, me furtunë apo me rrufe, do të jetë kurdoherë me çështjen tuaj të drejtë.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

## **DISA MENDIME PARAPRAKE PËR REVOLUCIONIN KULTUROR PROLETAR KINEZ**

*Fjala në Plenumin e 18-të të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**14 tetor 1966**

Dëshiroj, shokë, të shfaq disa mendime paraprake për Revolucionin Kulturor Proletar që po zhvillohet në Kinë gjatë këtyre muajve. Them mendime paraprake, sepse ky revolucion është një problem i madh dhe serioz, që kërkon nga ana jonë thellime të mètejshme, analiza më të hollësishme, të bazuara në fakte më të plota, mundësisht kërkesa për sqarime nga shokët kinezë dhe të gjitha këto t'i analizojmë me kujdes në prizmin e marksizëm-leninizmit. Shumë gjëra ne nuk i kemi të qarta, mund të bëjmë dhe bëjmë supozime,

---

<sup>1</sup> Kjo mbledhje plenumi u zhvillua për të shqyrtuar e miratuar raportin që do të mbahej në Kongresin e 5-të të PPSH, por shoku Enver Hoxha, jashtë rendit të ditës, mbajti në Plenum fjalën mbi «Disa mendime paraprake për Revolucionin Kulturor Proletar kinez», për të cilin kishte marrë edhe aprovimin e Byrosë Politike të KQ të PPSH, në mbledhjen e datës 10 e 11 tetor 1966.

por ato mbeten supozime, të cilat duhet t'i vërtetojnë faktet, t'i vërtetojë jeta.

Por, pavarësisht se nuk kemi aq të dhëna, Komiteti Qendror duhet të gjykojë mbi këto të dhëna që kemi dhe të ketë një mendim të brendshëm pak a shumë të qartë. Nuk përjashtohet mundësia që në disa gjykime ose përcaktime të mos jemi aq të saktë për arsyet që përmenda më lart. Por analiza e parë paraprake dhe e shkurtër (se në këtë mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror nuk figuron ky problem në rendin e ditës), dhe kritikën që ne mund t'u bëjmë principeve dhe formave të këtij revolucion kinez, shtyhen nga qëllime të mira shoqërore, nga parimet e drejta marksiste-leniniste, nga nevoja urgjente, nga imperativi i unitetit marksist-leninist në mes të dy partive tona dhe nga reperkusionet që mund të ketë ky revolucion në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Revolucioni Kulturor Proletar, kështu siç e kanë shtruar dhe si po e zhvillojnë udhëheqësit kinezë, ka dy aspekte në një problem të vetëm: aspektin kombëtar dhe aspektin ndërkombëtar. Qoftë njëri, qoftë tjetri, qoftë një i tëri, u intereson Partisë sonë, partive të tjera marksiste-leniniste dhe gjithë botës.

Ky Revolucion Kulturor Proletar shihet, analizohet, interpretohet, lavdërohet apo kritikohet nga shumë pozita të ndryshme, bëhen shumë spekulime mbi të, por ne mund të themi se interpretimi bëhet kryesisht në tri drejtime: interpretimi nga pozitat e borgjezisë kapitaliste, interpretimi nga pozitat borgjezo-revizioniste dhe interpretimi nga pozitat e vërteta konstruktive marksiste-leniniste.

Gabim i madh do të ishte nga ana e shokëve kinezë, në rast se ata do t'i konfondonin këto qëndrime dhe t'i futnin në një thes, ndërkohë që dy të parët janë dia-metralisht të kundërt me të tretin. Në këtë rast do t'u mungonte objektiviteti marksist-leninist.

Revizionistët modernë, si gjithmonë, me një demagogji të madhe do të shfrytëzojnë Marks, Engelsin e Leninin me qëllim që të luftojnë kundër Kinës dhe Partisë Komuniste të saj në disa aspekte, qoftë në parim, qoftë në shfaqje e në veprim të Revolucionit Kulturor kinez, dhe, njëkohësisht, për të maskuar më mirë, me këtë rast që u jepet, degjenerimin e kulturës socialiste në vendet ku ata janë në fuqi dhe në botë. Pra, me një gur, revizionistët kërkojnë të vrasin dy zogj. Por e keqja më e madhe qëndron në atë se Partia jonë dhe partitë e tjera marksiste-leniniste, në analizat dhe në kritikën marksiste-leniniste jopublike që do t'u bëjnë disa aspekteve të këtij revolucioni, mund të gjenden në format, por jo në qëllimet, në pozita të njëjta me këta demagogë tradhtarë. Armiqtë do ta shfrytëzojnë këtë gjë dhe shokëve kinezë u bie barra e rëndë të dallojnë miqtë nga armiqtë, kritikën e drejtë nga e shtrembra e me qëllim të keq.

Pra, e kuptoni shokë sa e vështirë bëhet për ne, për të mos thënë e pamundur, kritika e drejtë, e hapët dhe shoqërore ndaj shokëve kinezë në këto rrethana të koklavitura që përmendëm, si dhe kritika për ato që do të përmend më poshtë, e sidomos për kultin e shfrenuar të Mao Ce Dunit. Por Partia jonë, si kurdoherë, do të mbrojë me guxim, me drejtësi, pa frikë parimet dhe do të gjejë jo vetëm guximin, por edhe urtësinë e



gjakftohtësinë që s'i kanë munguar kurrë dhe që i ka fituar në luftën e vështirë, për t'i thënë mendimin e saj Partisë Komuniste të Kinës, për të diskutuar me durim shoqërisht me shokët kinezë, për të mirën e përbashkët, për të mirën e marksizëm-leninizmit.

Mendimet që do të shfaqim më poshtë i bazojmë në të dhënat, për të cilat ju jeni plotësisht në dijeni, që nga marrëdhëniet në mes Partisë sonë dhe Partisë Komuniste të Kinës për shumë vjet me radhë e te pikëpamjet e Partisë Komuniste të Kinës për problemet e mëdha ndërkombëtare e të komunizmit ndërkombëtar, te shkëmbimi i mendimeve me anë letrash e delegacionesh nga të dyja palët, te shkëmbimi i eksperiencës në rrugë partie dhe shtetërore etj. Gjithashtu për zhvillimin e Revolucionit Kulturor Proletar kinez ju jeni në dijeni që nga e para deri në fund nëpërmjet shtypit tonë dhe më hollësisht nëpërmjet materialit voluminoz të ATSH-së që ju dërgohet çdo ditë, prandaj nuk do të bëj asnjë historik, por do t'ju kujtoj shkurtimisht vetëm disa momente që i konsideroj se kanë rëndësi të veçantë:

1) Shokët kinezë, në kongresin e tyre<sup>1</sup>, dhjetë vjet më parë, jo vetëm nuk e kishin të qartë tradhtinë e Titos, po bënë fajtor Stalinin dhe shfajësonin Titon. Për këtë qëndrim kemi fakte, se e bënë thelb bisedimi me ne. Më vonë, siç e dini, ata e korrigjuan këtë qëndrim, por një nënvleftësim të rrezikshmërisë titiste e ruajtën edhe më vonë përpara rrezikut të madh hrushovian.

---

<sup>1</sup> Kongresi i 8-të i PKK që u zhvillua më 1956.

2) Shokët kinezë nuk e realizuan sa duhet dhe si duhet rrezikshmërinë e hrushovianëve. Ata nuk i pranuan haptazi akuzat dhe shpifjet hrushoviane kundër Stalinit, por një pjesë të madhe i besuan në vetvete dhe përforcuan edhe mendimet e tyre për Stalinin që në kohën e Kominternit e më vonë, gjoja me gabimet e Stalinit ndaj Kinës, «gabime» të cilat na i shtjelloi Çu En Lai apostafat për «të na bindur» kur erdhi këtu herën e fundit, por nuk na bindi dot. Edhe sikur të pranojmë për një çast ato që na tha Çuja për Stalinin, këto, sipas mendimit tonë, nuk bëjnë faje ose gabime parimore, por e shumta janë qëndrime taktike të mbajtura në situata të ndryshme politike dhe ushtarake, të cilat, pa pasur dokumente dhe pa i konfrontuar dhe sidomos kur evenimenteve u ka kaluar një kohë e gjatë dhe nuk ekzistojnë dokumente, të paktën për ne, ato fare lehtë mund të interpretohen të njëanshme.

Më vonë shokët kinezë e kuptuan rrezikshmërinë e hrushovianëve, por taktika e tyre ishte përsëri e butë, sidomos në fillim, bile edhe në Kongresin e 22-të të PK të BS, edhe pas tij, kur ne u sulmuam haptazi dhe zjarri revizionist ishte drejtuar vetëm mbi Partinë tonë, Partia Komuniste e Kinës përpiquej që të pushonte polemika. Pastaj Partia Komuniste e Kinës doli në luftë të hapët e të vendosur kundër revizionizmit modern, për të mos folur kundër imperializmit amerikan.

Por, megjithëkëtë, shokët kinezë fill pas rënies së Hrushovit u lëkundën disi, patën disa iluzione të gabuara dhe bënë disa veprime jo të drejta. Ju e dini episodin

e Çu En Lait me ambasadorin shqiptar<sup>1</sup> dhe qëndrimin e Partisë sonë.

Një qëndrim tjetër i gabuar i kinezëve që ka pasur edhe konsekuenca, sidomos me disa parti, si me atë të Koresë e të Japonisë, ishte propozimi për «krijimin e frontit antiimperialist tok me revizionistët»<sup>2</sup>. Ne e hodhëm poshtë me forcë e me këmbëngulje këtë propozim dhe shokët kinezë u tërhoqën. Këtë ide e kanë ngritur tash si flamur koreanët dhe japonezët. Tani të gjitha këto ju i patë në materialin që lexuat.

3) Me shokët kinezë, siç e dini, kemi pasur një kontroversë<sup>3</sup> parimore, jo kryesisht mbi luftën e klasave, por «mbi ekzistencën e klasës feudalo-borgjeze si klasë, si entitet, që na lufton, bile edhe nga pozita pushteti, në një kohë kur pushteti në vendet tona është diktatura e proletariatit». Ne e njohim tezën tonë dhe këtë e bazojmë në luftën, në faktet, në analizën marksiste-leniniste.

Shokët kinezë kanë pretenduar të kundërtën. Siç e dini, ne u kemi thënë se kjo mund të jetë te ju, por jo te ne, sepse lufta e klasave te ne është ndërmarrë dhe është vazhduar me ashpërsi e me konsekuencë që në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare, pas luftës deri tash e do të vazhdojë kundër mbeturinave të klasës feudalo-borgjeze etj., etj. Nuk ka borgjezi në fuqi te ne. Pikëpamjen e tyre, mundet të nxjerrë pas një analize të

1 Shih: Enver Hoxha. «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 125.

2 Po aty, f. 116.

3 Nga frëngjishtja — polemikë.

gjendjes në Kinë, shokët kinezë kërkonin që edhe ne ta bënim tonën. Por më kot, përpara analizës sonë ata u detyruan ta ulnin tonin, megjithëkëtë ne dyshojmë se nuk janë të bindur dhe vazhdojnë të mendojnë se «shqiptarët gabojnë në analizën e tyre». Dhe ja, ata e bënë edhe tentativën e fundit që këtë konkluzion të tyre të na e impononin në deklaratën e përbashkët kur vajti delegacioni ynë në Kinë. Por përsëri dështuan.

4) Analiza e shkaqeve të ardhjes së revizionizmit në fuqi në Bashkimin Sovjetik, çështje kjo me rëndësi të madhe për komunizmin ndërkombëtar, nga ana e shokëve kinezë, sipas mendimit tonë, nuk ka qenë plotësisht objektive. Ata fajin ia ngarkojnë vetëm Stalinit. Kjo ka rëndësi të veçantë dhe, në qoftë se nuk gabohemi, bëhet disi me tendencë. Partia jonë ka pikëpamje tjetër, analiza jonë mbi këtë problem të rëndësishëm ka anë që puqet me atë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, ka anë që nuk puqet dhe është në kundërshtim. Shkëmbimi i mendimeve, kritikrat e vërejtjet shoqi-shoqit janë të natyrshme, por ato janë konstruktive kur zhvillohen në rrugën marksiste-leniniste.

Çështjet që përmenda më lart i thashë jo pse ato janë bërë pengesë në marrëdhëniet tona me shokët kinezë, po për të mundur, sa të mundim, që nëpërmjet tyre të shohim më qartë në ngjarjet e fundit që zhvillohen në Kinë, sepse, përveç atyre që theksova, mund të ketë edhe gjëra të tjera që ne nuk i dimë.

Zhvillimin e ngjarjeve të fundit në Kinë ne e kemi marrë vesh dhe e ndjekim vetëm me anën e shtypit kinez

dhe të Hsinhuasë. Partia Komuniste e Kinës dhe Komiteti i saj Qendror nuk u kanë thënë shoqërisht asgjë të veçantë Partisë sonë dhe Komitetit Qendror. Ne mendojmë se ajo, në mënyrë internacionaliste, si një parti e lidhur aq ngushtë dhe afër me Partinë tonë, duhej të na vinte më në korent sidomos këta muajt e fundit.

Ju jeni njohur me ekspozenë që na bëri Çu En Lai. Ai nuk pohoi më tepër se ç'na kishte thënë deri atëherë shtypi kinez, po ç'u bë paskëtaj e ç'do të bëhet më vonë nuk dimë, përveç atyre që ka shkruar shtypi. Pra, e kuptoni, shokë, sa prudentë duhet të jemi ne në nxjerrjen e konkluzioneve të plota dhe të argumentuara mirë, pse shumë të dhëna të panjohura të brendshme të partisë së tyre na mungojnë. Ne kemi deri diku shfaqjen e jashtme të evenimenteve, zhvillimin e jashtëm të tyre, si dhe orientimin e zhvillimit të ngjarjeve, por shkaqet, arsyet bazë të tyre ne nuk i dimë, ne mund të imagjinojmë, të bëjmë supozime, të ndërtojmë hipoteza, por serioziteti i madh i problemit dhe serioziteti i Partisë sonë nuk na lejojnë të tregohemi të pamatur e të shpejtuar.

Në qoftë se nuk gabohemi, në kronologjinë e ngjarjeve, çështjet filluan me një artikull të Lin Biaos për ushtrinë, që mund të themi se s'linte të kuptohej ndonjë gjë speciale, veç forcimit të ushtrisë dhe propagandimit të saj të natyrshëm në këto situata ndërkombëtare. Kjo u vazhdua me kritikën e disa romaneve e artikujve dhe shkoi kreshendo, në universitetet e Pekinit, në rektoratet, te profesorët, sulmi kaloi në komitetin e partisë të Pekinit (pa përmendur hala edhe tash emrin e Pen Çenit), kaloi në disa anëtarë të Byrosë, si Lu Din I, tek ai

i ushtrisë, zëvendës i Lin Biaos, e kështu me radhë të krijimi i «Gardës së kuqe» dhe veprimet e saj. Gjatë kësaj kohe doli gjithashtu artikulli i dytë i Lin Biaos që frynte kultin e Maos dhe përsëri rekomandonte leximin e veprave të tij. Ky artikull ishte, si me thënë, kushtrimi etj., etj.

Disa gjëra na tërheqin vëmendjen. Në gazetën kineze komiteti i partisë i Pekinit, natyrisht edhe Pen Çeni, por pa e përmendur me emër (Çu En Lai na e përmendi), Lu Din I, Lo Zhui Çin etj. del se ishin «revizionistë, antiparti, agjentë të borgjezisë» etj., ata përkrahnin elementët borgjezë, letrarë, universitarë etj., dolën në gazeta dhe kritika për shumë vepra të tjera letrare. Pra, sipas tyre, kjo veprimtari armiqësore qëndron në lëmin e kulturës dhe të shkollës. Por këta të tre e të tjerë ishin anëtarë të Byrosë Politike të Komitetit Qendror. Vetëm në këtë sektor ata kishin tradhtuar? Për këtë asgjë s'mund të avancojmë, sepse te kinezët asgjë s'pipëtin. Kur u zbulua ky «komplot i madh», siç thonë ata? Sipas tyre, u analizua gjithë puna, gjithë vija, gjithë veprimet kolegjiale dhe individuale të udhëheqjes, siç bëhet zakonisht në kohë normale dhe sidomos anormale. Ne për këtë s'mund të themi asgjë, sepse kjo është çështje e brendshme e tyre, ne nuk dimë, vetëm mund të themi: si nuk u diktua më parë kjo punë armiqësore që manifestohej në fakt hapur?

Fakt është se kongresi i fundit i PKK ka 10 vjet që është bërë dhe plani i ri pesëvjeçar po kalon pa u parë në kongres. Kjo është anormale, jo e rregullt, thyerje e statutit dhe, me sa mund ta gjykojmë ne nga jashtë, s'ka

pasur arsye objektive që ta ndalonte mbajtjen e tij. Kjo nuk është një çështje thjesht organizative, por është në radhë të parë parimore: udhëheqja supreme e partisë as merr vendime dhe as i jepet llogari, domethënë nuk pyetet. Përse? Këtë nuk mund ta dimë, por mund të themi se është një shkelje shumë serioze dhe këndej mund të rrjedhin shumë gjëra të rrezikshme.

Mirë kongresi, po plenumi i Komitetit Qendror? Katër vjet pa u mbledhur! Si është e mundur? Fakti është fakt. Forumet kryesore të partisë nuk janë përfillur. Si janë gjykuar çështjet, në unitet apo jo në unitet? Shtrembër apo drejt? Këtë s'mund ta themi, asgjë s'mund të themi, se nuk dimë, por ne themi një gjë, që kjo është e parregullt, e paligjshme, e palejueshme, e dënueshme dhe ka konsekuenca të rënda e të rrezikshme për partinë dhe për vendin. Në asnjë parti marksiste-leniniste nuk mund të gjendet një praktikë e tillë.

Ç'gjë i ka shtyrë shokët kinezë që të shkelin rregullat më elementare dhe më jetike për partinë? Shumë gjëra mund të imagjinojmë.

Duke u mbështetur në eksperiencën dhe në normat e Partisë sonë, këto veprime ne do t'i dënonim rreptë, si veprime armiqësore, do t'i goditnim që në farë dhe nuk do t'i lejonim kurrsesi të trasheshin, sepse shembulli i udhëheqjes pasqyrohet deri në bazë, me të mirat dhe me të këqijat e tij.

Mund të merret me mend se si drejtohej e gjithë ajo parti kineze, e madhe në numër, në komitete dhe në territore e me probleme të shumta e të koklavitura.

Të marrim disa çështje. U bë plenumi i 11-të i Komitetit Qendror të PKK pas katër vjetëve. Ç'u bë, ç'u

diskutua, ç'u vendos në të, ne asgjë s'dimë, përveç komunikatës mbi luftën kundër imperializmit e revizionizmit sovjetik dhe disa gjërave që do t'i përmend më poshtë. Por a u analizua vija e partisë, a u vunë në dukje të mirat dhe gabimet, a u vunë përpara përgjegjësisë ata që kishin gabuar, individualisht dhe kolegjialisht, ç'masa u morën për t'i vënë në vend gjërat etj., etj.? Këto janë çështje të brendshme dhe asgjë s'pëpëtin. As kongresi nuk u shpall kur do të bëhet, domethënë do të vazhdohet të ecet pa kongres dhe kjo të lë të kuptosh se punët brenda nuk janë akoma aq në rregull, nuk janë sheshuar e sqaruar. Mund të gabohe mi, por mund të ketë edhe fraksione në gjirin e udhëheqjes; në qoftë se ka pasur, divergjencat duhet të jenë akoma të thella dhe, sipas mendimit dhe praktikës së Partisë sonë, është e zorshme të likuidohen me ato metoda e forma që kanë përdorur deri tash shokët kinezë, të cilët, elementët fraksionistë dhe armiq të njohur të partisë vazhdojnë t'i mbajnë jo vetëm në parti, por edhe në Komitetin Qendror, edhe në Byronë Politike.

Ç'doli zyrtarisht nga mbledhja e Komitetit Qendror? Ju e dini, doli sidomos deklarata me 16 pika për «Revolucionin Kulturor Proletar»<sup>1</sup>, doli Lin Biaoja si njeriu i dytë pas Maos, u publikua një radhitje e re e udhëheqjes kryesore kineze, ku dalin në plan të parë shokë të rinj dhe Liu Shao Çi, Çu De etj. kalojnë në plan të tetë, të nëntë e më poshtë. Kjo të lë të kuptosh se në mbledhje ka pasur diskutime dhe janë marrë masa, por konkretisht nuk dimë asgjë.

---

1 Shih: Enver Hoxha. «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 247.



Dimë një gjë se, më parë se të bëhej plenumi, «Garda e kuqe» qe krijuar dhe kishte hyrë në veprim, domethënë Revolucioni Kulturor kishte shpërthyer dhe tok me të kulturi i Maos u ngjiti në qiell në mënyrë të neveritshme dhe artificiale, sikundër e dini. Çdo gjë u identifikua me Maos; parti, Komitet Qendror gati nuk përmenden dhe del aqik se «partia rron, lufton në sajë të Maos, populli rron, lufton, merr frymë, vetëm në sajë të Maos, të ideve të Maos». Dhe e keqja qëndron në atë se vetë Maoja nuk i vë asnjë fre kultit të tij. Mos vallë ata duhet të kenë arritur në mendimin se partia është krimbur dhe vetëm autoriteti i Maos do të forcojë situatën? Natyrisht, autoriteti i Maos ka rëndësi, por çdo veprim i ndërmarrë nga shokët kinezë duhet bërë në rrugën e drejtë marksiste-leniniste.

Është e natyrrshme se kjo gjë na shqetëson shumë dhe ka përse të na shqetësojë për fatet e komunizmit ndërkombëtar, për fatet e Republikës Popullore të Kinës, të socializmit dhe të marrëdhënieve marksiste-leniniste midis dy partive dhe dy vendeve tona.

Shokët kinezë po i japin një rëndësi të paparë ndonjëherë këtij «revolucioni», por ne nuk po shohim mirë akoma krahas «kësaj rëndësie kolosale» orientime të qarta për këtë «revolucion». Në të 16 pikat, po të lexohen me kujdes, do të gjejmë disa orientime lakonike dhe disa aluzione të përgjithshme për çështje politike dhe organizative partie, që duhet të kenë qenë objekt i diskutimeve në plenum dhe që u jepen masave t'i kenë parasysh. Në mbështetje të atij klasifikimi të komunistëve ose të komiteteve që bëhen në këto 16

pika, Lin Biao flet përpara «Gardës së kuqe» duke thënë se «në udhëheqje ka një grusht kapitalistësh» etj., etj. Për sa i përket çështjes se si duhet zhvilluar ky Revolucion Kulturor Proletar, ç'shtigje duhet të ndjekë, ç'qëllime ka dhe ku duhet të arrijë, kjo të paktën për ne nuk është shumë e qartë, sepse ta përmbledhësh atë në «shkatërrimin e katër të vjetrave» dhe me zëvendësimin e tyre me «katër të rejt», nuk mund të jetë një shpjegim i plotë, as i qartë, por edhe po të përqendrohesh te këto «katër të vjetrat», mund të dalësh me mendimin se shokët kinezë nuk mendojnë aq drejt për revolucionin kulturor dhe për zhvillimin e kulturës socialiste; krijojnë përshtypjen se çdo gjë e vjetër, pa dallim, në kulturën kineze dhe në atë botërore duhet hedhur poshtë dhe duhet krijuar një kulturë e re, kultura që ata e quajnë proletare. Pra, teoria karteziiane «tabula rasa» së kaluarës për të ndërtuar kulturën e re, dhe kjo do të ndërtohet vetëm me «idetë e Maos», duke lexuar veprat dhe citatet e tij që tash në Kinë kanë zëvendësuar çdo gjë.

Tani do t'ju lexoj një citat të Leninit, por ju rekomandoj që librin e tij të shtypur në shqip 10 vjet më parë «Mbi kulturën dhe artin» ta studioni edhe një herë. Duhet kërkuar vazhdimisht në veprat e Leninit e të Stalinit, e të studiohet si e kanë trajtuar ata këtë ose atë problem.

Ja ç'thotë Lenini për kulturën socialiste:

*«Pa e kuptuar në mënyrë të qartë se vetëm duke e njohur me saktësi kulturën që ka kri-*

juar gjithë zhvillimi i njerëzimit, vetëm duke e ripunuar atë mund të ndërtohet kultura proletare — pa e kuptuar këtë ne nuk do të jemi në gjendje ta zgjidhim këtë detyrë. Kultura proletare nuk është një diçka që s'dihet se nga ka dalë, nuk është një shpikje e njerëzve që e quajnë veten specialistë të kulturës proletare. Të gjitha këto janë fund e krye gjepura. Kultura proletare duhet të jetë zhvillimi i natyreshëm i gjithë atyre diturive që ka përpunuar njerëzimi nën zgjedhën e shoqërisë kapitaliste, të shoqërisë çifligare, të shoqërisë burokrate. Të gjitha këto rrugë dhe rrugica kanë çuar dhe çojnë, dhe vazhdojnë të çojnë në kulturën proletare po ashtu, sikundër ekonomia politike, e ripunuar nga Marksi, na tregoi se ku duhet të arrijë shoqëria njerëzore, na tregoi kalimin në luftën e klasave, në fillimin e revolucionit proletar.

Kur dëgjojmë shumë herë si midis përfaqësuesve të rinisë, ashtu edhe midis disa mbrojtësve të arsimit të ri, sulme kundër shkollës së vjetër, kur dëgjojmë të thuhet se shkolla e vjetër ka qenë një shkollë, ku gjërat mësoheshin përmendsh, ne u themi se ne duhet të marrim ato gjëra të mira që ka pasur shkolla e vjetër. Ne nuk duhet të marrim nga shkolla e vjetër atë që ajo bënte duke e rënduar mendjen e të riut me një sasi të panumërt dijesh, nëntë të dhjetat e të cilave ishin të panevojshme dhe

*një e dhjeta e shtrembëruar, por kjo nuk do të thotë se ne mund të kufizohemi me konkluzionet komuniste dhe të mësojmë përmendsh vetëm parullat komuniste. Kështu nuk krijohet komunizmi. Komunist mund të bëhesh vetëm atëherë kur ta kesh pasuruar mendjen tënde me njohjen e të gjitha diturive që ka përpunuar njerëzimi.*

*Ne nuk kemi nevojë t'i mësojmë gjërat përmendsh, por ne kemi nevojë ta zhvillojmë dhe ta perfeksionojmë mendjen e çdo nxënësi me njohjen e fakteve themelore, sepse komunizmi do të shndërrohej në një fjalë boshe, do të shndërrohej në një etiketë të kotë, komunisti nuk do të ishte veçse një njeri mendjemadh dhe i zbrazët po të mos përpunoheshin në ndërgjegjen e tij të gjitha dijet e fituara. Ju duhet jo vetëm t'i përvetësoni këto dije, por t'i përvetësoni në mënyrë të tillë që t'i shikoni ato me sy kritik, që të mos e rëndoni mendjen tuaj me gjepura të panevojshme, por ta pasuroni atë me njohjen e të gjitha fakteve, pa të cilat sot nuk mund të kemi një njeri me kulturë. Sikur një komunist të fillonte të mburrej me komunizmin në bazë të konkluzioneve të gatshme që ka gjetur, pa bërë një punë shumë serioze, të vështirë, të madhe, pa i analizuar faktet, të cilat ai duhet t'i shikojë me sy kritik, një komunist i tillë do të ishte për t'u vajtuar. Dhe kjo cektësi do të ishte jashtëzakonisht e dëmshme. Në qoftë se unë e di se di pak, unë do të përpiqem*

që të di më shumë, por në qoftë se një njeri thotë se është komunist dhe se nuk ka nevojë të dijë asgjë serioze, atëherë ai nuk do të bëhet kurrë komunist dhe as do t'i shëmbëllejë një komunisti»<sup>1</sup>.

Në të njëjtën vepër Lenini thotë gjithashtu:

«Marksizmi e fitoi rëndësinë e tij historike botërore si ideologji e proletariatit revolucionar, sepse marksizmi nuk i flaku aspak realizimet më të vyera të epokës borgjeze, por, përkundrazi, përvetësoi dhe përpunoi çdo gjë të vyer që përmbante zhvillimi më se dymijëvjeçar i mendimit dhe i kulturës njerëzore. Vetëm puna e mëtejshme mbi këtë bazë dhe po në këtë drejtim, e frymëzuar nga eksperiencia praktike e diktaturës së proletariatit, si lufta e tij e fundit kundër çfarëdo shfrytëzimi, mund të quhet si një zhvillim i kulturës me të vërtetë proletare»<sup>2</sup>.

Kjo është e qartë, kurse rruga kineze, siç po trumbetohet, nuk është fort e qartë, të paktën për ne nuk është e qartë.

Në se konsiston ky Revolucion Kulturor kështu siç po zhvillohet në fakt në Kinë?

«Garda e kuqe» po ndërron tabelat e rrugëve e të restoranteve, pse kishin tituj reaksionarë, shkruan da-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 319-320,

2 Po aty, f. 356.

cibao dhe kritikon këdo dhe sido, bastis shtëpi dhe u vë kapele kulakëve e reaksionarëve, duke i shëtitur nëpër rrugë dhe sheshe; thonë se prishin varret e të huajve imperialistë dhe, çka është akoma më e rrezikshme, sulmojnë komitete partie, djegin biblioteka, djegin tablo, prishin monumente të vjetra etj.

Është zor për ne që këtë revolucion, kështu si e zhvillon «Garda e kuqe», ta quajmë Revolucion Kulturor Proletar. Tabelat mund të hiqeshin nga bashkitë, armiqtë mund dhe duhet të kapen nga organet e diktaturës në bazë të ligjeve, në qoftë se kanë infiltruar armiq në komitetet e partisë, le të spastrohen me rrugë partie. Ose, fundi i fundit, armatos klasën punëtore dhe sulmo komitetet, po jo me kalamanët. Përse këto veprime të tilla, në këtë mënyrë të bujshme që kanë më shumë karakter politik sesa kulturor? Dhe të gjithë këtyre që janë vënë në lëvizje për këtë punë, u janë mbyllur shkollat dhe do të rrinë një vit pa shkollë e pa kulturë, u është vënë në dorë një libër i vogël i kuq me citatet e Maos, një shirit i kuq në krah dhe u është dhënë leje të bërtasin.

Cilët janë pionierët e Revolucionit Kulturor Proletar? Janë studentët dhe nxënësit e shkollave dhe në komunikatat kineze thuhet që këta mbështeten nga punëtorët, ushtarët, fshatarët. Kjo, na duket neve, mund të bëhet, po s'është në rrugë të drejtë parimore, por është e rrezikshme, kjo nuk është serioze. Me këto parime, me këto forma, nuk mund të zhvillohet në rrugën e vërtetë marksiste-leniniste revolucionit kulturor socialist ose proletar, siç dëshirojnë ta quajnë shokët kinezë.

Revolucioni kulturor socialist është një problem

shumë serioz, shumë i koklavitur dhe këtë e njohin edhe shokët kinezë (siç e thonë), që duhet të udhëhiqet me seriozitetin më të madh nga partia, e cila të jetë vigjilente në çdo kohë për të kontrolluar vijën, për të verifikuar zbatimin, për të korrigjuar gabimet, për t'u ruajtur nga majtizmat dhe djathtizmat aq shumë të mundshme në këtë sektor kaq të gjerë e delikat.

Krijon përshtypjen se shokët kinezë, duke zbuluar «një rrymë të rëndë armiqësore në literaturë» (dhe këtë përse nuk e kanë parë më parë dhe nuk kanë marrë masa më parë), duke zbuluar se «kuadro të udhëheqjes së partisë dhe të shtetit janë në rrugë kapitaliste» (dhe këtë pse nuk e kanë parë më parë dhe pse nuk kanë marrë masa), duke u zgjuar nga gjumi i rëndë se kapitalistë dhe kulakë janë mahur dhe forcuar, saqë të arrihet në konstatimin se ata janë akoma në fuqi (edhe kjo pse është lejuar), shokët kinezë, pra, mund të kenë arritur në mendimin se të gjitha këto të këqija do t'i zgjidhë Revolucioni Kulturor Proletar, «Garda e kuqe», e përbërë nga të rinjtë, dhe ngritja në një shkallë fantastike e kultit të Maos.

Kjo është një çështje që nuk e kemi shumë të qartë, kjo është mbështetur në dukje në parullën e drejtë të «vijës së masave», por një vijë e masave që kapërcen normat, parimet, që lë mënjanë partinë, drejtësinë e saj dhe mbështetet në kultin e individit, në ekzaltimin e të rinjve joproletarë, të cilët shfrytëzojnë jo drejt të gjitha sukseset e arritura nga partia dhe populli në të gjitha fushat. Një rrugë e tillë mund të lejojë anarkinë, mund të dobësojë besimin e masave të vija e Partisë.

Ne mendojmë se ky Revolucioni Kulturor mund të

jetë një rektifikim i gjithë vijës së partisë, por rektifikim i ndërmarrë jashtë normave leniniste të partisë dhe ligjeve të diktaturës së proletariatit, me kultin e Maos e duke vënë përpara në veprim atë shtresë të popullit më ekzaltuese, më e zhurmshme, më delikate dhe më e lëvizshme si shtresë dhe jo e pjekur dhe e rrahur me vështirësitë e jetës.

Kjo mund të ketë konsekuenca të rënda, qoftë imediatisht, qoftë më vonë, në qoftë se shokët kinezë nuk i korrigjojnë këto gabime që vërtetohen. Eksperienca e Bashkimit Sovjetik, pas vdekjes së Stalinit, na ka mësuar shumë gjëra.

Siç e kuptoni edhe vetë, shumë çështje që unë përmenda më lart, të cilave u përpoqa t'u bëj një vlerësim që mund të jetë edhe i gabuar, pse na mungojnë të dhënat, janë çështje të brendshme të Kinës, të Partisë Komuniste të Kinës, që ne s'kemi të drejtë as të ndërhyjmë, as të themi mendimin tonë, në qoftë se nuk na kërkohet. Por që të mos kemi ne një mendim tonin të brendshëm, orientues, qoftë provizor, me pika të errëta, mundet edhe me disa konkluzione jo të drejta, nuk na lejohet. Nuk na lejohet, gjithashtu, të mos jemi prudentë dhe të matur në çështje të tilla me rëndësi kaq të madhe për çështjen e marksizëm-leninizmit.

Qëllimi dhe kujdesi ynë i madh është dhe duhet të jetë që ne të mos biem në gabime për veten tonë dhe të përpiqemi të shohim në qartë në këtë çështje dhe kur të kemi rastin, në mënyrë shoqërore, të shkëmbejmë mendime me shokët kinezë, në interesin e madh të përgjithshëm.

Por, çdo gjë që ngjet në Kinë nuk është vetëm çë-



shtje e brendshme e Kinës dhe e Partisë Komuniste të Kinës. Duke qenë e tyrja, ajo është njëkohësisht me karakter ndërkombëtar dhe internacionalist, pse Kina është një vend i madh, me peshë të madhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Udhëheqësit kinezë dhe propaganda kineze thonë se «Revolucioni Kulturor ka tronditur gjithë botën». Ky është fakt.

Çu En Lai, më 1 tetor tha afërsisht: «Bota është ndarë më dysh për çështjen e Revolucionit Kulturor, në armiq që na luftojnë dhe në miq që janë me ne dhe na mbrojnë».

Pikërisht këtë aspekt ndërkombëtar dhe internacionalist të Revolucionit Proletar kinez dua tash të prek, pasi e preka atë kombëtar.

Shokët kinezë dhe propaganda kineze tash e vënë problemin kështu: «Epoka aktuale është epoka e ideve të Mao Ce Dunit. Mao Ce Duni është marksisti më i madh i kohërave tona. Mao Ce Duni është trashëgimtari i të gjithë klasikëve të marksizëm-leninizmit, i shkencës marksiste-leniniste dhe i shkencës botërore, ai është dielli» etj., etj. Pra idetë e Mao Ce Dunit u dashka të udhëheqin botën dhe duke u përqendruar në Revolucionin Kulturor Proletar, ky zhvillohet dhe drejtohet personalisht nga Mao Ce Duni. Kjo nuk është parë ndonjëherë në historinë e botës.

Vënia ose vetëvënia kështu e këtij problemi të madh nga ana e shokëve kinezë, nuk është e drejtë, nuk është marksiste dhe nuk vuan nga thjeshtësia. Por ajo që është akoma më e rëndë, më e rrezikshme, është se format dhe metodat që ata përdorin brenda në vendin e

tyre duan dhe i përdorin edhe jashtë, domethënë këtë vënie të padrejtë dhe të gabuar të problemit në format kaq dogmatike, kërkojnë që edhe të tjerët ta pranojnë, ta zbatojnë pa diskutim, pse, përndryshe, për shokët kinëzë, kalon në anën tjetër të barrikadës, të armiqve.

**Kjo është e papranueshme për ne, me gjithë dashurinë dhe respektin që kemi për Partinë Komuniste të Kinës, për shokun Mao, për Kinën e madhe.**

**Pse është e papranueshme? Sepse Partinë Komuniste të Kinës, Maon, Kinën, ne i kemi dashur dhe i duam në rrugën marksiste-leniniste dhe vetëm në këtë rrugë.** Pse është kështu unë nuk mund ta shpreh me disa rradhë, pse kjo është gjithë vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë, se këtë e shpjegon qartë nga çdo pikëpamje dhe në çdo fushë raporti i Komitetit Qendror që porsa aprovuam dhe që do të mbajmë para Kongresit, prandaj s'kam pse të zgjatem për këtë çështje.

Tash disa orientime për ne:

a) Dua të theksoj disa gjëra që Partia duhet t'i ketë mirë parasysh dhe çdo komunist të punojë me kokë dhe jo të presë direktiva nga lart për çdo qëndrim. Qëndrimet e Partisë, të komunistëve e të kuadrove duhet të orientohen nga direktivat e Kongresit, të Komitetit Qendror, të Byrosë Politike dhe të Qeverisë. Këto shprehen qartë në dokumente dhe në shtypin tonë të përditshëm, prandaj këto të përvetësohen dhe nga ato të udhëhiqemi.

b) Vija e luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit modern nga ana e Partisë sonë është e drejtë, prandaj duhet të ecet me vendosmëri në këtë rrugë, pse është vendimtare.

c) Marrëdhëniet ekonomike e miqësore nga ana jonë do të ruhen e do të zhvillohen vetëm në rrugën e drejtë marksiste-leniniste.

d) Kulti i Maos ose i cilitdo qoftë duhet të luftohet dhe çdo gjë të ecë te ne ashtu siç ka ecur, në rrugën marksiste-leniniste. Këtu as më të voglin lëshim, as më të voglin oportunitizëm. Shokët kinezë me qëndrimet e drejta të Partisë sonë duhet ta kenë të qartë këtë çështje. Edhe në qoftë se nuk e kanë të qartë ose në qoftë se u vjen keq, ne nuk mund të bëjmë ndryshe, se kjo është çështje parimore. Ne Maon e respektojmë në rrugën dhe në normat marksiste-leniniste. Për Maon ne do të përdorim vetëm përcaktimet zyrtare të Partisë sonë.

dh) Siç e keni konstatuar, shtypi ynë nuk flet për Revolucionin Kulturor kinez në ato forma dhe në atë mënyrë siç bën propaganda kineze, por ne, shoqërisht, pa acaruar asgjë, e kemi evituar për arsyt që përmenda më lart. Shokëve kinezë mundet dhe sigurisht nuk u ka pëlqyer kjo gjë, por ne s'mund të bëjmë ndryshe, derisa çdo gjë të jetë më e qartë, e drejtë edhe për ne.

e) Propaganda në vendin tonë për Kinën, për sukseset e saj në të gjitha lëmet, edhe në kulturë, edhe në veprat e Maos etj., duhet të zhvillohet në normat e drejta si deri sot dhe të evitohet me takt çdo kërkesë teprimi nga ana e shokëve kinezë, të evitohen lëshimet dhe sektarizmat, pse as njëra, as tjetra nuk i shërbejnë çështjes sonë të madhe që na vihet detyrë ta kalitim në rrugën e drejtë marksiste-leniniste për të mirën e komunizmit.

Me raportin që do të mbajmë në Kongres, mendoj se, duke përcaktuar vijën tonë për shumë çështje, përcaktojmë indirekt edhe disa nga këto qëndrime ndaj pikëpamjeve të shokëve kinezë, të cilët, si me thënë, duhet t'i marrin si objeksione tonat sidomos ndaj kultit dhe Revolucionit Kulturor, ashtu si i konceptojmë ne. Nga Partia Komuniste e Kinës do të vijë në Kongresin tonë një delegacion dhe kemi shpresë se si shokë këto çështje ne do të përpiqemi t'i sqarojmë më tej.

Kaq kisha për t'ju thënë. Komiteti Qendror duhet të na këshillojë nëse i shohim drejt këto çështje. Të gjitha këto çështje mendoj se duhet të mbeten të brendshme, të Komitetit Qendror, për arsye se janë mjaft delikate. Kini parasysh çështjen e madhe të unitetit midis dy partive dhe dy vendeve tona dhe të lëvizjes komuniste marksiste-leniniste ndërkombëtare.

*I gjithë Plenumi i Komitetit Qendror u shfaq dakord me çështjet e paraqitura nga shoku Enver Hoxha.*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**SPASTRIMI I NDËRGJEGJES SË NJERËZVE  
NUK BËHET AS NË NJË VIT E AS  
NË DHJETË VJET**

*Nga biseda me delegacionin e Shoqatës së Miqësisë  
Kinë-Shqipëri*

**17 tetor 1966**

*Pasi u takua me miqtë kinezë dhe i pyeti se si ia kaluan në vendin tonë, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Jemi shumë të gëzuar për vizitën që po bëni në vendin tonë. Mundet edhe të jeni lodhur, por sidoqoftë revolucionarët nuk lodhen.

Miqësia në mes nesh është një faktor i rëndësishëm për përparimin, për ecjen tonë të sigurt përpara në rrugën e socializmit dhe për t'u dhënë grushtin e merituar imperialistëve amerikanë e revizionistëve modernë, me tradhtarët sovjetikë në krye. Partia jonë dhe partia juaj duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet që miqësinë dhe unitetin që ekzistojnë midis nesh t'i çelikosin akoma më shumë në rrugën marksiste-leniniste, sepse kështu do të kapërcejmë më lehtë çdo valë e stuhi që do të na dalë përpara. Kongresi i 5-të i PPSH, ku kemi ftuar

shumë parti dhe grupe marksiste-leniniste, mendojnë se do të kontribuojë në forcimin e këtij uniteti.

Uniteti marksist-leninist midis komunistëve revolucionarë na bën të pathyeshëm dhe na forcon besimin për fitoren tonë të pashmangshme mbi imperializmin dhe revizionizmin modern, prandaj ai i tmerron armiqtë.

Çdo ditë që shkon imperialistët dhe revizionistët dobësohen. Këto ditë revizionistët janë duke u mbledhur përsëri në Moskë. Gjer tani atje kanë arritur Gomułka, Kadari, Çausheku me gjithë ministrat e mbrojtjes, ose më mirë të themi ministrat e kapitullimit. Siç duket ata janë thirrur nga Brezhnjevi dhe Kosigini si dëshmitarë të rremë për të firmosur Traktatin sovjetiko-amerikan të mospërhapjes së armëve atomike. Të paktën kështu thuhet në shtyp. Revizionistët sovjetikë, kur nënshkruan Traktatin sovjetiko-amerikan të Moskës në vitin 1963, nuk i përfillën, nuk i pyetën fare «aleatët» e tyre revizionistë, por zjarri i marksistë-leninistëve i përvëloi hrushovianët për gjithë atë tradhti të madhe që bënë. Tani ata menduan se partitë marksiste-leniniste dhe antirevizionistët e tjerë do t'i ngrenë përsëri topat kundër tyre, prandaj kësaj radhe menduan t'i thërresin të tjerët për të pakësuar sadopak zjarrin kundër tyre. Thonë se do t'i çojnë miqtë e tyre edhe në Bajkonur, në vendin ku sovjetikët kanë bazën e lëshimit të raketave, dhe me këtë rast do të hedhin një grup kozmonautësh sovjetikë për nder të revizionistëve të tjerë.

Revizionistët sovjetikë bëjnë shumë zhurmë për të krijuar përshtypjen se në mes revizionistëve modernë ka unitet. Prandaj ata përpiqen t'i futin revizionistët e tjerë në një shportë dhe kësaj t'i vënë emrin unitet, gjë

që është gënjeshtër, sepse të gjithë revizionistët janë si shporta mbushur me karavidhe, të cilat përpiqen të hanë njëra-tjetrën.

Tani në Kinë po zhvillohet një Revolucion Kulturor me forma dhe me metoda që ju i keni parë të përshtatshme për vendin dhe për popullin tuaj. Pavarësisht nga format dhe nga metodat, ju keni deklaruar botërisht se qëllimi i madh i këtij revolucioni është lufta kundër mbeturinave borgjeze dhe mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve kinezë. Të spastrosh zemrën e ndërgjegjen e njerëzve, mendjen e tyre, t'i bësh njerëzit që të mendojnë, të punojnë dhe të rrojnë si revolucionarë, të kenë karakter me të vërtetë proletar, të hedhin tej mbeturinat e së kaluarës që e mykin revolucionarin, kjo është një detyrë e madhe partie. Nuk mund të jetë komunist një njeri me ndërgjegje borgjeze, komunisti i vërtetë ka vetëm ndërgjegje revolucionare proletare deri në fund.

Edhe Partia jonë ka bërë dhe bën një luftë të vazhdueshme, megjithëse në kushte dhe me metoda të tjera nga ato tuajat, për mendjet dhe zemrat e njerëzve, sepse njerëz me mbeturina borgjeze e mikroborgjeze në ndërgjegje nuk ka vetëm te ju, por edhe te ne.

Ju patët rast të shikonit disa nga shfaqjet tona teatrale. Ne kemi arritur përparime edhe në këtë fushë dhe bëjmë përpjekje që përmbajtja e pjesëve teatrale të jetë revolucionare, popullore, mobilizuese, me qëllim që ato t'i edukojnë njerëzit tanë që të jenë të gatshëm të bëjnë sakrifica, të jenë të thjeshtë, të ndershëm. Megjithatë, pavarësisht nga ajo që kemi bërë gjer tani, kemi akoma shumë për të bërë. Revolucionari-

zimi i njerëzve, pastrimi i plotë i ndërgjegjes së tyre nga mbeturinat e kapitalizmit nuk bëhet as në një vit, as në pesë e as në dhjetë vjet, por kërkon një kohë mjaft të gjatë. Brezit tonë i bie një detyrë e madhe të luftojë që mbi këtë truall të larë me gjak të mbijnë e të rriten lule të bukura e fidanë të shëndoshë, që kurdoherë rinia jonë të edukohet e pastër e revolucionare. Fjalën e kam që ne duhet të punojmë për ta rritur të tillë rininë tonë.

Zhvillimi i revolucionit tonë kulturor është pjesë e pandarë e luftës sonë të gjithanshme për ndërtimin e socializmit. Ju patë fushat tona, patë uzina dhe fabrika, shkolla dhe institucione shëndetësore, rrugë dhe kanale e me siguri keni vënë re përpjekjet e mëdha të popullit e të Partisë sonë, si dhe rezultatet që kemi arritur. Por në rrugën tonë ndërtimtare kemi pasur edhe vështirësi, të cilat kanë qenë shumë të mëdha, sepse vendi ynë ka qenë i prapambetur, bujqësia shumë e varfër, uzina dhe fabrika nuk kemi pasur, kuadro gjithashtu. Partisë dhe popullit tonë u është dashur ta nisnin çdo gjë nga e para dhe t'i ngrinin frontalisht të gjithë sektorët. Natyrisht, kjo ka qenë shumë e zorshme, por Partia jonë punoi qysh në fillim dhe çdo gjë u bë gradualisht në ngjitje, gurë-gurë. Gurë-gurë bëhet mur, gurë-gurë bëhet edhe kalaja, thotë populli ynë, dhe kalaja jonë është bërë sot e fortë dhe armiqtë nuk kanë ç'të na bëjnë.

Ne e ndërtojmë socializmin të rrethuar nga revizionistë dhe imperialistë që janë përreth vendit tonë. Ky është një rrethim, por pas këtij vjen një rrethim i dytë edhe më i madh, ai i imperialistëve amerikanë dhe i re-



vizionistëve sovjetikë. Por sado të rrethuar që jemi, ne nuk trembemi, sepse populli dhe Partia jonë janë të fortë. Pastaj ne kemi miq dhe aleatë popujt dhe revolucionarët e botës. Në këtë mënyrë Republika Popullore e Shqipërisë është bërë për armiq të imperialistë e revizionistë një kockë e fortë që ata nuk mund ta gëlltitin.

Me gjithë prapambetjen e trashëguar nga e kaluara dhe rrethimin armiqësor, sukseset e arritura në vendin tonë janë kolosale. Këto për ne janë të njohura, por bien menjëherë edhe në sy të miqve e të vizitorëve. Disa shqiptarë, që për arsye të varfërisë janë larguar qysh në kohën e Zogut, as që orientohen dot ku janë, kur kthehen për të vizituar atdheun e tyre. Një shok kishte babanë në emigracion, ky ishte larguar qysh para Çlirimit. Djalin e vet ai e kishte lënë të vogël. Kur u kthye nga mërgimi, i biri e priti në Durrës dhe filloi t'i shpjegonte me radhë çfarë ishte bërë në Shqipëri që pas Çlirimit. Ai mbante mend se sa shumë ishte shfrytëzuar nga çifligarët e vendit tonë para se të largohej, ashtu siç vazhdoi të shfrytëzohej në emigracion nga kapitalistët e huaj. Ai mbante mend vetëm Korçën dhe kënetën e Maliqit. Gjatë rrugës për në Korçë, kur djali i tregoi fushën e lulëzuar dhe i tha se ishin pikërisht në Maliq, i ati e pyeti se ku ishte kënetë dhe, kur mori përgjigje se kishte kohë që ajo nuk ekzistonte më, filloi të qante nga gëzimi. I biri i tregoi tërë rrugës se si Partia u kishte dhënë tokë fshatarëve, si u bashkuan pastaj ata në kooperativë, si kanë përparuar kooperativat bujqësore etj. Rrugës, pranë një fshati, babë e bir panë sekretarin e parë të Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës që po

bënte një konferencë me fshatarët mbi agroteknikën e përpeluar. Kur djali i tha se ai që po fliste ishte sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit, plaku me mentalitetet e vjetra, që nuk kishte kuptuar ç'është socializmi, i tha djalit që fshatarët që po dëgjonin me siguri ishin bujqit e sekretarit. Me këtë desha të them se është bërë një revolucion i vërtetë si nga ana materiale, mendore e shpirtërore. Këtë javë në prag të hapjes së Kongresit të 5-të të Partisë, i cili do t'i japë një hov akoma më të madh punës ndërtimore në vendin tonë, do të bëhet inaugurimi i shumë veprave, gjë që do ta gëzojë shumë popullin tonë.

Edhe Republika Popullore e Kinës ka bërë përpapime të mëdha. Njerëzit tanë, kudo që janë, gëzohen për rezultatet tuaja në bujqësi, në industri, në kulturë. Ne mësojmë nga eksperiencia e njëri-tjetrit dhe kjo na ndihmon të arrijmë rezultate më të mira dhe të ecim më shpejt përpara.

Ju vlerësuat shumë lart punën që është bërë për hapjen e tarracave në kooperativën bujqësore të Vri-thit në rrethin e Shkodrës, e cila është dhe 100 metra mbi nivelin e detit më lart se Taxhai juaj, ju vlerësuat gjithashtu edhe disa rendimente që janë arritur në disa parcela në rrethin e Matit. Parcela të vogla ku merren 60-70 kuintalë drithë për hektar gjen kudo në vendin tonë, por puna është që ne të arrijmë të marrim të tilla rendimente në sipërfaqe sa më të gjera. Edhe me tarracimet duhet të punojmë më mirë. Në qoftë se do të na vini përsëri në vendin tonë, keni për të parë se do të kemi bërë akoma më shumë tarraca nëpër malet tona.

Gjatë këtij pesëvjeçari parashikojmë të hapim afër 100 mijë hektarë tokë të re nëpër male.

Ne po revolucionarizojmë metodën e organizimit të tregtisë nga ana e kooperativave të konsumit<sup>1</sup>. Për ne ka rëndësi të madhe çështja e shkëmbimeve me fshatin dhe zhvillimi i tregtisë në fshatrat malore. Atje ne duhet të bëjmë një luftë të madhe, sidomos kundër burokratizmit. Pushteti socialist në fshat duhet të japë shembullin e lartë të organizimit të tregtisë, të drejtësisë në shitje, të kulturës tregtare, të pastërtisë, sepse atje ekzistojnë mbeturina edhe më të mëdha mikroborgjeze, të cilat janë të lidhura me pronën private që ka ekzistuar në shekuj. Për këtë arsye neve na duhet t'ua futim në gjak fshatarëve tanë nevojën e organizimit, si kudo, edhe në fushën e shkëmbimit të mallrave. Për këtë qëllim detyra jonë është që punonjësit e tregtisë t'i vëmë nën kontrollin e fortë të masave. Po i futëm në këtë kontroll, atëherë në tregtinë tonë do të ketë shpejtësi, ndershmëri, nuk do të ketë vjedhje e prishje, do të ketë pastërti e rregull, se masat nuk të lënë, kur gabon sadopak, ato të kapin për veshi.

Ju i vlerësuat lart realizimet tona dhe sukseset e arritura nga ne në ndërtimin e socializmit. Për fjalët e mira dhe të singërta që shprehët për vendin tonë ju falënderoj nga zemra. Ato ne na inkurajojnë në përpjekjet dhe në luftën tonë për ndërtimin e socializmit,

---

1 Shoku Enver Hoxha flet edhe për tregtinë në fshat, duke marrë parasysh se në delegacionin kinez kishte edhe një punonjëse të tregtisë, e cila shprehu kënaqësinë e saj që pa në fshatin shqiptar një tregti të kulturuar.

si dhe për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dhe të unitetit midis dy vendeve dhe dy partive tona.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

## SHKËMBIMI I MENDIMEVE ËSHTË NË INTERES TË FORCIMIT TË UNITETIT INTERNACIONALIST

*Nga biseda me delegacionin e PK të Kinës  
që kishte ardhur për të marrë pjesë  
në Kongresin e 5-të të PPSH<sup>1</sup>*

28 tetor 1966

*Delegacioni i Partisë Komuniste të Kinës u prit nga Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH. Pas përshëndetjeve, e mori fjalën*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Duke ju shprehur mirëseardhjen, dëshiroj, në të njëjtën kohë, t'ju shpreh ndjenjat e gëzimit të madh e të dashurisë revolucionare të Partisë e të popullit tonë për këtë nder që na bëtë, duke ardhur për të marrë pjesë në Kongresin e 5-të të Partisë. Ardhja e delegacionit tuaj në Shqipëri është një ndodhi e rëndësishme për ne.

Siç e dini, pas pak ditësh, Partia dhe populli ynë do

---

<sup>1</sup> Delegacionin e kryesonte anëtari i Komitetit të Përhershëm të Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të Komitetit Qendror të PKK, Kan Shen. Vdiq më 16 dhjetor 1975.

të jetojnë ditë historike, sepse Kongresi i 5-të i Partisë sonë do të jetë një ngjarje nga më të rëndësishmet e historisë së popullit shqiptar. Ky Kongres jo vetëm do të bëjë bilancin e veprimtarisë së Partisë, por edhe do të përcaktojë detyra të reja për ta çuar më tej me sukses ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Uniteti i vërtetë në mes partive marksiste-leniniste shprehet në unitetin e mendimeve dhe të veprimeve, në respektin reciprok marksist-leninist, në ruajtjen dhe në zhvillimin revolucionar të parimeve internacionaliste që rregullojnë marrëdhëniet në mes partive, në shkëmbimin e gjerë, të hapët, të sigurtë të eksperiencës midis tyre dhe në ndihmën reciproke që karakterizohet nga dashamirësia dhe qëllimet e pastra komuniste. Në këtë rrugë ka ecur e do të ecë Partia jonë për të forcuar vazhdimisht unitetin edhe në mes dy partive dhe dy popujve tanë, për të qenë kurdoherë shembull i qartë për unitetin marksist-leninist që duhet të ekzistojë e të kalitet çdo ditë në mes partive marksiste-leniniste.

Për ju, shokë kinezë, realiteti i vendit tonë është i njohur, pavarësisht se shoku Kan Shen dhe disa shokë të tjerë të delegacionit vijnë për herë të parë në Shqipëri. Ne shpresojmë se raportet dhe diskutimet që do të dëgjoni në Kongres do t'ju plotësojnë më tepër këto njohuri për të parë më thellë e më gjerë si mendojnë, si punojnë, si luftojnë dhe ç'rezultate kanë Partia dhe populli ynë dhe ç'perspektiva të reja i hapen vendit tonë. Puna e Partisë dhe e popullit ka dhënë rezultate të ndjeshme e të dukshme, që e kanë forcuar atdheun, ekonominë tonë, kanë forcuar socializmin te ne, kanë revolucionarizuar njerëzit, kanë zgjeruar e thelluar më

tej arsimin dhe kulturën revolucionare, kanë krijuar një entuziazëm të madh. Të gjitha këto janë arritur me një luftë të madhe e me përpjekje, por ne jemi të ndërgjegjshëm se mund dhe duhej të bënim më shumë.

Baza e sukseseve tona në çdo lëmë është vija e drejtë e Partisë. Por gjatë punës për zbatimin në jetë të kësaj vije, komunistët e punonjësit tanë nuk kanë qenë pa të meta e gabime, të cilat Partia na ka mësuar t'i njohim dhe të përpiqemi t'i korrigjojmë e t'i ndreqim. Siç do ta konstatojmë edhe vetë, në Kongres këto ne nuk do t'i fshehim dhe as do t'i zvogëlojmë, sepse një parti është serioze kur njeh, kritikon dhe korrigjon të metat e gabimet që vërtetohen në punën e përditshme të saj.

Mendoj se nuk është nevoja t'ju bëj një ekspozitë të gjatë për gjendjen në vendin tonë, sepse gjatë Kongresit dhe pas tij ju do të jeni plotësisht në dijeni për çdo gjë të ne. Atëherë ne mund të shkëmbejmë mendime gjerësisht me ju për një numër problemesh dhe ndihma juaj në këtë drejtim do të jetë shumë e çmueshme për punën tonë. Me këtë rast po ju them me pak fjalë se gjendja e ne paraqitet shumë e mirë; ekziston një frymë e lartë revolucionare në Parti dhe në popull. Parti e popull janë lidhur ngushtë si mishi me thoin dhe në radhët e Partisë ekziston një unitet i fortë marksist-leninist.

E mirë është edhe gjendja ekonomike e ne. Industria i ka realizuar planet me sukses, por edhe për bujqësinë sivjet ka qenë një vit i mbarë. Kjo ka ngjallur një entuziazëm të madh dhe realizimi i detyrave të vitit të parë të planit pesëvjeçar që do të vendosim në

Kongres është një inkurajim i madh për vitet e ardhshme.

Me rastin e Kongresit tonë, ne kemi ftuar delegacione nga të gjitha partitë komuniste marksiste-leniniste, të vjetra dhe të reja, që qëndrojnë në pozita të drejta marksiste-leniniste, kemi ftuar, gjithashtu, përfaqësues nga lëvizjet dhe nga grupet revolucionare marksiste-leniniste. Disa nga këta të fundit i kemi thirrur si dëgjues. Disa partive u kemi bërë ftesa, duke u thënë që, në rast se nuk do të kenë mundësi të na dërgojnë delegacione, le të na dërgojnë përshëndetje.

Ardhjen e këtyre delegacioneve në Kongresin e 5-të të Partisë sonë ne e çojmë si një ndihmë të madhe që i jepet Partisë sonë. Gjithashtu ne mendojmë se kjo do t'i shërbejë edhe forcimit të unitetit ndërkombëtar të marksistë-leninistëve, të partive e të grupeve të tyre, në luftën tonë të madhe kundër imperialistëve dhe tradhtarëve, renegatëve revizionistë modernë.

Sigurisht, shumë shokë mund të kërkojnë edhe takime për bisedime dypalëshe ose tripalëshe, me qëllim që të shkëmbehen mendime dhe eksperiencë. Kjo, mendojmë ne, do të jetë shumë e frytshme për lëvizjen tonë, e cila do të bëjë hapa të mëtejshëm përpara.

Mundet që shumë shokë do të kërkojnë të takohen dhe të bisedojnë edhe me ju, delegacionin e Partisë Komuniste të Kinës. Këto takime dhe bisedime eventuale tuajat me ta ne i konsiderojmë të një rëndësie të madhe për lëvizjen revolucionare. Ne, nga ana jonë, do të vëmë në dispozicionin tuaj çdo gjë, çdo lehtësi që të kërkon, në mënyrë që këto kontakte dhe bisedime me ta të kenë



sukses të plotë. Shokët e partive motra dhe të grupeve marksiste-leniniste, sigurisht do të shprehin mendimet e propozimet e tyre për problemet e përbashkëta të lëvizjes.

Ne do të jemi thellësisht të prekur nga besimi që ata do të tregojnë ndaj Partisë sonë, do t'u kushtojmë gjithë vëmendjen mendimeve e propozimeve të tyre dhe do të bëjmë ç'është e mundur për t'i ndihmuar ata me forcat tona modeste.

Por ne e ndiejmë si detyrë internacionaliste dhe në interes të forcimit të unitetit marksist-leninist që me ju të kemi shumë herë shkëmbim mendimesh në lidhje me problemet që ngrenë shokët e partive motra. Besojmë se ju nuk do të keni kundërshtim për këtë gjë. Mendojmë që partive tona u takon të hedhin hapat e parë për konkretizimin e lidhjeve më të ngushta, më efikase me gjithë lëvizjen marksiste-leniniste botërore, që të kalitet më tej uniteti ynë marksist-leninist dhe të forcohet më shumë lufta kundër imperializmit dhe revizionizmit modern.

Ne mendojmë, veçanërisht, se ka ardhur koha që në mes partive tona marksiste-leniniste të zhvillojmë kontakte të ndryshme pune nga më të përshtatshmet dhe frytdhënëset. Këtë problem të rëndësishëm ne nuk e shtrojmë për ta zgjidhur tani, me rastin e Kongresit të Partisë sonë. Jo. Këtë problem ne ua kemi shtruar edhe delegacioneve të tjera.

Ky problem na duket me rëndësi dhe i nevojshëm të diskutohet dhe të konkretizohet, sepse revizionistët modernë dhe padronët e tyre imperialistë kanë vënë të gjitha forcat demagogjike, ekonomike, presionet,

shantazhet që të godasin fort çdo forcim të unitetit tonë marksist-leninist internacionalist, të godasin lëvizjen nga brenda me diversion ideologjik dhe nga jashtë me izolim.

Revizionistët modernë bëjnë çdo përpjekje, çdo orvatje që të depërtojnë edhe në partitë tona, që kanë një përvojë revolucionare. Merrret me mend se ç'mund të bëjnë dhe ç'do të bëjnë ata me partitë e reja marksiste-leniniste dhe me grupet revolucionare. Ne e kemi për detyrë të madhe t'i ndihmojmë shokët tanë të këtyre partive, me të gjitha forcat dhe mjetet, me qëllim që të konsolidojnë pozitat e tyre marksiste-leniniste dhe luftën kundër armiqtve imperialistë e revizionistë<sup>1</sup>.

Me disa vende socialiste ne i ruajmë marrëdhëniet, nuk kemi dalë me polemikë të hapët me to, me qëndrimet dhe me pikëpamjet e tyre. Siç e dini, me shumë pikëpamje të tyre revizioniste ne jo vetëm që nuk jemi dakord, por jemi në luftë dhe, në raportin e Kongresit, siç do ta shihni, këto pikëpamje të tyre, pa zënë në gojë emër partie ose personi, ne i shtrojmë nga ana parimore.

Kështu, për shembull, bëjmë me Rumaninë, Par-

---

<sup>1</sup> Duke shtruar çështjen e ndihmës që u duhet dhënë partive e grupeve marksiste-leniniste, shoku Enver Hoxha synonte t'i nxiste shokët kinezë që të aktivizoheshin e t'i mbështetnin ato për të forcuar pozitat e tyre revolucionare, në luftë kundër imperializmit e revizionizmit. Problemi shtrohej me tendencë, sepse udhëheqja kineze nuk u jepte ndihmën e duhur partive e grupeve marksiste-leniniste.

tia Komuniste e së cilës na ka pasë sulmuar hapur. Pikëpamjet tona për këtë parti, ju i dini, sepse disa herë kemi biseduar me shokë të partisë suaj dhe kemi shprehur mendimin tonë mbi qëndrimet antimarksiste dhe demagogjinë e Partisë Komuniste të Rumanisë, së cilës, gjithashtu, ia kemi thënë haptazi mendimet tona.

Ne kemi ftuar në Kongresin e Partisë sonë delegacione edhe nga PK e Japonisë dhe nga Partia e Punës e Koresë.

Me Partinë Komuniste të Japonisë kemi pasur kontakt me një delegacion partie që kishte ardhur te ne për pushime. Ne organizuam një takim dhe shkëmbyem mendime me shokët japonezë. Pikëpamjet tona ua shfaqëm haptazi në këtë takim. Ata ishin ca të rezervuar, por aprovuan plotësisht pikëpamjet e Partisë sonë. Pas këtij takimi, shohim, por akoma jo shumë qartë, se vija e Partisë Komuniste të Japonisë ka pësuar ndryshime nga e djathta. Për ç'arsye?! Ne do të dëshironim, po të kishte mundësi, të na thoshit ndonjë gjë nga qëndrimet politiko-ideologjike të Partisë Komuniste të Japonisë.

Për sa i përket Partisë së Punës të Koresë, me të ne s'kemi pasur pothuaj fare kontakte partie. Nuk kemi qenë dakord me qëndrimin ekuivok të saj ndaj Hrushovit dhe revizionizmit hrushovian dhe dyshimet tona nuk kanë qenë pa baza. Qëndrimet e fundit të shokëve koreanë na vërtetojnë se ata në shumë çështje janë në kontradikta parimore me ne dhe këtë ua kemi thënë. Ata kanë adoptuar një vijë oportuniste ekuivoke, centriste. Por ne, gjithashtu, do të dëshi-

ronim, që edhe për Partinë e Punës të Koresë, në qoftë se do të kishte mundësi, të sqaroheshim se për çfarë arsye objektive dhe subjektive shokët koreanë rrëshqitën në këto pozita.

Shokë, ju kërkoj ndjesë dhe këtë takim të mos e konsiderojmë një takim pune, por si një takim me karakter informativ nga ana jonë, në lidhje me mbajtjen e Kongresit tonë të 5-të. Ne do të kemi takime e mbledhje të tjera së bashku, ku, si shokë, do të shkëmbejmë mendime dhe do të përfitojmë nga eksperiencia e njëri-tjetrit.

**KAN SHENI:** Shoku Enver Hoxha, në ekspozenë që na bëri, na foli se si do të zhvillohen punimet e Kongresit të 5-të të Partisë suaj, për çka ne ju falënderojmë shumë.

Detyra e parë që i është vënë delegacionit tonë menjëherë pas ardhjes në Tiranë është për t'u bërë një vizitë shokëve të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, me shokun Enver Hoxha në krye.

Personalisht për mua është një gëzim i madh që erdha në Shqipëri. Dëshira që kam pasur tash 7 vjet përpara, sot u realizua. Qysh në Mbledhjen e 81 partive në Moskë dhe në komisionin e redaktimit, që kemi luftuar së bashku me shokët Hysni Kapo dhe Ramiz Alia, shokët shqiptarë më patën ftuar mua të vija në Shqipëri dhe unë isha dakord, po edhe sikur të mos më kishin ftuar, unë do të vija këtu. Duke ushqyer vazhdimisht këtë dëshirë të madhe ju mund ta merrni me mend ç'ndjenja të zjarrita dhe ç'gëzim

të madh ndiem ne kur na u tha se do të vijmë në Shqipëri për të marrë pjesë në punimet e Kongresit tuaj, për arsye se kjo është një detyrë e lavdishme. Pjesëmarrja në punimet e Kongresit të 5-të të Partisë së lavdishme marksiste-leniniste të Punës të Shqipërisë për mua është një ngjarje e paharruar gjatë gjithë jetës.

Ne vëmë re se vitet qysh nga Kongresi i 4-t i Partisë suaj e gjer tani mund të themi se kanë qenë një periudhë përpjekjesh e lufte për kompaktësinë, gjatë së cilës Partia dhe populli juaj kanë arritur suksese të mëdha. Kohët e fundit sidomos Partia juaj, nën udhëheqjen e shokut Enver Hoxha, ka marrë një sërë masash të rëndësishme në fushën politike, ideologjike, ushtarake dhe në drejtim të Partisë, të cilat kanë një rëndësi të madhe jo vetëm për revolucionin dhe ndërtimin e socializmit në vendin tuaj, por ato janë njëkohësisht edhe një kontribut për gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare, duke përfshirë në këtë edhe Partinë Komuniste të Kinës. Tani, mbasi kanë kaluar këta pesë vjet lufte dhe përpjekjeje, Kongresi juaj do të bëjë bilancin e eksperiencës së fituar, si dhe do të shqyrtojë planin madhështor të pesëvjeçarit të katërt, i cili ka një rëndësi të madhe historike.

Ne nuk e kemi lexuar akoma raportin politik që do të mbajë në Kongres shoku Enver Hoxha, por kemi lexuar projektin e planit tuaj të katërt pesëvjeçar. Projekti i planit na është përkthyer në gjuhën kineze dhe mendojmë se ai është një plan madhësh-

tor që përputhet me realitetin e vendit tuaj dhe është i mundshëm të realizohet.

Ne së bashku jemi të lidhur ngushtë në miqësi në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit. Uniteti midis dy partive tona për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit ka një rëndësi të madhe dhe u shërben zhvillimit e forcimit të mëtejshëm të lëvizjes punëtore e komuniste në rrugën marksiste-leniniste.

Në luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, për fitoren e revolucionit, për ndërtimin e socializmit dhe për forcimin e Partisë suaj, edhe Partia juaj me ju në krye, shoku Enver Hoxha, së bashku me gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare, ka dhënë një kontribut të madh, ka ndihmuar për zhvillimin e marksizëm-leninizmit. Gjatë luftës kundër revizionizmit modern, jo vetëm partia jonë dhe shoku Mao Ce Dun kanë kontribuar në zhvillimin e marksizëm-leninizmit, po kanë kontribuar edhe Partia e Punës e Shqipërisë dhe shoku Enver Hoxha, po për këtë ju nuk flisni fare në fjalimet tuaja, shoku Enver, dhe neve na duhet të mësojmë në këtë drejtim nga modestia e shokut Enver Hoxha.

Ne, duke ardhur në Shqipëri, jo vetëm dëshirojmë t'ju urojmë ju në Kongresin tuaj, por njëkohësisht edhe të mësojmë nga ju, nga Partia e Punës e Shqipërisë, dhe jeni të bindur se gjer në përfundim të punimeve të Kongresit të 5-të të Partisë suaj ne do të përfitojmë shumë gjëra. Kongresi juaj do të jetë një kontribut i madh i ri për marksizëm-leninizmin, për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Partinë Komuniste të Kinës.

Një tjetër karakteristikë e Kongresit tuaj, sikurse e thatë edhe ju, është se në të do të marrin pjesë përfaqësues të partive të vjetra dhe të reja marksiste-leniniste dhe organizata e grupe marksiste-leniniste. Por mendimin tonë duhet ta themi pa fshehur gjë: ekzistojnë mjaft probleme midis këtyre partive, organizatave e grupeve të reja marksiste-leniniste, prandaj jemi dakord që këtu, në Tiranë, të zhvillojmë bisedime dypalëshe me partitë e tjera. Ne jemi plotësisht të bindur se Partia e Punës e Shqipërisë do të na japë për këtë qëllim çdo lehtësi, do të na krijojë të gjitha kushtet për t'i zhvilluar këto takime.

Për sa u përket takimeve shumëpalëshe midis përfaqësuesve të disa partive njëkohësisht, për këtë çështje ne mund të konsultohemi bashkërisht në të ardhmen, prandaj sot nuk duam t'u humbasim më shumë kohë shokut Enver Hoxha dhe shokëve të tjerë udhëheqës të Partisë së Punës të Shqipërisë për këtë çështje.

Tani dëshiroj t'ju them edhe disa fjalë lidhur me Partinë e Punës të Koresë. Unë mendoj se udhëheqja e Partisë së Punës të Koresë ka rrëshqitur në pozitën e bandës së revizionistëve. Këtë çështje unë jua them juve se nuk e kemi diskutuar në Komitetin Qendror të Partisë sonë, kjo që thashë është mendimi im personal. Shokët Hysni Kapo dhe Ramiz Alia e dinë që unë shumë herë flas në mënyrë radikale.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Bëni shumë mirë.

*KAN SHENI:* Përse mendoj kështu unë? Sepse nga njëra anë duket që ky qëndrim i udhëheqësve koreanë është kapitullim përpara revizionistëve, nga ana tjetër,

akoma më e madhe është frika e tyre nga imperialistët amerikanë. Me qëndrimet e tyre oportuniste udhëheqësit koreanë kënaqin imperialistët dhe revizionistët. Është edhe gjendja e brendshme jo e mirë që është krijuar në Kore. Shokun Çoj Jon Gen që ka qenë në Mbledhjen e Bukureshtit, e hoqën nga udhëheqja e partisë. Kjo tregon se në gjirin e udhëheqjes koreane kanë dalë probleme të mëdha të vështira. Gjer tani ata kanë folur botërisht se e kanë zgjidhur përfundimisht problemin e bujqësisë, kurse realiteti është krejt ndryshe, gjendja është shumë serioze.

Ç'rrugë do të marrë kjo parti në të ardhmen, ne nuk e dimë, po ndoshta mund të mësojë se si të veprojë nga mësuesit negativë, imperialistët amerikanë.

Edhe në Partinë Komuniste të Japonisë gjendja është keqësuar shumë. Sipas pikëpamjes sime, kjo parti po ndjek rrugën e parlamentarizmit. Tani udhëheqja e kësaj partie po bën përpjekje për të fituar vota për në parlament. Në Partinë Komuniste të Japonisë kanë filluar të pranojnë me shumicë anëtarë të rinj. Kjo parti gjer vjet kishte jo më shumë se 150 000 anëtarë, kurse tani numri i tyre ka arritur rreth 300 000, vetëm brenda një viti.

Nga ana tjetër, udhëheqësit e Partisë Komuniste të Japonisë kanë pikëpamje të gabuara lidhur me ngjarjet e 30 shtatorit në Indonezi. Sipas pikëpamjes sonë, këto ngjarje në Indonezi kanë ndodhur për arsye të pikëpamjeve të gabuara të kalimit paqësor në socializëm. Sipas pikëpamjes së udhëheqjes së Partisë Komuniste të Japonisë lufta e armatosur nuk ka asnjë rrugëdalje. Kjo pikëpamje e udhëheqjes së Partisë Ko-



muniste të Japonisë është krejtësisht revizioniste. Ky nuk është një fenomen i çuditshëm. Me zhvillimin e marksizëm-leninizmit dhe me luftën që bëhet për mbrojtjen e tij, bëhet edhe diferencimi i njerëzve, i grupeve e i partive. Shokët e majtë në Partinë Komuniste të Japonisë e kundërshtojnë vijën e gabuar të sekretarit të përgjithshëm të kësaj partie, Mijamotos.

Sot ne erdhëm në Komitetin tuaj Qendror vetëm për t'ju bërë një vizitë, prandaj këto që biseduam nuk i konsiderojmë si një bashkëbisedim zyrtar.

Ne jemi plotësisht të bindur dhe optimistë se nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, me shokun Enver Hoxha në krye, të orientuar nga vija e drejtë e Komitetit Qendror të Partisë suaj, Kongresi juaj i 5-të do të korrë sukses të plotë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Faleminderit. Do të shihemi e do të bisedojmë përsëri.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

**ASGJË NUK I MPOSHT POPUJT DHE  
KOMUNISTËT, KUR JANË TË VENDOSUR  
TË LUFTOJNË GJER NË FUND**

*Nga biseda me delegacionin e Frontit Kombëtar  
të Çlirimit të Vietnamit të Jugut*

**29 tetor 1966**

*Pasi u përshëndet me anëtarët e delegacionit, e  
mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Falënderojmë Frontin Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut që ju dërgoi për të marrë pjesë në punimet e Kongresit të 5-të të Partisë sonë. Ardhja juaj me këtë rast është nder dhe gëzim për popullin tonë.

Të dashur vëllezër vietnamezë, gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri, kudo që do të shkoni, do të shikoni se populli shqiptar ju do me gjithë shpirt, sepse ai dhe Partia e Punës e Shqipërisë janë të lidhur ngushtë me popullin vietnamez, i cili po lufton me heroizëm në Veri dhe në Jug të vendit. Ne luftojmë dhe jetojmë me zemër, me mendje dhe me

ndjenja bashkërisht me ju dhe e konsiderojmë luftën tuaj si një nga luftërat më legjendare që ka parë njerëzimi. Kjo është lufta e një populli heroik, që po bën sakrifica të panumërta për çlirimin e atdheut të vet, Vietnamit të Jugut, nga thundra e agresorëve barbarë imperialistë amerikanë, për bashkimin e vendit, për unitetin e popullit vietnamez. Populli heroik vietnamez lufton për të gjithë popujt e botës që janë ngritur në këmbë kundër imperializmit amerikan, si dhe imperialistëve dhe reaksionarëve kudo në botë, kundër intrigave të revizionistëve hrushovianë dhe aleatëve të tyre, prandaj populli shqiptar çdo ditë dhe çdo orë, pavarësisht se është larg jush, jeton me ju dhe gëzohet për luftën tuaj çlirimtare, për sukseset që ju arrini në këtë luftë.

Ne ia kemi bërë të njohur popullit shqiptar, luftën tuaj heroike, dhe po forcojmë vazhdimisht te të gjithë njerëzit tanë ndjenjën e solidaritetit internacionalist dhe dashurinë për popullin vietnamez. Kjo për Partinë, për Qeverinë dhe për popullin tonë është një nga detyrat më të rëndësishme, sepse lufta juaj shërben njëkohësisht edhe për mbrojtjen e gjithë popujve të botës, pra edhe për ne.

Ju po përleshni me forcat e imperializmit më barbar, të cilat, për të shfarosur popullin dhe partizanët vietnamezë, janë pajisur dhe po përdorin me shumicë armët më moderne e të çdo lloji. Përpara kësaj barbarie të madhe janë ngritur popujt dhe partizanët tuaj heroikë, të cilët jo vetëm mbajnë lart flamurin e lirisë, por i kanë shkaktuar dhe po i shkaktojnë disfatat më të mëdha dhe të turpshme ushtarake dhe politike

armikut më të madh të njerëzimit, imperializmit amerikan, këtij xhandari ndërkombëtar, si dhe aleatëve të tij, revizionistëve sovjetikë.

Lufta juaj nuk zhvillohet e veçuar nga ajo e popujve të tjerë. Edhe populli shqiptar ka luftuar e lufton me ashpërsi kundër imperialistëve e revizionistëve modernë, që bëjnë vazhdimisht plane kundër lirisë dhe pavarësisë së tij. Është fakt se këta armiq të shumtë e të egër e kanë rrethuar Shqipërinë nga të katër anët, duke formuar disa rrethime njëri pas tjetrit. Në luftën kundër këtyre armiqve e rrethimeve, populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, e ndien veten solidar dhe të lidhur ngushtë e gjer në fund me luftën tuaj. Shembulli juaj heroik na shërben jashtëzakonisht shumë për forcimin e mbrojtjes dhe të pavarësisë së vendit tonë. Ai na ka dhënë një mësim të madh dhe na ka rrënjosur bindjen se çdo orvatje për të sulmuar Republikën Popullore të Shqipërisë me siguri do të pësojë të njëjtën disfatë, siç po pësojnë imperialistët amerikanë te ju. Por shembulli juaj u ka dhënë një mësim të mirë edhe armiqve tanë. Ai i ka tmerruar imperialistët amerikanë dhe miqtë e tyre, revizionistët sovjetikë, si dhe armiqtë e tjerë që e rrethojnë nga afër vendin tonë, dhe i ka bërë ata të mendohen thellë para se të nisin një sulm eventual kundër Shqipërisë së vogël. Ata e dinë se Shqipëria është shumë më e vogël se vendi dhe populli juaj, por, duke njohur eksperiencën e luftës suaj, parashikojnë rezistencën e madhe heroike të popullit që do të përfundojë medoemos me fitoren e tij.

Nga ana tjetër, lufta që bëni ju është një ndihmë

kolosale për popujt që luftojnë për mbrojtjen e pavarësisë dhe të lirisë së tyre. Ajo u ka dhënë atyre një eksperiencë të pasur dhe ka provuar qartë se pa gjak nuk fitohet liria. Ju e thyes mitin aq shumë të përhapur në botë nga armiqtë e revolucionit, se imperializmi amerikan qenkësh i pathyeshëm. Me luftën tuaj, me gjakun që derdhni, ju po u provoni popujve dhe po rrënjosi tek ata bindjen se imperialistët amerikanë mund të thyhen edhe prej tyre, ashtu sikurse i keni thyer dhe do t'i thyeni përfundimisht ju.

Siç tregon eksperiencia e luftës së popullit vietnamez në Veri e në Jug të vendit, imperializmi thyhet duke e luftuar e duke ndjekur ndaj tij një politikë revolucionare. Ju keni mobilizuar rreth vetes të gjithë patriotët, burra e gra, pleq e të rinj, nën flamurin e luftës për liri, i keni organizuar e çelikosur ata dhe i keni hedhur në sulm për të shkatërruar imperializmin amerikan, manovrat e tij, kukullat me Kao Kinë në krye, si dhe revizionistët modernë. Duke u qëndruar atyre kurdoherë përballë, me siguri që ju do të fitoni.

Faktor tjetër është përpunimi i një strategjie e taktike të drejtë. Gjatë luftës kundër imperialistëve amerikanë që disponojnë mjete luftarake moderne, te ju po përpunohet një taktikë dhe strategji revolucionare e perfeksionuar, e plotësuar në kushte të reja, e cila po ju nxjerr vazhdimisht fitimtarë. Kjo është një eksperiencë kolosale për të gjithë ne, të cilën duhet ta përvetësojmë më së miri.

Lufta jonë e përbashkët kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tyre jo vetëm nuk ka mbaruar, por

do të jetë akoma e gjatë, prandaj jo vetëm juve, po edhe të gjithë neve, do të na duhet akoma të bëjmë sakrifica, gjë që nuk na tremb. Populli dhe Partia jonë janë të vendosur të luftojnë gjer në fund dhe të fitojnë kundër armiqve. Qëllimi ynë i përbashkët kërkon që në mes nesh të ketë një unitet të çeliktë marksist-leninist dhe një bashkëpunim e ndihmë reciproke sa më të ngushtë në çdo fushë, në politikë, në ideologji etj.

Partia dhe Qeveria jonë janë përpjekur që në fillim t'i japin gjithë ndihmën e mundshme në arenën ndërkombëtare luftës suaj heroike. Ndhimën për luftën e popullit vietnamez ne e kemi ndier kurdoherë si detyrën tonë nga më kryesoret, për të cilën nuk do të kursehemi të bëjmë sakrifica edhe më të mëdha, prandaj, në planet që do të aprovojmë, do të kemi kurdoherë parasysh që, bashkë me nevojat e popullit tonë, të figurojë edhe ndihma internacionale që ne duhet të japim për Vietnamin. Natyrisht; ndihma jonë është shumë e vogël përpara nevojave shumë të mëdha që ka lufta e popullit tuaj, por nga eksperiencia dimë, gjithashtu, se asgjë nuk e mposht vullnetin e popujve dhe të komunistëve kur ata janë të vendosur të luftojnë gjer në fund. Kështu kemi luftuar dhe kemi fituar ne 22 vjet më parë kundër barbarëve fashistë italianë, gjermanë dhe tradhtarëve të vendit. Kështu keni luftuar edhe ju kundër push-tuesve francezë dhe tani po luftoni kundër amerikanëve dhe faktet kanë treguar se, pa marrë parasysh nëse keni ose nuk keni bukë, këpucë, armë e muni-

cione të mjaftueshme, ju keni qëndruar e po qëndroni të papërkulur dhe fitoni.

Aktualisht ju bëni një luftë të armatosur jo vetëm kundër barbarëve amerikanë, por edhe kundër satelitëve të tyre, që vazhdimisht po dërgojnë në Vietnam ushtarë mercenarë, duke filluar nga Koreja e Jugut dhe gjer tek Australia. Veç kësaj, përpara syve të botës dhe në prapaskenë, po zhvillohet një lojë e madhe e poshtër politike për ta gjunjëzuar Vietnamin. Këtë lojë e udhëheqin Xhonsoni me tradhtarët revizionistë të Bashkimit Sovjetik. Për Partinë tonë është e qartë si drita e diellit tradhtia e revizionistëve sovjetikë. Kjo është një nga ngjarjet më të hidhura në historinë e komunizmit dhe të luftërave të popujve. Por kjo gjendje e vështirë do të kapërcehet me siguri nga marksizëm-leninizmi në sajë të vendosmërisë së partive marksiste-leniniste dhe të luftës së popujve. Intrigat e imperialistëve dhe të revizionistëve kanë për qëllim ta ulin Vietnamin në tryezën e bisedimeve dhe të shkelet kështu mbi gjakun e kulluar të heronjve të tij. Por mendojmë se ata nuk do t'ia arrijnë kësaj dhe besojmë se në Vietnam do të pësojnë një disfatë të turpshme ushtarake dhe politike, pasi me ju janë të gjithë popujt e të gjitha kontinentëve, ndërsa imperialistët dhe revizionistët janë vetëm disa klika.

Ne, nga eksperiencia jonë, e dimë si vepronte Stalini me popujt e vendeve socialiste. Në kohën që rronte ai edhe ne i kemi kërkuar ndihma Bashkimit Sovjetik, veçanërisht në fushën ushtarake, dhe kur e pyetëm në fillim Stalinin se si do t'i paguanim, ai na tha:

«Fabrika të makineritë e tjera do t'jua japim me kredi dhe do t'i paguani kur të keni mundësi, kurse armatimet ju jepen falas, nuk do të paguhen kurrë». Kështu e ndihmojnë vendet socialiste njëri-tjetrin, kjo është ndihmë internacionaliste. Ndërsa revizionistët hrushovianë e detyruan qeverinë e Koresë t'ia paguante edhe armët që Bashkimi Sovjetik ia kishte falur popullit korean gjatë luftës kundër amerikanëve. Ky veprim i revizionistëve sovjetikë është pasojë e drejtpërdrejtë e tradhtisë së tyre.

Ashtu si në Luftën tonë Nacionalçlirimtare gjaku që derdhnin shokët tanë kundër armiqve pushtues bëhej për ne flamur, edhe sot gjakun e derdhur nga heronjtë vietnamezë e konsiderojmë flamur. Qëndrimet tuaja heroike e të vendosura në luftë janë e do të mbeten shembull i lartë në historinë e luftërave çlirimtare të botës, do të jenë frymëzim për vazhdimin e luftës kundër imperializmit amerikan, revizionizmit modern, për fitoren e revolucionit. Ne i kuptojmë fare mirë qëndrimet dhe kushtet e vështira të luftës suaj, por ne kuptojmë, gjithashtu, edhe ndjenjat që vlojnë në zemrat dhe në mendjet e komunistëve dhe të luftëtarëve të vërtetë vietnamezë që sakrifikohen për lirinë e atdheut të tyre, për socializmin dhe komunizmin. Duke njohur vështirësitë, sakrificat dhe ndjenjat tuaja, ne shohim qartë edhe poshtërsinë që fshihet pas fjalëve, demagogjisë dhe veprimeve të revizionistëve modernë. Këta tradhtarë të marksizëm-leninizmit, që bashkëpunojnë ngushtë, haptazi e fshehurazi me vrasësit e vëllezërve heroikë të Vietnamit, e përdorin gjakun tuaj për intriga, për qëllime politike, ekono-



mike dhe ushtarake, prandaj mendojmë se qëndrimet që mban Partia jonë për demaskimin e tradhtisë revizioniste, i shërbejnë çështjes sonë të përbashkët, si dhe luftës heroike të popullit tuaj.

Ne kemi një admirim të madh për unitetin e gjithë popullit të Vietnamit, i cili, si në Jug, ashtu edhe në Veri, lufton e bën sakrifica të mëdha. Barbarët imperialistë amerikanë vazhdojnë ta bombardojnë Republikën Demokratike të Vietnamit, duke shkatërruar atje fshatra e qytete, rrugë e ura, fabrika dhe uzina, rezervuarë etj. dhe duke vrarë popullin e pafajshëm, fëmijët, gratë dhe pleqtë vietnamezë. Por me gjithë këto krime të përbindshme, ata nuk do të arrijnë kurrë ta nënshtrojnë popullin trim vietnamez, i cili është ngritur i tëri në këmbë dhe po lufton me një vendosmëri të madhe.

Dita kur do të hapet Kongresi i 5-të i Partisë sonë po afrohet. Admirimi ynë i madh për luftën tuaj do të shprehet edhe në punimet e këtij Kongresi, ku do t'i bëjmë jehonë dhe do të përkrahim edhe një herë fuqimisht luftën çlirimtare të popullit vietnamez, sepse kjo është pjesë përbërëse e luftës sonë të përbashkët. Atje ju do të keni rast të dëgjoni raportet e Komitetit Qendror dhe diskutimet e delegatëve të Kongresit dhe nëpërmjet tyre do të njiheni në hollësi me luftën tonë, me mendimet, përpjekjet dhe me të ardhmen e popullit tonë. Prandaj nuk do të zgjatëm dhe t'ju lodh, por dëshiroj vetëm t'ju them se gjendja te ne është shumë e mirë, kudo ka një hov të madh revolucionar, populli është në unitet të pathyeshëm me Partinë, radhët e së cilës janë gjithashtu në uni-

tet të çeliktë marksist-leninist. Ky ka qenë faktori vendimtar që na ka sjellë suksese në zhvillimin e të gjithë sektorëve në vendin tonë. Në rrugën tonë të zhvillimit kemi edhe vështirësi të mëdha, kemi bërë edhe gabime në punë, por, pasi i kemi zbuluar, ato na kanë shërbyer të korrigjohemi dhe të ecim përpara. Ne kemi besim të madh se Kongresi i 5-të i Partisë do t'i hapë popullit tonë perspektiva të reja për forcimin e pozitave të socializmit në Shqipëri, për ngritjen e ndërgjegjes revolucionare të të gjithë njerëzve dhe do të na shtojë forcat për të kapërcyer vështirësitë e reja e për të korrur fitore të reja.

Për realizimin e detyrave në të ardhmen Partisë dhe popullit tonë do t'u duhet të bëjnë një punë të madhe dhe plot sakrifica, të jenë shumë vigjilentë kundrejt armiqve të jashtëm e të brendshëm dhe të punojnë për të forcuar unitetin e madh ndërkombëtar në mes gjithë marksistë-leninistëve. Në punën ndërtime të Partisë dhe të popullit tonë ndihma internacionaliste e partive marksiste-leniniste dhe e grupeve të reja revolucionare ka qenë dhe është e madhe.

Sikurse do ta shihni edhe vetë, ne nuk kemi ftuar në Kongres delegacione nga partitë revizioniste, sepse Partia jonë i ka prerë të gjitha urat me ta, për arsye se kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin dhe janë armiq të betuar të popujve e të partive marksiste-leniniste. Por ne i mirëpresim delegacionet nga partitë që qëndrojnë në pozita të drejta, si dhe partitë e grupet e reja marksiste-leniniste revolucionare, sepse kjo është një ndihmë e madhe për ne dhe për lëvizjen komuniste ndërkombëtare e i shërben unitetit tonë.

Fakt është se revizionistët modernë me tradhtinë e tyre e përçanë lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Por logjika marksiste-leniniste dhe eksperiencia e revolucionit na mësojnë se pas një përçarjeje të tillë, do të vijë medoemos uniteti i shëndoshë marksist-leninist i një niveli më të lartë. Përçarje kanë ngjarë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare disa herë dhe jeta ka treguar se pas tyre është arritur në një unitet të ri. Kështu do të ndodhë edhe në të ardhmen, do të arrihet një unitet më i madh, por vetëm mbi bazat dhe nën flamurin e marksizëm-leninizmit. Ne kemi besim se edhe partia juaj dhe Fronti Kombëtar i Çlirimit të Vietnamit të Jugut, që udhëheqin një luftë të drejtë e heroike, do të japin kontributin e tyre për forcimin e këtij uniteti.

*Duke marrë fjalën, kryetari i delegacionit vietnamez falënderoi dhe përshëndeti në emër të Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut. Ai vlerësoi lart shembullin e rrallë që ka dhënë e jep populli shqiptar nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, si në luftën kundër fashistëve italianë e gjermanë, ashtu edhe në ndërtimin e socializmit, dhe pastaj foli për gjendjen e vështirësitë e luftës, duke shprehur vendosmërinë e patundur të popullit të Vietnamit të Jugut për ta çuar gjer në fund luftën për çlirimin e atdheut. Duke përfunduar, ai tha:*

Me këtë rast na lejoni t'ju dorëzojmë nga ana e presidentit të Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut, shokut Ngujen Huu Tho, si shenjë miqësie dhe admirimi të madh që kanë udhëheqësit tanë për udhëheqësit shqiptarë, dy dhurata të vogla: por-

tretin në një vazo të heroit tonë kombëtar të pushkatar nga imperialistët amerikanë dhe kukullat e tyre vietnamezojugore, Ngujen Van Troi, për shokun Enver Hoxha, si dhe disa mjete të luftës popullore për shokun Mehmet Shehu.

*Pasi i mori dhuratat, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Ju falemnderit shumë. Heroi Ngujen Van Troi është i njohur, si në të gjithë botën, ashtu edhe në vendin tonë, për qëndrimin e tij burrëror në luftën kundër pushtuesve amerikanë dhe tradhtarëve të vendit të vet. Po kështu, me rëndësi është edhe propozimi i Komitetit Qendror të Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut për të vendosur në Shqipëri një mision të përhershëm<sup>1</sup>. Këto do t'i shërbejnë forcimit të miqësisë midis popujve tanë.

Le ta pimë këtë doli për heronjtë e guximshëm që luftojnë për çlirimin e Vietnamit, për popullin heroik luftëtar vietnamez, për fitoren tuaj të shpejtë, për çlirimin, lulëzimin dhe bashkimin e gjithë Vietnamit, për miqësinë tonë.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

---

<sup>1</sup> Njoftimi për këtë mision u botua në gazetën «Zëri i popullit» më 3 nëntor 1966. Misioni u largua nga Shqipëria për në Vietnamin e Jugut më 30 prill 1975.

## NUK KA FORCË QË TË PENGOJË BASHKIMIN DHE LUFTËN E MARKSISTË-LENINISTËVE

*Përshëndetja në takimin me delegacionet e partive  
marksiste-leniniste dhe të grupeve revolucionare  
të ftuara për të marrë pjesë në Kongresin  
e 5-të të PPSH<sup>1</sup>*

31 tetor 1966

Të dashur shokë,

Partia dhe populli ynë janë jashtëzakonisht të lumtur dhe të gëzuar që sot, në këto ditë feste, në prag të Kongresit të 5-të të Partisë dhe të 25-vjetorit të themelimit të saj, ju kanë midis tyre ju, shokë dhe miq të dashur, përfaqësues të partive komuniste dhe punëtoresh motra marksiste-leniniste dhe të grupeve revolucionare. Ky është një nder i madh për Partinë dhe për popullin tonë, sepse prania dhe mbështetja vëllazërore, internacionaliste e partive komuniste

---

<sup>1</sup> Në këtë takim, i cili u zhvillua në sallën e pritjes të KQ të PPSH, ndodheshin të gjithë anëtarët dhe kandidatët e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH.

dhe punëtores përbën një forcë kolosale për Partinë dhe vendin tonë.

Ne ju falënderojmë nga zemra ju dhe, nëpërmjet jush, partitë e grupet tuaja dhe komunistët që bëjnë pjesë në to. Me këtë rast ju lutemi t'u transmetoni atyre nga ana e Partisë dhe e popullit shqiptar përsëritet më të nxehta revolucionare dhe i siguroni se Partia e Punës e Shqipërisë do të qëndrojë kurdoherë e vendosur gjer në fund në rrugën marksiste-leniniste për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit; për ndërtimin e plotë të socializmit në vendin e vet; për të dhënë kontributin e saj modest në luftën që bëjnë popujt për çlirimin e tyre nga kolonializmi e neokolonializmi, nga imperializmi botëror, me atë amerikan në krye, dhe kundër revizionizmit modern, me grupin tradhtar të Moskës në krye; për ta çuar edhe më përpara unitetin marksist-leninist me të gjitha partitë dhe grupet revolucionare marksiste-leniniste dhe me të gjitha forcat përparimtare të botës.

Të dashur shokë dhe miq, sot nuk dua t'ju lodh duke ju folur sadopak për gjendjen në vendin tonë, pse, duke filluar qysh nesër dhe gjatë gjithë ditëve që do të zhvillohen punimet e Kongresit, ju do të keni rast të dëgjoni raportet e Komitetit Qendror dhe diskutimet e delegatëve, do të mësoni me hollësi si ka luftuar dhe si lufton Partia jonë, vështirësitë që ka hasur ajo në rrugën e saj, sukseset e të metat, do të mësoni si mendon Partia jonë dhe ç'perspektiva hap ajo për vendin tonë.

Populli i vogël shqiptar ka marrë krahë këto ditë, pse ardhja juaj për të marrë pjesë në punimet e Kon-

gresit të 5-të është një ndihmë dhe një mbështetje e madhe për Partinë dhe popullin tonë. Ne e çmojmë jashtëzakonisht këtë nder të madh që po na bëni. Për shumë nga ju, të dashur shokë, ka qenë e lehtë të vini në Shqipëri, kurse për shumë të tjerë ka qenë e vështirë, disa shokëve bile u është dashur të kapërcejnë vështirësi dhe pengesa të rrezikshme, prandaj e çmojmë kaq shumë ardhjen tuaj. Nuk ka forcë në botë që të pengojë bashkimin dhe luftën e marksistë-leninistëve të të gjitha vendeve për socializëm, për komunizëm dhe për paqen e vërtetë në të gjithë botën.

Rroftë marksizëm-leninizmi dhe internacionalizmi proletar!

Rrofshin partitë motra komuniste marksiste-leniniste dhe grupet revolucionare që na nderuan me ardhjen e tyre në Shqipëri!

Më lejoni ta ngre këtë doli për unitetin tonë të çeliktë marksist-leninist, për partitë marksiste-leniniste dhe grupet revolucionare marksiste-leniniste, për udhëheqjet e partive dhe të grupeve tuaja, për shëndetin tuaj, të dashur shokë të delegacioneve!

Ju faleminderit.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 33-TË ..... V—VIII

1966

ORIENTIMI I PARTISË ËSHTË QË FSHATARËSIA TË LEHTËSOHET GJITHNJË E MË SHUMË NGA DETYRIMET — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (4 qershor 1966) .....	1—8
NE KURRË NUK LEJOJMË TË MERREN NËPËR KËMBË LIRIA DHE PAVARËSIA E ATDHEUT, NDERI DHE DINJITETI I POPULLIT — Nga biseda në takim me ambasadorin e jashtzakonshëm dhe fuqiptotë të Republikës Algjeriane Demokratike dhe Popullore (13 qershor 1966) .....	9—17
SOCIALIZMI KËRKON NJERËZ TË ZHDËRVJELLET, TË FORTË FIZIKISHT DHE TË PASTËR MORALISHT — Nga biseda me delegacionin e kooperativave të konsumit dhe me atë të atletëve kinezë (14 qershor 1966) .....	18—23
VETËM MBI BAZËN E MARKSIZËM-LENINIZMIT ZHVILLOHET E THELLOHET REVOLUCIONI SOCIALIST NË TË GJITHA FUSHAT — Nga biseda me delegacionin e punonjësve kinezë të bujqësisë (14 qershor 1966) .....	24—34
NJERËZIT KALITEN DUKE PUNUAR — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (16 qershor 1966) .....	35—50
LUFTA E ARMATOSUR — E VETMJA RRUGË E POPULLIT QË DËSHIRON LIRINË DHE PAVARËSINË E TIJ — Nga biseda me ambasadorin e Republikës Demokratike të Vietnamit (18 qershor 1966) .....	51—62



KUNDËRREVOLUCIONI DO TË SHKATËRROHET VETËM ME REVOLUCION DHE JO DUKE BËRË KOMPROMISE ME IMPERIALISTËT APO ME REVIZIONISTËT — Nga biseda me një delegacion të Partisë Komuniste të Cejlonit (20 qershor 1966) .....	63—70
ÇDO SHMANGIE NGA PARIMET E MARKSIZËM-LENINIZMIT ËSHTË ME PASOJA TË RËNDA — Nga biseda me ambasadorin e RDP të Koresë (20 qershor 1966) .....	71—76
KINEZËT U TËRHOQËN SE SHOKËT TANË NUK LËSHUAN — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (22 qershor 1966) .....	77—84
PARTIA JONË DO TË VAZHDOJË SI KURDOHERË ME KONSEKUENCË, ME TRIMËRI E ME PJEKURI LUFTËN E KLASAVE — Nga biseda me Çu En Lain (24 qershor 1966) .....	85—134
NË LIDHJET ME MASAT QËNDRON FORCA E PARTISË DHE E PUSHTETIT POPULLOR — Fjala në takimin me zgjedhësit e zonës elektorale Nr. 200 të kryeqytetit (8 korrik 1966) .....	135—175
USHTRIA TË NE ËSHTË E LIDHUR NGUSHTË ME PARTINË E ME POPULLIN DHE MËSON VAZHDMISHT PREJ TYRE — Nga biseda me delegacionin e ushtarakëve kinezë (11 korrik 1966) .....	176—181
MARKSIZËM-LENINIZMI QË NA FRYMËZON ËSHTË GARANCI E FITORES SONË — Nga biseda me delegacionin e punonjësve të naftës të RP të Kinës (11 korrik 1966) .....	182—189
DISA PROBLEME PËR REVOLUCIONARIZIMIN E ORGANIZATAVE TË PARTISË — Fjala në Plenumin e 17-të të KQ të PPSH (13 korrik 1966) .....	190—214
SISTEMIN ARSIMOR TA PËRMIRËSOJMË DUKE U BAZUAR NË KRITERE SHKENCORE — Diskutim	

në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (14 korrik 1966) .....	215—229
<b>NË KËSHILLIN POPULLOR TË ZGJIDHEN NJE- RËZIT MË TË MIRË</b> — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (15 korrik 1966) .....	230—232
<b>ANALIZA E THELLË E SHKAQEVË TË GABIMIT EDUKON EDHE KOMUNISTËT E TJERË</b> — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (15 korrik 1966) .....	233—236
<b>KARAKTERISTIKA E STUDENTIT TË SHKOLLËS SË PARTISË ËSHTË VLERËSIM I PUNËS DHE I QËNDRIMIT TË TIJ</b> — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (15 korrik 1966) .....	237—240
<b>DËSHIRAT E STUDIUESVË DHE TË SHKENCËTA- RËVË TANË U REALIZUAN VETËM NË PUSHTE- TIN POPULLOR</b> — Letër drejtuar profesor Spiro N. Kondas (19 korrik 1966) .....	241—242
<b>JUGOSLLAVIA TITISTE NË RRUGËKRYQ</b> — Arti- kull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (2 gusht 1966)	243—253
<b>KUSH PËRGJIGJET PËR KRIMET E GJENOCIDIT NË KOSOVË?</b> — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (31 gusht 1966) .....	254—273
<b>UNITETI I VËRTETË REVOLUCIONAR ARRIHET VETËM NË RRUGËN LENINISTE</b> — Nga biseda me ambasadorin e Republikës Socialiste të Rumanisë (2 shtator 1966) .....	274—290
<b>VEPRIMTARIA E GJYKATAVE TONA VARET NGA PARTIA DHE POPULLI</b> — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (6 shtator 1966) .....	291—303
<b>ZBATIMI NË JETË I MARKSIZËM-LENINIZMIT KËRKON PJEKURI TË MADHE, GUXIM DHE SA- KRIFICA</b> — Nga biseda me ambasadorin e RDP të Koresë (7 shtator 1966) .....	304—312

- DETYRA JONË SI PËRFAQËSUES TË POPULLIT ËSHTË TË JUSTIFIKOJMË ME PUNË BESIMIN E TIJ — Fjala në sesionin e parë të legjislaturës së 6-të të Kuvendit Popullor (10 shtator 1966) ..... 313—314
- AKSIONET TË SHËRBEJNË PËR KALITJEN REVOLUCIONARE TË RINISË — Bisedë në takim in me disa nxënës e studentë pjesëmarrës në aksionet ve-rore të rinisë (20 shtator 1966) ..... 315—335
- KOOPERATIVA BUJQËSORE DO TA PËRMIRËSO-JË JETËN E TË GJITHË FSHATARËVE — Bisedë me dy fshatarë nga Shmili i rrethit të Elbasanit (20 shtator 1966) ..... 336—349
- PAS NDARJES ME REVIZIONISTËT NEVOJITET UNITETI I FORCAVE MARKSISTE-LENINISTE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (10 tetor 1966) ..... 350—366
- PARTIA DHE POPULLI YNË KANË RESPEKT TË MADH PËR POPULLIN VIETNAMEZ — Nga biseda me delegacionin qeveritar të RD të Vietnamit (13 tetor 1966) ..... 367—377
- DISA MENDIME PARAPRAKE PËR REVOLUCIO-NIN KULTUROR PROLETAR KINEZ — Fjala në Plenumin e 18-të të KQ të PPSH (14 tetor 1966) ..... 378—400
- SPASTRIMI I NDËRGJEGJES SË NJERËZVE NUK BËHET AS NË NJË VIT E AS NË DHJETË VJET — Nga biseda me delegacionin e Shoqatës së Miqësisë Kinë-Shqipëri (17 tetor 1966) ..... 401—408
- SHKËMBIMI I MENDIMEVE ËSHTË NË INTERES TË FORCIMIT TË UNITETIT INTERNACIONALIST — Nga biseda me delegacionin e PK të Kinës që kish-te ardhur për të marrë pjesë në Kongresin e 5-të të PPSH (28 tetor 1966) ..... 409—421

- ASGJË NUK I MPOSHT POPUJT DHE KOMUNISTËT, KUR JANË TË VENDOSUR TË LUFTOJNË GJER NË FUND — Nga biseda me delegacionin e Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut (29 tetor 1966) ..... 422—432
- NUK KA FORCË QË TË PENGOJË BASHKIMIN DHE LUFTËN E MARKSISTË-LENINISTËVE — Përshëndetja në takim me delegacionet e partive marksiste-leniniste dhe të grupeve revolucionare të ftuara për të marrë pjesë në Kongresin e 5-të të PPSH (31 tetor 1966) ..... 433—435